



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, M ëshiruesit!

RIZGJIMI ISLAM NDËRMJET KUNDERSHTIMIT DHE EKSTREMIZMIT

Dr. Jusuf Kardavi

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

DY FJALË PËR AUTORIN	5
PARATHËNIE.....	6
KAPITULLI I PARË.....	14
EKSTREMIZMI: AKUZA DHE E VËRTETA	14
1. TË METAT E EKSTREMIZMIT FETAR.....	20
2. KONCEPTI I EKSTREMIZMIT FETAR.....	25
3. SHFAQJET E EKSTREMIZMIT	32
4. RËNIA NË HUMNERËN E TEKFIROT.....	49
KAPITULLI I DYTË.....	54
SHKAQET E EKSTREMIZMIT	54
1. MARRJA ME ÇËSHTJET E DORËS SË DYTË.....	65
2. ZGJERIMI TEJMASE I NDALIMEVE.....	68
3. IDETË E GABUARA.....	72
4. THEKSIMI I TEKSTEVE ALEGORIKE (MUTESHABIH)	82
5. NEVOJA PËR TA NJOHUR DHE RESPEKTUAR SPECIALIZIMIN.....	88
6. MUNGESA E AFTËSISË PËR TË DEPËRTUAR NË BRENDINË E HISTORISË, REALITETIT DHE LIGJEVE TË ALL-LLAHUT	97
7. DY SUNENE TË RËNDËSISHME.....	104
8. ISLAMI: NJË I HUAJ NË ATDHEUN E TIJ	108
9. PENGESAT E VENDOSURA NDAJ DA'VES DHE THIRRËSVE NË ISLAM	118

KAPITULLI I TRETË	126
DREJT NJË ILACI PËR EKSTREMIZMIN	126
1. DETYRIMET E SHOQËRISË	127
2. DETYRIMET E TË RINJVE MUSLIMANË	145
3. DITURIA, VLERAT DHE VEPRAT	169
SHKALLËT E TË NDALUARAVE	172
SHKALLËT E NJERËZVE ME VEPRAT	174
4. KUPTIMI I AFTËSIVE, KUFIZIMEVE DHE KUSHTEVE TË TË TJERËVE	179
5. NJOHJA DHE KUPTIMI I SUNENEVE TË ALL-LLAHUT NË ATË QË KA KRIJUAR AI	186
6. DIALOG MBI SUNENET DHE KUSHTET E FITORES	191
KAPITULLI I KATËRT	195
KËSHILLA ATËRORE PËR RININË ISLAME	195
1. DREJT NJË DIALOGU KONSTRUKTIV	196
2. PËRFITONI NGA TË DEVOTSHMIT DHE TË DREJTËT	201
3. LEHTËSONI E MOS VËSHITRËSONI	204
4. THIRRNI ME URTËSI DHE BUTËSI	207
5. KULTURA E THIRRJES DHE DIALOGUT	211
6. JETONI ME MASAT E GJERA	213
7. DËSHIRONI TË MIRËN MUSLIMANËVE	218

DY FJALË PËR AUTORIN

- U lind në Egjipt më 1926/1344
- Kreu (hifzin) memorizimin e Kur'anit në moshën 10 vjeçare.
- Studioi në El Ez-her nga niveli fillor deri në atë universitar dhe më 1973/1393 mori titullin “Doktor në filozofi”.
- Punoi si hatib, mësues dhe autor në Departamentin e Vakëfeve dhe në El Ez-her.
- Aktualisht është i caktuar për dekan të Fakultetit të Sheriatit dhe Studimeve Islame si dhe drejtor i Qendrës së Studimeve mbi Sunnetin dhe Siren në Universitetin e Katarit. Është anëtar i shumë shoqatave akademike islame etj.
- Ka botuar mbi 42 libra që trajtojnë aspekte të ndryshme të jetës, letërsisë dhe poezisë islame. Midis tyre janë: Fikhu i zekatit; Hallalli dhe harami në Islam; Imani dhe jeta; Fetva bashkëkohore; Rizgjimi islam ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit, etj.
- Artikujt dhe punimet e tij janë botuar në shumë gazeta dhe revista arabe islame.
- Dr. Kardavi konsiderohet si një nga mendimtarët më të moderuar islamë dhe njëri prej atyre që kombinojnë diturinë tradicionale të Sheriatit me një kuptim bashkëkohor të problemeve (Fikh ul

Vâki’). Shkrimet e dr. Kardavit kanë gjetur një përkrahje të gjerë në të gjitha shtresat e botës islame dhe shumë prej tyre janë përkthyer në gjuhë të ndryshme.

PARATHËNIE

Në Ramazan dhe Shevval të vitit 1981/1401, revista “*El Ummeh*” botoi artikullin tim dypjesësh mbi rizgjimën e rinisë islame.¹ Në atë studim tërhoqa vëmendjen tek aspektet pozitive dhe negative, të cilat u interesojnë vëzhguesve, thirrësve dhe dijetarëve islamë, të përkushtuar ndaj Rizgjimit. Gjithashtu sugjeroja se duhet të bashkëbisedojmë me rininë, t’u shfaqim simpati prindore dhe ta kanalizojmë rizgjimën e tyre, në mënyrë që ta forcojmë Islamin, e jo ta dobësojmë atë. Përgjigjja ndaj këtij studimi ishte kaq e ngrohtë në gjithë botën islame, sa që studimi u përkthye në gjuhë të ndryshme. Veç kësaj, rinia në shumë universitete islame, në mënyrë tolerante i studioi pikëpamjet e mia, pavarësisht nga fakti se ato kritikonin shumë prej tyre.

Këtu dëshiroj të falënderoj qëndrimin e Grupit Islam në Universitetin e Kajros, të cilët përdorën studimin tim gjatë kampit të tyre të nëntë në verën e 1981, e shtypën dhe ua shpërndanë atë të gjithë pjesëmarrësve. Kjo gjë pasqyron një vetëdije të lartë dhe gatishmërinë për të përkrahur moderimin dhe vijën e objektivitetit.

¹ El-Kardavi, "Rizgjimi i rinisë islame është dukuri e dobishme që duhet prirë e jo kundërshtuar", revista "El Ummeh" (1981)

Nuk do të futem në diskutimin e ngjarjeve të fundit, të cilat ndodhën në disa vende islame ku pati një konfrontim serioz dhe të përgjakshëm midis të rinjve dhe autoriteteve, jo sepse nuk dua ta rëndoj edhe më shumë çështjen, por për shkak se revista *“El Ummeh”* i ka shërbyer gjithmonë krejt Ummetit islam, e jo vetëm një grupi të caktuar. Ajo që na shqetëson këtu janë debatet e flakta dhe të zgjatura, të nxitura nga këto ngjarje, mbi të ashtuquajturin *“ekstremizëm fetar”*, në të cilat u përfshinë jo vetëm njerëzit e arsimuar, por edhe ata, njohja e Islamit dhe injoranca si dhe sjellja e të cilëve karakterizohet nga armiqësia, sarkazmi dhe cinizmi.

Para pak muajsh m'u kërkua nga revista *“El Arabi”* të shkruaja mbi temën *“ekstremizmi fetar”* me theks të veçantë në natyrën e vërtetë dhe karakteristikat e tij. Kur artikulli doli në botimin e posaçëm të janarit 1982, disa miq më qortuan se kam hyrë në një çështje në të cilën po shfrytëzohet fjala e vërtetë për mbështetje të së pavërtetës. Megjithëse miqtë e mi nuk e vinin në dyshim përmbajtjen apo thelbin e artikullit, prapë ata dyshonin për motivet dhe synimet të cilat fshihehin pas fushatës që kishte filluar kohëve të fundit kundër *“ekstremizmit fetar”*. Ata nuk ishin të bindur se, me të vërtetë, ajo fushatë kërkonte t'i rezistonte ekstremizmit apo t'i udhëzonte ekstremistët drejt rrugës së moderimit; përkundrazi, ajo synonte ta shtypte Rizgimin islam, para se të mund të forcohej dhe popullarizohej më shumë, e së fundi të merrte përsipër një rol të rëndësishëm politik. Miqtë e mi kishin vënë re se autoritetet nuk i kishin kushtuar vëmendje rinisë fetare, derisa kjo e fundit filloi të kundërshtojë, mbi baza fetare, disa veprime politike të qeverisë. Kjo mbështetje nga fakti se pushtetarët aktualisht posedojnë disa grupe fetare, që kanë shfaqur prirje ekstreme, me qëllim që t'i përdorin ato kundër lëvizjeve të tjera islame dhe më pas t'i shtypin ato, pasi ta kryejnë rolin e caktuar. Kështu miqtë e mi këmbëngulën se shkakun që fshihej pas konfrontimit midis autoriteteve dhe grupeve islame, s'mund të ishte shfaqja e ekstremizmit.

Ata besonin se autoritetet në vendet tona islame e konsideronin Lëvizjen islame si armikun më të rrezikshëm. Kështu, ata mundën dhe bënë aleanca me të djathtit ose me të majtit, por kurrë me Lëvizjen islame. Disa herë u shpall një armëpushim i përkohshëm me këtë lëvizje; disa herë të tjera autoritetet u përpoqën ta futnin atë në konfrontim me kundërshtarët e tyre politikë dhe ideologjikë. Si përfundim, autoritetet dhe kundërshtarët e tyre zbuluan se kishin më shumë afërsi qëllimesh dhe mjetesh nga ç'e mendonin, kështu që u bashkuan kundër Lëvizjes islame. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an:

“Zullumqarët janë miq të njëri-tjetrit, kurse All-llahu është mbrojtës i besimtarëve të devotshëm”.
(45:19)

Ngjarjet e fundit e vërtetojnë këtë gjë. Shfaqja e grupeve islame në fillimin e tyre në Egjipt u karakterizua nga ekstremizmi. Megjithatë së fundi ata filluan të mbajnë një qëndrim të pjekur dhe të moderuar, falë përpjekjeve të shumë mendimtarëve dhe thirrësve islamë, të cilët ia dolën të ndikojnë në mendimin dhe sjelljen e këtyre të rinjve muslimanë, në atë masë sa që maturia dhe moderimi u bënë tiparet dalluese të shumicës së tyre. Është për t'u habitur se pushtetarët heshtnin në kohën kur ekstremizmi mbizotëronte, ndërsa kur filloi të mbizotërojë moderimi, ata i shtypën këto grupe.

Unë isha në dijeni të këtyre ngjarjeve dëshpëruese, bile ato më shtynë ta filloja artikullin tim në “*El Arabi*” kështu (revista në fjalë i ka hequr disa pjesë nga artikulli që kanë argumentuar dhe që ishin me rëndësi sipas mendimit tim, edhe pse nuk ka ndryshuar gjë nga esenca):

Pavarësisht nga bindja ime për qëllimin fisnik, i cili e nxiti “*El Arabi*” të hapë një dialog mbi atë që po quhet “*ekstremizëm fetar*”, dhe pavarësisht nga besimi im i patundur në rëndësinë e problemit dhe

thellësinë e ndikimit të tij në çështjet tona bashkëkohore, s'mund ta fsheh faktin se hezitova në fillim, për arsye se ajo që mund të shkruaj, veçanërisht në këtë kohë, mund të keqinterpretohet, bile mund të shfrytëzohet qëllimisht për t'i shërbyer diçkaje në kundërshtim me qëllimin tim apo të vetë revistës.

Hezitimi im përforcohej nga fakti se për dekada islamistët janë mbytur me akuza nga kundërshtarët e tyre. Ata janë damkosur si *“reaksionarë”*, *“tradicionalistë kokëfortë”*, *“fanatikë”*, *“agjentë”* të vendeve armike, megjithëse asnjë vëzhgues s'mund të mos shohë se Lindja dhe Perëndimi, e majta dhe e djathta, janë bashkuar në armiqësinë e tyre ndaj islamistëve dhe kërkojnë shkak që ta shtypin Rizgjimin islam.

Pasi u mendova shumë, arrita në përfundimin se kjo çështje i përket krejt botës islame e jo vetëm një vendi, andaj heshtja s'është zgjidhje dhe se refuzimi për të kontribuar në të është joislam, një arratisje nga fushëbeteja. Ndaj jam mbështetur tek All-llahu (xh.sh.) dhe vendosa të sqaroj të vërtetën. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) thotë në një hadith:

“Shpërblimi i veprave varet nga qëllimet dhe çdo person do ta marrë shpërblimin sipas qëllimit të tij”

(Buhariu dhe Muslimi).

Shumë shkrimtarë, të cilët janë injorantë të udhëhequr nga motive të ulëta ose persona që nuk kanë aftësi të depërtojnë në natyrën e problemit, e ndiejnë veten të lirë të shprehin mendimet e tyre. Një situatë e tillë, pashmangshmërisht i fton të gjithë dijetarët islamë që të hedhin shikimin, se ç'fshihet pas kësaj fushate dhe ta përballojnë problemin, me qëllim që të qartësojnë të vërtetën.

Vendimi im u përforcua më shumë nga interesimi im i hershëm mbi problemin e “*ekstremizmit fetar*”. Pak vite më parë, botova një artikull në “*El Muslim el Muâsir*”² rreth “*Fenomenit të tekfirit të tepruar*”³ (më vonë ky punim u botua si broshurë e veçantë). Një artikull tjetër, “*Rizgjimi i rinisë islame*”, i përmendur më sipër, u botua para disa muajsh në “*El Ummeh*” (Katar). Kam pasur rastin të takoj shumë të rinj muslimanë në kampet e tyre dhe gjatë seminareve, dhe kam diskutuar me ta çështje të cilat përqëndrohen në një temë: thirrja për moderim dhe kujdesi ndaj ekstremizmit. Megjithatë, ajo që shkrova në “*El Arabi*” ishte e kufizuar në temën specifike të kërkuar nga gazeta si dhe në hapësirën e rezervuar për të.

Për këto arsye, disa herë jam ndier i detyruar t’i rikthehem këtij problemi, fenomenit të “*ekstremizmit fetar*” dhe të bëjë një studim objektiv të realitetit, të shkaqeve dhe shërimit të tij brenda një kornize të vërtetë islame. Vendosmëria ime për të ecur përpara nuk do të shkurajohet nga pjesëmarrja e atyre që mundohen ta shtrembërojnë dhe shfrytëzojnë problemin. I Dërguari (a.s.) ka thënë:

“Flamuri i diturisë islame do të bartet nga njëri brez tek tjetri nga të moderuarit, të cilët e mbrojnë atë nga shtrembërimet e fanatikëve, pretendimet e falsifikuesve dhe keqinterpretimet e injorantëve”.

² “*Muslimani bashkëkohor*”, botohet në Herndon, Virginia, SHBA

³ Tekfir - të shpallurit e individëve (nga grupe të ndryshme) për jobesimtarë

Ky hadith tregon me saktësi detyrën e të diturve, të cilët duhet ta sqarojnë e jo ta fshehin të vërtetën, që kështu të mund të shmangin mallkimin e All-llahut (xh.sh.) dhe të mallkuesve⁴. Por, përgjegjësia shtrihet edhe në grupe të tjera, të cilat preken direkt apo indirekt, nga problemi në diskutim.

Nuk është as e drejtë as e ndershme t'i fajësojmë vetëm të rinjtë apo disa prej tyre që kanë rënë në teprim në mendim apo ekstremitet në sjellje. Shumë të tjerë, veçanërisht ata të cilët e kanë neglizhuar përkatësinë e tyre në Islam dhe mësimet e tij, e ndajnë këtë përgjegjësi, madje para të rinjve, megjithëse ata përpiqen gjithmonë të shfajësojnë vetveten. Muslimanë vetëm me emër, qofshin prindër, apo mësues, dijetarë, pushtetarë etj., e kanë bërë Islamin, islamistët dhe thirrësit islamë, të përbuzur në vendet e tyre islame. Është e çuditshme që ne jemi të gatshëm në mosaprovimin e ekstremizmit tonë. Ne kërkojmë nga të rinjtë të tregojnë maturi dhe urtësi, të heqin dorë nga ekstremizmi dhe teprimi, por kurrë nuk kërkojmë nga më të vjetrit të pastrojnë vetveten prej hipokrizisë, gënjeshtërisë, mashtrimit dhe nga të gjitha format e vetëkundërthënies. Ne kërkojmë çdo gjë nga rinia, ndërkohë që nuk zbatojmë atë që predikojmë, sikur na janë dhënë të gjitha të drejtat, ndërsa rinia është ngarkuar me të gjitha detyrat, edhe pse e pranojmë se çdo e drejtë me vete bart edhe obligimin. Ajo, për të cilën kemi nevojë sot, është kurajoja për të pranuar se rinia jonë është detyruar t'i drejtohet atij që e quajmë "*ekstremizëm fetar*" për shkak të fajeve tona. Ne deklarojmë se jemi muslimanë, ndërkohë që nuk ndjekim mësimet e Islamit; lexojmë Kur'anin, ndërkohë që nuk zbatojmë urdhrat (ahkamet) e tij; deklarojmë se e duam Muhammedin (a.s.), ndërkohë që nuk e ndjekim Sunnetin e tij; deklarojmë në kushtetutat tona se Islami është fe

⁴ Aludohet në ajetin kur'anor

zyrtare, por kurrë nuk ia japim Islamit vendin e duhur në legjislacionin ose orientimin qeveritar. Hipokrizia dhe vetëkundërthënia jonë e kanë ftohur rininë, të cilët kanë kërkuar ta kuptojnë Islamin pa ndihmë dhe udhëzim nga ne. Ata kanë gjetur prindër shkurajues, ulema indiferentë, sundimtarë armiqësorë dhe këshilltarë cinikë. Prandaj, me qëllim që ta përmirësojmë këtë situatë, nevojitet të fillojmë me reformimin e vetvetes dhe të shoqërive tona sipas urdhrit të All-llahut, përpara se t'i kërkojmë rinisë të jetë e qetë, të tregojë urtësi dhe maturi.

Vlen të tërheqim vëmendjen në një pikë, në të cilën pushtetarët si dhe disa shkrimtarë, përqëndrohen zakonisht: detyra dhe roli i institucioneve fetare “zyrtare” në çrrënjosjen e ekstremizmit dhe në udhëheqjen e rizgjimit islam tek të rinjtë. Disa i quajnë këto institucione fetare “zyrtare”, si përgjegjëse për atë që ka ndodhur dhe që po ndodh, si dhe për të gjitha format e ekstremizmit dhe devijimit. Duket se pavarësisht nga rëndësia dhe rrënjët e tyre të thella, këto institucione sot janë të paafta për të kryer misionin e besuar, përderisa autoritetet politike të pushojnë së manipuluari dhe së shfrytëzuari ato, duke i përdorur ato si instrumente të mbështetjes dhe lavdërimit të politikës zyrtare. Institucionet zyrtare fetare në botën islame mund të luajnë një rol me të vërtetë pozitiv në udhëzimin e rinisë dhe pajisjen e saj me dituri të vërtetë islame, nëse lihen të lira t'i drejtojnë vetë punët e tyre, pa ndërhyrje nga pushtetarët. Megjithatë, në mungesë të kësaj lirie, ato mbesin skelete të pajetë.

Gjithashtu duhet të kujtojmë se këshilla është pa kuptim, nëse këshilluesi nuk gëzon besimin e rinisë. Në mungesë të këtij besimi dhe konfidence të dyanshme thelbësore, çdo këshillë e dhënë shndërrohet thjesht në retorikë. Të rinjtë tanë nuk kanë besim në këto institucione fetare dhe prijësit e tyre, të cilët janë caktuar nga autoritetet. Ekzistojnë rrethana dhe arsye të cilat e kanë bindur rininë se këto institucione nuk pasqyrojnë mësimet e Sheriatit, por janë shndërruar në

tellallë të regjimit. Institucionet e tilla mund të ushtrojnë ndikim vetëm kur t'i rregullojnë çështjet e tyre të brendshme. Ato duhet të kundërshtojnë hyrjen në rrethin vicioz, gjithnjë në ndryshim, të politikës; veprimtaritë e tyre duhet të përqëndrohen në rritjen e brezave të juristëve (fukahave) të ditur dhe krejtësisht të ndërgjegjshëm për problemet e kohës së tyre dmth.:

“Të cilët i kumtojnë Shpalljet e All-llahut, i frikësohen vetëm All-llahut e askujt tjetër veç Tij”
(33:39)

Shoqëria jonë moderne e sotme ka nevojë të ngutshme për dijetarë të tillë të drejtë, të cilët janë të bekuar me largpamësi dhe të cilët mund t'i udhëzojnë të rinjtë tanë në fenë e tyre dhe t'i japin udhëzimin e duhur Rizgjimit islam. Ata, të cilët qëndrojnë mënjanë dhe që janë indiferentë ndaj ringjalljes islame, apo që e kritikojnë atë pa marrë pjesë në vuajtjet e saj dhe pa i ndier aspiratat dhe deiluzionet e saj, nuk mund të luajnë një rol pozitiv në udhëzimin e saj.

Ata, të cilët nuk jetojnë për Islamin dhe përhapjen e tij dhe që nuk marrin pjesë në vuajtjet dhe vështirësitë nëpër të cilat kalon Ummeti, janë egocentrikë (egoistë). Njerëzit e tillë nuk kanë të drejtë t'u thonë atyre që besojnë në Islam dhe që jetojnë për të, se janë në rrugë të gabuar dhe duhet të ndryshojnë; dhe nëse e marrin këtë të drejtë me forcë, askush s'do t'ua vërë veshin.

Si përfundim, këshilla ime për cilindo që merr përsipër të këshillojë rininë është: të dalë nga kulla e fildishtë, ta harrojë trashëgiminë e tij intelektuale dhe të zbresë në tokë, me të rinjtë. Ai duhet të identifikohet me shpresat e tyre të mëdha, ngrohtësinë e dashurisë, vendosmërinë e vërtetë, motivimin fisnik dhe veprat e mira. Për më tepër, ai duhet të bëjë dallimin midis sjelljes dhe qëndrimeve të tyre, negative dhe pozitive, në mënyrë që të mund të japë këshilla të bazuara në largpamësi dhe të bëjë gjykime të bazuara në argumente.

All-llahu (xh.sh.) na ruajtë nga të gjitha teprimet dhe ekstremizmi dhe na drejtoftë në rrugën e Tij të drejtë. Amin

Dr. Jusuf El Kardavi

Shevval 1402 H

gusht 1982

KAPITULLI I PARË

EKSTREMIZMI: AKUZA DHE E VËRTETA

Shkencëtarët e logjikës mbështesin idenë se nuk mund të jepet gjykim mbi diçka, pa pasur një njohje të mirë të saj, sepse e panjohura dhe e papërcaktuara s'mund të gjykohen. Prandaj, së pari duhet të përcaktojmë se çfarë do të thotë “*ekstremizëm fetar*” para se ta dënojmë apo miratojmë atë. Këtë gjë mund ta bëjmë duke pasur parasysh realitetin dhe tiparet më të shquara të tij. Fjalë për fjalë, ekstremizëm do të thotë pozicionim në pikën më të largët nga qendra. Në mënyrë figurative ai tregon një largim të ngjashëm në fe, mendim dhe sjellje. Një nga pasojat kryesore të ekstremizmit është ekspozimi ndaj rrezikut dhe pasigurisë. Prandaj Islami këshillon moderim dhe ekuilibër në çdo gjë: në besim, ibadet, sjellje dhe legjislacion. Kjo është rruga e drejtë, të cilën All-llahu (xh.sh.) e quan “es sirâtul mustekîm”, e cila dallon nga rrugët që ndoqën ata të cilët tërhoqën mbi vete zemërimin e All-llahut dhe ata të cilët e humbën rrugën. Moderimi apo

ekuilibri është jo vetëm një veçori e përgjithshme e Islamit, por edhe një pikë themelore referimi me të cilën All-llahu e dalloi Ummetin islam nga të tjerët. Kur'ani thotë:

“Dhe ashtu Ne ju bëmë juve një popull të drejtë për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve dhe për të qenë i Dërguari dëshmitar ndaj tyre...”

(Kur'ani... 2:143)

Si i tillë, Ummeti islam është një ummet i drejtësisë dhe moderimit; ai dëshmon çdo shmangie, qoftë ajo majtas apo djathtas, nga rruga e drejtë e mesit, në këtë botë dhe në tjetrën. Tekstet islame i ftojnë muslimanët të jenë të moderuar dhe të hedhin poshtë dhe kundërshtojnë të gjitha llojet e ekstremizmit: *“gulûv”* (teprimin), *“tenattu”* (tejkalimin e kufijve, pedantizmin fetar) dhe *“teshdîd”* (rreptësinë). Një shqyrtim i hollë i këtyre teksteve tregon që Islami porosit largim nga teprimi. Të shqyrtojmë hadithet e mëposhtme:

1. “Ruhuni nga teprimi në fe. (Popuj) para jush janë zhdukur si pasojë e teprimit”.⁵ Popujt, për të cilët bëhet fjalë, janë popujt e feve të mëparshme, veçanërisht Ehl ul Kitab (Popujt e Librit), çifutët dhe të krishterët, kryesisht këta të fundit. Kur'ani u drejtohet këtyre popujve:

⁵ Transmetojnë Ahmedi, en-Nesaiu dhe Ibn Maxhe në Sunenet e tyre (përmbledhjet e tyre të haditheve të Pejgamberit a.s.) Shakiri (për këtë hadith) thotë: "Zinxhiri i tij është i vërtetë (sahih); edhe El-Munavi në librin e tij El-Fejd (3/126) e cek thënien e Ibn Tejmijjes: "Ky është zinxhir sahih sipas kushtit të Muslimit

“Thuaju: “O ithtarë të Librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë së vërtetës dhe mos shkoni pas epsheve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë.”

(5:77)

Prandaj muslimanët janë paralajmëruar që të mos ndjekin gjurmët e tyre; ai, i cili mëson nga gabimet e të tjerëve, jeton një jetë të lumtur. Për më tepër, mësimi i nxjerrë nga hadithi i mësipërm, na vë në gatishmëri para faktit që teprimi mund të na duket si një veprim i parëndësishëm, të cilin, pa e kuptuar, e lëmë të vazhdojë, derisa ai shndërrohet në një kërcënim për ne. Gjatë Haxhxit lamtumirës, pasi mbërriti në Muzdelife, Muhammedi (a.s.) i kërkoi ibni Abbasit të mblidhte disa gurë për të. Ibni Abbasi mblodhi disa gurë të vegjël. Pasi i pa gurët, i Dërguari e miratoi madhësinë e tyre dhe tha: “Me të tillë (gurë ta qëlloni Shejtanin). Ruhuni nga teprimi në fe”⁶. Kjo tregon qartë se muslimanët s’duhet të mendojnë se përdorimi i gurëve të mëdhenj është më i mirë, duke e lejuar kështu teprimin të hyjë në jetën e tyre. Imam ibn Tejmije është i mendimit që ky paralajmërim kundër teprimit përfshin të gjitha format e besimit, adhurimit dhe veprimit, dhe thotë që përderisa të krishterët e teprojnë më shumë në besim dhe praktikë, All-llahu (xh.sh.) i paralajmëron në Kur’an:

“Mos e teproni në fenë tuaj”.

(4:171)

⁶ Transmetojnë Ahmed i në Musnedin e tij, en-Nesa’iu dhe Ibn Kethiri në Sunenet e tyre

2. “Të shkatërruar janë mutenettiun-ët”. Dhe ai (i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e përsëriti këtë tri herë”⁷.

Imam Neveviu thotë që njerëzit, për të cilët bëhet fjalë këtu, janë ata që e kalojnë kufirin me fjalët dhe veprat e tyre. Siç shihet, dy hadithet e mësipërme theksojnë që pasojë e teprimit dhe zellshmërisë do të jetë humbja e plotë në këtë jetë dhe në tjetrën.

3. Muhammedi (a.s.) vazhdimisht thoshte: “Mos e mbingarkoni veten tuaj, që të mos mbingarkoheni. Njerëz (para jush) e mbingarkuan veten e tyre dhe u mbingarkuan. Mbeturinat e tyre gjenden në vendet e asketëve dhe në manastire”⁸. Gjithmonë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dënoi çdo prirje drejt teprimit fetar. Ai i paralajmëroi ata sahabë, të cilët e tepronin në ibadet ose ata që ishin shumë asketë, atëherë kur, ajo që bënë i tejkaloi kufijtë e qëndrimit të moderuar islam. Islami synon të vendosë një ekuilibër midis nevojave trupore dhe atyre shpirtërore, midis së drejtës së njeriut për ta jetuar jetën plotësisht dhe së drejtës së Krijuesit për t’u adhuruar nga njeriu, e cila është vetë arsyeja e krijimit të tij.

Islami ka përcaktuar ibadete që pastrojnë qenien njerëzore, e ngrenë atë shpirtërisht dhe materialisht, individualisht dhe kolektivisht, me anë të të cilave krijohet një bashkësi harmonike, në të cilën mbizotërojnë ndjenjat e vëllazërimit dhe solidaritetit, pa u penguar njeriu nga përmbushja e

⁷ Transmeton Muslimi. Es-Sujutiu këtë hadith ua atribuon edhe Ahmedit edhe Ebu Davudit

⁸ Transmetuar nga Ebu Ja'la në Musnedin e tij bazuar në Enes ibn Malikun. Cituar nga Ibn Kethiri në interpretimin e tij të ajetit kur'anor 57:27: “... **ndërsa murgësinë ata vetë e shpikën. Ne atë nuk ua bëmë obligim atyre...**”

detyrës së tij për ngritjen e kulturës dhe qytetërimit. Përmbushja e këtyre obligimeve, as nuk e ndan muslimanin nga rrjedha e jetës, as nuk e largon nga bashkësia. Përkundrazi, lidhjet e tij forcohen, emocionalisht dhe praktikisht. Kjo është arsyeja pse Islami nuk këshillon murgërinë, gjë e cila kërkon largim dhe veçim, duke e ndaluar njeriun nga gëzimi i begatisë dhe të mirave të jetës normale, si dhe nga pjesëmarrja në zhvillimin dhe përkrahjen e tij. Islami e konsideron punën si një formë ibadeti dhe një xhihad, kur qëllimi është i pastër dhe brenda kufijve të caktuar nga All-lahu (xh.sh.). Si përfundim, Islami nuk e miraton ndjekjen e anës shpirtërore në dëm të asaj materiale, por gjithashtu as prirjen për të “pastruar shpirtin” duke lënë pas dore dhe ndëshkuar trupin, siç këshillojnë dhe predikojnë fetë dhe filozofitë e tjera. Islami erdhi në baraspeshë me gjithë këtë. Në Kur’an thuhet:

“Zoti ynë! Na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër.”

(2:201)

dhe në hadithin: “O All-llah! Ma rregullo fenë time, e cila është mbrojtësja e punëve të mia; m’i rregullo punët e jetës sime në këtë botë, në të cilën po jetoj; ma rregullo ahiretin prej të cilit varet jeta ime e përtejvarrit; bëma jetën burim bollëku për çdo të mirë dhe bëje vdekjen time burim rehatie, duke më ruajtur nga çdo e keqe”⁹ si dhe “Trupi ka një të drejtë mbi ty”.¹⁰

⁹ Transmeton Muslimi

¹⁰ Autenticiteti i vërtetuar nga të gjitha autoritetet

Veç kësaj, Kur'ani kundërshton prirjen për ndalimin e të mirave dhe zbukurimeve (*z'neb*), me të cilat All-llahu (xh.sh.) ka furnizuar robërit e tij. Në një ajet të shpallur në Mekke, All-llahu (xh.sh.) thotë:

“O bijtë e Ademit! Vishuni bukur për çdo namaz, hani dhe pini e mos e teproni, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë. Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet...”

(7:31-32)

Në një sure tjetër të shpallur në Medine, All-llahu (xh.sh.) u drejtohet besimtarëve:

“O ju që besuat! Mos i ndaloni të mirat që për ju All-llahu i lejoi dhe mos e teproni, se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë” “Hani nga ajo që All-llahu ju furnizoi si hallall të mirë dhe, duke qenë se ju All-llahut i besoni, ruajuni dënimit të Tij”.

(5:87-88)

Këto ajete u shpjegojnë besimtarëve mënyrën e vërtetë islame të gëzimit të të mirave dhe të ruajtjes nga teprimi, i cili vihet re tek fetë e tjera. Transmetohet se shkaku i zbritjes së këtyre dy ajeteve ishte ngjarja kur një grup sahabësh vendosën të tridheshin, për t'u tërhequr nga të mirat e kësaj bote dhe të endeshin nëpër botë si murgj.

Gjithashtu Ibni Abbasi (radijall-llahu anhu) transmeton: “Një njeri erdhi tek I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe i tha: O i Dërguar i All-llahut, sa herë që ha këtë mish, kam (gjithmonë) një dëshirë për të bërë dashuri, ndaj kam vendosur të heq dorë nga ngrënia e mishit”.

Për këtë shkak zbritën këto ajete.¹¹

Enes ibn Maliku transmeton: “Një grup burrash erdhi tek shtëpitë e grave të të Dërguarit (sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem) dhe pyetën për ibadetin e tij. Kur u informuan mbi këtë, ata e konsideruan ibadetin e tij të pamjaftueshëm. Njëri prej tyre tha: Unë do të fal namaz gjithë natën sa të jem gjallë. Një tjetër tha: Unë do të agjëroj gjithë vitin pa e prishur agjërimin. I Dërguari i All-llahut iu afërua dhe u tha atyre: “Pasha All-llahun, unë i nënshtrohem dhe i frikësohem Atij më shumë sesa ju. Unë agjëroj dhe e prish agjërimin, natën fal namaz, por edhe fle, dhe martohem me gra. Ai, i cili nuk e ndjek Sunnetin tim, nuk është prej meje (dmth s’është pasuesi im)”.

Sunneti i Pejgamberit (sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem) përfaqëson mënyrën se si ai e kuptonte dhe e zbatonte fenë dmth. obligimin ndaj Zotit të tij, vetvetes, familjes së tij dhe pasuesve të tij, duke i dhënë secilit të drejtën e tij në mënyrë të ekuilibruar dhe të moderuar.

1. TË METAT E EKSTREMIZMIT FETAR

Të gjitha këto paralajmërime kundër ekstremizmit dhe teprimit janë të nevojshme, për shkak të të metave që vihen re në këto tendenca.

¹¹ *Muhtesar Ibn Kethir*, vëll. 1, f. 541

E meta e parë është që teprimi s'është i durueshëm ose i tolerueshëm, për shkak të natyrës së qenies njerëzore. Edhe sikur disa njerëz të mund të pajtohen me teprimin për një kohë të shkurtër, prapëseprapë, shumica e njerëzve s'janë në gjendje të bëjnë të njëjtën gjë. Legjislacioni i All-llahut i drejtohet krejt njerëzimit e jo një grupi të posaçëm njerëzish, të cilët mund të zotërojnë një aftësi unike për të duruar. Kjo është arsyeja pse njëherë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u zemërua me një sahab të shquar, Muadhin, për shkak se ky i fundit u priu një ditë njerëzve në namaz dhe e zgjati atë aq shumë, saqë një nga njerëzit shkoi tek Pejgamberi dhe iu ankua. Ai i tha Muadhit: “O Muadh! A po i vë njerëzit në provë?” dhe e përsëriti këtë tri herë.¹²

Në një rast tjetër, ai iu drejtua një imami, me një zemërim të pazakontë: “Disa nga ju bëjnë që njerëzit të largohen nga punët e mira (namazi). Prandaj cilido prej jush, që u prin njerëzve në namaz, duhet ta shkurtojë atë, sepse mes jush ka të dobët, pleq dhe prej atyre që kanë punë”.¹³

Veç kësaj, kur i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dërgoi Muadhin dhe Ebu Musën në Jemen, u dha këtë këshillë: “Lehtësoni dhe mos vështirësoni. Përgëzoni dhe mos i bëni njerëzit të ikin. Bindjuni njëri-tjetrit dhe mos u përçani”.¹⁴

Gjithashtu Umer ibnul Hattabi e ka theksuar këtë duke thënë: “Mos e bëni All-llahun të urrejtur tek robërit e Tij, duke u prirë njerëzve në namaz dhe duke e zgjatur atë aq shumë, saqë ata ta urrejnë atë që po bëjnë”.

¹² Transmeton Buhariu

¹³ Transmeton Buhariu

¹⁴ Autentik sipas të gjitha autoriteteve

E meta e dytë është që teprimi është jetëshkurtër. Meqë këmbëngulja dhe aftësia e njeriut për të duruar është e kufizuar dhe meqë njeriu mërzitet shpejt, ai s'mund ta durojë shumë gjatë një veprim të tepruar. Bile, edhe sikur të mund të pajtohet me të për pak kohë, së shpejti atë do ta mposhtë lodhja, fizikisht dhe shpirtërisht, dhe së fundi, do të heqë dorë edhe nga ajo pak gjë që mund të bëjë, ose mund të marrë një drejtim të kundërt, duke e zëvendësuar teprimin me një pakujdesi dhe shthurje të plotë. Kam njohur shumë njerëz, të njohur për rreptësinë dhe ekstremizmin e tyre. Më pas, për shumë kohë, e humba kontaktin me ta. Pas shumë kohësh, kur u interesova dhe pyeta për ta, mora vesh se ata ose kishin devijuar dhe kishin dalë në ekstremin tjetër, ose të paktën, kishin ngelur prapa si “i nxituari”¹⁵, për të cilin flitet në hadithin e mëposhtëm:

“Ai (i nxituari) as e përshkon distancën e dëshiruar as e kursen kurrizin (e mjetit të tij të transportit)”.¹⁶

Shikoni se si udhëzon i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në një hadith: “Kryej ato punë, të cilat mund t’i durosh, sepse All-llahu s’do të lodhet (së dhëni shpërblim) derisa ti të durosh dhe të lodhesh (së kryeri punë të mira)... dhe puna më e dashur tek All-llahu është që kryhet rregullisht, edhe sikur të jetë e vogël”.¹⁷

¹⁵ “*I nxituari*” është ai që e ka humbur shoqërinë e bashkudhëtarëve të vet për shkak se e ka lodhur kafshën me të cilën ka udhëtuar

¹⁶ Transmetuar nga el-Bezzari sipas Xhabirit, me isnad të dobët

¹⁷ Transmetojnë Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Nesa’iu duke u mbështetur në autoritetin e Aishes (r.a.)

Ibn Abbasi ka thënë: “Një shërbëtore e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e kishte zakon të agjëronte gjatë ditës dhe ta kalonte tërë natën në ibadet. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u njoftua për këtë gjë dhe tha: “Në çdo punë ka një kulm të energjisë, i cili pasohet nga lodhja. Ai, që në këtë lodhje ndjek Sunnetin tim, është në rrugë të drejtë, ndërsa ai, i cili në këtë lodhje, ndjek tjetër (udhëzim), ka (gabuar dhe) humbur rrugën”.¹⁸

Abdull-llah ibn Amri ka thënë: i Dërguari i All-llahut u njoftua për ata që ishin të rraskapitur nga ibadeti. Ai tha: “Ky është maksimumi i Islamit dhe kulmi i energjisë së tij. Çdo maksimum ka një kulm energjie dhe çdo kulm pasohet nga lodhja... ai, lodhja e të cilit është në përputhje me Librin (Kur'anin) dhe Sunnetin, është në rrugë të drejtë, ndërsa ai, lodhja e të cilit është për mosbindje, do të humbasë”.¹⁹

Sa kuptimplote është këshilla e të Dërguarit për muslimanët që të mos e mbingarkojnë veten e tyre dhe të njekin rrugën e mesme, në mënyrë që të mos i kaplojë lodhja dhe të heqin dorë nga vazhdimi. Ai ka thënë: “Feja është shumë e lehtë dhe cilido që e mbingarkon vetveten, s’do të mund të vazhdojë në këtë rrugë. Bëhuni të drejtë (pa teprim apo pakujdesi), afrojuni (përsosjes) dhe merrni sihariq (me shpërblimin e veprave tuaja)...”.²⁰

E meta e tretë është që teprimi vë në rrezik të drejtat dhe detyrimet e tjera. Një i urtë ka thënë: “Çdo teprim deri diku shoqërohet me humbjen e një të drejte”.

¹⁸ Transmeton el-Bezzari dhe njerëzit e isnadit janë njerëz të sahihut

¹⁹ Transmeton Ahmedî, ndërsa Ebu Shakiri thotë se isnadi i tij është sahih

²⁰ Transmetojnë Buhariu dhe en-Nesaiu mbi autoritetin e Ebu Hurejres. Shpjeguar nga el-Menaviu

Kur i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) mori vesh që Abdull-llah ibn Amri ishte aq i dhënë pas ibadetit, sa që linte pas dore detyrën që kishte ndaj gruas së tij, i tha atij: “O Abdull-llah! A është e vërtetë ajo që kam marrë vesh se ti agjëron çdo ditë dhe bën ibadet tërë natën?” Abdull-llahu iu përgjigj: “Po, o i Dërguar i All-llahut!” i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha: “Mos vepro kështu, por agjëro dhe prishe atë, kryej ibadet gjatë natës, por edhe fli. Trupi yt ka të drejta mbi ty, sytë tu kanë të drejta mbi ty, gruaja jote ka të drejta mbi ty dhe mysafiri yt ka të drejta mbi ty”.²¹

Ngjarja që ndodhi midis Selman Farisiut (radijall-llahu anhu), sahab i shquar dhe njohës i mirë i fikhut dhe mikut të tij të shtrenjtë Ebu Derdait, zahidit të madh, është një rast tjetër kuptimplotë. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i kishte lidhur dhe bërë vëllezër Selmanin dhe Ebu Derdain. Njëherë Selmani i bëri një vizitë Ebu Derdait dhe e gjeti Ummi Derdanë (gruan e tij) të veshur me rroba të rreckosura. Ai e pyeti atë pse ishte veshur ashtu dhe ajo iu përgjigj: “Yt vëlla, Ebu Derdai, nuk interesohet më për këtë botë”. Ndërkohë, mbërriti Ebu Derdai, i shprehu mirëseardhje Selmanit dhe i përgatiti për të ngrënë, ia ofroi ushqimin dhe i tha: “Urdhëro ti, se unë jam duke agjëruar”. Selmani i tha: “Unë nuk ha po nuk hëngre edhe ti”. Kështu Ebu Derdai hëngri (me Selmanin). Kur erdhi koha e fjetjes, ai u nda për të falur namaz (nafile), por Selmani e urdhëroi të flinte dhe ai ra të flejë. Ebu Derdai u ngrit natën përsëri për të bërë ibadet, por Selmani sërish e urdhëroi që të flinte. Nga fundi i natës, Selmani e ngriti Ebu Derdain dhe së bashku falën namazin (tehexhxhudin). Më pas Selmani i tha Ebu Derdait: “Zoti yt ka të drejtë mbi ty, trupi yt ka të drejtë mbi ty, familja jote ka të drejtë mbi ty. Prandaj, jepi gjithsecilit të

²¹ Transmeton Buhariu

drejtën e vet”. Ebu Derdai ia rrëfeu këtë ngjarje të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili tha: “Selmani ka thënë të vërtetën”.²²

2. KONCEPTI I EKSTREMIZMIT FETAR

Paraqitja dhe përcaktimi i drejtë i këtij ekstremizmi, si dhe një vështrim i tij i brendshëm, do të ishte hapi i parë drejt përvijimit të zgjidhjes. Një gjykim apo përshkrim, i pabazuar në konceptet e vërteta islame dhe në Sheriat, por thjesht në mendimet personale të individëve, do të ishte krejt i pavlerë. Në lidhje me këtë Kur’ani thotë:

“Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë tek All-llahu dhe tek i Dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe Ditës së fundit.”

(4:59)

Gjatë gjithë historisë së Ummetit, ka pasur gjithmonë ixhma,²³ se parashtrimi i mosmarrëveshjeve midis muslimanëve tek All-llahu (xh.sh.) dhe i Dërguari i Tij do të thotë t’i parashtrosh ato tek Libri i Tij, Kur’ani dhe tek Sunneti i Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Pa një vërtetim të bazuar në Sheriat, rinia islame, e cila akuzohet për “*ekstremizëm*”, s’do t’u kushtojë kurrë vëmendje

²² Transmetojnë Buhariu dhe et-Tirmidhiu

²³ Ixhma: "Konsensusi si burim i Ligjit islam"

fetvave²⁴ të këtij apo atij dijetari islam, dhe do të mohojë dhe kundërshtojë ta pranojë një akuzë të tillë. Veç kësaj, ata do t'i akuzojnë të tjerët për padituri dhe falsifikim.

Transmetohet që Imam Muhammed ibn Idris Esh-Shafiiu u akuzua me refd²⁵. I fyer nga një akuzë e tillë e ulët, ai recitoi një varg poetik:

“Nëse dashuria për ehl ul bejtin²⁶ është refd, atëherë të gjithë njerëzit dhe xhintë të dëshmojnë se unë jam rafidij”.

Kur dëgjoi se e kishin quajtur reaksionar, një thirrës islam i ditëve tona tha: “Nëse besnikëria ndaj Kur’anit dhe Sunnetit është reaksion, atëherë do të dëshiroja të jetoja, vdisja dhe të ringjallesha si reaksionar”.

Është i një rëndësie të madhe përcaktimi me saktësi i termave të tillë të zakonshëm si “*reaksion*”, “*ngurtësi*”, “*ekstremizëm*”, “*fanatizëm*” etj., në mënyrë që të mos përbëjnë koncepte me dy kuptime, të cilat njëri grup ia hedh grupit tjetër dhe të cilat mund të interpretohen në mënyra të ndryshme nga forca të ndryshme intelektuale dhe shoqërore, të së majtës apo të djathtës ekstreme. Mospërcaktimi dhe moskuptimi i “*ekstremizmit fetar*”, si dhe lënia e kësaj çështjeje në dëshirat kapriçioze të njerëzve, do të çonte në një përçarje ndërmjet muslimanëve. Kur’ani thotë:

²⁴ Fetva: "Mendim juridik i dhënë nga një alim (në këtë rast mufti) lidhur me çfarëdo çështjeje që ka të bëjë me Ligjin islam."

²⁵ Refd - "Kundërshtim"; Rafidi: "Kundërshtues": një person i cili e do Pejgamberin a.s. dhe familjen e Ali ibn Ebu Talibit, por që nuk e pranon hilafetin e Ebu Bekrit dhe Umerit

²⁶ Ehl-ul bejt: Familja e Pejgamberit a.s.

“E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to.”

(23:71)

Në këtë pikë, do të dëshiroja të tërhiqja vëmendjen tek dy vëzhgime të rëndësishme.

I pari: shkalla e devocionit të personit, po ashtu si edhe e shoqërisë në të cilën jeton, ndikon në gjykimin e tij për të tjerët në lidhje me ekstremizmin, moderimin dhe shthurjen. Zakonisht, një shoqëri fetare krijon një individ të ndjeshëm, i cili ndjen antipati për çdo lloj shmangieje apo neglizhence, sado e vogël që të jetë ajo. Duke gjykuar me kriterin e praktikës dhe eksperiencës sime, një individ i tillë do të habitej kur të shihte se ka muslimanë që nuk bëjnë ibadet natën apo nuk agjërojnë. Historikisht, kjo është e kuptueshme. Nëse shqyrtohen veprat dhe punët e njerëzve, të cilët kanë jetuar në kohën e Pejgamberit (sal-lah-llahu alejhi ve sel-lem), sahabëve të tij dhe tabiunëve,²⁷ atëherë veprat dhe punët e të devotshmëve të brezave të mëvonshëm do të dukeshin shumë më pak të vlefshme. Nga kjo kuptohet dhe thelbi i thënies: “Meritat e atyre, që janë më afër All-llahut, s’janë veçse të metat e të drejtëve”.

Kjo na sjell ndërmend atë që Enes ibn Malik (radijall-llahu anhu) ua thoshte tabiinëve: “Ju bëni gjëra që i konsideroni si vogëlsira. Por, në kohën e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), këto veprime i shikonin si mëkate të mëdha”.

²⁷ Et-Tabi’i (sh. Tâbi’ûn): fjalëpërfjalshëm: "Ithtar, pjesëtar i gjeneratës së parë të muslimanëve që pasuan pas bashkëkohasve të Pejgamberit a.s.

Të njëjtin qëndrim mbante dhe Aisheja (radijall-llahu anha), e cila e kishte për zakon të recitonte një varg poeme të Lebid ibn Rebias, poetit të mirënjohur, i cili ankohet për shkuarjen e atyre njerëzve, që ishin shembull i një jete të drejtë shembullore, duke i lënë njerëzit në mëshirën e të prishurve, shoqërimi me të cilët është aq molepsës, sa edhe një qen i zgjebosur. Veç kësaj, ajo dëshironte të dinte se si do të ishte ndier Lebidi, sikur të kishte jetuar dhe vetë të shihte se ç'bënin brezat e mëvoshëm. Gjithashtu edhe djali i motrës së Aishes, Urveh ibn Zubejri e recitonte atë varg dhe pyeste veten se si do të ishin ndier Aisheja dhe Lebidi, nëse do të kishin jetuar në kohën e tij.

Nga ana tjetër, një njeri me një njohje dhe sjellje të paktë islame, ose i cili është rritur në një ambient në të cilin praktikohen ato që ka ndaluar All-llahu (xh.sh.) dhe nuk përfilllet Sheriati, e konsideron besnikërinë më të vogël ndaj Islamit si një lloj ekstremizmi apo fanatizmi. Gjithashtu ai do t'i akuzonte ata që zbatojnë Islamin dhe që besojnë në atë që është e ndaluar (haram) dhe në atë që është e lejuar (hallall). Natyrisht që qëndrimi i tij do të varej nga largësia e tij prej fundamenteve të Islamit.

Disa muslimanë, të ndikuar nga ideologjitë dhe praktikat e huaja, e konsiderojnë besnikërinë ndaj mësimëve të qarta islame në lidhje me ngrënien, pirjen, zbukurimin apo kërkesën për zbatimin e Sheriatit dhe vendosjen e shtetit islam në tokën islame, si shfaqje të “*ekstremizmit fetar*”. Për një person të tillë, një i ri musliman me mjekër apo një vajzë e re me hixhab (mbulesë) janë ekstremistë. Bile edhe urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja shikohen si forma të ekstremizmit dhe ndërhyrjes në lirinë personale të të tjerëve.

Megjithëse në Islam është një nga bazat e besimit që feja jonë është e drejtë, dhe ata që nuk besojnë në të janë në rrugë të shtrembër, prapëseprapë ka muslimanë, të cilët nuk pranojnë t'i konsiderojnë ata që ndjekin fe tjetër përveç Islamit, si kuffarë (jobesimtarë), duke e quajtur këtë gjë si fanatizëm dhe ekstremizëm.

I dyti: është e padrejtë të akuzosh një person për "*ekstremizëm fetar*" vetëm sepse ai ndjek mendimet juridike "*të një së ashpër*" të disa fukahave (juristëve). Nëse një person është i bindur që mendimi i filan fakihut është i drejtë dhe që përmes tij ai është i lidhur me Sheriatin, ai është i lirë të veprojë kështu edhe sikur të tjerët të mendojnë se argumenti juridik është i dobët. Vetëm ai është përgjegjës për çka mendon dhe beson, po edhe sikur duke vepruar kështu, të mbingarkojë vetveten, veçanërisht kur nuk është i kënaqur duke e kufizuar vetveten me detyrimet (farzet) e prera të cilat kërkohen prej tij dhe kërkon kënaqësinë e All-llahut (xh.sh.) nëpërmjet kryerjes së nafileve (ibadete shtesë).

Natyrisht, njerëzit kanë mendime të ndryshme rreth këtyre çështjeve. Disa i marrin gjërat lehtë dhe i lehtësojnë punët, ndërsa disa të tjerë jo. E njëjta gjë ka ndodhur me shokët e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). P.sh. Ibni Abbasi i lehtësonte çështjet fetare, ndërsa Ibni Umeri ishte i rreptë. Duke parë këtë, do të ishte e mjaftueshme për një musliman ta mbështeste bindjen e tij në argumentet e njërit prej medh'hebëve islamë ose në një ixhtihad²⁸ të besueshëm, të bazuar në argumente të shëndosha nga Kur'ani dhe Sunneti. A duhet cilësuar një person si ekstremist, sepse pranon dhe zbaton një ligj të nxjerrë nga njëri prej katër juristëve të mëdhenj të Islamit: Ebu Hanifes, Shafiut, Malikut dhe Ahmed ibn Hanbelit, vetëm pse ai nuk pajtohet me interpreti-

²⁸ Ixhtihad: "*Vetëpërpjekja kreative për të nxjerrë ligje nga burimet legjitime*".

met e dijetarëve të ndryshëm, veçanërisht të atyre bashkëkohorë? A kemi të drejtë të ndalojmë dikë nga zgjedhja e ixhtihadit, veçanërisht nëse kjo gjë lidhet me jetën dhe sjelljen e tij personale?

Një numër i madh juristësh islamë, nga të parët dhe bashkëkohorët, deklarojnë që gruaja duhet të vishet me një veshje që do t'ia mbulonte krejt trupin, me përjashtim të fytyrës dhe duarve. Përjashtimi i duarve dhe fytyrës mbështetet në ajetin kur'anor:

“... të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme...”

(24:31)

Më tej e përforcojnë këtë duke e mbështetur me hadithe, ngjarje dhe rrëfime. Shumë dijetarë bashkëkohorë, midis të cilëve edhe unë, e mbështesin këtë verdikt.

Nga ana tjetër, një numër dijetarësh të shquar debatojnë se fytyra dhe duart janë avret (pjesë e turpshme), dhe si të tilla, duhen mbuluar. Ata nxjerrin argumente nga Kur'ani, hadithet dhe rrëfimet. Ky argumentim mbrohet nga shumë dijetarë bashkëkohorë, veçanërisht në Pakistan, Indi, Arabinë Saudite dhe shtetet e Gjirit Persik. Ata i bëjnë thirrje çdo gruaje muslimane, që beson në All-llahun (xh.sh.) dhe në botën tjetër, të mbulojë fytyrën dhe të veshë dorëza. Nëse një grua beson në këtë dhe e konsideron atë si pjesë të mësimave të Islamit, a duhet cilësuar ajo si ekstremiste? Nëse një burrë, e thërret bijën ose gruan e tij t'i nënshtrohet kësaj gjëje, e ajo pranon, a duhet shikuar ai si ekstremist? A kemi të drejtë ne të detyrojmë dikë që të heqë dorë nga ajo që ai ose ajo e beson si urdhër të All-llahut (xh.sh.)? Duke vepruar kështu, a nuk jemi duke e detyruar atë që të kërkojë zemërimin e All-llahut, që ai ta shesë xhennetin e ta blejë xhehennemin vetëm e vetëm që të kënaqim tekat tona dhe të mos akuzohet për “*ekstremizëm*”?

E njëjta gjë mund të thuhet për ata që janë besnikë të opinioneve “*të vijës së ashpër*” për sa i përket të kënduarit, muzikës, pikturës, fotografimit etj. Këto mendime, jo vetëm që ndryshojnë nga ixhtihadi im personal rreth këtyre çështjeve, por edhe nga ixhtihadi i shumë dijetarëve të shquar. Megjithatë, mendimet e tilla janë në përputhje me pikëpamjet e një numri dijetarësh të hershëm dhe bashkëkohorë.

Sidoqoftë, shumë nga ç’kritikohet tek ata, të cilët i cilësojmë si “*ekstremistë*”, si psh. veshja e një theubi²⁹ të shkurtër në vend të këmishës dhe pantallonave, apo kundërshtimi për t’u dhënë dorën grave, të cilat mund të konsiderohen si “*të tepërta*”, e gjejnë argumentin e tyre në Usul ul Fikh³⁰ dhe në traditat e Ummitit. Si të tilla ato janë pranuar, mbrojtur dhe përhapur nga disa prej dijetarëve tanë bashkëkohorë. Si pasojë, disa të rinj muslimanë të devotshëm i janë përgjigjur kësaj, duke shpresuar në mëshirën e All-llahut dhe duke iu frikësuar ndëshkimit të Tij. Prandaj, s’duhet të dënojmë veprimet e ndonjë muslimani apo ta akuzojmë atë për “*ekstremizëm*”, nëse ai ndjek një mendim të vijës së ashpër të bazuar mbi gjykimin ligjor, me anë të të cilit ai kërkon kënaqësinë e All-llahut. Nuk kemi të drejtë ta detyrojmë atë të heqë dorë nga mendimi i tij ose t’i kërkojmë të ndjekë një vijë sjelljeje, e cila është kundër bindjeve të tij. Detyra jonë është t’i bëjmë thirrje atij me urtësi, të debatojmë me durim dhe mirësi, dhe të mundohemi ta bindim atë duke i paraqitur argumente, me shpresë që ai të mund të ndryshojë mendimin dhe të mund të pranojë atë që ne besojmë se është e vërtetë.

²⁹ Mbulesë e gjerë e jashtme për mbulimin e trupit

³⁰ Usul-ul Fikh: "Burimet e Ligjit islamik". "Shkenca e jurisprudencës islame apo metodologjia e nxjerrjes së ligjeve nga burimet e Islamit dhe vendosja e vlefshmërisë së tyre juridike apo kushtetuese."

3. SHFAQJET E EKSTREMIZMIT

Treguesit e parë të ekstremizmit janë fanatizmi dhe intoleranca, të cilat bëjnë që individi të jetë i përkushtuar ndaj mendimeve dhe paragjykimeve të tilla, me kokëfortësi; po ashtu si edhe ngurtësia, e cila e privon atë që të shohë qartë interesat e qenieve njerëzore, qëllimet e Sheriatit apo rrethanat e kohës në të cilën jeton. Një person i tillë nuk i lejon vetes të bashkëbisedojë me të tjerët, në mënyrë që të krahasojë mendimet e tij me ato të të tjerëve, por ndjek ato mendime që i duken atij më të drejta. Ne dënojmë përpjekjet e këtij individi për të përçmuar dhe hedhur poshtë mendimet e të tjerëve, po ashtu siç dënojmë qëndrimin e njëjtë të akuzuesve dhe kundërshtarëve të tij. Me të vërtetë, ne e dënojmë me rreptësi qëndrimin e tij, nëse pretendon se vetëm ai ka të drejtë dhe se të tjerët e kanë gabim, duke i akuzuar ata që kanë ide dhe mendime të ndryshme, për injorancë dhe egoizëm, si dhe ata që sillen ndryshe nga ai, për mosbindje dhe fisk,³¹ sikur ai vetë të ishte një pejgamber i pagabueshëm dhe fjalët që flet të ishin shpallje hyjnore. Ky qëndrim bie në kundërshtim me konsensusin e Ummetit se fjalët e një personi mund të pranohen ose hidhen poshtë, tërësisht ose pjesërisht, me përjashtim të haditheve të të Dërguarit tonë, Muhammedit (sal-lallahu alejhi ve sel-lem).

Është për t'u çuditur, që disa nga këta njerëz i japin vetes të drejtën e ushtrimit të ixhtihadit në çështjet dhe problemet më të ndërlikuara, si dhe japin gjykime spekulative dhe kapriçioze, duke ua hequr dijetarëve tanë ekspertë bashkëkohorë, të drejtën për të kryer ixhtihad në çështje që u kundërvihen atyre. Disa prej tyre nuk ngurrojnë të japin mendime dhe interpretime qesharake të

³¹ Fisk: "Kryerja e mëkatit, ndjekja e një drejtimi të mëkatimit dhe ligësisë."

Kur'anit dhe Sunnetit, të cilat bien në kundërshtim me ato që na kanë lënë të parët tanë apo ato të nxjerra nga dijetarët e kohës sonë. Kjo moskokëçarje i dedikohet pandehmës së tyre se gjoja ata po ecin gjurmëve të Ebu Bekrit, Umerit, Aliut dhe ibni Abbasit (radijall-llahu anhum). Kjo gjë s'do të kishte qenë kaq e rëndë, sikur këta njerëz të pranonin që edhe bashkëkohësit e tyre, të cilët kanë pikëpamje apo mendime të ndryshme, janë po aq të aftë për ixhtihad sa edhe ata vetë. Por ata këtë gjë s'e pranojnë.

Fanatizmi është prova më e qartë e ekstremizmit. Një ekstremist u drejtohet njerëzve kështu: "Unë e kam të drejtën për të folur, ndërsa detyra juaj është të dëgjoni. Unë e kam të drejtën për të udhëhequr, ndërsa detyra juaj është të më ndiqni. Mendimi im është i drejtë, s'mund të jetë i gabuar. Mendimi juaj është i gabuar, ai s'mund të jetë kurrë i drejtë".

Kështu një fanatik s'mund të merret vesh kurrë me të tjerët. Pajtimi është i mundshëm dhe mund të arrihet vetëm nëse njerëzit mbajnë qëndrim të moderuar, por fanatiku as s'e njeh dhe as që beson tek moderimi. Në marrëdhëniet me njerëzit, ai sillet si Lindja me Perëndimin; sa më afër që t'i afroresh, aq më larg largohet prej teje.

Problemi bëhet edhe më kritik kur një person i tillë paraqet prirjen për t'i kërcënuar të tjerët, jo domosdoshmërisht nga ana fizike, por duke i akuzuar ata për bid'at, shthurje, kufr dhe devijim. Një terrorizëm i tillë intelektual është më i tmerrshëm sa ai fizik.

Tipari i dytë i ekstremizmit fetar shfaqet në angazhimin e përhershëm për teprim dhe në përpjekjet për t'i detyruar të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë, pavarësisht se ka arsye të shumta për lehtësim dhe se faktikisht, All-llahu (xh.sh.) nuk ka urdhëruar për këtë gjë. Nëse dëshiron, një person i shtyrë nga devocioni dhe maturia, mund të ndjekë një mendim të vijës së ashpër, në

lidhje me disa çështje dhe në disa raste. Por, s’duhet të heqë dorë nga lehtësimi, kur ka nevojë për të. Një qëndrim i tillë nuk është në pajtim me mësimet e Kur’anit dhe Sunnetit, siç bëhet e qartë nga ajeti i mëposhtëm:

“All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju...”

(2:185)

Gjithashtu i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë në një hadith të cituar më parë: “Lehtësoni dhe mos vështirësoni”.³²

Gjithashtu ai ka thënë: “All-llahu dëshiron të zbatohen lejimet (lehtësimet) e Tij, ashtu siç urren që të kryhen mëkatet”.³³

Veç kësaj transmetohet që “sa herë që të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i duhej të zgjedhte midis dy obcioneve, gjithmonë zgjedhte më të lehtë, nëse kjo nuk përbënte një mëkat”.³⁴

T’ua ndërlikosh gjërat njerëzve dhe të shkaktosh ndrydhje në jetën e tyre, është në kundërshtim me cilësitë më të spikatura të të Dërguarit Muhammed (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), që janë përmendur në librat e shenjtë të mëparshëm dhe më vonë janë shpallur në Kur’an:

³² Sipas të gjitha autoriteteve

³³ Transmetuar nga Imam Ahmedit dhe Bejhekiu mbi autoritetin e Ibn Umerit, si dhe nga Taberiu mbi autoritetin e Ibn Abbasit

³⁴ Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi

“... që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, ua lejon ushqimet e këndshme dhe ua ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta”

(7:157)

Kjo është arsyeja që i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e zgjaste namazin kur ishte vetëm. Ai falte namaz gjatë natës përderisa i ënjteshin këmbët. Por, kur u printe njerëzve në namaz, ai e shkurtonte atë, duke marrë parasysh kushtet e pasuesve të tij dhe shkallën e qëndrueshmërisë dhe durimit të tyre.

Në lidhje me këtë, ai ka thënë: “Nëse dikush nga ju u prin njerëzve në namaz, ai duhet ta shkurttojë atë, sepse midis tyre gjenden njerëz të dobët, të sëmurë dhe pleq, dhe nëse dikush prej jush fal namaz vetëm, atëherë mund ta zgjasë namazin sa të dëshirojë”.³⁵

Ebu Mes’ud el Ensariu transmeton se një njeri i tha të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem): “O i Dërguar i All-llahut! Unë vonohem në namazin e sabahut (mëngjesit) vetëm sepse filani e zgjat atë”. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u zemërua si kurrë më parë dhe tha: “O njerëz! Disa nga ju bëjnë që njerëzit të mos i pëlqejnë punët e mira (namazin). Prandaj, cilido prej jush që u prin njerëzve në namaz, duhet ta shkurttojë atë, sepse mes tyre ka të dobët, pleq dhe prej atyre që kanë punë për të kryer”.³⁶

³⁵ Transmetuar me pajtim sipas autoritetit të Abdull-llah ibn Amrit

³⁶ Iddet: "Koha e pritjes e caktuar ligjërisht, gjatë së cilës gruaja e posa shkurorëzuar apo e lënë e vejë nuk guxon të martohet."

Siç e kemi përmendur më parë, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) reagoi në të njëjtën mënyrë, kur një njeri iu ankua atij se Muadhi (radijall-llahu anhu) e zgjaste namazin.

Enes ibni Maliku transmeton: i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Kur ngrihem për namaz, dua ta zgjas atë, por e shkurttoj kur dëgjoj të qarat e ndonjë fëmije, sepse nuk dua ta vë në vështirësi nënën e tij”. (Gjithashtu është e tepruar dhe mbingarkuese t’u kërkojë njerëzve të kryejnë punët shtesë (adhurimet nafile) në po atë mënyrë siç i kryejnë obligimet apo t’u kërkojë llogari për gjëra që janë mekruh (jo të pëlqyeshme), sikur të ishin të ndaluara (haram). Nga ne nuk kërkohet t’i ngarkojmë njerëzit, pos me atë që i ka ngarkuar All-llahu doemos; jashtë kësaj ata janë të lirë që po deshën, të shtojnë (nga nafilet), e po s’deshën, u mjaftojnë obligimet.

Ngjarja e mëposhtme tregon se i tillë ishte edhe mendimi i të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Njëherë një beduin e pyeti të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) mbi obligimet që kishte. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) përmendi vetëm tri: namazin (pesë kohët e tij), zekatin dhe agjërimin. Kur beduini e pyeti nëse duhej të bënte diçka tjetër veç këtyre, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u përgjigj: “Jo”, dhe shtoi që ai mund të bënte edhe më shumë se këto, në qoftë se dëshironte (nga nafilet). Duke u larguar, beduini u betua se s’do të bënte as më shumë dhe as më pak nga ç’i kishte kërkuar i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Kur e dëgjoji këtë, ai (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha: “Nëse po thotë të vërtetën, ai do të shpëtojë ose do të fitojë xhenetin”.³⁷

³⁷ Transmeton Buhariu

Në kohën tonë, nëse një musliman i kryen të gjitha obligimet (farzet) dhe ruhet nga mëkatet e mëdha, atëherë ai bën pjesë në Ummetin islam dhe konsiderohet si një nga mbrojtësit e tij, për aq kohë sa tregohet besnik ndaj All-llahut (xh.sh.) dhe të Dërguarit të Tij (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Bile, edhe nëse kryen disa gjëra të vogla të ndaluara (mëkate të vogla), sevabet e fituara nga kryerja e pesë namazeve të përditshme, namazit të xhumasë, agjërimit etj., do t'ia shlyejnë gabimet e vogla.

Kur'ani thotë:

“S’ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat.”

(11:114)

dhe në një ajet tjetër:

“Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha, të cilat u janë të ndalueshme, Ne ua shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm.”

(4:31)

Duke pasur parasysh argumentet e mësipërme nga Kur’ani dhe Sunneti, si mund ta dëbojmë nga bashkësia e Islamit një musliman, vetëm pse ai kryen disa punë të diskutueshme, për të cilat s’jemi të sigurt se a janë hallall (të lejuara) apo haram (të ndaluara), apo sepse nuk kryen diçka për të cilën s’jemi të sigurt se është vaxhib (obligim) apo mendub (e lavdërueshme)? Kjo është arsyeja përse e kundërshtoj prirjen e disa njerëzve të devotshëm për të pranuar dhe për t’u kapur pas mendimeve të vijës së ashpër, jo vetëm në praktikën e tyre personale, por edhe në ndikimin tek të tjerët për të kryer të njëjtën gjë. Gjithashtu, unë kundërshtoj akuzat që i bëjnë njerëzit e tillë kundër ndonjë dijetari musliman, i cili nuk pajtohet me vijën e tyre të mendimit dhe zgjedh rru-

gën e lehtësimit nën dritën e Kur'anit dhe Sunnetit, me qëllim që t'i lehtësojë njerëzit nga vështirësitë dhe shtrëngimet e tepërta në përditshmërinë e tyre fetare.

Tipari i tretë i ekstremizmit është teprimi fetar, i vjetëruar dhe i papërshtatshëm, si dhe mbingarkimi i të tjerëve dmth. në zbatimin e parimeve islame tek njerëzit në vendet joislame apo tek njerëzit që sapo e kanë pranuar Islamin. Në marrëdhëniet me këta njerëz duhet të vihet theksi në fundamentet e jo në çështjet e vogla dhe të diskutueshme. Para së gjithash, duhen bërë përpjekje për të korrigjuar konceptet dhe kuptimin e tyre të Islamit. Sapo të arrihet ky korrigjim i besimeve, atëherë mund të fillohet nga shpjegimi i pesë shtyllave të Islamit dhe dalëngadalë, mund të theksohen ato aspekte, të cilat lidhin besimet me praktikën e muslimanit dhe të cilat bëjnë që krejt jeta e tij të jetë mishërim i asaj që i pëlqen All-llahut (xh.xh.). Ky fakt është pranuar nga vetë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), kur e dërgoi Muadhin në Jemen. Ai i tha atij:

“Ti po shkon te një popull i Librit (të shenjtë) dhe kur të arrish atje, ftoji ata të dëshmojnë se s’ka zot përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij. Dhe nëse të binden për këtë, atëherë tregoju që All-llahu ka pëlqyer për ta pesë namaze për t’u kryer çdo ditë dhe çdo natë. Dhe nëse të binden për këtë, tregoju atyre që All-llahu ka pëlqyer për ta sadakanë (zekatin), që u merret të pasurve për t’iu dhënë të varfërve të tyre”.³⁸

Vini re shkallëzimin në thirrje në këshillën e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për Muadhin.

³⁸ Israilijat: tregime të vjetra të çifutëve, qofshin ato në Tevrat apo gjetiu

Gjatë një udhëtimi nëpër Amerikën Veriore, u trondita dhe u shqetësova kur pashë të rinj të devotshëm muslimanë, të cilët u përkisnin disa grupimeve islame, që kishin filluar një polemikë të madhe, për shkak se gjatë leksioneve që mbaheshin në xhami të shtunën dhe të dielën, muslimanët uleshin nëpër karrige, në vend që të uleshin përtokë në qilima dhe nuk ktheheshin nga Qabeja si të gjithë muslimanët, se vishnin këmisha dhe pantallona në vend të xhelabijeve, si dhe sepse ata hanin në tryeza, në vend që të hanin në tokë. Unë u zemërova nga ky lloj mendimi dhe sjelljeje mu në zemër të Amerikës Veriore, prandaj iu drejtova njerëzve:

“Do të ishte më e vlefshme, në këtë shoqëri materialiste, që ta drejtoni vëmendjen tuaj kryesore në thirrjen në monoteizëm (tevhid) dhe në adhurimin e All-llahut (xh.sh.), t’ua përkujtoni njerëzve botën tjetër, vlerat e çmuara islame dhe t’i paralajmëroni ndaj veprimeve të urryera në të cilat janë të zhytura vendet materialisht të zhvilluara. Normat e sjelljes dhe përmirësimet në praktikën fetare rregullohen nga vendi dhe koha. Kjo duhet bërë vetëm pasi të jenë forcuar parimet më të domosdoshme dhe fundamentale”.

Në një qendër tjetër islame, ishte bërë një rrëmujë e madhe rreth shfaqjes së një filmi historik apo edukues në xhami dhe disa njerëz thonin që “*xhamitë janë kthyer në kinema*” duke harruar që xhamia është për t’u shërbyer interesave të kësaj bote si dhe atyre shpirtërore. Gjatë kohës së të Dërguarit Muhammed (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) xhamia (mesxhid) ishte qendra e da’ves (thirrjes në Islam) dhe e shtetit, si dhe e veprimtarive shoqërore. Të gjithë e dimë që i Dërguari i dha leje një grupi njerëzish nga Abisinia për të treguar mjeshtërinë në hedhjen e heshtës mu në mes të xhamisë dhe e lejoi Aishen (radijall-llahu anhu) t’i shikonte ata.³⁹

³⁹ Transmeton Buhariu

Tipari i katërt i ekstremizmit shfaqet tek brutaliteti në marrëdhëniet me njerëzit, vrazhdësia në mënyrën e afrimit dhe tek ashpërsia në thirrjen e njerëzve në Islam, të cilat janë në kundërshtim me mësimet e Kur'anit dhe Sunnetit.

All-llahu (xh.sh.) na urdhëron të thërrasim në Islam dhe në mësimet e Tij me urtësi e jo me marrëzi, miqësisht e jo me fjalë të vrazhda:

“Ti thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata në atë mënyrë që është më e mira”.

(16:125)

Gjithashtu i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) përshkruhet kështu:

“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”

(9:128)

Kur'ani i drejtohet të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), duke përcaktuar marrëdhëniet e tij me shokët:

“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje...”

(3:159)

Fortësia dhe ashpërsia përmenden në Kur'an vetëm në lidhje me dy çështje. Së pari, në lidhje me luftën, kur një strategji ushtarake e suksesshme kërkon burrëri dhe heqje dorë nga butësia deri në fund të luftës:

“Luftoni jobesimtarët që i keni pranë jush, e le ta ndjejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre”.

(9:123)

Së dyti, në lidhje me zbatimin e ndëshkimit sipas Sheriatit, s’ka vend për mëshirë në zbatimin e urdhrave të All-llahut:

“Laviren dhe pushtin t’i rrihni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që i besoni All-llahut dhe botës tjetër”.

(24:2)

Por, në fushën e da’ves (thirrjes) s’ka vend për dhunë dhe vrazhdësi. Kjo evidencohet edhe në hadithet e mëposhtme: “All-llahu do mirësi (butësi) në të gjitha punët”⁴⁰ dhe “Mirësia i zbukuron gjërat, ndërsa dhuna i shëmton ato”, si dhe në fjalën e urtë të të parëve tanë: “Cilido që dëshiron të urdhërojë për të mirën e përbashkët, le ta bëjë këtë me butësi”.

Dhuna s’bën gjë tjetër veçse shtrembëron da’ven në rrugën e All-llahut (xh.sh.). Daaveja (thirrja në Islam) kërkon që të depërtosh në skutat më të fshehta të njeriut, në mënyrë që ta shndërrosh atë në një njeri të devotshëm në konceptet, ndjenjat dhe sjelljen e tij, duke ia ndryshuar mendimet, ndjesitë dhe vullnetin e tij, domethënë krejt qenien e tij dhe duke e kthyer atë në një njeri krejt tjetër. Gjithashtu ajo e shkund mbarë strukturën e shoqërisë dhe ndryshon besimet e saj të trashëguara, traditat e hershme, bindjet morale dhe sistemet mbizotëruese.

⁴⁰ Fakih: njohës i shkëlqyeshëm i Sheriatit

E gjithë kjo s'mund të arrihet pa urtësi dhe miqësi, dhe pa marrë parasysh natyrën njerëzore, këfortësinë e njeriut, kundërshtimin për të ndryshuar dhe dëshirën për të debatuar. Këto veçori bëjnë të nevojshëm përdorimin e mirësisë dhe butësisë, në përpjekje për t'u futur në zemrën dhe mendjen e tjetrit, në mënyrë që fortësia e tij të zbutet, ngurtësia të pakësohet dhe mburrja (mendjemadhësia) të kufizohet. Kjo mënyrë e të afruarit, siç përshkruhet në Kur'an, është zbatuar nga pejgamberët e mëparshëm dhe besimtarët e sinqertë, të cilët i kanë thirrur njerëzit në adhurimin e All-llahut (xh.sh.).

Shembujt mund të gjenden në thirrjen që i bëri Ibrahim babait dhe popullit të tij; në thirrjen e Shuajbit ndaj popullit të tij; thirrjen e Musait ndaj Faronit; në thirrjen e Besimtarit, në suren Jasin (36:20) si edhe në thirrjet e të tjerëve, të cilët i udhëzuan njerëzit në të vërtetën dhe të drejtën.

Le të dëgjojmë dhe të mendojmë për kurajon me të cilën Besimtari, një njeri nga populli i Faraonit i cili kishte iman (besim), iu drejtua Faraonit dhe popullit të tij duke shprehur përkatësinë e tij në atë popull, interesimin e tij për fatin e tyre dhe dëshirën e tij për qëndrueshmërinë e sundimit dhe lavdisë së tyre:

“O populli im! Sot pushteti është juaji në vend, po kush do të na mbrojë prej dënimit të All-llahut nëse ai na përfshin...”

(40:29)

Më pas, ai u përmend atyre kombe të tjera të cilat refuzuan të dëgjojnë mesazhin e All-llahut (xh.sh.):

“O populli im! Unë kam frikë për ju se po ju gjen si i gjeti popujt e mëparshëm! Si rasti i popullit të Nuhut, të Adit, të Themudit dhe të atyre që ishin pas. All-llahu nuk bën padrejtësi ndaj robërve”.

(40:30-31)

Më tej, ai përshkruan fatkeqësinë që mund t’u bie në Ditën e Gjykimit, ditë të cilën ata e besonin, në një mënyrë ose tjetër:

“O populli im! Unë kam frikë për ju ditën e britmës. Ditën, kur nga frika ktheheni të ikni e nuk ka kush që ta prapësojë prej jush dënimin e All-llahut. Atë që All-llahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë që e drejton.”

(40:32-33)

Ai e vazhdon lutjen e tij të zjarrtë në një mënyrë të butë dhe të dhemshur; ai paralajmëron, por edhe mbush me shpresë:

“O populli im! Ejani pas meje, e unë t’ju udhëzoj në rrugën e drejtë! O populli im! Kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se një përjetim i përkohshëm, ndërsa bota tjetër është ajo e përhershme.”

(40:38-39)

“Dhe, o populli im! Ç’është me ju që unë ju thërras në shpëtim, e ju më thërritni për në zjarr? Më thërritni ta mohoj All-llahun dhe ta adhuroj atë që nuk di asgjë për të, ndërsa unë ju thërras për tek I Gjithëfuqishmi, Mëkatfalësi!”

(40:41-42)

Ai e përfundon këshillën e tij me këto fjalë:

“Juve do t’ju bie ndërmend çka po ju them, se çështjen time ia besoj All-llahut; vërtet, All-llahu mbikëqyr robërit!”

(40:44)

Kjo është mënyra si duhet t’u drejtohem i njerëzve, të cilën çdo thirrës në Islam i kohës sonë duhet ta përvetësojë dhe ta zbatojë me guxim ndaj njerëzve të feve tjera.

Kjo gjë mishërohet tek këshilla, që ua dha All-llahu (xh.sh.) dy të dërguarve të tij, Musait dhe Harunit, kur i dërgoi tek Faraoni:

“Shkoni që të dy tek Faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.”

(20:43-44)

Në zbatim të kësaj, Musai (alejhis-selam) iu drejtua butësisht Faraonit:

“A ke ndërmend të pastrohesh. Unë të udhëzoj tek Zoti yt, e ti t’ia kesh frikën Atij”

(79:18-19)

Kështu s’duhet të çuditemi që njerëz me përvojë në thirrjen islame nuk i miratojnë dhe i kundërshtojnë metodat e disa të rinjve në debatimin me ata që kanë mendime të ndryshme. Në vend që t’i thërrasin njerëzit në Rrugën e All-llahut (xh.sh.) me urtësi, shumë shpesh ata sillen me vrazhdësi, rreptësi dhe papjekuri. S’bëhet dallim midis të moshuarit dhe të riut, s’u bëhet nderim i veçantë atyre, mosha dhe statusi i të cilëve meritojnë respekt të posaçëm dmth. prindërve, mësuesve, të diturve apo atyre që janë të parë në da’ve dhe xhihad. Ata as që bëjnë diferencimin

midis atyre shtresave të bashkësisë të cilat deri diku kanë arsye, si profanët, analfabetët dhe të mashtruarit, të cilët luftojnë pareshtur për të fituar kafshatën e gojës, dhe atyre të cilët nuk kanë arsye, por e kundërshtojnë aktivisht Islamin nga urrejtja ndaj tij, ligësia apo tradhtia, por jo nga padituria.

Kjo mendjecekësi mbizotëron akoma në shoqërinë islame, pavarësisht nga fakti që dijetarët e hershëm të hadithit bënë një dallim të qartë midis risimtarëve të zakonshëm, të cilët nuk i ftonin njerëzit në risitë e tyre dhe atyre, që me qëllim përhapnin dhe mbronin bid'atet (risitë) e tyre. Transmetimet e të parëve janë pranuar, ndërsa ato të të dytëve janë hedhur poshtë.

Dyshimi dhe mosbesimi janë gjithashtu shfaqje të ekstremizmit. Një ekstremist është i gatshëm t'i akuzojë të tjerët dhe të japë gjykime të shpejta, në kundërshtim me parimin e pranuar nga të gjithë se *"i pandeburi është i pafajshëm deri kur t'i vërtetohet fajësia"*. Ai e konsideron një person si fajtor, në çastin në të cilin dyshon tek ai për diçka. Në vend që të kërkojë shpjegime, ai shkon drejt e në përfundime. Gabimi bëhet mëkat dhe mëkati kufr!! Një reagim i tillë është dhunim i plotë i frymës dhe mësimëve të Islamit, të cilat i inkurajojnë muslimanët të mendojnë mirë për njëritjetrin, të mundohen të gjejnë një shkak për sjelljen jo të mirë të të tjerëve dhe t'u ndihmojnë atyre në përmirësimin e fjalëve dhe veprimeve të tyre. Singeriteti dhe ndershmëria fetare e atyre që nuk pajtohen me një ekstremist të tillë, vihen në dyshim. Një ekstremist i akuzon të tjerët si fajtorë për shkelje, risi apo mosrespektim të Sunnetit të të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sellem) edhe nëse pikëpamjet e tyre janë të bazuara mbi tekste të vërteta islame.

Mund të sjellim shumë shembuj: nëse debaton se mbajtja e shkopes apo ngrënia ulur në tokë s'ka të bëjë aspak me Sunnetin, do të akuzohesh se nuk ke respekt ndaj Sunnetit apo nuk e do vetë të

Dërguarin. Këtyre akuzave nuk u shpëtojnë as shumë dijetarë muslimanë dhe ulema. Nëse një fakih (jurist) jep një fetva, e cila ua lehtëson gjërat muslimanëve, ai akuzohet se është i shkujdesur në çështjet e fesë; nëse një thirrës në Islam mundohet t'i ftojë njerëzit në Islam në një mënyrë të përshtatshme për frymën dhe shijen e kohës në të cilën jetojmë, ai akuzohet se po lëshon pe dhe se është nën ndikimin e qytetërimit perëndimor.

Veç kësaj, këto akuza nuk u bëhen vetëm të gjallëve por edhe të vdekurve, të cilët s'janë në gjendje të mbrohen. Asnjëri prej atyre që kanë mendime të ndryshme s'mund t'u shpëtojë akuzave të padrejta diskriminuese si psh. akuzohet si mason, si predeterminist, si xhehmij apo si racionalist muëtezil. Bile edhe juristët e mëdhenj (imamët e medh'hebeve) të Islamit, të cilët themeluan shkollat kryesore të mendimit ligjor dhe të cilët kanë fituar respektin e muslimanëve gjatë shekujve, nuk u kanë shpëtuar fyerjeve të ulëta nga ana e ekstremistëve. Me të vërtetë, e tërë historia e Ummetit islam pas shekullit të katërt hixhrij, me trashëgiminë e saj të lavdishme dhe qytetërimin pa precedent, ka qenë gjithashtu objekt kritikash të pabaza. Kjo histori konsiderohet nga ekstremistët si burim i të këqijave të sotme dhe rrënja e sëmundjes sonë. Për disa ekstremistë, ajo ishte periudha e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve, e luftës për pushtet vetjak, ndërsa për të tjerë, një periudhë injorance dhe bile kufri.

Kjo prirje destruktive nuk është e re. Ekstremistët kanë ekzistuar bile dhe në kohën e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Njëherë, një ekstremist prej ensarëve (muslimanëve të Medines) e akuzoi të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për favorizim në pjesëtimin dhe ndarjen e presë së luftës.

Gabimi më i rëndë i ekstremistëve të sotëm është dyshimi. Sikur ta kishin kuptuar Kur'anin dhe Sunnetin, ata do të kishin zbuluar se të dy këto synojnë të mbjellin në mendjen e çdo muslimani konfidencën dhe besimin ndaj muslimanëve të tjerë.

Bile një muslimani nuk i lejohet të trumbetojë gabimet dhe fajet e vogla të të tjerëve ose të errësojë virtytet e tyre; kështu disa njerëz janë të interesuar për të kritikuar të tjerët dhe lavdëruar vetveten:

“... Pra, mos lavdëroni veten, se Ai e di kush është i ruajtur.”

(53:32)

Islami paralajmëron fuqimisht kundër dy veçorive: heqjes së shpresës nga mëshira e All-llahut dhe dyshimit tek të tjerët. All-llahu (xh.sh.) thotë:

“O ju që keni besuar! Largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat...”

(49:12)

Në lidhje me këtë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) thotë: “Shmanguni supozimit, sepse supozimi është pjesa më e rrejtshme e të folurit”.⁴¹

Origjina e gjithë kësaj është mendjemadhësia në vetvete dhe përçmimi i të tjerëve. Këto janë baza e aktit të parë të mosbindjes, atij të Iblisit (Shejtanit), i cili e kundërshtoi urdhrin e All-llahut për t'i rënë sexhde Ademit, duke pretenduar:

⁴¹ Sipas të gjitha autoriteteve

“Unë jam më i mirë se ai...”

(38:76)

Është vlerë t'i kushtojmë vëmendje paralajmërimit të mishëruar në këtë hadith: “Nëse dëgjoni një njeri të thotë se njerëzit janë të shkatërruar, ai vetë është më i shkatërruari (se është mburravec dhe mendjemadh)”.⁴²

Dhe në një transmetim tjetër: “ai vetë i ka shkatërruar ata”, dmth. me dyshimin dhe snobizmin e tij, si dhe duke bërë që ata ta heqin shpresën nga mëshira e All-llahut.

Mendjemadhësia është një nga tiparet shkatërruese, të cilat shkaktojnë degjenerim dhe që janë quajtur nga dijetarët tanë islamë si “mëkatet e zemrave”. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) na ka paralajmëruar kundër këtyre mëkateve me thënien e tij: “Ka tri mëkate shumë të mëdha (shkatërruese): koprracia e shfrenuar, epshi dhe mendjemadhësia.” Një musliman i vërtetë nuk mburret kurr me punën dhe veprat e tij, sepse ai gjithmonë frikësohet të mos ketë hyrë në atë punë diç nga ajo që do të mund ta bënte atë të papranuar (te All-llahu), e ai nuk di për këtë.

Kur’ani i përshkruan mu’minët bamirës:

“Dhe ata, të cilët japin nga ajo që u është dhënë, pse e dinë se do të kthehen tek Zoti i tyre, andaj zemrat e tyre i kanë të frikësuar.”

(23:60)

⁴² Transmeton Muslimi

Transmetohet në hadithe se ky ajet kur'anor bën fjalë për ata njerëz të cilët kryejnë punë të mira, por frikësohen se All-llahu (xh.sh.) mund të mos ua pranojë ato. Ibni Ata' ka thënë: “All-llahu mund të ta ketë hapur derën e bindjes, por nuk mund të ta ketë hapur derën e pranimi. Ai mund të ta ketë mundësuar kryerjen e mëkatit, e ai të jetë shkak i arritjes (tek All-llahu). Mëkati, që u mëson përlulje dhe nënshtrim pas tij (All-llahut), është më i mirë sesa bindja, që lind sqimën dhe mendjemadhësinë!”

Kjo bazohet në urtësinë e thënies së Ali ibn Ebu Talibit (radijall-llahu anhu):

“Një prapësi, që të bën të pendohesh, është më e mirë përpara All-llahut, sesa një vepër e mirë e cila sjell arrogancë”.

Ibni Mes'udi (radijall-llahu anhu) ka thënë: “Shkatërrimi shkaktohet nga dy gjëra: krenaria dhe dëshpërimi. Lumturia s'mund të arrihet pa luftë dhe përpjekje. Një njeri mendjemadh s'bën asnjë përpjekje, sepse ai beson se është i përkryer; një njeri i dëshpëruar nuk bën asnjë përpjekje, sepse ai beson se ajo është e padobishme”.

4. RËNIA NË HUMNERËN E TEKFIKIT

Ekstremizmi arrin kulmin e tij, kur një grup i vetëm i privon njerëzit e tjerë nga e drejta për siguri dhe mbrojtje, duke e quajtur të ligjshme vrasjen e tyre dhe konfiskimin e pasurisë së tyre. Natyrisht, kjo ndodh kur ekstremistë i quan të gjithë njerëzit, me përjashtim të grupit të tij, si

kuffarë (jobesimtarë). Ky lloj ekstremizmi këput çdo lidhje midis një personi të tillë dhe Ummetit islam. Në këtë grackë ranë havarixhët, megjithëse ishin të njohur për kryerjen me rreptësi të detyrimeve fetare si psh. namazit, agjërimit dhe leximit të Kur'anit. Megjithatë, mendimi i tyre, ashtu si edhe vetëdija, u shtrembërua dhe u prish. Ata ishin kaq të dhënë pas besimeve dhe sjelljes së tyre, saqë veprat e tyre të shëmtuara i shihnin si të mira dhe pa dashur, u shmangën nga rruga e drejtë.

I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e ka përshkruar kështu devocionin e këtyre njerëzve: “Njëri nga ju do ta quajë të parëndësishëm namazin e tij, krahasuar me namazin e tyre (havarixhëve) dhe kijamin (ibadetin natën) e tij, krahasuar me atë të tyre, leximin (e Kur'anit) e tij, krahasuar me leximin e tyre”.⁴³ Po ashtu, për leximin e tyre të Kur'anit ai ka thënë: “Ata do ta lexojnë Kur'anin, por ai s'do të shkojë përtej fyteve të tyre.” “Ata (havarixhët) dalin nga feja ashtu siç del shtiza nga shigjeta”.⁴⁴ Gjithashtu i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka treguar edhe atë që do t'i dallojë ata, e ajo është se: “do t'i luftojnë pasuesit e Islamit dhe t'i lënë idhujtarët”.⁴⁵

Kjo është arsyeja se pse një dijetar musliman, kur ra në duart e tyre dhe u pyet për identitetin e tij, tha se ishte mushrik (idhujtar), i cili ishte shumë i interesuar të dinte rreth mesazhit dhe librit të All-llahut. Sapo e morën vesh këtë, havarixhët i thanë atij se do ta mbronin atë dhe se do ta lejonin të kalonte i pacenuar. Në mbështetje të vendimit të tyre, ata lexuan këtë ajet të Kur'anit:

⁴³ Transmeton Muslimi

⁴⁴ Transmeton Muslimi

⁴⁵ Transmeton Muslimi

“E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t’i dëgjojë fjalët e All-llahut, e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt. Këtë, ngase ata janë popull që nuk dinë.”
(9:6)

Çfarë ironie! Sikur ky njeri të kishte pranuar se ishte musliman, ata do ta kishin vrarë!

Për fat të keq, disa muslimanë akoma s’kanë nxjerrë mësimë prej kësaj. Grupi i ashtuquajtur *“Xbemaat-ut-Tekfir vel Hixbreh”* duket se ec gjurmëve të havarixhëve. Ata cilësojnë si kafir cilindo që kryen një mëkat dhe ngul këmbë në të, e nuk pendohet për të. Më të dënuar prej tyre janë sundimtarët, të cilët nuk zbatojnë Sheriatin si dhe popujt që u nënshtrohen sundimtarëve të tillë. Akoma më shumë mëkatarë, sipas pikëpamjeve të tyre, janë ulematë (dijetarët), të cilët nuk i dënojnë ata si kuffarë (jobesimtarë), si dhe ata, të cilët u kundërvihen besimeve të grupit dhe që zbatojnë ligjet e përpunuara nga juristët (imamët) e mëdhenj të Islamit mbi bazë të Ixhmasë, Kijasit, Maslaha Murseleh apo Istihsanit.⁴⁶ Veç kësaj, cilido që betohet për besnikëri ndaj kauzës së tyre dhe futet në grupin e tyre, por që më pas, për një arsye apo një tjetër, vendos të largohet prej tij, konsiderohet si murtedd (renegat) dhe duhet të dënohet me vdekje. Ata i cilësojnë të gjitha periudhat islame pas shekullit të katërt hixhri, si periudha injorance, kufri dhe adhurimi të idhujve të traditës në vend të All-llahut (xh.sh.).

⁴⁶ Kijas: "Deduksioni logjik nga Kur'ani dhe Sunneti si burime të Ligjit islam". Maslaha Murseleh: "Mirëqenia publike që nuk është as e urdhëruar e as e ndaluar në ndonjë burim islamik, si burim i Ligjit islam." Istihsan: "Si burim i Ligjit islam - pranimi i një urdhri për shkak të paanësisë së tij më të lartë në krahasim me një ligj tashmë të miratuar."

Kështu, ky grup e tepron aq shumë me akuzat e tij ndaj të tjerëve për kufr, saqë nuk kursehen as të vdekurit. Ky grup futet në ujëra të thella, sepse të akuzosh një musliman për kufr është një çështje shumë serioze, e cila ka pasoja shumë serioze, sepse bëhet e ligjshme (ligjësohet) vrasja e tij dhe konfiskimi i pasurisë së tij. Duke qenë kafir, ai duhet të ndahet nga gruaja dhe fëmijët, këputet çdo lidhje e tij me muslimanët e tjerë, ai duhet të privohet nga trashëgimi dhe prej tij s'mund të trashëgohet, atij i mohohet varrimi islam dhe namazi i xhenazes si dhe nuk duhet të varroset në varrezat muslimane. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Kur një musliman e quan kafir një musliman tjetër, atëherë, pa dyshim. njëri prej tyre është i tillë”.⁴⁷ Kjo do të thotë që, nëse akuza është e pavlerë dhe e pabazuar, atëherë ky cilësim i kthehet akuzuesit, i cili vihet përballë një rreziku të madh, në këtë botë dhe në tjetrën.

Usameh ibn Zejdi ka thënë: “Nëse dikush thotë: Dëshmoj se nuk ka zot përveç All-llahut, ai ka përqafuar Islamin dhe për pasojë, jeta dhe pasuria e tij janë të sigurta. Nëse e thotë këtë nga frika ose për t'u mbrojtur nga shpata, ai do të japë llogari përpara All-llahut. Ne duhet të gjykojmë vetëm nga ajo çfarë paraqet”.⁴⁸

I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e qortoi Usamen, kur mori vesh se ky i fundit gjatë një beteje kishte vrarë një njeri që kishte shqiptuar shehadetin. Kur Usame tha se në atë kohë ai mendoi se ai njeri kishte vepruar kështu nga frika, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha: “A mos e pe se ç'kishte në zemër, pasi pohoi se s'ka zot përveç All-llahut?”

⁴⁷ Transmeton Buhariu

⁴⁸ Transmeton Buhariu

Uσαμε tregon: “Ai (i Dërguari) vazhdoi të ma përsëriste këtë gjë, saqë dëshiroja të mos e kisha pranuar Islamin para asaj dite”.

Sheriati na mëson se ata, të cilët e përqafojnë Islamin me singeritet dhe bindje, nuk mund të dëbohen nga bashkësia e tij, veçse me argumente bindëse se ata kanë dalur nga ai. Bindja pra nuk mund të fshihet me dyshim. Bile edhe mëkatet e mëdha si vrasja, prostitucioni dhe konsumimi i alkoolit nuk e nxjerrin muslimanin nga Islami, me përjashtim të rastit kur personi në fjalë nuk tregon respekt, e kundërshton apo refuzon ta njohë Sheriatin.

Kjo është arsyeja që Kur’ani vendos vëllazëri fetare midis personit që kryen një vrasje me pararendim dhe të afërmit të të vrarit musliman, siç tregohet në këtë ajet:

“Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet kuptueshëm dhe shpagimi atij le t’i bëhet me të mirë.”

(2:178)

Gjithashtu, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) iu drejtua një personi i cili mallkoi një pijanec, që ishte ndëshkuar më shumë se një herë për alkoolizëm: “Mos e mallko atë, sepse ai e do All-llahun dhe të Dërguarin e Tij”.⁴⁹

Për më tepër, Sheriati ka caktuar ndëshkime të ndryshme për krime si vrasja, prostitucioni dhe dehja. Sikur të gjitha këto krime të kishin qenë kufr, atëherë ato do të ishin ndëshkuar (njësoj) me ndëshkim të murtedit!

⁴⁹ Transmeton Buhariu

Të gjitha dyshimet e errëta dhe të paqarta, mbi të cilat i mbështesin akuzat e tyre ekstremistët, kundërshtohen nga tekste fundamentale dhe kategorike në Kur'an dhe Sunnet. Nga ky lloj i të menduarit Ummeti islam është liruar shekuj më parë, e tani kanë ardhur këta ta përtërijnë atë, por jo, jo!!

KAPITULLI I DYTË

SHKAQET E EKSTREMIZMIT

Ekstremizmi nuk lind rastësisht. Ai duhet të ketë shkaqe dhe motive. Ashtu si organizmat e gjalla, ngjarjet dhe veprimet s'mund të dalin nga hiçi dhe s'mund të mbijnë pa fara. Përkundrazi, ato rregullohen nga ligji i shkakut dhe pasojës, një nga Sunenet⁵⁰ e All-llahut. Prandaj, njohja e shkaqeve është e domosdoshme, në mënyrë që të jemi në gjendje të përcaktojmë ilaçin e shërimit, i cili, nëse flasim me terma mjekësorë, duhet të paraprihet gjithmonë nga diagnoza. Por, diagnoza është shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur, nëse nuk dihen shkaqet. Duke e pasur këtë parasysh, ne do të mundohemi të shqyrtojmë shkaqet dhe motivet, të cilat kanë lindur ekstremizmin, një term, i cili është bërë sinonim i guluvit dmth. teprimit në fe.

Që në fillim, duhet të kuptojmë se një shkak i vetëm nuk mund të jetë përgjegjës për përhapjen e ekstremizmit. Ai është një fenomen kompleks me shkaqe të shumta të ndërthurura, disa prej të

⁵⁰ Sunen: "Ligjet apo shembujt në Gjithësi"

cilave janë direkte ndërsa të tjerat indirekte, disa gjenden në të kaluarën e largët, të tjerat në kohën e sotme. Si rrjedhim, ne nuk do të përqëndrohemi vetëm në një shkak, duke mos i përfillur të tjerët, siç bëjnë disa persona që përkrahin ca shkolla të mendimit.

Psikologët e veçanërisht psikoanalistët, sjelljen ua dedikojnë disa shkaqeve psikologjike subkoshiente.

Ndërkohë, sociologët vënë në dukje paaftësinë e njeriut përballë ndikimit të shoqërisë dhe mjedisit; për ta njeriu është thjesht një kukull e pajetë e cila vërtetet nga dora e shoqërisë, siç thotë Dyrkemi.

Përkrahësit e materializmit historik e vënë theksin tek aspektet materiale dhe forcat ekonomike, të cilat, sipas tyre, krijojnë ngjarjet dhe ndryshojnë rrjedhën e historisë.

Nga ana tjetër, të tjerët, të cilët kanë një pikëpamje më të plotë dhe më të ekuilibruar, besojnë se shkaqet janë të ndërlikuara dhe të ndërthurura, të cilat sjellin pasoja të ndryshme të cilat, megjithëse ndryshojnë nga një shkak tek tjetri, lënë gjurmën e tyre të pamohueshme në analizimin përfundimtar, te dikush më pak e te dikush më shumë. Është e rëndësishme që të mos përqëndrohemi vetëm mbi një shkak të ekstremizmit që e vërejmë ne, sepse shkaqet e tij janë të ndryshme dhe mund të jenë direkte ose indirekte, të dukshme apo të padukshme. Shkaqet e tij mund të jenë fetare, politike, shoqërore, ekonomike, psikologjike, intelektuale ose kombinim i të gjitha këtyre, apo i disa prej tyre. Shkaku kryesor mund të gjendet në vetë ekstremistin, ose nëse vazhdojmë së hulumtuari mund të gjendet shkaku, apo një pjesë e tij, brenda familjes së tij, tek prindërit dhe vëllezërit e tij dhe në marrëdhëniet e tij me anëtarët e tjerë të familjes ose, nëse shqyrtojmë në thellësi, mund të gjendet në shoqërinë e tij dhe në të gjitha kontradiktat e saj midis

besimit dhe sjelljes, obligimit dhe realitetit, fesë dhe politikës, fjalëve dhe veprimeve, aspiratave dhe arritjeve, laikes dhe fetares. Natyrisht, nëse këto kontradikta tolerohen nga brezi i vjetër, ato s'mund të tolerohen nga të rinjtë. Nëse disa të rinj i tolerojnë dhe durojnë, kjo s'është veçse e përkohshme.

Gjithashtu ekstremizmi mund të lindë si pasojë e korrupsionit të regjimeve dmth. despotizmit të sundimtarëve, synimeve të tyre egoiste, zbatimit të këshillave që marrin nga këshilltarë të korruptuar apo nga armiqtë e ndryshëm të Ummetit si dhe mospërfilljes së të drejtave të popujve të tyre. Këto gjëra kanë bërë që Kur'ani dhe sundimtari, apo feja dhe shteti të shkojnë në drejtime të kundërta e të mos takohen.

Pa dyshim, një nga shkaqet kryesore të ekstremizmit është mungesa e njohjes dhe e mendjemp-rehtësisë për të kuptuar qëllimet, shpirtin dhe thelbin e Dinit (fesë islame). Megjithatë, me këtë shkak nuk nënkuptoj inorancën e plotë në fe, sepse ajo nuk të çon në ekstremizëm apo teprim, por në të kundërtat e tyre, domethënë në degjenerim dhe shthurje. Prapëseprapë, ajo do të thotë një njohje gjysmake. Një njeri mund të pretendojë dhe disa herë të besojë, se ai di çdo gjë që është për t'u ditur, se ai është dijetar, fakih. Por në të vërtetë, ai ka vetëm një turli "*diturie*" të patretur dhe të papërvetësuar, e cila as ta rrit mendjemp-rehtësinë, as ta qartëson shikimin. Një njeri me një "*dituri*" të tillë, përqëndrohet vetëm në gjërat anësore dhe të parëndësishme dhe si pasojë, nuk vë re lidhjen midis pjesëve që formojnë të tërën (dhe vetë të tërës) ose ndërmjet teksteve të prera dhe fundamentale me ato alegorike. Për më tepër, ky njeri s'mund të sintetizojë ose t'i japë përparësi argumentit para mendimeve të dikujt. Kini kujdes nga rreziku i një diturie të tillë gjysmake. Ebu Is'hak esh-Shatibiu (All-llahu e mëshiroftë) e ka trajtuar këtë gjë në librin e tij unik "*El I'tisam*". Ai thotë që besimi i tepërt në vetvete dhe mendjemadhësia janë shkaqet rrënjësore

të bid'atit dhe përçarjes së Ummetit, dhe si të tilla, mund të çojnë në skizmë të brendshme dhe në dekompozim gradual. Gjithashtu, ai thotë se kur një njeri pretendon pa të drejtë apo e konsiderojnë të tjerët, se është i ditur në çështjet e fesë dhe i aftë për të kryer Ixhtihad, si dhe kur vepron kështu, duke pretenduar se ka të drejtë të paraqesë mendime dhe interpretime të ndryshme, por këtë e bënë ndonjëherë në çështjet parcialet dhe anësore (të dorës së dytë) të fesë - e ndonjëherë në krucialet dhe fundamentet e saj - nga fundamentet akaidologjike ose atyre praktike dhe kështu e shohim atë duke u marrë me disa çështje të vogla të Sheriatit për t'i rrënuar ato të mëdhatë, derisa të përputhet ai (Sheriati) me mendimin e tij fillestar, pa i përfshirë kuptimet e tij dhe pa u thelluar në kuptimin e qëllimeve të tij, atëherë ai është pa dyshim një mubtedi' (risimtar). Në hadithin e mëposhtëm, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) na paralajmëron kundër një personi të tillë:

“All-llahu (xh.sh.) nuk e merr diturinë duke e hequr atë nga (zemrat) e njerëzve, por e merr kur s'mbetet më asnjë dijetar dhe njerëzit do të marrin si prijës të tyre njerëz injorantë, të cilët kur të pyeten, do të japin vendim pa pasur dituri. Kështu ata do ta humbin rrugën dhe do t'i humbin të tjerët”.⁵¹

Ata që dinë do të kuptojnë nga hadithi i mësipërm që (njerëzit) populli nuk shkon në rrugë të gabuar prej ulemave të vërtetë, por ai e humb rrugën kur, në mungesë të dijetarëve të tillë, u drejtohen gjysmëdijetarët, të cilët u japin atyre këshilla të gabuara. Kështu, ka një thënie se një njeri i besueshëm s'e tradhton kurrë atë që i besohet, ndërsa tradhtari e bën këtë menjëherë. Kësaj

⁵¹ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi

thënie mund t'i shtojmë: një alim i vërtetë kurrë nuk nxjerr risi në fe, ndërsa gjysmalimi e bën këtë.

Enes ibn Maliku (radijall-lahu anhu) transmeton: “Njëherë Rebian e panë duke qarë me hidhërim. Kur u pyet nëse i kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi, ai u përgjigj: Jo, por populli po kërkon fetva nga persona që s’kanë dituri!”

Është fakt se dituria gjysmake, e shoqëruar me krenari dhe mendjemadhësi, është më e rrezikshme dhe më shkatërrimtare sesa injoranca e plotë e pranuar, sepse dituria gjysmake është injorancë e një personi, i cili nuk është i vetëdijshëm për kufizimet e vetvetes, i cili nuk e di se nuk di. Një injorancë e tillë shfaqet në shumë mënyra, më e rëndësishme prej të cilave është këmbëngulja në kuptimin e dukshëm të teksteve, duke mos përfillur thelbin dhe qëllimet e tyre. Ky fenomen nuk është i ri. Shekuj më parë, shkolla Dhahirijeh (e fjalëpërfjalshme) e mendimit ka bërë pikërisht të njëjtën gjë. Ithtarët e kësaj shkolle e hodhën poshtë “*Ta’lil ul Ahkam*”⁵² dhe si rrjedhim edhe Kijasin (analogjinë), sepse ata besonin se Sheriati bën diferencim midis identikeve (të njëjtave) dhe i bashkon (barazon) të ndryshmet.

Dhahirijtë e sotëm pasojnë ata të vjetrit duke u munduar t’i rregullojnë veprimet e ibadetit dhe çështjet e tjera fetare pa asnjë lloj racionalizimi, reflektimi apo përpjekjeje për të kuptuar domethëniet e tyre të thella. Ndoshta i vetmi ndryshim midis dy shkollave është se pasuesit e së vjetrës ishin shumë më të përkushtuar ndaj bindjeve të tyre, ndërsa pasardhësit e tyre nuk e pranojnë kurrë se ata vetëm ndjekin verbërisht qëndrimet negative të paraardhësve të tyre dmth

⁵² Ta’lil ul Ahkam: "Racionalizimi i verdikteve ligjore në Sheri'at"

kundërshtimin e plotë të Ta'lilit. Mendimi im personal, ashtu si dhe ai i dijetarëve të tjerë të cilët e kanë studiuar këtë çështje në thellësi, është që ibadeti është shkaku dhe qëllimi i detyrimeve (El-Ibadat), të cilat s'janë dhe kurrë s'mund të jenë objekt vlerësimi. Megjithatë, mësimet që synojnë të rregullojnë jetën tonë mund dhe duhet të analizohen (El-Adat dhe El-Muamelat).⁵³

Prandaj është e gabuar të thuhet se një njeri, i cili u ndihmon me para muslimanëve të varfër apo financon projekte të dobishme islame, mund të shkarkohet nga obligimi i haxhxhit; si dhe se dhënia e vlerës në para të "*haxhxb ut temettu we el-kiran*"⁵⁴ në sadaka apo kiran gjatë haxhxhit është më e mirë sesa kurban i detyrueshëm. Kjo është njësoj sikur të thuash se taksat e kohës sonë mund ta zëvendësojnë zekatin, shtylla e tretë e Islamit dhe e barabartë për nga vlera me namazin. Me të vërtetë, shumë rrallë në Kur'an përmendet namazi pa u përmendur menjëherë pas tij zekati. Gjithashtu, s'mundet që një muaj tjetër ta zëvendësojë Ramazanin për agjërim, as ndonjë ditë tjetër s'mund ta zëvendësojë të premtën për faljen e namazit të xhumasë, i cili është obligim javor për muslimanët. Përveç çështjeve të pastra të devotshmërisë (El-Ibadat), në çështjet e tjera (El-Adat dhe El-Muamelat) ne mund të shqyrtojmë dhe të marrim parasysh kuptimet dhe qëllimet që fshehen në brendësi të tyre. Sapo t'i nxjerrim, ne mund të bazojmë vendime mbi to si dhe në bazë të tyre, mund të pranojmë ose të hedhim poshtë vendime të ndryshme.

Le të shqyrtojmë tekstet e mëposhtme:

⁵³ Autenticiteti i kësaj bazohet në dëshminë nga Kur'ani dhe Sunneti, ndërsa cekur nga Imam esh-Shatibiu në veprat e tij *el-Muwafekat dhe el-I'tisam*

⁵⁴ Një kafshë e ofruar si sakrificë nga ana e pelegrinit (haxhiut) gjatë umres ("*haxhxbhit të vogël*") para haxhxhit duke veshur ihramin (veshjen e haxhilerëve) veçmas për të dy këto akte."

a) Transmetohet në një hadith të vërtetë⁵⁵ se muslimani s'duhet të mbajë me vete ndonjë kopje të Kur'anit kur është duke udhëtuar nëpër vendin e jobesimtarëve apo të armikut. Por nëse analizojmë shkakun që qëndron pas një ndalimi të tillë, do të arrijmë në përfundimin se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e ndaloi këtë gjë duke patur parasysh se jobesimtarët mund ta dëmtojnë apo ndotin Librin. Në mungesë të një rreziku të tillë, muslimanët mund ta marrin atë me vete ku të duan. Kjo është një praktikë e zakonshme midis muslimanëve sot. Njerëzit e feve dhe besimeve të tjera janë në garë me njëri-tjetrin për shpërndarjen e *"librave të tyre të shenjtë"* dhe për këtë qëllim po përdorin të gjitha mjetet e mundshme. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe muslimanët nëpërmjet përkthimeve të kuptimeve të Kur'anit për ata që nuk e njohin arabishten.

b) Një hadith tjetër i vërtetë i ndalon një gruaje muslimane të udhëtojë e pashoqëruar nga një mahrem.⁵⁶ Sigurisht, qëllimi kryesor i këtij ndalimi ishte mbrojtja e gruas, në një kohë kur udhëtimi ishte shumë i vështirë dhe i rrezikshëm. Por sot, mjetet e transportit të përdorura nga udhëtarët i kanë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme rreziqet për një grua që udhëton vetëm. psh. bashkëshorti i saj e çon atë në aeroport dhe kujdeset për të derisa të niset. Kur mbërrin në aeroportin tjetër, ajo pritet nga një mahrem, i cili e shoqëron atë deri në vendin e dëshiruar. Me të vërtetë, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) parashikoi një zhvillim të tillë kur tha se do të vijë një kohë, në të cilën njerëzit do të udhëtojnë nga Iraku në Kabe (Mekke) duke mos iu frikësuar askujt përveç All-llahut (xh.sh.).

⁵⁵ Transmetojnë Maliku, Buhariu, Muslimi dhe përmbledhësit e suneneve të tjera

⁵⁶ Mahrem: "I afërt (mashkull), të cilit për arsye të lidhjeve familjare nuk i lejohet të martohet me gruan në fjalë."

c) Gjithashtu i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk e lejoi një musliman, i cili kishte ndenjor larg familjes për një periudhë të gjatë kohe, të shkonte në shtëpi natën. Vetë ai (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e kishte për zakon të kthehej në shtëpi vetëm në mëngjes ose herët në mbrëmje. Ka dy arsye për këtë gjë. Së pari, kthimi në shtëpi papritmas pas një mungese të gjatë mund të merret se burri s'ka besim ndaj gruas së tij dhe si rrjedhim, do ta kapë atë në befasi. Ky lloj mosbesimi është i papranueshëm për marrëdhëniet bashkëshortore në Islam. Së dyti, mund të thuhet se ky ndalim synon t'i japë gruas të drejtën për të marrë vesh mbërritjen e burrit, në mënyrë që të zbukurohet për të. Por në kohën e sotme, një udhëtar mund të kthehet në shtëpi në cilëndo orë të dojë, me kusht që ta informojë gruan e tij me telefon, letër, teleks, telegram etj. Veç kësaj, udhëtari i sotëm nuk mund të zgjedhë gjithmonë se kur do të udhëtojë, sepse ai është i varur nga planet dhe oraret e punës dhe atyre të komunikacionit. Prandaj ky ndalim s'mund të merret ashtu siç duket, por duhet analizuar në bazë të qëllimit të tij themelor dhe të shikohet në lidhje me rrethanat e kohës dhe vendit.

Siç u përmend më lart, obligimet në lidhje me ibadetet s'mund të racionalizohen aq sa të përjashtohet zekati duke pretenduar se ai më shumë është pjesë e sistemit ekonomik-financiar sesa ibadet. Zekati, jo vetëm që është shtyllë e Islamit, një detyrë fetare dhe caktim Hyjnor, por ai përbën një burim të përherëshëm dhe të rëndësishëm të ardhurash në Sheriatin islam, prandaj ai është edhe një shtyllë e sistemit ekonomik islam. Kjo është edhe arsyeja pse të gjitha medh'hebet zbatojnë deduksionin racional të Ahkameve (vendimeve) të tij, duke përfshirë edhe Kijasin, për shkak të rritjes aktuale ose potenciale të tij si pasuri. Personalisht, unë besoj se është e detyrueshme për muslimanët t'iu japin 10% ose 5% të të gjithë prodhimit të tokës së punuar të varfërve, sido që të jetë ai, fruta apo drith, i njomë apo i thatë, i ngrënë apo jo. Të gjitha arsyet e

domosdoshme janë atje dmth. rritja, e drejta e përcaktuar e nevojtarit për paratë e të pasurit si dhe për perimet e kultivuesit, të cilat duhet të pastrohen dhe shtohen:

“Merr prej pasurisë së tyre lëmoshë që t’i pastrosh me të dhe t’ua shtosh (të mirat).”

(9:103)

Megjithatë, një dhahirij bashkëkohës e hodhi poshtë argumentin e mësipërm, duke përmendur këtë hadith: “*S’ka sadaka për perimet*”. Gjithashtu ai deklaroi që s’ka ndonjë precedent në praktikën e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) që të tregojë se ai mori zekat për perimet. Unë iu përgjigja që argumenti i parë ishte i pavlefshëm, sepse hadithi ishte i dobët dhe si i tillë, është një argument i dyshimtë përballë frymës së përgjithshme të Kur’anit dhe Sunnetit. Ky hadith nuk është vërtetuar nga asnjë prej dijetarëve të hadithit, por vetëm është transmetuar nga Tirmidhiu, i cili e ka klasifikuar si të dobët, duke shtuar që asnjë gjë autentike s’mund t’i atribuohet të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në lidhje me këtë çështje.

Argumenti i dytë është gjithashtu jo i vërtetë për dy arsye, njëra nga të cilat është paraqitur nga Imam Ibnul Arabi, i cili ka thënë që s’ka nevojë të përmendet ky lloj argumenti, përderisa kjo çështje trajtohet në mënyrë të prerë në Kur’an⁵⁷:

“Hani frutat e tyre kur të piquen dhe ditën e korrijës (vjeljes) së frutave jepni atë pjesë që është obligim dhe mos e teproni, pse Ai nuk i do shkapërderdhësit.”

(6:141)

⁵⁷ Ebu Bekr ibn-ul Arebi: Ahkam-ul Kur’an

Arsyeja e dytë është që edhe nëse s'ka ndonjë precedent në praktikën e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), ne duhet të nxjerrim përfundim se ai mund t'ia ketë lënë këtë çështje ndërgjegjes së pasuesve të tij, meqë në atë kohë ishte e vështirë të kultivoje fruta dhe perime.

Megjithatë, dhahiriu bashkëkohës ngulte këmbë që ka një hadith, i cili e kufizon zekatin vetëm tek hurmat, rrushi i thatë, gruri dhe elbi. Por edhe ky hadith është i dobët. Ai nuk është vërtetuar nga asnjë nga dijetarët e hadithit⁵⁸ dhe si rrjedhim, nuk është marrë si argument nga asnjëri prej medh'hebeve. Prandaj, si mund të qëndrojë ai si argument përballë teksteve të plota të vërteta, të cilat e përcaktojnë zekatin si të detyrueshëm për të gjitha prodhimet e tokës, siç thuhet në ajetin e mëposhtëm:

“O ju që besuat! Jepni nga më e mira e asaj që fituat dhe nga ajo që ju dhamë prej tokës...”

(2:267)

dhe në tjetrin:

“Ai (All-llahu) është që krijoi kopshte të ngritura lart dhe të rrafshta, edhe hurmat dhe drithërat me frute të ndryshme; ulla të shëgjeta dhe shëgjeta të ngjashme e jo të ngjashme. Hani frutat e tyre kur të pihen dhe ditën e korres së fryteve jepni atë pjesë që është obligim dhe mos e teproni, pse Ai nuk i do shkapërderdhësit.”

(6:141)

Gjithashtu ka një hadith i saktë, i cili bën që dhënia e zekatit të jetë shumë më e gjerë sesa do t'i pëlqente dhahiriut të sotëm. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Një e dhjeta për

⁵⁸ Shih, el-Kardavi, J., Fikh-uz-Zekat, 1:349-358

tokën që ujitet nga lumenjtë ose shirat (dmth. ujitje natyrore); pesë për qind për tokën që ujitet me sakijeh (ujitje artificiale)”.⁵⁹

Këto tekste nuk kufizohen vetëm në një prodhim të veçantë dhe detyrimi për dhënien e një të dhjetës apo pesë përqindëshit është shumë i qartë. Kjo është çka nxori Ebu Hanife (All-llahu e mëshiroftë) nga tekstet e mësipërme dhe që më parë u pranua nga Umer ibn Abdulazizi. Ky interpretim është në përputhje me thelbin dhe qëllimet e Sheriatit. All-llahu (xh.sh.) e bekoftë imamin malikij dhe gjykatësin e drejtë Ebu Bekr Ibnul Arabi, i cili vuri në dukje se pikëpamjet e Ebu Hanifes në lidhje me këtë problem janë më të shëndosha se ato të parashtruara nga të tjerët. Këto pikëpamje u shprehën në interpretimin që i bëri Ibnul Arabi ajetit:

“Ai është që krijoi kopshte...”

(6:141)⁶⁰

dhe në shpjegimin e hadithit të sipërpërmendur: “... për tokën që ujitet nga lumenjtë”.⁶¹

Pasi paraqet argumentet e sjella nga medh’hebet e ndryshme dhe tregon dobësinë e tyre, Ibnul Arabi thotë në “*Abkam ul Kur’an*” 2/947: “Ebu Hanifeja e bëri ajetin (e lartpërmendur) pasqyrën (udhëzuesin) e tij dhe, si rrjedhim, arriti të shihte të vërtetën”. Gjithashtu ai thotë në “*Sherh ut Tirmidhi*”:

⁵⁹ Transmeton Muslimi

⁶⁰ Ebu Bekr Ibn-ul Arebi, Ahkam-ul Kur'an

⁶¹ Ebu Bekr ibn-ul Arebi: Aradat-ul Ahvadi fi Sherh-ut Tirmidhi

“Në lidhje me këtë problem, medh’hebi i Ebu Hanifes paraqet argumentin më të fortë, tregon kujdesin më të madh për të varfërit dhe falënderimin për begatitë e All-llahut; të gjitha këto janë të qarta në përmbajtjen e përgjithshme të ajetit dhe hadithit”.

Si përfundim

Mosvërejtja e lidhjes midis Ahkameve dhe arsyeve të tyre na çon në kontradikta të rrezikshme, ku do të biem në diferencim midis të ngjashmeve dhe barazojmë të ndryshmet; kjo është në kundërshtim me drejtësinë e cila është baza e Sheriatit. Është e vërtetë që pseudodijetarët shpesh futen në probleme të tilla të ndërlikuara, duke kërkuar (pa pasur dijeni apo mendjemprehtësi) arsyet për Ahkamet dhe kështu e shtrijnë dominimin e tyre pa pasur argumente të sakta. Kjo s’duhet të na pengojë që të mundohemi t’u japim të drejtën pronarëve të saj ose të hapim portën e Ixhtihadit për ata që janë të aftë dhe të kualifikuar, si dhe, në të njëjtën kohë, të paralajmërojmë kundër mashtruesve dhe parazitëve.

1. MARRJA ME ÇËSHTJET E DORËS SË DYTË

Cektësia intelektuale dhe mungesa e mendjemprehtësisë fetare shfaqen edhe në një interesim të madh nga disa prej këtyre për çështjet e imëta dhe të dorës së dytë në kurriz të atyre kryesore, të cilat janë të lidhura me ekzistencën, identitetin dhe fatin e krejt Ummetit. Sot ekziston një polemikë e tepërt dhe e panevojshme rreth mbajtjes së mjekrës, veshjes së rrobave që qëndrojnë mbi nyjen e këmbës, lëvizjes së gishtit gjatë thënies së teshehudit në namaz, daljes në fotografi

etj., etj. Për fat të keq, diskutime të tilla që vetëm të humbin kohën, vazhdojnë të pushtojnë mendimin tonë në një kohë kur ballafaqohemi me armiqësinë e vazhdueshme dhe infiltrimin në botën islame të laicizmit, komunizmit, cionizmit, Krishterimit si dhe të grupeve devijuese (shmangëse). Misionarët e krishterë janë hedhur në një kryqëzatë të re kundër Ummetit me qëllim të minimimit të karakterit historik dhe islamik të tij. Muslimanët po masakrohen pa mëshirë në pjesë të ndryshme të botës dhe thirrësit islamë po u nënshtrohen formave më të ulëta të kërcënimit dhe sulmit.

Është e çuditshme dhe për të të ardhur keq, kur shoh se ata që kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe në Evropë në kërkim të diturisë apo për të fituar për jetesë, kanë sjellë me vete konflikte dhe polemika të tilla mbi çështje të dorës së dytë, të cilat janë të përhapura në shoqëritë prej të cilave ata vijnë. Shpesh kam qenë dëshmitar dhe kam dëgjuar me veshët e mi debate dhe diskutime të furishme, të cilat ia kanë dalë mbanë të shkaktojnë përçarje midis muslimanëve, në lidhje me çështje që varen nga ekstrapolimi dhe Ixhtihadi, disa prej të cilave i kam cekur më lart, dhe rreth të cilave juristët do të vazhdojnë të mos pajtohen dhe për të cilat ka shumë pak të ngjarë që njerëzit të pajtohen ndonjëherë. Në vend të këtyre grindjeve të kota, do të ishte shumë më mirë për këta emigrantë muslimanë që t'i përqëndronin përpjekjet e tyre për të propaganduar mes tyre një ndjekje të vërtetë të Islamit, veçanërisht nga ana e të rinjve, duke bërë që ata të kryejnë obligimet dhe të shmangen nga ndalimet kryesore të fesë. Nëse duke vepruar kështu ata ia dalin në krye këtij objekti, atëherë ata do të realizojnë një shpresë të madhe dhe do të krijojnë mundësi të reja për përhapjen e Islamit.

Është për të të ardhur keq që ata, të cilët i fillojnë dhe i inkurajojnë këto konfrontime, janë të njohur për neglizhencën e tyre në kryerjen e detyrave fetare si kujdesi ndaj prindërve, ndjekja me

kujdes e atyre që janë të lejuara dhe atyre që janë të ndaluara, kryerja e detyrave të tyre si dhe respekti për të drejtat e grave, fëmijëve dhe fqinjve të tyre. Në vend që ta përmirësojnë vetveten, ata ndiejnë kënaqësi të madhe nga nxitja e konflikteve të cilat eventualisht i shtynjë ata të marrin një qëndrim armiqësor apo hipokrit. Rreth grindjeve të tilla bëhet fjalë në këtë hadith: “Njerëzit, të cilët e humbin rrugën, pasi që janë udhëzuar, janë të prirur për të filluar diskutime”.⁶²

Gjithashtu, s’është ndonjë gjë e pazakontë, të gjeshe njerëz që i paralajmërojnë muslimanët të mos e hanë mishin e kafshëve të therura nga populli i Librit (të krishterët dhe çifutët), megjithëse ekzistojnë shumë fetva, të vjetra dhe të reja, të cilat e lejojnë këtë gjë. Nëse shqyrtojmë qëndrimin dhe sjelljen e këtyre njerëzve në lidhje me çështje të tjera shumë më serioze se kjo, do të shohim se ata merren me shumë gjëra rreptësisht të ndaluara. Kjo më sjell ndërmend rastin e një personi që jeton në Shtetet e Bashkuara, për të cilin më kanë treguar disa vëllezër të besueshëm, i cili fliste me të madhe kundër ngrënies së mishit të kafshëve të therura nga çifutët ose të krishterët, ndërkohë që nuk i bënte përshtypje të hante në një tryezë në të cilën disa të tjerë pinin alkool. Pavarësisht nga kjo, ai mbante një qëndrim të tillë ekstrem ndaj çështjeve të paqarta dhe të diskutueshme.

Një sjellje e tillë kontradiktore e inatosi njëherë Abdull-llah ibn Umerin (radijall-llahu anhumu), kur menjëherë pas vrasjes së dëshmorit (shehidit) të madh, zotëriut të të rinjve Husejn ibn Aliut (radijall-llahu anhumu), një njeri nga Iraku e pyeti atë, nëse vrasja e një mushkonje ishte hallall apo haram. Ahmed i transmeton në Musnedin e tij nga Ibn Ebi Nezimi të ketë thënë:

⁶² Transmetojnë Ahmed i, Ebu Davudi dhe et-Tirmidhiu i cili thotë: *"hadith basen sabih."*

“Ndërsa po qëndroja ulur me Ibni Umerin, erdhi një njeri dhe e pyeti atë për gjakun e mushkonjës. (Në një version tjetër, njeriu e pyeti për haxhiun që vret një mushkonjë). Ibni Umeri e pyeti: “Nga cili vend je?” Njeriu iu përgjigj: “Nga Iraku”. Ibni Umeri tha: “Shikoje këtë njeri! Ai më pyet për gjakun e mushkonjave, kur pikërisht ata (irakianët) e vranë nipin e të Dërguarit (dmth. Husejnin, të birin e Aliut (radijall-llahu anhumu). Unë e kam dëgjuar të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) të thotë: “Ata (Hasani dhe Husejni) janë dy lulet e mia më me aromë në këtë botë”.⁶³

2. ZGJERIMI TEJMASE I NDALIMEVE

Një nga treguesit e kësaj cektësie dhe të mungesës së një njohjeje të plotë të jurisprudencës islame dhe Sheriatit, është vështirësimi i gjërave përmes një zgjerimi të pavlefshëm të ndalimeve, pavarësisht nga paralajmërimet e qarta kundër një gjëje të tillë, në Kur'an dhe Sunnet:

“Mos i thoni asaj rrenës së gjuhëve tuaja: “Kjo është hallall e kjo është haram” e të shpifni ndaj All-llahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim.”

(16:166)

Sahabët e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), ashtu edhe paraardhësit tanë të drejtë nuk e ndalonin ndonjë gjë nëse nuk ishin të sigurt se ajo me të vërtetë ishte rreptësisht e ndaluar.

⁶³ Transmeton Ahmedi. Shejh Ahmed Shakiri konfirmon se isnadi i tij është autentik

Përndryshe, ata këshillonin kundër asaj gjëje ose shprehnin neverinë e tyre, por nuk e shpallnin atë në mënyrë të prerë, të ndaluar (haram). Megjithatë, ekstremistët ndalojnë shumë gjëra pa u rezervuar dhe me pakujdesi. Nëse për një çështje të caktuar, në jurisprudencën islame ekzistojnë dy mendime, njëri e përcakton atë si mubah (të lejueshme) dhe tjetri si mekruh (të papëlqyeshme), ekstremistët marrin këtë të fundit; nëse përcaktohet si mekruh nga njëri dhe haram nga tjetri, atëherë ata parapëlqejnë këtë të fundit. Nëse ekzistojnë dy mendime, njëri prej të cilëve i lehtëson gjërat, ndërsa tjetri i vështirëson ato, atëherë ata pasojnë të dytin. Me këmbëngulje, ata ndjekin mendimet e vjës së ashpër të Ibni Umerit, duke mos i pranuar kurrë lehtësimet e Ibni Abbasit. Kjo prirej, në përgjithësi, vjen nga mosnjohja nga ana e tyre e pikëpamjes e cila të fton për lehtësim.

Për ta ilustruar këtë pikë, do të doja të rrëfej rastin e mëposhtëm, për të cilin isha vetë dëshmitar. Një ditë, një ekstremist pa një njeri i cili po pinte ujë në këmbë. Me vrazhdësi, ekstremisti i kërkoi atij që të ulej, sepse një veprim i tillë ishte shmangie nga Sunneti i të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). I hutuar, njeriu vazhdoi të qëndronte në këmbë. Ekstremisti i tha atij se nëse ishte musliman i vërtetë, ai duhej ta villte menjëherë për t'u pastruar. Në këtë çast ndërhyra me butësi, duke i thënë ekstremistit: “Kjo gjë nuk meriton një vrazhdësi të tillë. Pirja e ujit në këmbë është një çështje e diskutueshme, e cila nuk meriton dënim ose brutalitet të hapur”. Ekstremisti u përgjigj se kishte një hadith sahih, i cili e ndalonte rreptësisht një gjë të tillë dhe që kërkonte që “cilido që vepron kështu, duke mos e patur mendjen aty, duhet ta vjellë atë”. Përgjigjja ime ishte: “Por hadithet, të cilat e lejojnë pirjen në këmbë, janë më të sakta dhe për këtë janë përmbledhur nga Buhariu në një kapitull të titulluar “Pirja në këmbë”, por ai s’ka përmendur asnjë hadith që e ndalon këtë gjë. Përveç kësaj, Tirmidhiu dhe të tjerë kanë transmetuar disa hadithe të cilat

dëshmojnë për këtë. Gjithashtu, është e vërtetë se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka pirë ujë në këmbë gjatë Haxhxhit të lamtumirës.⁶⁴ Veç kësaj, transmetohet se Ali ibn Ebu Talibi (radijall-llahu anhu) me një rast mori abdest, pastaj u ngrit dhe e piu ujin e mbetur në këmbë dhe tha: “Disa njerëz nuk e pëlqejnë pirjen në këmbë, por unë e kam parë të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) duke vepruar tamam kështu siç po më shikoni duke bërë tani”.⁶⁵

Gjithashtu, Tirmidhiu vërteton për lejimin e pirjes në këmbë, duke e mbështetur këtë në thëniet dhe veprimet e një numri sahabësh të të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Sipas Tirmidhiut, Ibni Umeri ka thënë: “Gjatë kohës së të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), ne hanim duke ecur dhe pinim në këmbë”.

Gjithashtu Keshshehu vërteton dhe thotë: “Njëherë jam takuar me Pejgamberin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe e pashë atë duke pirë nga një calik lëkure (me ujë) i varur”.⁶⁶

Interpretimet që janë bërë nga dijetarët më të besueshëm të hadithit, tregojnë që, megjithëse ka një inkurajim të qartë për të pirë ulur, prapëseprapë nuk ka asnjë ndalim për pirjen në këmbë. Këta dijetarë pohojnë se hadithet të cilat e inkurajojnë qëndrimin e parë, janë anuluar nga hadithe të tjera dhe kjo konfirmohet nga praktika e Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Aliut. Prandaj në këtë çështje të koklavitur, do të ishte krejtësisht e gabuar të ndalosh dikë që të pijë ujë në këmbë e posaçërisht të jeshë i ashpër ndaj tij.

⁶⁴ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi mbi autoritetin e Ibn Abbasit

⁶⁵ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi

⁶⁶ Transmeton et-Tirmidhiu

Shumë të rinj të sotëm merren me spekulime rreth veshjes së duhur islame. Spekulumet e tilla bazohen në këtë hadith të saktë: “Pjesa (e veshjes) poshtë nyjes së këmbës është në zjarr”.⁶⁷ Duke dashur ta zbatojnë këtë hadith, shumë të rinj veshin rroba mbi nyjen e këmbës dhe mundohen t’ua imponojnë këtë gjë edhe të tjerëve. Ky presion mbi të tjerët ngjall vullnet të keq në të dy palët dhe akuzat për ekstremizëm apo për mosndjekje të rregullave islame lëshohen reciprokisht nga të dy anët. Hadithet të cilat i paralajmërojnë muslimanët kundër veshjes së rrobave nën nyjen e këmbës, plotësohen nga hadithe të tjera, të cilat nëse shqyrtohen në thellësi zbulojnë arsyen për këtë ndalim. Një herë e një kohë, rrobat që qëndronin poshtë nyjes së këmbës, shikoheshin si shfaqje të mendjemadhësisë, arrogancës dhe ekstravagancës.

Për shembull, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “All-llahu nuk do ta shikojë në Ditën e Gjykimit atë person, i cili i tërheq (zvarrë) rrobat e tij në shenjë mendjemadhësie”.⁶⁸

Njëherë Ebu Bekri (radijall-llahu anhu) i tha të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem): “Tzari im më varet poshtë nëse nuk e ngre atë” dhe i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) iu përgjigj: “Ti nuk je nga ata që veprojnë kështu nga mendjemadhësia”.⁶⁹

Për këtë shkak, Imam Neveviu dhe dijetarë të tjerë islamë janë të mendimit se veshja e një rrobe të tillë është mekruh, por një mekruh mund të bëhet mubah (i lejueshëm), nëse ka një shkak të çfarëdo lloji qoftë.

⁶⁷ Transmeton Buhariu sipas Ebu Hurejres

⁶⁸ Transmeton Muslimi

⁶⁹ Transmeton Buhariu sipas Abdull-llah ibn Umerit

3. IDETË E GABUARA

Shembujt e lartpërmendur të një mendimi të çrregullt dhe të një vizioni të turbullt të fundamenteve të Islamit, Sheriatit dhe synimeve të mesazhit të tij, kanë bërë që në mendjet e të rinjve islamë të zënë vend shumë ide të gabuara. Këto ide të tilla të gabuara duhet shpjeguar plotësisht dhe përcaktuar me kujdes, sepse ato shërbejnë si bazë për gjykimin dhe reformimin e tyre. Ndër idetë kryesore të gabuara mund të përmendim koncepte të tilla të imanit dhe Islamit, kufrit dhe shirkut, nifakut dhe xhahilijetit etj. Komplexitetet gjuhësore apo moszotërimi i gjuhës arabe nga ana e disa personave, kanë çuar në konfuzion dhe keqkuptim. Komplexitetet e gjuhës u rrëshqasin atyre që s'janë ekspertë të saj. Si rrjedhim, ata s'janë në gjendje të vënë re dallimin midis kuptimeve figurative apo metaforike dhe atyre literale (të dukshme), ndaj edhe i ngatërrojnë gjërat. P.sh. ata s'janë në gjendje të kuptojnë dallimin midis imanit absolut (apo të përkryer) dhe atij të kufizuar (apo nominal), midis Islamit të plotë dhe atij nominal; nuk bëjnë dallimin mes kufrit të madh i cili nxjerr nga feja dhe atij që nuk nxjerr nga feja; midis shirkut të madh dhe atij të vogël; midis hipokrizisë (nifakut) në besim dhe asaj në veprim. Gjithashtu, ata barazojnë xhahilijen (injurancën) e etikës dhe sjelljes me atë të besimit. Ajo që do të shkruaj më poshtë, është një qartësim i shkurtër i këtyre koncepteve, me qëllim që të parandalojmë pasojat e rrezikshme.

Imani absolut (i përkryer) përmbledh çdo gjë që një njeri beson, thotë dhe vepron. Ky është ai lloj i imanit për të cilin flitet në ajetet kur'anore:

“E besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.”

(8:2)

“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përlurur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit.”

(23:1-2)

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All-llahut, të Dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të All-llahut luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetët.”

(49:15)

I njëjti koncept i imanit shprehet edhe në hadithin e mëposhtëm:

“Çilido që i beson All-llahut dhe Ditës së Gjykimit (së Fundit) duhet të ketë marrëdhënie të mira me të njohurit dhe farefisin... le të flasë vetëm atë që është e mirë ose le të heshtë”.⁷⁰

Në një hadith tjetër, imani përcaktohet duke mohuar atë që s’është iman:

“Askush nga ju s’do të ketë iman (të plotë) derisa të mos dëshirojë për vëllain e tij (musliman) atë që dëshiron për vete”.⁷¹

Në një hadith tjetër, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e përcakton kështu imantin:

⁷⁰ Transmeton Buhariu sipas Ebu Hurejres

⁷¹ Transmeton Buhariu sipas Enes ibn Malikut

“Kur një pusht kryen prostitucion (kurvëri), ai nuk ka iman në kohën kur e bën atë; kur ndonjëri pi pije alkoolike, ai nuk ka iman në kohën e pirjes dhe kur një hajn vjedh, ai nuk ka iman në kohën kur është duke vjedhur”.⁷²

Është e rëndësishme të vihet re se në të dy hadithet e fundit, imani përcaktohet me mohim. Kjo do të thotë se bëhet fjalë për imanin absolut apo të përkryer e jo për imanin (në përgjithësi), si në këtë thënie: “Ai që nuk e zbaton diturinë e tij, s’është dijetar”. Këtu mohimi është për diturinë e përkryer e jo për atë të kufizuar. Gjithashtu, iman i përkryer është ai për të cilin na njofton hadithi: “Imani përbëhet nga shtatëdhjetë e sa degë (dmth. pjesë) dhe haja’ (turpi) është pjesë e imanit”. Në librin e tij “*El Xhami li Shuab el Iman*”, Ebu Bekr El Bejhekiu e krahason imanin me një pemë. Trungu simbolizon parimet themelore të besimit si ritet (obligimet) fetare, sjelljen, etikën dhe marrëdhëniet. Ashtu siç është i domosdoshëm trugu që të ekzistojë pema, ashtu edhe parimet themelore të besimit janë të domosdoshme për besimtarin. Ndërsa, përderisa pema mund të ekzistojë edhe në mungesë të disa degëve, i tillë është statusi i besimtarit në bashkësinë islame në lidhje me ç’ka mbetet nga degët e imanit të tij. Imani themelor është përcaktuar në thënien e melekut Xhibril (alejhis-selam): “Imani është të besosh në All-llahun, melekët (engjëjt) e Tij, librat, të dërguarit dhe Kaderin (përcaktimin hyjnor)”.

Hafizi Ibn Haxheri shkruan në Fet-hul Bari:

“Paraardhësit tanë të drejtë kanë thënë: ‘Imani është besimi me zemër, shqiptimi me gjuhë dhe zbatimi i themeleve të besimit’. Ata kishin parasysh që zbatimi i imanit në praktikë është

⁷² Transmeton Buhariu sipas Ebu Hurejres

domosdoshmëri për përsosjen e tij. Nga kjo edhe del thënia e tyre se imani shtohet dhe mangësohet. Murxhijtë pohojnë se imani është vetëm besimi dhe shqiptimi; Keramitët thonin se ai është vetëm shqiptim; Mu'tezilët besojnë se ai përbëhet nga zbatimi, shqiptimi dhe besimi. Dallimi ndërmjet tyre dhe paraardhësve tanë të drejtë është se, ndërsa të parët tanë e konsideronin zbatimin si një kusht të nevojshëm për përsosjen e imanit, të dytët e konsideronin atë si një kusht të nevojshëm për besueshmërinë e tij. Por përsosuria është kompetencë vetëm e All-llahut; për ne deklarimi i imanit me gojë është i mjaftueshëm. Me t'u kryer kjo, personi gjykohet në përputhje me Sheriatin dhe s'mund të konsiderohet kafir (jobesimtar) përderisa nuk kryen një veprim që tregon kufrin e tij, si të bërit sexhde një idhulli. Nëse një person kryen një vepër (mëkat) që nuk e çon në kufër por tregon fiskun e tij, ai që e konsideron këtë njeri se ka iman, e bën këtë në koncept të shqiptimit të tij, ndërsa ai që ia mohon imanin këtij, atë e bën në koncept të përsosurisë (përkryerjes) së imanit. Edhe ai që e quan këtë person kafir e bën këtë në koncept se ai ka bërë vepër të kafirit, ndërsa ai që mohon kufrin e tij, e bën këtë në koncept të vërtetësisë së tij (kufrin)."

Islami e njeh shqiptimin me gojë të shehadetit (dëshmisë) i cili është porta e hyrjes në Islam; një jobesimtar bëhet musliman, sapo dëshmon që nuk ka zot përveç All-llahut dhe që Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është i Dërguari i Tij, para se të kryejë namazin apo dhënien e zekatit, sepse këto forma ibadeti pranohen vetëm nëse kryhen nga muslimani. Atij i duhet vetëm t'i pranojë këto detyrime dhe të zotohet për t'i kryer ato, edhe nëse nuk i zbaton. Shqiptimi i shehadetit është ajo që u siguron atyre mbrojtjen e jetës dhe pasurisë së tyre. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: "Nëse ata (njerëzit) e shqiptojnë atë (shehadetin), gjaku dhe pasuria e tyre janë të ruajtura nga unë, për aq kohë sa ata i përmbushin përgjegjësitë e tij. Për këtë

ata janë përgjegjës tek All-llahu”.⁷³ Termi “*Islam*” mund të përdoret edhe për të nënkuptuar pesë shtyllat, siç përmenden në hadithin e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), të transmetuar nga Ibni Umeri: “Islami mbështetet mbi pesë shtylla: të dëshmosh se s’ka zot përveç All-llahut dhe se Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është i Dërguari i Tij, të falësh namazin; të japësh zekatin; të agjërosh gjatë Ramazanit dhe të kryesh haxhxin”.

Literatura e hadithit përmban përcaktimin që i bëri Islamit Xhibrili (alejhis-selam). Kur i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e pyeti Xhibrilin për Islamin, ky iu përgjigj: “Islami është të adhurosh vetëm All-llahun dhe të mos i shoqërosh Atij asnjë (shok), të falësh namazin, të japësh zekatin e urdhëruar dhe të agjërosh gjatë Ramazanit”.⁷⁴ Në fjalët e Xhibrilit mund të gjejmë ndryshimin midis konceptit të imanit dhe Islamit; gjithashtu është e qartë se që të dy termat mund të përdoren si sinonime, nëse ato janë të lidhura së bashku, secili prej tyre nënkuptohet tek tjetri. Nuk ka iman pa Islam dhe s’ka Islam pa iman.

Imani ka të bëjë me zemrën, ndërsa Islami ka të bëjë me veprimet trupore dhe sjelljen e jashtme, siç mund të vihet re në këtë hadith: “Islami është i hapur, imani është (çka besohet) në zemër”.⁷⁵

I njëjti përkufizim i imanit dhe Islamit gjendet në këtë ajet kur’anor:

“Beduinët thanë: “Ne kemi besuar!” Thuaj: “Ju nuk keni besuar ende, por thoni: Ne jemi dorëzuar e ende nuk po hyn besimi në zemrat tuaja.”

⁷³ Transmeton Buhariu sipas Ibn Umerit

⁷⁴ Transmeton Buhariu sipas Ebu Hurejres

⁷⁵ Transmetojnë Ahmedi dhe el-Bezzari, isnadi i tij është sahih

(49:14)

Gjithashtu Islami mund të përdoret për të nënkuptuar Islamin e përsosur siç tregohet në këtë hadith: “Islami është (gjendja kur) zemra jote i nënshtrohet (krejtësisht) All-llahut dhe kur ti nuk i dëmton muslimanët me gjuhën apo dorën tënde”. Në një hadith tjetër: “Musliman është ai që nuk i dëmton muslimanët me gjuhën dhe dorën e tij” dhe “Dëshiro për të tjerët atë që dëshiron për vete e do të jeshë musliman”.

Në gjuhën ligjore, kufr do të thotë kundërshtimi dhe mohimi i All-llahut (xh.sh.) dhe i mesazheve të Tij, siç thuhet në këtë ajet kur'anor:

“Kush nuk i beson All-llahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg.”

(4:136)

Gjithashtu kufri përfshin ridden (femohimin) dhe si rrjedhim humbjen e plotë të imanit:

“E kush mohon (tradhton) besimin, ai e ka asgjësuar veprën e vet dhe ai në botën tjetër është prej të shkatërruarve.”

(5: 5)

gjithashtu:

“E kush zbrapset prej jush nga feja e tij dhe vdes si jobesimtar, ai i ka zhdukur veprat e veta në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetë.”

(2:217)

Veç kësaj, termi “kufr” përdoret për të treguar shkelje të cilat nuk përbëjnë kundërshtim të plotë të Islamit dhe nuk arrijnë deri në kundërshtimin dhe mohimin e All-llahut (xh.sh.) dhe të Dërguarit të Tij. Dijetari Ibn Kajjimi e ka ndarë kufrin në dy kategori: në të madh dhe në të vogël. Kufri i madh çon në ndëshkim të përjetshëm në xhehennem, ndërsa kufri i vogël çon në ndëshkim të përkohshëm (jo të përjetshëm) në xhehennem.

Kini parasysh hadithin: “Dy gjëra, nëse kryhen nga Ummeti im, janë shfaqje të kufrit: akuzimi i rrejshëm rreth prejardhjes së një personi dhe vajtimi për të vdekurin”. Dhe: “Ai, i cili kryen marrëdhënie seksuale në anus me gruan e tij, kryen kufr (mohon) atë që i ka zbritur Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)”. Dhe: “Ai, i cili kërkon një falltar apo fatthënës dhe i beson atij apo asaj, kryen kufr (mohon) atë çka i ka zbritur Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem)”.

Gjithashtu: “Mos u riktheni në kufr pas vdekjes sime, duke vrarë njëri-tjetrin”. Ky është interpretimi i Ibni Abbasit si dhe i shumicës së sahabëve, i ajetit kur’anor:

“E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues (kafirûn).”

(5:44)

Ekzistojnë interpretime të ndryshme të ajetit të mësipërm. Ibni Abbasi thotë: “Nuk është kufr që e nxjerr një person nga Ummeti islam, sepse personi që e kryen atë nuk e mohon All-llahun dhe Ditën e Fundit”. Tavusi ka shprehur të njëjtin mendim. Ataja ka thënë: “Ky është kufr ose padrejtësi ose fisk, i cili mund të jetë më i madh ose më i vogël në gradë se tjetri (kufri më i madh, mohimi i All-llahut dhe ligjit të tij)”. Të tjerë, si Ikrimëh, pohojnë se ata, të cilët nuk gjykojnë sipas asaj që e zbriti All-llahu (xh.sh.), duke kundërshtuar, kryejnë kufr. Por ky argument është i dobët, sepse kundërshtimi i dukshëm i Shpalljes së All-llahut (xh.sh.) të çon në kufr, ka gjykuar

apo s'ka gjykuar dikush sipas Sheriatit. Abdulaziz El Kinaniu beson se kufri përfshin heqjen dorë nga gjykimi sipas asaj që e ka zbritur All-llahu (xh.sh.), duke përfshirë tevhidin dhe Islamin. Por edhe kjo është e ekzagjeruar, sepse ajeti bën fjalë për kundërshtimin e gjithçkaje ose një pjese të asaj që ka zbritur.

El Bagaviu thotë që shumë juristë janë pajtuar në atë se në këtë ajet bëhet fjalë për ata që me qëllim kundërshtojnë tekstet, e jo nga mosdija dhe gabimi. Katade, Ed Dahhak dhe të tjerë janë të mendimit që kufri në ajetin e mësipërm është ai i popujve të Librit dmth. çifutëve dhe të krishterëve. Por kjo bie në kundërshtim me kuptimin e dukshëm të ajetit dhe si rrjedhim, s'mund të pranohet. Disa juristë mendojnë se bëhet fjalë për një formë të kufrit, e cila e nxjerr njeriun nga Islami. Ibnul Kajjimi thotë:

“Gjykimi, në kundërshtim me atë që ka zbritur All-llahu (xh.sh.), i përmban të dy llojet e kufrit, të madhin dhe të voglin, sipas qëndrimit të personit që bën gjykimin. Nëse ai beson se duhet që gjykimi dhe ndëshkimi të bëhen në përputhje me çfarë ka zbritur All-llahu, por nuk vepron kështu për shkak të mosbindjes dhe tejkalimit të kufijve, në këtë rast ai kryen kufr të vogël. Por, nëse beson se kjo nuk është e detyrueshme dhe se ai është i lirë të veprojë, megjithë bindjen e tij se ky është ligj i All-llahut, atëherë ai kryen kufr të madh. Por, nëse vepron kështu nga padituria apo bën një gabim të paqëllimtë, atëherë ai duhet gjykuar vetëm si keqbërës”.

Thelbi i kësaj çështjeje është se të gjitha shkeljet dhe mosbindjet janë lloje të kufrit, të cilat përmblajnë mosmirënjohje, sepse mirënjohja kërkon pajtim dhe bindje. Prandaj, përpjekja njerëzore mund të shfaqet në mirënjohje, kufr ose diçka tjetër veç këtyre. Vetëm All-llahu (xh.sh.) e di më së miri.

Edhe shirku ndahet në dy kategori: i madh dhe i vogël. Në përgjithësi, shirku i madh është të adhurosh dikë tjetër përveç All-llahut (xh.sh.) apo t'i shoqërosh atij shokë. Për këtë flitet në këtë ajet kur'anor:

“S’ka dyshim se All-llahu nuk fal t’i përshkruhet Atij shok e përveç këtij i fal kujtdo. Kush i përshkruan All-llahut shok, ai ka bërë një mëkat të madh.”

(4:48)

Në shirkun e vogël hyjnë të betohesh në emër të dikujt ose diçkaje tjetër përveç All-llahut, apo të besosh se hajmalitë kanë fuqi të sjellin fat të mirë apo të keq. Për këtë shirk flitet në këtë hadith: “Ai, i cili betohet në emër të dikujt tjetër përveç All-llahut, ka bërë shirk”⁷⁶ dhe “Ai, i cili mban hajmali, kryen shirk”⁷⁷, dhe “Magjepsjet (ruka), hajmalitë (temaim, teavidh) dhe nuskat (teveh) janë shirk”.⁷⁸

Edhe nifaku (hipokrizia) është i madh dhe i vogël. Nifak i madh është të fshehësh në zemër kufrin, ndërkohë që shfaq iman, me qëllim që t'i mashtrosh të tjerët; kjo përmendet në këtë ajet kur'anor:

⁷⁶ Transmetojnë Ebu Davudi, et-Trimidhiu dhe el-Hakimi

⁷⁷ Transmetojnë Ahmedi dhe el-Hakimi

⁷⁸ Transmetojnë ibn Hibbani dhe el-Hakimi i cili vlerëson se isnadi është autentik (sahih)

“Ka disa njerëz që thonë: ‘Ne i kemi besuar All-llahut dhe jetës tjetër’, po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë.”

(2:8-9)

si dhe:

“E kur i takojnë ata që besuan, thonë: “Ne kemi besuar!”, por kur veçohen me djajtë e vet u thonë: “Ne jemi me ju, ne vetëm jemi tallur.”

(2:14)

Ky është lloji i nifakut i cili përmendet në fillim të sures El Munafikun, si dhe në ajete të tjera kur’anore. Është i njëjti nifak, të cilin All-llahu (xh.sh.) ka premtuar se do ta ndëshkojë:

“S’ka dyshim, munafikët do të jenë në shtresën më të ulët të zjarrit dhe për ta nuk do të giesh mbrojtës.”

(4:145)

Me nifak të vogël nënkuptohet nifaku i besimtarëve në punë, dmth. sjellja e një muslimani i cili beson me zemër në All-llahun (xh.sh.) dhe në botën tjetër, por ruan akoma disa tipare të hipokrizisë. Kjo gjë përsëritet më mirë në këto hadithe:

“Shenjat e munafikut (hipokritit) janë tri: kur flet, gënjen; kur premt, nuk e mban premtimin dhe kur i besohet diçka, tregohet i pandershëm (tradhton)”.⁷⁹

⁷⁹ Transmetuar me pajtim sipas autoritetit të Ebu Hurejres

“Cilido, që i ka këto katër cilësi, do të jetë një munafik i hapur dhe cilido, që ka njërën nga këto cilësi, do të ketë një element të nifakut, derisa të heqë dorë prej tij; nëse flet, gënjen; nëse i besohet diçka, tradhton; nëse premton, tregohet tradhtar dhe nëse kundërshton diçka, sillet në një mënyrë shumë të paturp, të keqe dhe fyese”.⁸⁰

Ky është lloji i nifakut, të cilit sahabët e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe paraardhësit tanë të drejtë i frikësoheshin me të madhe. Duke e përshkruar këtë, ata kanë thënë: “Askush, përveç munafikut, nuk e ndjen veten të siguruar nga ky lloj nifaku, të cilit i frikësohet vetëm një besimtar i vërtetë”.

4. THEKSIMI I TEKSTEVE ALEGORIKE (MUTESHABIH)

Është e rëndësishme të tregojmë që shkak i kryesor i ekstremizmit dhe i keqkuptimit të çështjeve fetare, në të kaluarën dhe në të sotmen, është theksimi i teksteve alegorike dhe mospërfillja e atyre kategorike (muhkemat): tekste alegorike janë ato tekste që përmbajnë kuptime të fshehura dhe të paqarta, ndërsa tekste kategorike janë ato tekste, kuptimi i të cilave është i qartë, i dukshëm dhe i përcaktuar. Vënia e theksit në tekstet alegorike s’mund të jetë qëndrimi i atyre personave me dituri dhe mendjemprehtësi, por i atyre të cilët fshehin devijimin (shmangien) në zemër. Kur’ani thotë:

⁸⁰ Transmeton Buhariu

“Ai është që ta zbriti Librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e Librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). Ata që në zemrat e tyre kanë anim nga e shtrembra, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti e kinse kërkojnë komentin e tyre. Por, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë.”

(3:7)

Ekstremistët dhe risimtarët e së djeshmes i përdorën tekstet e tilla alegorike si argumentin e tyre përfundimtar, duke neglizhuar dhe duke mos shikuar tekstet themelore kategorike. Sot ekstremistët bëjnë të njëjtën gjë, përdorin alegoriken për të përcaktuar konceptet e rëndësishme, gjë e cila sjell pasoja serioze dhe të rënda, kur përdoret si bazë për gjykimin e personave apo grupeve (xhemateve), për vlerësimin e sjelljes së tyre dhe për cilësimin e tyre si miq apo si armiq, si besimtarë të cilët duhet ndihmuar, apo si kuffarë (jobesimtarë), të cilët duhen luftuar.

Një cektësi e tillë në kuptim dhe nxitimi për të dhënë mendime, pa bërë një gjurmim apo krahasim të kujdesshëm (pasi nuk u përfillën tekstet themelore kategorike dhe u morën parasysh vetëm ato alegorike) bëri që havarixhët të bien në kurthin e tekfirit, duke i quajtur të gjithë muslimanët, me përjashtim të tyre, si kuffarë (jobesimtarë). Duke u mbështetur në nocione të çuditshme “*fetare*” dhe deluzione, ata luftuan njeriun e madh të Islamit, Ali ibn Ebu Talibin (radijall-llahu anhu), megjithëse ata ishin prej pasuesve dhe ushtarëve të tij. Shkaku kryesor i mospajtimit të tyre me Aliun (radijall-llahu anhu) ishte vendimi i tij për të pranuar arbitrim (ndërmjetësim) në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Muavije ibn Ebu Sufjanin, me qëllim që të ruhet uniteti i ushtrisë së tij dhe të kursehej jeta e muslimanëve nga të dy palët. Havarixhët kundërshtuan çdo arbitrim, sepse e keqkuptuan dhe keqinterpretuan ajetin:

“... vendimi nuk i takon tjetërkujt, përveç All-llahut.”

(12:40)

dhe e akuzuan për devijim Aliun (radijall-llahu anhu), një nga muslimanët e parë, i cili i shkriu energjitë e tij për çështjen e Islamit. Aliu iu përgjigj përmendjes nga ana e tyre të ajetit të mësipërm, me thënien e tij të famshme: “Fjalë e vërtetë me të cilën dëshirohet e pavërteta”.

Fakti që vendimi dhe autoriteti në të gjitha çështjet i përket vetëm All-llahut, nuk do të thotë se qeniet njerëzore janë të ndaluara të arbitrojnë dhe të gjykojnë probleme anësore brenda kornizës dhe urdhrave të Sheriatit. Abdull-llah ibn Abbasi, i cili kishte një mendjemprehtësi dhe njohje të thellë të Sheriatit, debatoi me havarixhët për këtë problem dhe kundërshtoi argumentet e tyre, duke përmendur ajete nga Kur’ani të cilat sanksionojnë lloje të ndryshme të arbitrimit. Për shembull, ky ajet sanksionon arbitrimin për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet burrit dhe gruas:

“Nëse i frikësoheni përçarjes midis tyre, dërgoni një pari të drejtë nga familja e tij dhe një pari të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy kanë për qëllim pajtimin, All-llahu ua mundëson afrimin midis tyre.”

(4:35)

Një rast tjetër arbitrimi mund të shihet në maturinë që arbitruesit mund të ushtrojnë në gjykimin e një haxhiu, i cili gjuan dhe vret kur është me veshjen e ihramit:

“O ju që besuat! Mos e mbytni gjahun, duke qenë ju në ihram. E kush e mbyt atë me qëllim, atëherë dënimi është therja e një kafshe shtëpiake të ngjashme me atë që e ka mbytur. Për këtë çështje vendosin dy njerëz të drejtë nga mesi juaj, duke bërë atë kurban për Qabe, ose duke ushqyer të varfër, ose sa ai, agjërim, këtë për ta shijuar të keqen e punës së tij.”

Disa njerëz, të cilët nuk i shqyrtojnë dhe vëzhgojnë me kujdes Kur'anin dhe Sunnetin dhe që i marrin ata në tërësi, duke kërkuar të ekuilibrojnë të vërtetuarën me të mohuarën, duke krahasuar të veçantën me të përgjithshmen ose absoluten me të kufizuarën, duke besuar në kategoriken dhe alegoriken; të gjithë këta njerëz të pakujdesshëm, në mënyrë të paevitueshme do të shkojnë shtrembër, do ta humbasin qartësinë e shikimit dhe do të bëjnë gjykime të nxituara.

Ky është kurthi, në të cilin kanë rënë ata të cilët në ditët tona i njollosin të tjerët si jobesimtarë dhe në të cilin kanë havarixhët. Sipas Esh Shatibiut, shkaku kryesor i këtij ekstremizmi është mosnjohja e qëllimeve dhe kuptimeve të Sheriatit si dhe pandehmat e tyre të gabuara për to, gjë të cilën s'mund ta bëjë një njohës me përvojë i diturisë islame. Është me shumë vlerë t'i rikthehemi rastit të havarixhëve, të cilëve u jemi referuar më parë, dhe të shikojmë se si ata "dolën nga feja ashtu siç rrëshqet shigjeta nga harku", gjë e cila dëshmohet nga përshkrimi që u ka bërë atyre i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) si njerëz "të cilët e lexojnë Kur'anin, por (mësimet e tij) nuk i prekin zemrat e tyre". All-llahu e di më së miri, por ndoshta kjo do të thotë se këndimi i tyre verbal i Kur'anit është vetëm një ushtrim fizik i cili nuk ndikon tek ata. Kjo na sjell ndërmend hadithin që kemi përmendur më lart mbi "marrjen e diturisë".

Ky interpretim është në përputhje me interpretimin e Ibni Abbasit (radijall-llahu anhu), që transmetohet nga Ibrahim Et Tejmiu në veprën e Ebu Ubejdes "*Fedail-ul Kur'an*" si dhe me interpretimin e Kur'anit nga Seid ibn Mensuri:

- Njëherë, ndërsa po qëndronte ulur vetëm, Umer ibn El Hatabi u çudit se përse njerëzit, të cilët pasojnë një të Dërguar dhe drejtohen nga Kibla në namaz, mundohen nga mospajtimi. Ai thirri

Ibni Abbasin dhe e pyeti: “Përse duhet të mundohet ky Ummet nga mospajtimi, kur ai ka të njëjtin të Dërguar dhe të njëjtën Kible?!” (Seidi shton “dhe të njëjtin Libër”). Ibni Abbasi u përgjigj: “Kur’ani u shpall, ne e lexuam atë dhe i kuptuam arsyet për shpalljen e tij. Por, do të vijmë njerëz, të cilët do ta këndojnë atë duke mos i kuptuar arsyet dhe shkaqet e zbritjes. Si pasojë, ata do të bëjnë interpretime të ndryshme dhe do të kenë mosmarrëveshje”.

Seid ibn Mensuri shton:

- Ibni Abbasi ka thënë: “Çdo grup njerëzish do të kenë nga një mendim për Kur’anin, gjë që do të çojë në mosmarrëveshje dhe më pas në luftë”. Por, Umeri dhe Aliu, që ishin të pranishëm, nuk e pëlqyen këtë shpjegim ogurzi dhe e qortuan atë. Por jo shumë kohë pasi Ibni Abbasi u largua, Umerit i shkoi ndërmend se mund të kishte diçka të vërtetë në fjalët e tij. Ai e thirri atë përsëri dhe i kërkoi atij të përsëriste edhe një herë ç’kishte thënë më parë. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm, Umeri i pranoi dhe i çmoi ato që kishte thënë Ibni Abbasi.

Esh Shatibiu ka shkruar:

- Ibni Abbasi kishte të drejtë. Kur dikush e di shkakun që fshihet pas zbritjes së një ajeti apo sureje, ai di se si ta interpretojë atë dhe se cilat janë synimet e tij. Mosnjohja e tij bën që njerëzit ta keqinterpretojnë atë dhe të kenë mendime të ndryshme, pa pasur dijeni dhe mendjemprehtësi të cilat do t’i çonin drejt së vërtetës dhe do t’i shmangnin ata nga marrja me çështje të tilla, pa pasur mbështetje apo argumente dhe si pasojë, ata shkojnë në rrugë të shtrembër dhe marrin me vete edhe të tjerët.

Si shembull për këtë marrim rastin i cili transmetohet nga Ibn Vehebi nga Bukejri i cili e pyeti Nafiu: “Çfarë mendon Ibni Umeri për ata të Harurijes? (dmth. havarixhët të cilët thirrreshin edhe harurijeh sipas vendit Harura, ku ata u mbledhën dhe u luftuan nga Ali ibn Ebi Talibi dhe sahabët, të cilët e përkrahën atë). Nafiu u përgjigj: “Ai (Ibni Umeri) mendon se ata janë më të keqjijtë e njerëzve. Ata i zbatuan ajetet që kishin të bënin me kuffarët (jobesimtarët), ndaj besimtarëve”. Said ibn Xhubejri e ka shpjeguar këtë, duke thënë se prej ajeteve të keqinterpretuara nga havarixhët ishin:

“E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues (kafirûn).”

(5:44)

të cilin ata zakonisht e kombinonin me:

“... e megjithëkëtë, ata që mohuan i barazojnë (idhujt) me Zotin e tyre.”

(6:1).

Kështu ata arritën në përfundimin se nëse një sundues nuk sundon në mënyrë të drejtë, ai kryen kufr dhe ai i cili kryen kufr, i shoqëron të tjerë All-llahut dhe kështu kryen shirk. Në bazë të kësaj, ata i shpallën të tjerët mushrikë (idhujtarë), duke i luftuar dhe vrarë ata. Ky është pikërisht ai lloj keqinterpretimi dhe keqkuptimi, ndaj të cilit kishte paralajmëruar Ibni Abbasi dhe i cili ndodhi si pasojë e mosnjohjes së asaj për çka ka zbritur.

Nafiu ka thënë: “Sa herë që Ibni Umeri pyetej për harurijet, ai thoshte: “Ata i quajnë muslimanët si jobesimtarë, ligjësojnë derdhjen e gjakut të tyre dhe konfiskimin e pasurisë së tyre, ata

martohen me gratë gjatë periudhës së iddes,⁸¹ martohen me gra që janë të martuara dhe bashkëshortët e tyre janë gjallë. Nuk njoh njerëz të tjerë që meritojnë të luftohen më shumë se ata”.⁸²

5. NEVOJA PËR TA NJOHUR DHE RESPEKTUAR SPECIALIZIMIN

Një nga shkaqet e cektësisë dhe mungesës së mendjemprehtësisë nga ana e ekstremistëve është se ata kurrë nuk ua vënë veshin atyre që kanë mendime të ndryshme nga ata, nuk pranojnë dialog me ta dhe as që u shkon ndërmend se pikëpamjet e tyre mund të provohen nën dritën e të tjerëve ose mund të hidhen poshtë. Shumë prej tyre nuk kanë marrë mësim nga dijetarë të besueshëm muslimanë të specializuar në atë fushë. Përkundrazi, ata kanë marrë njohuri gjysmake drejt e nga librat dhe fletushkat, pa pasur rast për rishikim apo diskutim, i cili do të provonte kuptimin e lexuesit dhe do të analizonte thellësinë e njohurive të tij. Ata thjesht lexojnë, “*kuptojnë*”, dhe më pas arrijnë në përfundimin që e dëshirojnë. Leximi, kuptimi dhe të menduarit e tyre mund të jetë i gabuar ose me të meta, e ata këtë fare nuk e hetojnë.

Mund të gjendet dikush që i kundërshton mendimet e tyre, i mbështetur mbi baza më të forta dhe të vlefshme, por ata s’e kuptojnë këtë gjë, sepse askush nuk ua ka tërhequr vëmendjen për një

⁸¹ Transmeton Buhariu

⁸² Esh-Shatibu, el-I’tisam, 2:182-184

mundësi të tillë. Këta të rinj të devotshëm e kanë injoruar faktin se nëse duan të studiojnë Sheriatin, duhet të kërkojnë ndihmën e dijetarëve të besueshëm muslimanë. Ata s'mund të zhyten kuturu në këtë disiplinë të gjerë dhe të sofistikuar pa udhëheqjen e dijetarëve të tillë të besueshëm, të cilët mund t'i interpretojnë dhe shpjegojnë gjërat e errëta, të përcaktojnë termat dhe të nxjerrin ngjashmëritë dhe lidhjet midis pjesëve dhe tërësisë. Ata që kuturisen në të, vetëm do të hasin në të njëjtat rezultate katastrofike, të cilat i ndodhin notarit të pamësuar, i cili zhytet në ujëra të thella. Njohja si duhet e Sheriatit s'mund të përsoset pa praktikë dhe kontakt të ngushtë me ekspertët, veçanërisht në ato fusha ku opinionet divergojnë, argumentet duket se bien në kundërshtim me njëri-tjetrin dhe çështje të ndryshme duken se ngatërrohen. Kjo është arsyeja që dijetarët tanë të hershëm na kanë paralajmëruar që të mos përpiqemi ta studiojmë dhe kuptojmë Kur'anin me dikë që e ka mësuar atë përmendsh, pa pasur dijeni rreth përmbajtjes së tij, as të kërkojmë diturinë me dikë që e ka fituar "diturinë" e tij vetëm nga leximi i librave dhe fletushkave, pa mbikëqyrjen e dijetarëve me reputacion dhe të kualifikuar.

Kërkimi i diturisë në mënyrë të vetmuar dhe vetëm nëpërmjet librave tregon humbjen e plotë të besimit të të rinjve tek dijetarët e shkolluar dhe profesionistë, veçanërisht tek ata që përkrahen nga autoritetet zyrtare, sepse ata besojnë se këta njerëz e kanë humbur kurajon për t'iu kundërvënë sunduesve që shkojnë në rrugë të shtrembër. Jo vetëm që dijetarët fetarë heshtin para mizorisë së sundimtarëve dhe mospërfilljes nga ana e tyre e Sheriatit, por ata shpesh dhe në mënyrë hipokrite, u thurin lavde atyre për veprime të tilla të dënueshme. Do të kishte qenë më mirë për këta dijetarë të heshtnin sesa të përkrahnin të pavërtetën.

Ndaj s'është për t'u habitur që të rinjtë muslimanë besojnë më shumë tek dijetarët e hershëm sesa tek ata të sotmit dhe si rrjedhim e kërkojnë diturinë dhe udhëzimin tek librat e tyre. Kur njëherë

pyeta njërin nga këta të rinj muslimanë të devotshëm, pse nuk e kërkonin diturinë përmes dijetarëve të shkolluar, ai m'u përgjigj: "E ku t'i gjejmë ulematë (dijetarët) që t'u besojmë? Ka vetëm prej atyre që janë kukulla në duart e sundimtarëve, që në mënyrë të paskrupullt japin fetva për lejime ose ndalime sipas kapriçiove të sundimtarëve, që e bekojnë socializmin dhe e konsiderojnë atë si islamik, nëse ndodh që sunduesi është socialist, por nëse ndodh që sunduesi të jetë kapitalist, atëherë bekohet kapitalizmi dhe konsiderohet si islamik! Dijetarë të cilët shpallin se paqja me armikun është haram (e ndaluar) kur një sundimtar vendos të shpallë luftë, por që shpejt e mbështesin dhe e bekojnë këtë paqe, nëse ndryshon politika e tij, të cilët:

"... në një vit e bëjnë të lejuar atë (muajin e shenjtë), e në një vit të ndaluar..."

(9:37)

të cilët barazojnë xhaminë me kishën dhe Pakistanin musliman me Indinë pagane!"

Unë iu përgjigja: "Nuk duhet të përgjithësojmë. Ka dijetarë të cilët e kanë dënuar të pavërtetën, janë ngritur kundër shtypjes dhe kanë kundërshtuar të bëjnë kompromis apo të mbështesin diktatorët (tagutët), pavarësisht nga kërcënimet dhe joshjet. Shumë prej tyre janë burgosur, u janë nënshtruar të gjitha llojeve të torturave dhe bile kanë rënë dëshmorë (shehidë) e nuk i janë gjunjëzuar Tagutit". Megjithëse e pranonte se kjo ishte e vërtetë, i riu ngulte këmbë se fuqia për të dhënë fetva është akoma në duart e "*dijetarëve*" kukulla, në duart e të cilëve janë institucionet fetare dhe ato të fetvasë.

E pranojmë se në fjalët e të riut ka shumë gjëra të vërteta. Shumë prej dijetarëve "*eminentë*" të cilëve u është besuar udhëheqja dhe udhëzimi, janë kthyer në figura shahu në duart e pushtetarëve të cilët i drejtojnë siç duan. Dijetarët e tillë duhet të dinë se heshtja para së vërtetës është e njëjtë me

thënien e batilit (të pavërtetës); të dyja janë të këqija djallëzore. Në një debat në Televizionin egjiptian mbi *“planifikimin familjar”* dhe *“kontrollin e lindjeve”* në këndvështrimin e Sheriatit, njëri nga folësit, një dijetar musliman i mirënjohur, për habinë e drejtuesit të emisionit, pyeti nëse qëllimi i debatit ishte mbrojtja apo kundërshtimi i *“planifikimit familjar”*, kështu që të mund të vihej në mbrojtje të këtij qëllimi!?! All-llahu (xh.sh.) e bekoftë brezin e mëparshëm të dijetarëve, njëri nga të cilët me kurajo iu drejtua një eksponenti me shumë influencë të regjimit në Egjipt me këto fjalë: *“Ai që i shtrin këmbët për të kërkuar punë, s’ka nevojë të shtrijë duart për të lypur”*. Dëshirojmë që dijetarët bashkëkohorë, të cilët kanë pasur të meta në besim dhe devotshmëri, të mund ta pasurojnë dhe thellojnë diturinë e tyre në përgjithësi dhe fikhun në veçanti!

Megjithatë është fakt se të rinjtë e devotshëm, të cilët dëshirojnë t’i thellojnë njohuritë e tyre mbi Islamin, kontaktojnë me dijetarë të njohur, të shquar në rrethet e retorikës dhe letrave, vetëm e vetëm që të zbulojnë se njohuritë e këtyre të fundit mbi Kur’anin dhe Sunnetin janë me të meta serioze.

Një nga këta dijetarë shkroi në një gazetë të përditshme se nuk ka kamatë në transaksionet midis qeverisë dhe shtetasve të saj. Me një besim në vetvete, ai deduktoi se meqë nuk ka kamatë midis babait dhe birit, mund të thuhet se s’ka kamatë midis qeverisë dhe shtetasve të saj. Por, konteksti i babait dhe birit, mbi të cilin është bazuar ky person, është kontraversial dhe ka qenë subjekt i shumë mosmarrëveshjeve. Ai nuk është mbështetur nga ndonjë tekst i vërtetë ose me konsensus. Si mund të merret ai si bazë mbi të cilën do të analizohen dhe gjykohen çështjet e tjera me analogji? Bile edhe nëse do të mund të merrej si kriter, ajo do të kishte qenë analogji e ndryshme.

Duke patur parasysh këto, e pranojmë se zhgënjimi dhe dëshpërimi i rinisë ndaj këtyre njerëzve pa devocion dhe dituri, është i justifikueshëm. Ata kanë parë se disa nga këta “dijetarë” citojnë hadithe të rreme në përmbajtje ose isnad (zinxhir transmetimi) dhe nuk përfillin hadithet e vërteta, për të cilat kanë rënë dakord të gjithë; kanë parë se disa nga këta argumentojnë me israilijate⁸³, ëndrra dhe se në kokat e tyre nuk gjendet gjë pos tregimeve dhe hiqajeve! Disa mundohen të fitojnë popullaritet duke iu referuar dëshirave të masave dhe “elitës”, duke mos e kërkuar diturinë nga burimi i duhur. Për këto arsye, të rinjtë e kanë humbur besimin tek ata dhe në çdo gjë që thonë. Bile edhe disa dijetarë me reputacion, të cilët të rinjtë i respektonin dhe admironin, ranë në kurth dhe u joshën nga mas-mediat (mjetet e informacionit masiv) për të shprehur mbështetjen e tyre për autoritetet, duke ua hedhur krejt fajin të rinjve, pa dëgjuar argumentet apo pikëpamjet e tyre dhe pa u përpjekur të kuptojnë arsyet që janë pas qëndrimeve të tyre.

Në një rast tjetër, pasi qeveria egjiptiane burgosi shumë anëtarë të xhemateve të ndryshme islame dhe pezulloi aktivitetet e tyre, një dijetar i mirënjohur deklaroi në një takim publik se xhematet islame ishin braktisur nga All-llahu (xh.sh.). Ai tha se nëse ata do të kishin ndjekur rrugën e drejtë dhe do të kishin fituar bekimin e All-llahut (xh.sh.), as policia dhe as ushtria s’do t’i kishin mundur dot. Një absurditet i tillë nuk është kriter për të gjykuar midis së drejtës dhe batilit, dhe është kokë e këmbë joislam.

Ka shumë kushte dhe mjete, të cilat çojnë drejt fitores, por këto mund të mos i jepen një personi ose grupi, i cili lufton për të vërtetën kështu që ai pëson disfatë. Po kështu, një person ose grup i

⁸³ Autentik sipas të gjitha autoriteteve

cili lufton për të pavërtetën mund të ndihmohet deri në triumf nga rrethana të caktuara, por një fitore e tillë s'mund të jetë e përjetshme, sado që të zgjasë. Të ulurat dhe ngriturat e historisë e dëshmojnë këtë gjë. Në ditët tona, disfata dhe fitorja nuk përcaktohen nga e vërteta dhe e pavërteta: ato përcaktohen nga ndërhyrja e superfuqive. Një shembull i këtij lloji janë edhe *“fitoret”* e Izraelit mbi arabët.

A nuk e dinë të gjithë se si u shtyp pa mëshirë populli turk musliman dhe dijetarët e tij nga Atatürku dhe banda e tij? Dhe se si Islami u përzu nga atdheu i Halifatit për t'u zëvendësuar me forcë nga laicizmi antifetar, i cili iu imponua me dhunë popullit turk? Cila nga të dy palët po ndiqte të vërtetën dhe cila të pavërtetën? Kohët e fundit, disa dijetarë të nderuar u torturuan dhe u dënuan me vdekje në një vend musliman, për shkak se kundërshtuan *“ligjin e familjes”*, të cilin qeveria kishte ndërmend ta impononte, megjithëse kjo gjë ishte një shmangie e plotë nga Sheriati. Ndëshkimi kishte si qëllim t'i tmerronte dhe t'ua mbyllte gojën të gjithë atyre që e kundërshtonin ligjin. Regjimi despotik ia arriti qëllimit dhe dijetarëve të tjerë e popullit në përgjithësi iu mbyll goja. A do të thotë kjo se qeveria kishte të drejtë, ndërsa dijetarët e ekzekutuar jo? Në një vend tjetër musliman, pakica jomuslimane sundon shumicën muslimane. Mijëra muslimanë dhe muslimane arrestohen dhe terrorizohen çdo ditë për të shtypur çdo kundërshtim. Kur burgjet mbushen plot, këta burra dhe gra asgjësohen. Për më tepër, për t'i poshtëruar dhe kërcënuar këta muslimanë të devotshëm, të cilët nuk u tremben as torturave dhe vdekjes, autoritetet përdorin mizoritë më të tmerrshme të cilat nuk janë përdorur as nga vrasës të tillë si Hulagu, Xhengiz Hani etj; ata i përdhunojnë bijat, motrat dhe gratë në sytë e tyre.

O Zot! Sa shumë njerëz të pafajshëm janë vrarë!

Sa shumë gjëra të shenjta janë çnderuar!

Sa shumë vende të shenjta janë poshtëruar!

Sa shumë xhami të nderuara janë rrënuar!

Sa shumë pasuri të çmuara janë plaçkitur!

Sa shumë shtëpi dhe qytete të tëra janë shembur mbi banorët e tyre!

Sa shumë burra, gra dhe fëmijë të pafajshëm u janë nënshtruar mizorive! Kjo është historia.

Babai i shehidëve, Husejni, i biri i Aliut (radijall-llahu anhu) pësoi disfatë nga ushtria e prirë nga Ibni Zijadi, njëri nga komandantët e Jezid ibn Ebu Sufjanit. Si rezultat, Benu Umejje (emevitët) sunduan për dekada, por familjes (Ehlul Bejtit) të të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk iu bë ndonjë privilegj, madje as gjatë sundimit të abbasidëve, kushërinjve të tyre. A mund të merret kjo si argument që Jezidi po ndiqte të vërtetën, ndërsa Husejni (radijall-llahu anhu) të pavërtetën?!

Për më tepër, vite më vonë, komandanti i ditur dhe me kurajo Abdull-llah Ibn Zubejri u mund nga i paskrupullti Haxhaxhaxh ibn Jusufi. Më pas Haxhaxhaxhi mundi një tjetër komandant të madh musliman, Abdurrahman ibn El Esh'ath, si dhe një grup dijetarësh të shquar, midis të cilëve ishin Seid Ibn Xhubejri, Esh Shaabiu, Mutrif Ibn Abdull-llahu e shumë të tjerë. Të gjitha këto disfata ishin humbje të mëdha për Ummetin, veçanërisht Seid Ibn Xhubejri, për të cilin Imam Ahmedi ka thënë: “Seidi u vra në një kohë kur çdo musliman kishte nevojë të madhe për njohuritë dhe dijen e tij”.

Është me vend të përmendim këtu se disa muslimanë, kur u mposhtën nga armiqtë gjatë betejës, thanë: “Pasha All-llahun! Edhe sikur egërsirat të na shqyejnë copë-copë, ne kurrë s’do të dyshojmë se ju jeni në batil (në të pavërtetën), e se ne jemi në hak”. Kur Ibn Zubejri dhe disa nga ithtarët e tij u rrethuan në Mekke, ai tha: “Pasha All-llahun, të drejtët kurrë nuk do të përulen edhe sikur e gjithë bota të bashkëpunojë kundër tyre. Dhe pasha All-llahun, keqbërësit nuk do të nderohen kurrë krejtësisht, edhe sikur hëna t’u qëndrojë në ballë!”

Kjo është në përputhje me atë që Kur’ani na tregon për fatin e pejgamberëve, të cilët u vranë nga armiqtë e tyre. Duke iu drejtuar Beni Israilëve, All-llahu thotë:

“E sa herë që ju erdhi ndonjë i dërguar me çka nuk ju pëlqeu juve, a nuk u bëtë kryelartë dhe disa prej tyre i përgënjeshtruat e disa i mbytet (vratë).”

(2:87)

Nga këta të dërguar ishte Zekerija (a.s.) dhe biri i tij Jahja (a.s.). A mund të thuhet se vrasja e këtyre të dërguarve dhe sukcesi i armiqve të tyre tregojnë që qëndrimi i të parëve (të dërguarve) ishte jo i drejtë? Gjithashtu lexojmë në Kur’an historinë e “*As-hab ul Uhdud*” (Gërmuesit e hendeqeve), të cilët bënë hendeqe me zjarr dhe i hidhnin të gjallë në to besimtarët, ndërsa vetë qëndronin të ulur, në mënyrë sadiste, duke u kënaqur me këtë spektakël të tmerrshëm:

“E nuk patën pse t’i urrejnë, përveç që besuan All-llahun, Ngadhënjyesin, të Lavdëruarin”

(85:8)

A ishin me të drejtën këta tiranë, vetëm sepse i mundën besimtarët e pandihmuar dhe i eliminuan ata? A ishin me të pavërtetën besimtarët, vetëm sepse fundi i tyre ishte aq i tmerrshëm? Këto janë

shembuj nga Kur'ani, të cilët tregojnë se besimtarët sprovohen disa herë me dështime dhe jobesimtarët joshen me sukses.

All-llahu (xh.sh.) thotë:

“A menduan njerëzit të thonë: Ne kemi besuar; e të mos vihen në provë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që All-llahu gjithsesi do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën, do t'i dallojë edhe gënjeshtarët.”

(29:2-3)

Pas disfatës së muslimanëve në Betejën e Uhudit, u shpall ky ajet:

“Në qoftë se juve ju preku çka ju dhemb (në Uhud), edhe atë popull (armikun) e pat prekur dhembje si kjo e juaja (në Bedr). Ne këto ditë i ndërrojmë ndërmjet njerëzve për t'u ditur tek All-llahu ata që besuan dhe për t'i zgjedhur disa prej jush dëshmorë. All-llahu nuk i do zullumqarët.”

(3:140)

Gjithashtu All-llahu (xh.sh.) thotë për jobesimtarët:

“... ne do t'i afrojmë ata dalëngadalë tek dënimi prej nga nuk e presin.”

(68:44)

6. MUNGESA E AFTËSISË PËR TË DEPËRTUAR NË BRENDINË E HISTORISË, REALITETIT DHE LIGJEVE TË ALL-LLAHUT

Veç mungesës së aftësisë për të depërtuar në brendinë e mësimave të vërteta të Islamit, mund të shtojmë edhe mungesën e aftësisë së depërtimit në realitetin, historinë si dhe Sunenet (ligjet) e All-llahut në krijesat e Tij. Në mungesë të kësaj, disa njerëz do të vazhdojnë të kërkojnë të pamundurën dhe të paarrtshmen. Ata do të përfytyrojnë atë që s'ndodh dhe që s'mund të ndodhë, të keqkuptojnë ngjarjet dhe t'i interpretojnë ato në bazë të disa iluzioneve të fshehura, të cilat nuk kanë aspak lidhje me Sunenet e All-llahut në atë që e ka krijuar, e as me thelbin e Sheriatit. Ata duan ta ndryshojnë gjithë strukturën e shoqërisë: mendimin e saj, ndjenjat, traditat, etikën, sistemet; duan të ndryshojnë sistemet e saj shoqërore, politike dhe ekonomike me mjete iluzore dhe metoda imagjinare. Për t'i realizuar këto objektiva joreale, ata tregojnë kurajë, guxim dhe sakrificë deri në vdekje, duke mos marrë parasysh nëse pasojat janë për apo kundër tyre, përderisa qëllimet dhe objektivat e tyre janë për hir të All-llahut dhe mesazhit të Tij. Prandaj s'është për t'u habitur që njerëz të tillë lëshohen në veprime të cilat nga disa njerëz cilësohen si *"vetëvrasëse"* e nga disa të tjerë *"të marra"*, duke mos e çarë kokën për numrin e viktimave.

Nëse këta muslimanë do të mendoheshin dhe do t'i kushtonin vëmendje, vetëm për një çast, Sunetit të Të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), me siguri do të gjenin në të udhëzimin. Vlen të përmendim që i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) kaloi trembëdhjetë vjet në Mekke, duke i mësuar dhe thirrur njerëzit në mesazhin e tij dhe bile, duke bërë tavaf dhe duke u falur në Qabe, megjithëse ajo asokohe rrethohej nga më shumë se 360 idhuj. Duke e kuptuar mosbarazinë midis fuqisë së tij fizike dhe asaj të armiqve të tij, ai kurrë nuk vendosi të bënte një sulm komandosësh për

t'i shkatërruar idhujt. Ai qe mjaft i zgjuar të kuptonte se kryerja e një veprimi të tillë do të thoshte rrezikim i tij dhe i pasuesve të tij. Për më tepër, shkatërrimi fizik i idhujve, të cilët mund të zëvendësoheshin me lehtësi, nuk do të mund ta shuante politeizmin, i cili ishte rrënjësor në mendjet dhe zemrat e bashkëfisasve të tij. Për këtë arsye, ai u përpoq t'i çlironte mendjet dhe mendimet e tyre nga prangat e besëtytnisë dhe paganizmit. Kështu i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk i përfilli idhujt dhe i përqëndroi përpjekjet e tij në mësimin e monoteizmit dhe pastrimin e zemrës pagane përmes devotshmërisë, në mënyrë që ata, të cilët e përqafuan mesazhin, të mund të përbënin një bërthamë besimtarësh të cilët e dinin përse luftonin; një grup i sigurt në sukses përmes durimit dhe këmbënguljes; një grup që s'mund të dehej nga fitorja apo të dëshpërohej nga disfata. Pas një kohe, kur shokët e tij, të zemëruar nga mizoritë që po hiqnin nga paganët, të rraskapitur dhe të plagosur duke u rrjedhur gjaku i vinin të Dërguarit dhe i kërkonin leje t'i luftojnë ata, por gjithmonë ai kundërshtoi, duke e kuptuar se akoma nuk ishin pjekur kushtet dhe se ata duhet të duronin derisa All-llahu (xh.sh.) t'u jepte leje për luftë.

Një ditë, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) takoi Ammar ibn Jasirin (radijall-llahu anhu) dhe prindërit e tij, të cilët ishin torturuar nga jobesimtarët. E gjithë ajo që bëri ai ishte t'u jepte atyre kurajë të duronin dhe t'i përgëzonte ata me sihariqin për vendin që kishin siguruar në xhennet. Punët vazhduan kështu derisa muslimanët u lejuan të luftonin në mbrojtje të lirisë dhe fesë së tyre:

“Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtësi, e All-llahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre. (U lejuan të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: “All-llahu është Zoti ynë” u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte.”

(22:39-40)

Por ky lejim u dha vetëm pasi i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe shokët e tij ia dolën të kenë një atdhe për vetvete dhe të rrisnin fuqinë dhe autoritetin e tyre. Vetëm tani ata u lejuan t'i luftonin armiqtë e tyre. Ata fituan beteja pas betejash, derisa All-llahu (xh.sh.) u dha atyre Fet'hun (çlirimin) e Mekkes prej së cilës i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) kishte emigruar nën presionin e përndjekjes, duke i shkatërruar të gjithë idhujt në të dhe duke recituar këtë ajet kur'anor:

“Dhe thuaj: Erdhi e vërteta e u zhduk e kota. Vërtet e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur.”

(17:81)

Prej çudirave që kam lexuar dhe dëgjuar është edhe qëndrimi i udhëheqjes së *“Xhemaat ut Tekfir vel Hixhre”* (që nga fundi i viteve ‘60), e cila, çuditërisht, historinë e konsideron si të pavlefshme për t'u pranuar ose imituar. Një qëndrim i tillë i çuditshëm dhe absurd është shkaku i dallimeve midis dy prijësve të këtij grupi, Abdurrahman Ebu Hajrit dhe Shejh Shukriut, themeluesit të tij. Në librin e tij *“Kujtime”*, Ebul Hajri kujton se *“mungesa e besimit dhe mosmbështetja në historinë islame”* nga ana e grupit ishte aspekti i katërt i divergjencave midis tij dhe Shejh Shukriut, i cili e konsideronte historinë islame *“një seri ngjarjesh të pavërteta”*. Për Shukriun, historia përbëhet vetëm nga historitë e rrëfyera në Kur'an dhe për këtë ai ndaloj çdo interesim për studimin e periudhave të Halifatit islam”.

Mendoni rreth këtij koncepti të paarsyeshëm, mendjengushtë dhe të cekët, *“te një njeri i cili mbi bazat fetare”* e konsideron studimin e historisë islame si haram (të ndaluar). Historia e një ummeti, me të gjitha aspektet e saj negative dhe pozitive, me fitoret dhe disfatat e saj, është një minierë e pasur në të cilën ummeti gërmon për të rikonstruktuar dhe ridrejtuar të tashmen e tij. Një ummet

i cili nuk përfill historinë e tij, është si një person që ka humbur kujtesën ose si një komb pa rrënjë, sens, përkitje apo drejtim. Si mundet që një grup ta bëjë këtë kusht jo të shëndoshë dhe jonormal, bazën e mbijetesës së tij? Për më tepër, historia është pasqyra në të cilën janë reflektuar Sunenet e All-llahut në krejt Gjithësinë, në përgjithësi dhe në jetën njerëzore, në veçanti. Kjo është edhe arsyeja që Kur’ani i kushton vëmendje të veçantë lidhjes midis perspektivës historike dhe urtësisë që mund të nxirret prej saj. Në Kur’an ka shumë raste të tilla; le të shqyrtojmë ajetet e mëposhtme:

“Përpara jush kanë kaluar popujt ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet, ndaj udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni si qe përfundimi i atyre që përgënjeshtroan.”

(3:137)

Megjithatë, Sunenet (ligjet) e All-llahut karakterizohen nga vazhdueshmëria, ato kurrë nuk ndryshojnë. Lidhur me këtë All-llahu thotë:

“Ata me betimin më të fortë të tyre janë betuar në All-llahun se, nëse u vjen atyre ndonjë peygamber, do të jenë më të udhëzuarit nga njeriu i atyre popujve (hebre ose i krishterë) e kur u erdhi atyre peygamberi, nuk u shtoi tjetër veçse largim. Për shkak të mendjemadhësisë dhe dredhisë së keqe, por dredhia e keqe nuk godet tjetër vetëm ata që e kurdisën. Pra, ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm se gjurmën e të parëve, e në ligjin e All-llahut kurrë nuk do të hasësh devijim.”

(35:42-43)

Meqë Sunenet e All-llahut janë faktorë të përbashkët për të gjithë, mënyra se si i trajton Ai ata që bëjnë keq, është e njëjtë në të gjitha rastet dhe zbatohet mbi të gjithë popujt pa marrë parasysh fenë e tyre si dhe kohën dhe hapësirën. Në luftën e Uhudit kemi një shembull prej të cilit nxjerrim mësim, kur muslimanët e paguan shtrenjtë mospërfilljen ndaj këshillës së të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), e cila tregohet në Kur'an:

“E kur juve ju goditi një dështim (në Uhud) e që ju ia patët dhënë atë dyfish (armikut në Bedr), thatë: “Prej nga kjo?” Thuaj: “Ajo është nga vetë ju!”. S’ka dyshim se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send.”

(3:165)

Një ajet tjetër bën të qartë natyrën e gabimit, i cili çoi në disfatë:

“All-llahu përmbushi premtimin e vet ndaj jush, ngase me vullnetin e Tij i korrët ata, deri kur u dobësuar dhe u përçatë ndërmjet vete, në çështjen e vendit dhe pasi vërejtët atë që dëshironit, e atëherë kundërshtuat...”

(3:152)

Pohimi se historia është një varg ngjarjesh të dyshimta, mund të jetë i vërtetë për sa u përket disa incidenteve të vogla, por drejtimi i përgjithshëm dhe ngjarjet kryesore janë të mirënjohura dhe të vërtetuara mirë nga më shumë se një burim. Bile edhe ato ngjarje, të cilat janë të dyshimta, mund të shqyrtohen nga dijetarët, në mënyrë që të përcaktohet e vërteta dhe të eliminohen gabimet, falsifikimet ose ekzagjerimet.

Megjithatë, ne interesohemi jo vetëm për historinë islame, por edhe për historinë e krejt njerëzimit, të muslimanëve dhe jomuslimanëve, që nga fillimet e krijimit. Urtësia (mësimet) nuk nxirret vetëm nga historia e besimtarëve, por edhe nga ajo e jobesimtarëve, sepse Sunenet e Allahut, si modele natyrore, veprojnë mbi të dy palët pa ndonjë favorizim të monoteistit apo paganit. S'mund ta kuptojmë Kur'anin siç duhet apo të falënderojmë me mirënjohje për favorin që na ka bërë Islami, nëse nuk kuptojmë natyrën dhe praktikën e gabuara të Xhahilijetit (periudhës paraislame) të treguar në këto ajete:

“... edhe pse më parë, ata ishin krejtësisht të humbur.”

(3:164)

dhe:

“... madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit e Ai ju shpëtoi prej tij.”

(3:103)

Gjithashtu ky është edhe thelbi i thënies së Umer Ibnul Hattabit (radijall-llahu anhu): “Lidhjet e Islamit do të prishen, një nga një, kur të vijnë muslimanë që nuk e njohin (natyrën e keqe) të xhahilijetit (dhe që nuk e çmojnë Islamin).”

Duhet pranuar se shumë njerëz të interesuar për Islamin dhe përhapjen e tij nuk e kanë studiuar me kujdes dhe s'e kanë kuptuar historinë, por prapëseprapë ata nuk ia kanë ndaluar studimin e saj vetvetes ose pasuesve të tyre siç kanë vepruar disa ekstremistë. Studimi i historisë nuk është vetëm njohje e ngjarjeve në periudhën e tyre kohore, por është një aktivitet që kërkon

mendjemprehtësi dhe kuptim të ngjarjeve me qëllim që të kuptohet thelbi i tyre, të nxirret mësim prej tyre dhe të nxirren prej tyre Sunenet e All-llahut. Vetëm vëzhgimi i rrënojave të popujve të mëparshëm nuk ka vlerë. Ajeti i mëposhtëm tregon që depërtimi në histori s'mund të realizohet vetëm nga vëzhgime të tilla apo vetëm me të dëgjuar:

“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë dhe veshë me të cilët do të dëgjojnë? Pse në të vërtetë sytë nuk verbohën, por verbohën zemrat në kraharrorë.”

(22:46)

Ngjarjet historike përsëriten dhe ngjasojnë me njëra-tjetrën, sepse ato qeverisen nga ligje të vazhdueshme, të cilat i vënë në lëvizje dhe i rregullojnë ato. Kjo është arsyeja që perëndimorët thonë: “*Historia përsëritet*” dhe arabët shprehen me këtë thënie: “A ka më të ngjashme se nata e sontme me të mbrëmshmen”.

Kur’ani i referohet ngjashmërisë së vëzhguar në qëndrimet, thëniet dhe veprimet për shkak të ngjashmërisë së mendimeve dhe vizioneve, që rrjedhin prej tyre:

“E ata që nuk dinë thanë: “Përse të mos na flasë neve All-llahu ose të na vijë ndonjë argument!” Po kështu, thëniet e tyre në mënyrë të njëjtë i patën përsëritur edhe ata që ishin para tyre. Të njëjta janë zemrat e tyre. Ne tanimë i sqaruam argumentet për një popull që dëshiron të bindet.”

(2:118)

All-llahu (xh.sh.) thotë gjithashtu për idhujtarët kurejshë:

“Ja, ashtu pra, edhe atyre që ishin më parë nuk u erdhi i dërguar e që nuk thanë: “Është magjistar ose është i çmendur! A mos e porositën njëri-tjetrin me këtë? Jo, por ata janë popull renegat.”

(51:52-53)

Kjo ngjashmëri midis qëndrimit të popujve të mëparshëm dhe atyre të mëvonshme kundrejt të dërguarve të All-llahut (xh.sh.) dhe nxitimi me të cilin popujt i akuzuan të dërguarit për magji apo çmenduri, nuk është rezultat i trashëgimisë së transmetuar midis tyre, por sepse ata ishin të padrejtë dhe i kalonin kufijtë. Meqë shkaku, dmth. tejkalimi i kufijve dhe mizoria është e përbashkët, qëndrimi i tyre është i njëjtë.

Ata që e kuptojnë rëndësinë e historisë dhe veprimin e Suneneve të All-llahut në të, mund dhe duhet të mësojnë nga gabimet e brezave të mëparshëm. Do të ishin të lumtur ata, të cilët nxjerrin mësim nga gabimet dhe fatkeqësitë e të tjerëve dhe që mundohen të zbatojnë të mirën e tyre. Urtësia është synimi i besimtarit, kudo që ta gjejë atë, ai e meriton atë më shumë se kushdo tjetër.

7. DY SUNENE TË RËNDËSISHME

Zakonisht muslimanët entuziastë dhe të nxituar nuk vënë re dy Sunene të rëndësishme, shkallëzimin dhe atë se për të arritur objektivat, nevojitet një kohë e caktuar. Së pari: Shkallëzimi shfaqet qartë si në procesin e krijimit ashtu edhe në legjislacion. All-llahu (xh.sh.) është i aftë të krijojë qiejt dhe tokën sa të hapësh e të mbyllësh sytë:

“Ai vetëm thotë: ‘Bëhul’ Në atë moment bëhet.”

(2:117).

Megjithatë, Ai i krijoi ato në gjashtë ditë të Tij dmth në etapa, të cilat i di vetëm Ai, sepse ato ndryshojnë nga koncepti ynë i ditës. Gjithashtu shkallëzimi është i dukshëm në krijimin e të gjithë organizmave të gjallë, të cilët rriten me etapa derisa arrijnë pjekurinë. I njëjti proces shikohet në da'ven, e cila fillon me ngulitjen e monoteizmit për të çliruar mendjet nga prangat e paganizmit dhe besëtytnisë. Posa ky të jetë ngulitur fort, atëherë paraqiten gradualisht vaxhibatet (obligimet) dhe muharrematet (të ndaluarat), si psh. namazi, agjërimi, zekati, ndalimi i alkoolit etj. Dhe te kjo ne vemë re dallimin midis teksteve të shpallura në Mekke dhe atyre të shpallura në Medine.

Aisheja (radijall-llahu anha) e përshkruan kështu procesin e shkallëzimit në paraqitjen e Sheriatit dhe shpalljen e Kur'anit: “Të parat ajete kur'anore që u shpallën ishin ato, në të cilat përmenden xhenneti dhe xhehennemi. (Më vonë) kur njerëzit e përqaftuan Islamin, u shpallën ajetet që trajtonin hallallin dhe haramin. Nëse në fillim do të ishin shpallur ajetet të cilat ndalojnë pirjen e alkoolit dhe praktikimin e kurvërisë (zinasë), njerëzit do të kishin thënë: “Kurrë s'do të heqim dorë nga alkooli dhe kurvëria”.⁸⁴

Prandaj, ata që thërrasin për kthim në mënyrën islame të jetës dhe vendosjen e Shtetit islam, duhet të marrin parasysh nevojën e shkallëzimit për realizimin e objektivave të tyre, sublimitetin e qëllimit, mjetet dhe potencialin e tyre dhe pengesat e shumta. Kjo gjë na sjell në mendje shembullin e Halifit të drejtë, Umer ibn Abdulaziz, i cili ia doli me sukses, ta rindërtojë jetën sipas shembullit të katër halifëve në Rugë të drejtë. Por, procesi i rindërtimit s'ishte i lehtë. Bile edhe biri i tij Abdulmeliku, një musliman i devotshëm dhe entuziast, mendonte se babai i tij ishte shumë i ngadalshëm në përpjekjet e tij për të çrrënjësuar të gjitha gjurmët e devijimit dhe agresionit.

⁸⁴ Transmetojnë Buhariu dhe të tjerët

Njëherë ai iu drejtua të atit me këto fjalë: “O baba, përse nuk i kryen (reformat më shpejt)? Pasha All-llahun, unë nuk shqetësohem nëse unë dhe ti vritemi për hir të së vërtetës!” Por, përgjigja e babait fakih⁸⁵ e mu’min ishte: “Mos u nxito biri im. All-llahu e dënoi alkoolin dy herë në Kur’an dhe e ndaloi atë vetëm herën e tretë. Unë kam frikë se nëse ia imponoj gjithë të vërtetën popullit (menjëherë), ata do ta kundërshtojnë atë. Kjo mund të shkaktojë fitne (përçarje)”.⁸⁶

Së dyti: I dyti nga këto Sunene plotëson të parin dmth çdo gjë ka një afat të caktuar gjatë të cilit arrin pjekurinë dhe përkryerjen. Kjo zbatohet si tek materialja ashtu edhe tek moralja. Asgjë s’duhet vjelë para afatit të caktuar; prodhimet s’mund të vilen para se të piqen. Në vend që të sjellin dobi, frutat dhe perimet e papjekura mund të shkaktojnë dëm. Ashtu si perimet që kanë nevojë për disa muaj apo një vit, e edhe disa pemë për disa vite për dhënien e frutave, ashtu edhe kuptimet dhe vlerat e vërteta të aksioneve të mëdha duken pas shumë vjetësh. Sa më shumë kohë që u duhet aksioneve për t’u pjekur, aq më të mëdha janë ato. Shpesh përpjekjet e një brezi materializohen në brezin e mëpasshëm ose edhe më vonë. Në këtë gjë s’ka ndonjë të keqe, nëse çdo gjë ndjek rrugën e saj të planifikuar dhe natyrore. Gjatë kohës kur i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) qëndroi në Mekke, jobesimtarët talleshin me të sa herë që ai i paralajmëronte ata për ndëshkimin që i priste, nëse vazhdonin ta kundërshtonin All-llahun (xh.sh.) dhe për këtë, ata i kërkuan atij ta shpejtonte këtë ndëshkim, duke mos e kuptuar që ai duhet të ndiqte rrugën e tij dhe s’mund të shtyhej as të afrohej:

⁸⁵ Transmeton Buhariu

⁸⁶ Esh-Shatibi, El-Muwafekat, 2, 94

“Ata kërkojnë prej teje përshpejtimin e ndëshkimit, e sikur të mos ishte afati i caktuar, atyre do t’u vinte ndëshkimi, po ai patjetër do t’u vijë atyre befas ashtu që ata nuk e hetojnë.”

(29:53)

dhe:

“Ata kërkojnë prej teje t’ua përshpejtosh dënimin, po All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti Yt, është sa një mijë vjet, si llogaritni ju.”

(22:47)

Në këtë etapë All-llahu (xh.sh.) e këshilloi të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) të bënte durim siç kishin bërë edhe të dërguarit e mëparshëm dhe të mos ngutej të kërkonte ndëshkimin e All-llahut ndaj tyre:

“Ti (Muhammed) duro, ashtu siç duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko përshpejtimin e dënimit për ta...”

(46:35)

All-llahu (xh.sh.) i kujton të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe pasuesve të tij se si duruan të dërguarit e mëparshëm përballë torturave të ashpra, rrugës së gjatë dhe vështirësive të fitores së pritur:

“Po ju menduat se do të hyni në xhennet pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, saqë i Dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: “Kur do të jetë ndihma e All-llahut?” Ja (u erdhi ndihma), vërtet ndihma e All-llahut është afër!”

Me të vërtetë, fitorja e All-llahut është afër, por ajo ka një kohë të caktuar, të cilën e di vetëm Ai, sepse Ai nuk i shpejton gjërat siç bëjnë krijesat e Tij. Për këtë arsye, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i këshillonte shokët e tij të ishin të durueshëm dhe të mos e pritnin fitoren para kohës së saj të caktuar. Kjo gjë tregohet në këtë shembull: kur Habab ibn el Arati iu ankua të Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për vuajtjet e mëdha që po hiqte për hir të Islamit dhe i kërkoi atij t'i bëjë lutje All-llahut (xh.sh.) për ndihmë, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u zemërua kaq shumë, saqë fytyra iu skuq dhe tha:

“(Një besimtar) përpara jush është copëtuar me mjete prerëse prej hekuri, saqë asgjë përveç kockave nuk i mbeti dhe një tjetër u sharrua (i gjallë) në dy pjesë, por asnjëri prej tyre nuk e braktisi fenë e tij. Pasha All-llahun, Ai do ta bëjë Islamin të dominojë, saqë një udhëtar që shkon nga San'a (në Jemen) në Hadremevt nuk do t'i frikësohet (gjatë udhëtimit të tij) asgjëje me përjashtim të All-llahut dhe ujkut për dhentë e tij. Po ju po nguteni”⁸⁷.

8. ISLAMI: NJË I HUAJ NË ATDHEUN E TIJ

Ndoshta faktori më alarmues dhe më i padurueshëm për çdo musliman të flaktë, veçanërisht për të rinjtë, është moszbatimi i mësimëve të Islamit në vendet muslimane, në të cilat çoroditja,

⁸⁷ Transmeton Buhariu

korupsioni dhe gënjeshtria po përhapen me shpejtësi. Marksizmi dhe laicizmi po përhapen haptas dhe publikisht. “*Kryqtarët*” bashkëkohorë planifikojnë dhe veprojnë për të depërtuar kudo pa frikë. Përveç klubeve dhe teatrove, mas-media përhap paturpësinë dhe sjelljet e këqija. Gra gjysmëlakuriqe dhe të dehura enden rrugëve duke joshur dhe provokuar; pirja e alkoolit është e ligjësuar dhe e zakonshme. Çdo aspekt i marrëzisë ose zbavitjes sensuale në formën e letërsisë, këngëve, teatrove, filmave dhe materialit pornografik, projektohet për të korruptuar, për të thelluar mosnjohjen e Islamit dhe për të penguar besimin.

Veç kësaj, muslimani i përkushtuar sheh çdo ditë që legjislacioni, i cili supozohet të mishërojë besimet dhe vlerat e Ummetit në formën e ligjeve, të cilat duhet të ngrenë lart moralin e tij dhe të ndëshkojnë ata që i shkelin ato, miraton çdo gjë që ndalohet nga Sheriati dhe mbron korupsionin, sepse legjislacioni ekzistues nuk rrjedh nga Udhëzimi hyjnor, por nga filozofitë sekulare. Ndaj s’duhet të habitemi që ai sanksionon si të ligjshme atë që All-llahu (xh.sh.) e ka ndaluar dhe ndalon atë që Ai e ka lejuar. Gjithashtu ai nuk përfill obligimet e urdhëruara nga All-llahu (xh.sh.) dhe nuk zbaton ndëshkimet specifike, të caktuara për veprat e ndaluara nga All-llahu (xh.sh.) ose i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Për më tepër, çdo ditë të rinjtë janë dëshmitarë të devijimit të shumicës së sundimtarëve të vendeve islame, atyre të cilëve u është besuar kjo përgjegjësi. Me paturpësi ata zënë miq armiq të All-llahut (xh.sh.) dhe shfaqin armiqësi ndaj atyre që i frikësohen Atij dhe që kërkojnë të Vërtetën hyjnore; të parët gëzojnë favorizimin dhe mbrojtjen e sundimtarëve, ndërsa të dytët egërsinë dhe shtypjen e tyre. Islami përmendet rrallë, në festa kombëtare dhe “*fetare*”, për të mashtruar masat.

Gjithashtu, të rinjtë janë dëshmitarë të padrejtësive të hapura shoqërore dhe mosbarazisë së madhe midis të varfërve dhe të pasurve, midis atyre që mezi nxjerrin bukën e gojës dhe atyre që

humbin miliona në bixhoz dhe me femra; ata shikojnë vila që kushtojnë miliona, por që përdoren me raste, ndërsa miliona muslimanë janë pa strehë; ata dëgjojnë për pasuri që transferohen për t'u ruajtur në llogari të fshehta të bankave, ndërsa miliona muslimanë kënaqen me pak, bile edhe ajo u mohohet; të cilët mezi ushqejnë fëmijët dhe blejnë ilaçet për të sëmurët dhe pleqtë. Megjithatë, sikur këta persona që kanë uzurpuar të ardhurat nga nafta, që kanë përfituar nga politika e bashkëpunimit ekonomik me Perëndimin, agjentët e kompanive të mëdha ndërkombëtare, të dhuronin veçse një pjesë të pasurisë së harxhuar në bixhoz ose femra, do të mund të lehtësohej një pjesë e madhe e varfërisë si dhe do të sigurohej ushqimi dhe strehimi për dhjetëra mijë njerëz. Pasuri të panumërta dhe fonde publike përvetësohen në mes të ditës, marrja e ryshfeteve dhe favorizimi janë rrënjësor thellë. Ata që kryejnë këto vjedhje, i shpëtojnë gjithmonë drejtësisë, ndërsa ata që kryejnë shkelje relativisht të parëndësishme, ndëshkohen rreptësisht. Një padrejtësi e tillë ka ngjallur ndjenjat e hidhura të zilisë, urrejtjes dhe mërisë midis shtresave të ndryshme të shoqërisë. Mbrojtësit e ideologjive destruktive i shfrytëzojnë këto ndjenja zemërimi, i fryjnë zjarrit të luftës së klasave dhe urrejtjes shoqërore, duke ia dalë të krijojnë një atmosferë, në të cilën ideologjitë e tyre të huaja dhe të importuara pranohen si alternativa. Në këtë atmosferë, mbrojtësit e ideologjive të tilla gjejnë një numër të madh njerëzish, të gatshëm për t'i dëgjuar ata, jo sepse i pranojnë idetë e tyre, por kjo ndodh si një kundërveprim dhe urrejtje ndaj kushteve mbizotëruese.

S'ka asgjë enigmatike në gjetjen e shkakut kryesor të kësaj gjendjeje tragjike. Islami, si një mënyrë jetese, me gjithanshmërinë, vizionin, drejtësinë dhe ekuilibrin e tij, gati mungon në skenë, është i huaj në atdheun e tij. Ai është larguar nga jeta publike, çështjet ekonomike dhe publike të shtetit, legjislacioni dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, duke u shndërruar në një marrëdhënie private

midis individit dhe Zotit të tij, një gjendje e ngjashme me atë të Krishterimit gjatë periudhës së tij të dekadencës. Islami është shndërruar në një fe pa Sheriat, në një fe pa shtet, në një Kur'an pa autoritet.

Islami është detyruar të vuajë pasojat e një të kaluare të huaj për historinë dhe Ummetin e tij. Historia e kishës katolike në Perëndim është e mbushur plot me shkatërrime dhe qëndrime negative, me të cilat kisha u radhit më një rresht me despotizmin, monarkët e padrejtë dhe lordët feudalë kundër masave të pambrojtura. Ajo krijoi Inkuizicionin, i cili përdoqi dhe torturoi njerëzit me dituri dhe ide të reja, dijetarët dhe shkencëtarët u dogjën të gjallë, injoranca dhe agresioni iu imponuan shoqërive në emër të fesë dmth. të Krishterimit. Nuk duhet të habitemi pse masat u ngritën kundër saj dhe kërkuan të çlirohen. Ndaj, s'ka arsye që Islami të bartë pasojat e kësaj historie të zymtë dhe të huaj, vetëm me qëllim që të ndalohet nga ndonjë vend me influencë në legjislacionin dhe udhëheqjen e Ummetit dhe të kufizohet në ndërgjegjen e njerëzve apo në xhami, një "xhami" gjuhëlidhur e cila është gjithmonë nën mbikëqyrjen e shërbimit të fshehtë. Bile edhe atje, Islami nuk lejohet të urdhërojë për të mirë dhe të ndalojë atë që është e keqe dhe e padëshiruar.

Ky problem mund t'i atribuohet imponimit të laicizmit ndaj shoqërive muslimane, një tendencë e huaj e cila është në kundërshtim me çdo gjë që është islame. Laicizmi predikon ndarjen e fesë nga shteti, legjislacionit nga autoriteti (pushteti), një koncept i panjohur gjatë gjithë historisë së Ummetit islam. Islami dhe Sheriati kanë qenë gjithmonë burime të ibadetit, legjislacionit, transaksioneve publike, traditave dhe etikës. Kanë ekzistuar disa raste kur Sheriati nuk është përfillur gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis palëve kundërshtarë, kur disa nga udhëheqësit dhe të udhëhequrit devijuan nga haku, por nuk njihet ndonjë të jetë ngritur kundër Sheriatit si ligj tek i

cili duhet kthyer në zgjidhjen e të gjitha problemeve jetike. Bile edhe sundues të tillë despotikë si Haxhixhaxh ibn Jusufi, nuk u treguan aq të pacipë sa të kundërshtonin ndonjë vendim të bazuar mbi Kur'anin dhe Sunnetin. Ky krahasim është i rëndësishëm, sepse ka një dallim shumë të madh midis shmangies nga Sheriati për qëllime vetjake, zili, mospërfillje, zemërim etj., dhe mohimit të superioritetit të tij mbi të gjitha sistemet; kjo sepse Sheriati duhet të sundojë çdokënd dhe çdo gjë për shkak të natyrës dhe aftësisë së tij si mishërim i fjalës dhe gjykimit të All-llahut (xh.sh.):

“A thua mos po kërkojmë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më të mirë se ai i All-llahut.”

(5:50)

S'duhet të habitemi pse ndërgjegjja e të rinjve muslimanë, e ndodhur përballë kësaj gjendjeje të punëve, tronditet kur sheh që vendet jomuslimane e rregullojnë jetën e tyre në pajtim me ideologjitë e tyre, filozofitë ose konceptet e tyre për fenë, ekzistencën, Zotin dhe njeriun, ndërsa muslimanët detyrohen të vuajnë një kundërshti midis besimeve të tyre dhe realitetit, midis fesë së tyre dhe shoqërisë. Në lidhje me këtë, kam shkruar:

- Laicizmi mbase mund të pranohet në një shoqëri të krishterë, por s'mund të gëzojë kurrë përkrashje të gjerë në një shoqëri islame. Krishterimi është i privuar nga një shariat apo një sistem i plotë jete, të cilin pasuesit e tij do të mund ta zbatonin. Vetë Testamenti i Ri (Dhjata e Re) e ndan jetën në dy pjesë: njëra për Zotin apo fenë, tjetra për Qesarin apo shtetin: “Jepi Qesarit atë që i përket Qesarit dhe jepi Zotit atë që i përket Zotit (Mateu 22:21). Kështu, një i krishterë mund ta pranojë laicizmin pa asnjë vlarje të ndërgjegjes. Aq më tepër perëndimorët, veçanërisht të krishterët, kanë arsye të preferojnë një regjim laik ndaj një regjimi fetar. Eksperienca e tyre me

“regjimet fetare” të cilat i kanë njohur mirë, do të thotë sundim i klerit, autoritet despotik i kishës, dekrete çkishërimi dhe letra faljeje papnore.

Për shoqërinë muslimane, pranimi i laicizmit do të thotë diçka krejt ndryshe; meqë Islami është sistem i plotë adhurimi (ibadeti) dhe legjislacioni (Sheriati), pranimi i laicizmit do të thotë braktisje e Sheriatit, mohim i Udhëheqjes hyjnore dhe kundërshtim i urdhrave të All-llahut. Është e pavërtetë thënia se Sheriati s’është në gjendje të plotësojë kërkesat e kohës sonë. Pranimi i një legjislacioni të formuluar nga njerëzit do të thotë preferencë e dëturisë dhe eksperiencës së kufizuar njerëzore ndaj Udhëzimit hyjnor:

“Thuaj: A e dini ju më mirë apo All-llahu.”

(2:140)

Për këtë arsye, thirrja për laicizëm midis muslimanëve është ateizëm dhe kundërshtim i Islamit. Pranimi i tij si bazë për qeverisje në vend të Sheriatit është riddeh (renegatizëm, femohim). Heshtja e masave në botën islame për këtë devijim ka qenë një shkelje e madhe dhe një shembull i qartë mosbindjeje, e cila ka sjellë një sens faji, pendimi dhe lëndimi të brendshëm. Të gjitha këto kanë lindur pakënaqësi, pasiguri dhe urrejtje në mesin e muslimanëve të flaktë, sepse një devijim i tillë është i paligjshëm. Laicizmi është në pajtim me konceptin përëndimor mbi Zotin, i cili pohon se pasi Zoti krijoi botën, Ai e la atë të kujdesej për vete. Në këtë sens, lidhja e Zotit me botën është si ajo e një orëpunuesi me një orë; ai e prodhon atë dhe pastaj e lë atë të punojë pa patur nevojë për të. Ky koncept është i trashëguar nga filozofia greke, veçanërisht ajo e Aristotelit, i cili pohonte se Zoti as s’e kontrollon botën dhe as s’di gjë për të. Ky është një Zot i paaftë siç e ka përshkruar Will Durant (Uill Djurënt). S’është për t’u çuditur pse një zot i tillë i lë njerëzit t’i

rregullojnë vetë punët e tyre. Si mundet që ai të vendosë ligje për ta, kur ai nuk i di punët e tyre? Ky koncept është krejtësisht i kundërt me atë të muslimanëve. Ne muslimanët besojmë që All-lahu (xh.sh.) është Krijuesi dhe Furnizuesi i vetëm i botëve, i cili:

“... e di sasinë e çdo gjëje që ekziston.”

dhe i cili është i Gjithëpushtetshëm dhe i Gjithëdijshtëm, mëshira dhe mirësia e Tij kapërcejnë çdo gjë dhe mjaftojnë për të gjithë. Me këtë cilësi, All-lahu (xh.sh.) ia shpalli udhëzimin e Tij hyjnor njerëzimit, lejoi disa gjëra dhe ndaloj disa të tjera, i urdhëroi njerëzit të zbatojnë urdhrat e Tij dhe të gjykojnë sipas tyre. Nëse nuk veprojnë kështu, ata bëjnë kufr, shkelje dhe tejkalim kufijsh. Çdo ditë, të rinjtë muslimanë të devotshëm e të flaktë janë dëshmitarë të këtyre të këqijave të urrejtura dhe praktikave joislame, por nuk dinë si t’u bëjnë ballë atyre. Ata s’mund t’i ndryshojnë punët me forcë fizike apo duke shprehur me fjalë shqetësimin dhe mendimin e tyre. E vetmja rrugë për ta është t’i dënojnë këto praktika me zemër, megjithëse kjo është shkalla më e ulët e imanit. Por, kjo revoltë e brendshme s’mund të shtypet përgjithmonë dhe një herë do të shpërthejë.

Veç kësaj, Bota islame dhe çdo gjë që muslimanët e quajnë të shenjtë e të paprekshme, gjenden nën sulm. Forca të ndryshme joislame, cioniste, të krishtera, marksiste, pagane etj., harrojnë dallimet e tyre fundamentale dhe bashkojnë forcat në një fushatë herë të hapur e herë të fshehtë, kundër çdo shenje të ringjalljes islame në formë të lëvizjes apo shtetit islam. Për këtë arsye, çdo rrymë joislame gjen mbështetje morale dhe materiale nga Lindja dhe Perëndimi. Ndërsa ato islame s’kanë as mbështetje reale as praktike prej ndokujt. All-lahu (xh.sh.) e ka treguar këtë në Librin e Tij:

“Ata që e mohuan të vërtetën, janë miq të njëri-tjetrit.”

Është e pamundur për një musliman të sodisë në heshtje dhe me indiferencë fatkeqësitë tragjike që bien mbi Ummetin e tij (apo të vështrojë vëllezërit e tij në Islam të theren si kafshët apo të konvertohen në Krishterim, apo të çohen drejt së shtrembrës dhe injorancës). Ç'mund të thuhet për vëllazërinë muslimane dhe solidaritetin e muslimanëve? Një musliman duhet të besojë në vëllazërinë e muslimanëve. Ai duhet të jetë krenar që i përket Ummetit më të mirë që ka dalë nga njerëzimi. Aq më tepër, ai duhet të besojë se muslimanët, pa dallim kombi apo gjuhe, janë një Ummet në të cilin, personi që është i fundit në radhë, është përgjegjës për të gjithë dhe në të cilin, të gjithë bashkohen kundër armikut dhe pranojnë hadithin e Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) se “ai që nuk interesohet (shqetësohet) për gjendjen e muslimanëve, nuk është musliman”. Lajmet e përditshme i sjellin muslimanit të flaktë njoftime për vuajtjet e vëllezërve të tij muslimanë në Palestinë, Liban, Afganistan, Filipine, Eritre, Somali, Qipro, Indi (Bosnjë, Çeçeni, Kosovë - G.Ç.) dhe vende të tjera ku sot ekziston një pakicë e shtypur muslimane ose një shumicë e nënshtruar muslimane. Veç kësaj, i riu vëzhgon me indinjatë se ndodhi të tilla nuk nxisin ndonjë reagim të duhur nga qeveritë e vendeve të tyre islame. Përkundrazi, ato qëndrojnë krejtësisht indiferente ndaj persekutimit të vëllezërve muslimanë dhe ose e ndalojnë transmetimin e këtyre lajmeve ose edhe më keq, i përkrahin armiqitë e Islamit. Sundimtarët muslimanë interesohen vetëm për interesat e tyre të ngushta lokale, rajonale, kombëtare apo racore; ose për besnikërinë ndaj disa fuqive të huaja, në vend që të jenë besnikë të All-llahut (xh.sh.), të Dërguarit të Tij (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), fesë së Tij, Ummetit të Tij dhe kauzës së Tij.

Gjithashtu rinia muslimane është e vetëdijshme se të gjitha këto qëndrime negative ndaj çështjes së Islamit, në rang lokal dhe ndërkombëtar, janë të nxitura nga forcat e huaja dhe zbatohen nga

disa sundues muslimanë, të cilët sillen si kukulla që dirigjohen nga forcat cioniste, të krishtera apo ateiste. Këto forca mbjellin në zemrat e këtyre sundimtarëve frikën ndaj një revolte islame, i bindin ata për një rrezik potencial dhe i nxisin që të shtypin grupet apo lëvizjet islame; gjithmonë ata bien në kurth!

Një nga çështjet kryesore që ka shkaktuar humbjen e shpresës dhe lëndim në zemrat dhe mendjet e të rinjve muslimanë, gjatë dy dekadave të fundit, është Lufta e Gjashtë Ditëve e 1967-ës midis arabëve dhe izraelitëve, një katastrofë e madhe, pasojat e së cilës u minimizuan me qëllim, kur përgjegjësit e saj, së bashku me bashkëpunëtorët e tyre, e quajtën atë një *“tërheqje”* në vend të fjalës *“disfatë”*. Rinia muslimane në vendet arabe u rrit me bindjen se Izraeli ishte një parazit, një i huaj në atë rajon, i krijuar me agresion dhe uzurpim, dhe se çlirimi i tokave islame nga ky trup i huaj ishte një detyrë fetare dhe kombëtare; se Izraeli s’kishte të drejtë të pushtonte një vend që nuk i përkiste atij. I ndjeri haxhi Emin El Husejni (All-llahu e mëshiroftë), myftiu i Palestinës, ka thënë në lidhje me këtë: “Palestina nuk është atdhe pa popull që të pranojë një popull pa atdhe!” Megjithatë pas disfatës katastrofike të regjimeve arabe më 1967, politika në botën arabe mori një kthesë të re, objektivi kryesor i së cilës u bë *“riparimi i efekteve të agresionit”*, dmth. njohja e ekzistencës së Izraelit. Në fakt, kjo do të thotë se agresioni i Izraelit i 1967-ës i ka legalizuar ata të mëparshmit. Nëse është kështu, atëherë cila ishte arsyeja e luftërave të 1949-ës, 1956-ës dhe 1967-ës? Përse nuk ranë dakord regjimet arabe për të njohur Izraelin që në fillim dhe ta shpëtonin Ummetin nga pasojat tragjike të këtyre luftërave? Kjo u pasua nga *“nisma”* e së ashtuquajturës *“zgjidhje paqësore”* dhe traktateve të paqes. Por një orvatje e tillë ishte tronditëse dhe rrënuese për aspiratat e rinisë muslimane. Autoritetet në Egjipt u përpoqën t’i justifikojnë ato duke u arsyetuar me kushtet ushtarake dhe politike, lokale dhe ndërkombëtare. Por e gjithë kjo ishte një goditje e

fortë për shpresat dhe aspiratat e rinisë muslimane. Goditja u argumentua me faktin se të gjitha fuqitë e mëdha e mbështetën ekzistencën ilegale të Izraelit, megjithëse të drejtat e arabëve dhe muslimanëve ishin të qarta.

Kjo çoi në konkluzionin e paevitueshëm, të mbështetur me argumente të vërteta, veçanërisht midis të rinjve, se një “kryqëzatë” bashkëkohore, e cila ka marrë një trajtë të re, është lëshuar kundër Islamit. Këto ndjenja e kanë influencuar shumë rininë muslimane, e cila e ndjen që shpirti i vjetër kryqtar akoma motivon një numër të madh të udhëheqësve dhe politikanëve perëndimorë, të cilët e shohin botën islame, si dhe çdo lëvizje islame, me një urrejtje të trashëguar të grumbulluar gjatë shekujsh të tërë lufte me Ummetin islam.

Megjithatë shumë intelektualë muslimanë, që dyshojnë shumë për realitetin e këtij shpirti kryqtar perëndimor, deklarojnë se interesat kombëtare janë ato të dorës së parë dhe në përgjithësi, motivet e vetme për Perëndimin, kur merr një vendim apo veprim politik ose ushtarak. Por ndodhitë e djeshme dhe të sotme u tregojnë qartë këtyre optimistëve, se mendimi i tyre është i gabuar dhe se shpirti kryqtar është akoma gjallë. Nuk flas për gjeneralët Alenbi (Allenby) apo Gura (Gourand), por për bashkëkohësit tanë: Përse Perëndimi e mbështet ekzistencën e Izraelit në tokën islame? Përse Shtetet e Bashkuara sfidojnë krejt botën, duke i vënë veton çdo rezolute të Kombeve të Bashkuara që dënon Izraelin? Përse përkrahin Etiopinë, megjithëse është një vend marksist, që prej shumë vjetësh, kundër Eritresë? Përse varrosen dhe lihen në errësirë problemet e vendeve islame, ndërkohë që u kushtohet rëndësi shumë e madhe incidenteve të vogla si psh. rrëmbimit të një aeroplani? Pse gjaku musliman është më i liri në faqe të dheut? Duket se për këto gjëra s'ka shpjegim tjetër, veç ekzistencës së një aleance djallëzore, xhehennemite të fuqive

cioniste, të krishtera dhe ateiste për një fushatë të bashkuar dhe qëllimkeqe kundër Islamit dhe muslimanëve.

Opinion i të rinjve muslimanë është se të gjithë sunduesit e vendeve arabe dhe muslimane janë thjesht “gurë shahu” dhe kukulla në duart e forcave të fshehta, të cilat sundojnë botën. Ata i shohin grusht shtetet ushtarake dhe ndryshimet e mëdha politike në botën islame si manovra të fuqive të huaja për të sjellë në pushtet persona të paaftë për të drejtuar, por që paraqiten si heronj. Në këtë mendim mund të ketë shumë ekzagjerime, por në përgjithësi, dyshimet e të rinjve janë pjesërisht të bazuara dhe të mbështetura nga shumë ngjarje dhe incidente, të cilat të forcojnë bindjen se këta sundues janë bashkëfajtorë në një strategji djallëzore, e cila kërkon t’ia presë rrënjët rizgjimit islam dhe ta shuaj lëvizjen islame. Rinia beson se këta sundimtarë vetëm paraqiten si udhëheqës të vërtetë kombëtarë, të interesuar për gjendjen e popujve dhe fesë së tyre, por në të vërtetë ata s’janë gjë tjetër veçse agjentë të paguar që u shërbejnë armiqve të Ummetit.

9. PENGESAT E VENDOSURA NDAJ DA’VES DHE THIRRËSVE NË ISLAM

Një shkak tjetër i ekstremizmit ka të bëjë me lirinë apo më mirë, detyrën e thirrjes së njerëzve në Islam. Është një e vërtetë se Islami i mëson të tjerët jo vetëm të jenë të drejtë dhe të devotshëm, por gjithashtu i mëson edhe të mundohen të rregullojnë të tjerët. Ky është qëllimi i obligimit për t’i thirrur njerëzit drejt së vërtetës, për t’i urdhëruar në të mirën e përbashkët, për t’i ndaluar nga

ajo që është e keqe dhe e papëlqyer dhe për ta këshilluar njëri-tjetrin për të vërtetën dhe durimin. Sipas pikëpamjes islame, çdo muslimani i kërkohet të thërrasë në Islam me të gjitha forcat dhe mundësitë e tij. Ajeti i mëposhtëm i drejtohet çdo muslimani:

“Ti thirr për në rrugën e Zotit tënd...”

(16:125)

Çdo pasues i të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është daijeh (thirrës islam) siç tregohet në këtë ajet:

“Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që thërras te All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje...”

(12:108).

Ndaj motoja e reformatoreve muxheddidë (përtëritës) është: *“Bëhu vetë i drejtë (përmirëso veten) dhe thirri edhe të tjerët drejt saj”*. Kur’ani thotë:

“E kush është folës më i mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: Unë jam prej muslimanëve.”

(41:33)

Islami nuk kërkon prej muslimanit që të punojë i vetëm. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Dora (e mbështetjes) e All-llahut është me xhematin” dhe “Besimtari për besimtarin është si një ndërtesë, tullat e së cilës forcojnë njëra-tjetrën”.⁸⁸ Bashkëpunimi në mirësi dhe në ur-

⁸⁸ Transmeton Buhariu

dhërimin për të mirën, nuk është vetëm detyrim fetar, por edhe një nevojë jetësore. S'është për t'u habitur që puna kolektive në fushën e da'ves është detyrë obligative dhe domosdoshmëri jetësore, sepse ajo pa të cilën nuk plotësohet vaxhibi (obligimi), është vaxhib. Fakti që forcat ideologjike jomuslimane punojnë kolektivisht në formë të blloqeve, partive dhe shoqatave, e bën të detyrueshme për muslimanët që t'u kundërvihen këtyre forcave me po të njëjtën metodë. Përndryshe do të vazhdojmë të mbetemi prapa, krejtësisht të paafte për të bërë diçka, ndërsa të tjerët përparojnë. Për këtë arsye, mëkati më i rëndë që kryhet nga disa qeveri në vendet muslimane është censurimi i lirisë për t'i thirrur njerëzit në Islamin si fe, sistem besimesh dhe mënyrë e të jetuari dhe kërcënimi i thirrësve islamë dhe atyre që thërrasin për zbatimin e Sheriatit, çlirimin e tokave islame, ngritjen e shtetit islam, bashkimin e Ummetit dhe përkrahjen e të gjitha çështjeve të tij. Ky presion mbi da'ven dhe thirrësit islamë si dhe kufizimi i të gjitha formave të punës islame, veçanërisht të asaj kolektive, është prej shkaqeve kryesore që e shkaktojnë ekstremizmin. Dhe kjo ndodh kur ithtarët e filozofive dhe ideologjive sekulare lejohen të organizohen në grupe dhe të përhapin idetë e tyre me mbështetje dhe liri të plotë, pa ndonjë ndërhyrje ose kufizim. Është jologjike t'u japësh liri të plotë në një vend musliman përkrahësve të laicizmit, marksizmit, liberalizmit etj., që të ngrenë parti, organizata, të botojnë gazeta e vetëm Islami dhe thirrësit e tij të censurohen, edhe pse përfaqësojnë shumicën e popullit dhe shprehin besimin dhe tiparet e tij.

Thirrja në Islam, si një fe pozitive e plotë - besim dhe sistem jete - has në censurim dhe shtypje në shumë vende muslimane. E vetmja formë e lejuar e Islamit është ajo e dervishëve dhe e tregtarëve profesionistë të fesë, "*Islami*" i kohëve të prapambetjes dhe dekadencës..., "*Islami*" i cili festohet me raste, përkrah sundimtarët despotikë dhe lutet për ta që të kenë "*jetë të gjatë*". Ky është

një “Islam” i bazuar në “*paracaktimin hyjnor*” dhe “*moszgjedhjen*” në besim, përvetëson bid’atet (risitë) e dënueshme në ibadet, lejon etikën pasive dhe ngurtësinë intelektuale dhe inkurajon marrjen me çështjet e vogla në vend të atyre me rëndësi jetësore. Ata, të cilët e ndjekin dhe e përkrahin këtë “Islam” patronizohen nga sundimtarët e korruptuar dhe despotikë. Bile edhe sundimtarët afetarë, laikë e bekojnë këtë formë religjioziteti, tregojnë respekt dhe përkrahin mbrojtësit e saj me qëllim quo-në dhe ta tërheqim rininë në rrjetën e iluzioneve, simboleve, termave dhe vogëlsirave. Kështu, ata sabotojnë zellin e tyre për xhihad, vendosmërinë e tyre për të luftuar kundër padrejtësisë, degjenerimit dhe korrupsionit. Ndoshta kjo është arsyeja që e bëri Marks-in të deklarojë se “*jeja është opium për popullin*”.

Por Islami origjinal autentik, i cili përmbahet në Kur’an dhe Sunnet, i kuptuar dhe i praktikuar nga sahabët e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) si dhe tabiinët⁸⁹, si mishërim i së vërtetës dhe fuqisë, nderit dhe dinjitetit, sakrificës dhe xhihadit, ashtu siç e kemi përmendur më parë, kundërshtohet nga ata që janë në pushtet, sepse ai ndez shpirtin e revoltës kundër padrejtësisë dhe errësirës, dhe i mëson pasuesit e tij të ndjekin shembullin e:

“Atyre, të cilët i kumtojnë shpalljet e All-llahut, i frikësohen vetëm All-llahut e askujt tjetër veç Tij...”

(33:39)

Në këtë bindje dhe qartësi vizioni, ata besojnë se përderisa ushqimi dhe zgjatja e jetës së njeriut përcaktohen vetëm nga All-llahu, s’ka arsye pse të frikësohemi apo të kërkojmë përkrahje nga

⁸⁹ Tabiinë: gjenerata pas sahabëve (G.Ç.)

dikush tjetër përveç Tij. Në Turqinë bashkëkohore, një vend musliman i cili ka qenë selia e hilafetit shekuj me radhë, udhëheqësi i një partie popullore, i cili në atë kohë ishte zëvendëskryeministër, përfundoi nga ministria e tij në burg. Ai dhe pasuesit e tij u nxorën në gjyq të akuzuar se kishin bërë thirrje për zbatimin e Sheriatit në një vend ku 99% e popullsisë është muslimanell!? Pala paditëse solli pesëmbëdhjetë akuza kundër tyre, të cilat të gjitha përqëndroheshin në orvatjen e tyre për ta shndërruar Turqinë nga një shtet laik, jofetar që e kundërshton Islamin (fenë e popullit turk), në një shtet që e respekton fenë e tij dhe u bindet urdhrave të saj, në përputhje me kërkesat e imanit. Autoritetet ushtarake, të cilat e sundojnë Turqinë me forcë, i betohen për bindje Atatürkut (Mustafa Qemalit), themeluesit të Turqisë laike, në vend që t'i betohen All-llahut (xh.sh.) dhe të Dërguarit të Tij (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Si pasojë, çdo thirrje për zbatimin e Sheriatit ose për rikthim në mënyrën islame të jetës ata e konsiderojnë krim, edhe nëse thirrësi përdor mjete të ligjshme, të njohura dhe të sanksionuara nga të gjitha *“sistemet demokratike”*, me të cilat autoritetet kanë qejf të mburren. Ata muslimanë të devotshëm nuk u përdoqën për përdorim të forcës dhe dhunës për të përmbysur qeverinë, por vetëm sepse ata besonin në Islam, besimin e baballarëve dhe gjyshërve të tyre, dhe u munduan që të thërrasin në të me urtësi dhe miqësi përmes platformave ligjore dhe kanaleve kushtetuese. Prokurori ushtarak i akuzoi ata se i plasonin këto parulla: *“Islami është rruga e vetme”*, *“Muhammedi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është udhëheqësi i vetëm”*, *“Sheriati dhe Islami janë një dhe e pandarë”* dhe *“Kur’ani është kushtetuta jonë”*.

A është e mundur për një musliman, i cili e pranon All-llahun (xh.sh.) si Zotin e tij, Islamin si fenë e tij dhe Muhammedin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) si të Dërguarin e tij, që t'i mohojë këto? Çfarë do të bëjnë muslimanët që aspirojnë të jetojnë në përputhje me mësimet e Islamit,

kur u rekomandohet kufri dhe kundërshtohet imani, kur ligjësohet harami dhe çligjësohet hallalli? A nuk janë këto situata të panatyrshme shkaku kryesor i teprimit dhe ekstremizmit?

Në një prej vendeve afrikano-arabe, i cili konsiderohet si pjesë e “*Botës së Lirë*”, komunistët lejojnë të ngrenë parti politike zyrtare, e cila kryen veprimtari të hapur dhe mbrohet nga kushtetuta dhe ligjet e atij vendi. Por lëvizja islame e cila përfaqëson ndërgjegjen e vërtetë të kombit, besimet, vuajtjet dhe aspiratat e tij, ndalohej që të ketë një ekzistencë ose platformë ligjore dhe zyrtare. Për më keq, udhëheqësit islamë dhe thirrësit islamë aktivë në atë vend, janë në burg dhe u nënshtrohen torturave më të egra çnjerëzore. Akuza e vetme kundër tyre është se ata deklarojnë se vetëm All-llahu (xh.sh.) është Zoti i tyre, se e Vërteta është qëllimi i tyre final, se Islami është e vetmja rrugë dhe burim gjykimi, se fjala është arma e tyre dhe se dituria është municioni i tyre i vetëm.

Ndaj është logjike të qortojmë rininë, e cila e dëshpëruar se nuk lejohet të thërrasë në Islam me urtësi dhe sjellje të mirë, u është drejtuar mjeteve të tjera nëpërmjet të cilave ata do të ndeshen me forcën dhe dhunën. Kjo gjendje nuk duhet të lejohet të vazhdojë. Insha All-llah, Islami do të gjejë pasues dhe përkrahës dhe një grup besimtarësh do të vazhdojë të kapet pas së Vërtetës, pa u dëmtuar dhe penguar nga ata që i kundërshtojnë apo i shkurajojnë. Është në interesin tonë të kuptojmë përgjegjësinë tonë për ta lënë këtë grup besimtarësh të lindet në mënyrë natyrore dhe t’u japim atyre shansin për t’u pjekur dhe zhvilluar në një atmosferë të shëndoshë lirie, pa shtypje dhe presion, përndryshe ngjarjet do të marrin një rrugë të ndryshme, të papranueshme për ne. Da’veja (thirrja) në Islam dhe në rrugën e All-llahut (xh.sh.) do të shpërthejë dhe, nëse nuk i jepet shansi për t’u zhvilluar haptas, pa kufizime dhe pengesa, atëherë do të zhvillohet një veprimtari e fshehtë, e cila zakonisht shkakton konfuzion dhe të shpie në ekstremizëm.

Gabimi më i rëndë i autoriteteve është përdorimi i dhunës, torturave fizike dhe psikologjike në burgje dhe kampe të përqëndrimit, ku njerëzit trajtohen si kafshë. Në Egjipt (si më 1954 ashtu dhe më 1965) muslimanët e devotshëm iu nënshtuan torturave dhe ndëshkimeve të llahtarshme, frikësuese dhe të pabesueshme në Burgun ushtarak të Kajros; u rrahën, u torturuan me flakë, iu dogj trupi me cigare; burrat e disa herë edhe gratë u varën kokëposhtë si kafshë të therura, ndërsa torturuesit e tyre silleshin përreth duke i djegur ata derisa në trupat e tyre mpiksej gjaku dhe qelbi. Shumica u martirizuan me këtë metodë çnjerëzore, ndërsa torturuesit e tyre nuk tregonin shenjë frike ndaj All-llahut (xh.sh.), apo mëshirë o humanizëm ndaj krijesave të Tijj! Ata jo vetëm që i përdorën të gjithë format e torturës të shpikura nga nazizmi, fashizmi dhe komunizmi, por shpikën dhe zhvilluan metoda të reja. Ekstremizmi dhe tendenca për tekfir lindën në këtë burg famëkeq. Të burgosurit filluan të bënin këto pyetje të thjeshta: Përse po u nënshtrohemi gjithë këtyre torturave? Ç'krim kemi bërë? A mos kemi thënë gjë tjetër përveç se All-llahu (xh.sh.) është Zoti ynë, se Islami është rruga jonë dhe Kur'ani kushtetuta jonë? Duke thënë kështu, ne nuk kemi kërkuar veçse kënaqësinë e All-llahut. Ne s'kemi kërkuar shpërblim apo falënderim prej ndokujt! A mos përkushtimi ndaj kauzës së Islamit në një vend musliman konsiderohet krim, gjë për të cilën po torturohemi kështu? Këto pyetje sollën të tjera: Ç'janë këto bisha që na torturojnë, degradojnë humanizmin tonë, shajnë fenë tonë, çnderojnë besimet tona të shenjta, tallen me devocionin tonë fetar dhe ibadetin, bile edhe guxojnë të flasin pa respekt për Zotin tonë? Njëherë, njëri prej zyrtarëve të tyre të lartë tha: “Ma sillni Zotin tuaj dhe unë do ta fus në burg”. A mund të quhen këta muslimanë? Ç'është kufri nëse këta janë muslimanë? S'ka dyshim se këta janë kuffarë (jobesimtarë) që duhet të ndiqen nga bashkësia e Islamit.

Gjithashtu kjo sjell edhe këto pyetje: Nëse ky është gjykimi ynë për ata që na torturojnë për vdekje, atëherë cili do të ishte gjykimi ynë për padronët e tyre? Ç'gjykim duhet dhënë për udhëheqësit dhe qeveritarët, të cilët jo vetëm që kundërshtojnë të qeverisin sipas urdhrave të All-llahut, por bile i luftojnë ata që thërrasin për zbatimin e Sheriatit? Në krahasim me të parët, këta të dytët janë më të këqij në kufrin e tyre dhe më të prerë në riden (femohimin) e tyre ashtu siç përshkruhet në Kur'an:

“E kush nuk gjykon me atë që zbriti All-llahu, ata janë mohues.”

(5:44).

Duke arritur në këtë rezultat, këta muslimanë të shtypur shtruan një pyetje tjetër, drejtuar shokëve të tyre të burgosur: Çfarë mendoni për ata sundues që nuk gjykojnë sipas asaj që zbriti All-llahu dhe që torturojnë ata që thërrasin për zbatimin e Sheriatit të Tij? Ata të cilët ishin të një mendjeje me ta se sunduesit e tillë ishin kuffarë (jobesimtarë) i konsideruan si miq, ndërsa ata që nuk mendonin ashtu i konsideruan si kuffarë, duke pretenduar se ai i cili dyshon në kufrin e kafirit (jobesimtarit) është vetë kafir. Por kjo nuk ishte e tëra. Një pyetje tjetër u shtrua për masat që u nënshtrohen dhe binden sundimtarëve të tillë. Përgjigjja ishte e gatshme: Edhe ata janë kuffarë, sepse janë pajtuar me kufrin e sundimtarëve të tyre dhe e kanë aprovuar, e i kanë brohoritur atij. Të pajtuarit me kufrin është kufr pa dyshim.

Në këtë mënyrë lindi dhe u rrit prirja për të etiketuar persona dhe grupe si kuffarë. Ligji i jetës së dëshmuar dhe provuar është se: dhuna nuk lind tjetër vetëmse dhunën, por edhe moleps mendimin e qartë; pashmangshmërisht shtypja e fortë shkakton revoltë.

KAPITULLI I TRETË

DREJT NJË ILAÇI PËR EKSTREMIZMIN

Pasi hodhëm dritë mbi të ashtuquajturin “*ekstremizëm fetar*”, vumë në dukje aspektet e natyrës dhe karakteristikat e vërteta të tij dhe zbuluam shkaqet, motivet dhe nxitësit e tij më të rëndësishëm, nevojitet të përvijojmë një shërim për të, mjetet dhe metodat e këtij shërimi dhe kush duhet bërë këtë? Duhet të theksojmë që në fillim se ilaçi është i pandashëm nga shkaqet dhe si i tillë, duhet të jetë i shumëllojshëm dhe kompleks, siç janë edhe vetë shkaqet. S’ka nevojë të themi se asnjë prekje magjike s’mund t’i japë fund ekstremizmit dhe t’i sjellë ekstremistët në vijën e moderacionit. Sëmundja, e cila prek shpirtin dhe mendjen e njerëzimit është shumë më e rrënjësuar se ç’mund ta mendojmë dhe si rrjedhim shumë më e vështirë për t’u kuruar. Ekstremizmi është fenomen fetar me një shumëllojshmëri përmasash psikologjike, shoqërore dhe politike. Si i tillë, të gjitha këto aspekte duhet trajtuar në një këndvështrim islam:

Nuk jam në një mendje me deterministët, të cilët e konsiderojnë vetëm shoqërinë ose kushtet ekonomike si përgjegjëse për shkaqet e fenomenit, ndërsa injorojnë veprimet dhe sjelljen e rinisë, të cilën ata e konsiderojnë si një gjë të cilën nga të fryjë era atë e bart. Gjithashtu, është e padrejtë ta quajmë rininë si përgjegjëse e vetme dhe të shfajësojmë shoqërinë, regjimin dhe departamentet e tij qeveritare, veçanërisht ato të ngarkuara me edukimin, udhëheqjen dhe mas-median. Në fakt përgjegjësia është e dyanshme dhe secila palë ka luajtur një rol të rëndësishëm.

I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Të gjithë ju jeni kujdestarë dhe të gjithë ju jeni përgjegjës për tufën tuaj dhe gjërat nën kujdesin tuaj”.⁹⁰ Ndaj, do të diskutojmë në vijim detyrimet që duhet të plotësojë shoqëria me qëllim që të kapërcehet ekstremizmi si dhe detyrimet e rinisë për t’i rezistuar kësaj prirjeje destruktive.

1. DETYRIMET E SHOQËRISË

Kam treguar më parë se kontradiktat e brendshme dhe kaosi që i karakterizon shoqëritë muslimane të sotme, si dhe largimi i këtyre shoqërive nga Islami, kanë kontribuar shumë në lindjen dhe përhapjen e ekstremizmit. Prandaj këto shoqëri duhet të luajnë një rol pozitiv për shërimin e tij. Hapi fillestar për një shoqëri muslimane është të njohë dhe të konfirmojë lidhjen e saj të vërtetë me Islamin. Kjo s’mund të arrihet nëpërmjet një deklarate verbale, shprehjeje apo një mori sloganesh ose përmes një neni në kushtetutë që thotë se “Islami është feja zyrtare e shtetit”, por kjo realizohet nëpërmjet një ndjekjeje të vërtetë të mësimave të Islamit.

Islami është një sistem i plotë jete. Ai e tregon karakterin e tij hyjnor në jetë dhe e udhëheq atë përmes një drejtimi etik; ai i ngre kornizat, kufijtë shtetërorë dhe kufizimet që qeverisin lëvizjen dhe qëllimet e jetës, duke e mbajtur gjithmonë atë në rrugë të drejtë dhe duke e mbrojtur atë nga kurthet dhe humbja e udhës. Për këtë qëllim, Islami përbëhet prej besimesh që pasurojnë

⁹⁰ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi

mendjen, prej ibadetit që pastron zemrën, prej moralesh që pastrojnë shpirtin, prej ligjesh që vendosin drejtësinë dhe sjelljeve që zbukurojnë jetën. Që një shoqëri të jetë islame duhet që krejtësisht t'i përkushtohet Islamit, jo si çifutët të cilët zbatuan vetëm disa pjesë të Teuratit, duke injoruar pjesën tjetër. Si pasojë, All-llahu (xh.sh.) i paralajmëron ata në Kur'an:

“A besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni. Ç'mund të jetë ndëshkimi ndaj atij që punon ashtu prej jush, veç poshtërim në jetën e kësaj bote, e në Ditën e Gjykimit ata hidhen në dënimin më të ashpër.”

(2:85)

Veç kësaj, që një shoqëri të jetë islame duhet që ajo të zbatojë me zell urdhrat e All-llahut (xh.sh.) dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) në të gjitha çështjet dhe aspektet e jetës; në atë shoqërore, ekonomike, politike apo intelektuale. Kjo është kërkesë e imanit:

“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë derisa të mos të zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt ndërmjet tyre e pastaj të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht.”

(4:65)

dhe:

“Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmejt tyre tek All-llahu dhe tek i Dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: ‘Dëgjuam dhe respektojmë (u bindëm)!’ Të tillët janë ata të shpëtuarit.”

(24:51)

Shoqëritë tona duhet të përpiqen ta eliminojnë këtë kontradiktë të qartë - ne besojmë Islamin si besim dhe Sheriat hyjnor, por e kemi braktisur Sheriatin e tij dhe kemi shpërfillur udhëzimin dhe mësimet morale të tij. Këto i kemi zëvendësuar me sisteme të importuara dhe ideologji të huaja të marra nga Lindja dhe Perëndimi, ndërkohë që deklarohe mi si muslimanë!

Qeveritarët tanë duhet ta kuptojnë se janë në një vend musliman dhe se po qeverisin popuj muslimanë, të cilët kanë të drejtë të qeverisen sipas mësimave të fesë së tyre. Kushtetutat, ligjet, sistemet arsimore etj., duhet që të pasqyrojnë dhe shprehin besimet, vlerat dhe traditat e popullit, të cilat duhet mbledhur, konsoliduar dhe përhapur përmes medias. Politikat ekonomike dhe shoqërore, në nivel lokal dhe ndërkombëtar, duhet formuluar brenda kornizës së këtyre besimeve dhe duhet t'u shërbejnë qëllimeve të tyre. Dështimi i sundimtarëve në vendet muslimane për të jetuar sipas këtyre parimeve është kryekëput i papranueshëm dhe në kundërshtim të plotë me Islamin.

Në të vërtetë, kundërshtimi nga ana e sundimtarëve i ndërgjegjes së muslimanëve, në shumicën e vendeve muslimane është bërë i padurueshëm. Disa prej tyre e kundërshtojnë haptas Islamin dhe shprehin përkushtimin e tyre ndaj ideologjive lindore ose perëndimore. Për më tepër, ata e privojnë Islamin nga çdo formë e të shprehurit. Bile edhe xhamia me aktivitetet e saj fetare është manipuluar për të shprehur mbështetje për regjimet dhe sunduesit. Ata, të cilët guxojnë të kundërshtojnë, ndëshkohen rreptë! Sundimtarë të tjerë në vendet muslimane shpallin se janë muslimanë, por koncepti i tyre për Islamin është një version i trilerëve të tyre satanikë. Ata marrin dhe zgjedhin, pranojnë atë që i shërben interesit të tyre dhe hedhin pas shpine atë që nuk u shkon për shtati!

Ajo, të cilën ata e “besojnë” dhe e shpallin si “islame” është “e vërteta” dhe ajo të cilën e kundërshtojnë, është “e pavërteta”. Ata i përçmojnë të gjitha interpretimet e paraardhësve të nderuar si dhe të pasardhësve dhe bashkëkohësve të tyre të shquar, në mënyrë të paskrupullt. Ata bien në kundërshtim me krejt Ummetin, injorojnë traditat e sahabëve të të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), të juristëve, të komentuesve të Kur’anit dhe Hadithit. Ata s’ndiejnë ndonjë nevojë të këshillohen me ndonjërin prej tyre. Një sundimtar i tillë e konsideron veten si fakih (jurist), komentues, transmetues, mutekel-lim dhe filozof.

Një sundimtar i tillë pretendon se si ai s’ka njeri në botë. Ai nuk ndien ndonjë nevojë për të mësuar ndonjë gjë bile edhe nga vetë i Dërguari Muhammed (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), duke thënë se ai mbështetet vetëm tek Kur’ani, por duke harruar se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) është komentuesi i Kur’anit. Në lidhje me këtë, All-llahu (xh.sh.) thotë:

“Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur All-llahut.”

(4:80)

Megjithatë, disa sundimtarë lejojnë zbatimin e Sheriatit vetëm në çështjet private, si dhe disa mundësi të papërfillshme për biseda mbi Islamin në radio dhe televizion; gjithashtu ata lejojnë një kolonë në një gazetë të përditshme vetëm të premteve. Tema e saj, nëse ka ndonjë të tillë, kufizohet në fenë sipas konceptit të krishterë perëndimor si lidhje midis ndërgjegjes së individit dhe Krijuesit të tij. Ajo s’ka të bëjë me shoqërinë dhe jetën, Qesari dhe Zoti marrin secili atë pjesë që u takon! I tyre është edhe koncepti i “fese” si “besim” pa Sheriat, një “e” pa një shtet islam, “ibadet” personal pa da’ve, xhihad apo urdhërim për të mirën dhe ndalim nga e keqja. Nëse dikush dënon diçka si të padrejtë, kritikon disa shmangie, përkrah një thirrje për ndjekjen e rrugës së

drejtë, i del përballë së padrejtës nga platforma e një xhamie ose në një gazetë, i kujtojnë me ashpërsi se ai i ka tejkaluar të gjitha kufijtë duke përzier fenë me politikën! Për sundues të tillë, në politikë s'ka vend për fenë, as vend për politikën në fe. Natyrisht, e gjithë kjo bie në kundërshtim me urdhrat e All-llahut (xh.sh.) dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), si dhe praktikën e sahabëve dhe tabiinëve. Ka ardhur koha që sundimtarët tanë të kuptojnë që në shoqëritë tona s'mund të ketë qëndrueshmëri as shpresë për popujt tanë pa lidhje dhe përkushtim ndaj Islamit. Umer Ibn el Hattabi ka thënë: “Ne ishim më të ulëtit e kombeve, por All-llahu na nderoi me Islamin. Nëse mundohemi të arrijmë lavdinë me mjete të tjera përveç Islamit, atëherë All-llahu do të na poshtërojë”. Për më tepër, për aq kohë sa Sheriati nuk zbatohet, shoqëritë tona do të vazhdojnë të ushqejnë ekstremistë, fetarë apo jofetarë.

Hapi i dytë drejt shërimit ka të bëjë me qëndrimin e shoqërisë ndaj rinisë. Për ta filluar, duhet që ne të vjetrit të mos u drejtohem atyre nga brendia e kullës së fildishtë, duke treguar superioritet apo mospërfillje për ta. Ky qëndrim është i prirur të krijojë një të çarë të madhe, e cila do t'i detyrojë ata të mos na besojnë dhe dëgjojnë. Ne duhet t'i kuptojmë ata dhe të depërtojmë në skutat e thella të jetës dhe realitetit të problemeve të tyre. Qëndrimi ynë ndaj tyre s'duhet të jetë që vetëm t'i akuzojmë duke i cekur të metat e tyre, duke ekzagjeruar tiparet e tyre negative si dhe duke dyshuar dhe diskredituar qëllimet dhe veprimet e tyre në përpjekje për të provuar se ata meritojnë ndëshkimin më të ashpër. Përkundrazi, duhet që të sillemi me ta me dashuri prindore dhe vëllazërore, duke i bërë ata ta ndjejnë veten si pjesë e jona, të dashurit tanë dhe shpresa e së ardhmes së Ummetit tonë. Vetëm me dashuri dhe dhembshuri, jo me akuzime dhe arrogancë, mund t'u afrohem. Ne duhet të vihem në mbrojtje të tyre në një kohë kur nga të gjitha drejtimit ngrihen akuza kundër tyre, të vërteta dhe të rreme. Nëse nuk vihem në rolin e mbrojtësit, për një

shkak ose një tjetër, së paku të ngulim këmbë për zbatimin e drejtësisë, e cila as s'ndëshkon pa prova të qarta, as s'përkrah paditësin apo të paditurin.

Një nga të metat tona është prirja jonë për të bërë gjykime të nxituara, të përgjithësuara dhe përfundimtare në lidhje me problemet shoqërore. Kjo shpesh bëhet pa ia vënë veshin mbrojtjes së të akuzuarit dhe argumenteve të kundërshtarit, një qëndrim i privuar nga çdo sens drejtësie. Shumë njerëz prej së largu nguten për t'i gjykuar këta të rinj pa i njohur më parë ata, pa u shoqëruar me ta në mënyrë që të shohin si mendojnë, ndjejnë, sillen dhe reagojnë ata. Shumica i gjykojnë ata nga sjellja e disave, pa marrë parasysh faktin që shumica s'mund të konsiderohet përgjegjëse për veprimet dhe sjelljen e pakicës. Është kjo arsyeja që juristët muslimanë kanë miratuar ligj që gjykimi i dhënë për shumicën është i zbatueshëm për të gjithë, por jo anasjelltas. Për më shumë, disa njerëz japin gjykime përfundimtare për një person duke u mbështetur vetëm në një aspekt të sjelljes së tij, për të cilin ai mund të ketë pasur motivet dhe rrethanat e tij specifike personale. Sikur akuzuesit e tij të mund t'i dëgjojnë me durim justifikimet e tij, mund të ndryshojnë mendimin.

Sido që të jetë, s'duhet të jepen gjykime përfundimtare dhe moralndryshuese për një person në bazë të një apo dy veprimeve. Një person duhet vlerësuar në bazë të të gjitha veprimeve dhe sjelljeve të tij, nën dritën e këtij ajeti kur'anor:

“E kujt i peshojnë më rëndë peshojat (veprat e mira), ata janë të shpëtuar.”

(23:102)

Nga ana tjetër, ka njerëz që e gjykojnë rininë sipas konceptit të tyre personal se ç'është Islami dhe ç'do të thotë të jesh fetar. Sipas mendimit të këtyre njerëzve, këta të rinj muslimanë janë thjesht

ekscentrikë që vuajnë nga probleme psikologjike. Kjo mund të jetë e vërtetë për një numër të vogël, por në përgjithësi të rinjtë janë të shëndoshë psikologjikisht, sinqeriteti i veprimeve të tyre është i padiskutueshëm, praktika dhe veprimet e tyre private dhe publike janë harmonike. Tek ta nuk ekziston një ndarje midis besimit dhe praktikës, midis asaj që kryejnë haptas dhe asaj që fshehin në zemrat e tyre. Unë vetë kam njohur shumë mirë shumë prej këtyre të rinjve muslimanë në shumë vende islame dhe dëshmoj se kam gjetur forcë në imanin e tyre, qëndrueshmëri në bindjet e tyre, vërtetësi në fjalët e tyre dhe sinqeritet në punën e tyre. Gjithashtu e admiroj dashurinë e tyre për të vërtetën dhe urrejtjen e tyre për të pavërtetën, zellin e tyre për përhapjen e fjalës së All-llahut, vendosmërinë e tyre për të urdhëruar për vepra të mira dhe për të ndaluar nga e keqja dhe e padëshirueshmja, zellin e tyre për xhihad në rrugën e All-llahut dhe ngritjen e fjalës së Tij, interesimin e tyre për muslimanët kudo në botë, aspiratën e tyre për ngritjen e një shoqërie islame e cila do të jetojë në përputhje me mësimet e All-llahut (xh.sh.), të udhëhiqet nga Islami dhe të disiplinohet nga Sheriati dhe vlerat e tij etike.

Takimet dhe kontaktet e mia me këta të rinj më kanë bindur për dallimet e mëdha midis konceptit tonë islam tradicional dhe atij të tyre; ata janë të përkushtuar ndaj një Islami të ri vital, i cili i kundërvihet besimit tonë të vjetëruar tradicional. Imani i tyre është i ngrohtë dhe i flaktë, ndërsa yni është i ftohtë; vendosmëria e tyre në drejtësinë është solide dhe e patundshme, ndërsa e jona është apatike; zemrat e tyre i frikësohen All-llahut (xh.sh.) dhe janë plot me dashuri për Të, gjuhët e tyre rrahin me përkujtimin e Tij në leximin e përhershëm të Kur'anit. Gjithashtu vihet re vendosmëria e tyre për të rikapur shpirtin e vërtetë islam dhe për ta rindërtuar jetën sipas tij. Unë e di se shumë prej tyre e kalojnë tërë natën në ibadet, agjërojnë ditën, kërkojnë faljen e All-llahut në agim dhe garojnë me njëri-tjetrin në kryerjen e veprave të mira. Është kjo arsyeja që shumë

njerëz, duke përfshirë edhe veten, ushqejnë shpresën që e ardhmja e Islamit, insha All-llah, do të realizohet nga përpjekjet e vendosura të këtyre të rinjve. Ja pse kam deklaruar në disa tubime në Egjipt se brezi i ri, i rritur në drejtësi dhe devocion, është thesari i vërtetë mbi të cilin Egjipti do të mund të ndërtojë shpresat e tij. Ata janë më të vlefshëm se çdo gjë tjetër.

Unë besoj se cilido që do të përpiqet të sugjerojë një ilaç për këtë problem, duhet të tregojë ekuilibër, drejtësi dhe çiltërsi. Përndryshe, ky person është i detyruar vetë të tregojë ekstremizëm në shqyrtimin e fenomenit dhe sugjerimin e ilaçit të tij. Në lidhje me këtë, veçoria e parë e ekuilibrit është të evitojë ekzagjerimin e shfaqjeve të fenomenit, duke mos bërë “shumë zhurmë për asgjë” dhe duke përhapur frikë dhe tmerr. Për fat të keq, kjo është prirja e jonë e zakonshme në trajtimin e çështjeve të tilla. Ekzagjerimi është jashtëzakonisht dëmtes, sepse ai shtrembëron faktet, prish kriterin e gjykimit, errëson vizionin dhe moleps mendimin e qartë. Si pasojë, çdo verdikt për ose kundër këtij problemi është i predispozuar të jetë i padrejtë ose, së paku, jo i plotë.

Është për të ardhur keq që një pjesë e madhe e asaj që është thënë apo shkruar pas krizës, e cila ndodhi pas përplasjes së autoriteteve me rininë muslimane në Egjipt dhe shfaqjes së të ashtuquajturit “*ekstremizëm fetar*”, nuk i ka shpëtuar ekzagjerimit dhe teprimit në përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi. Këto përpjekje janë ndikuar nga atmosfera keqdashëse e përhapur te shumica e njerëzve kundër rinisë. Ky qëndrim e nxiti sociologun egjiptian dr. Saaduddin Ibrahim, i cili e kishte vëzhguar këtë fenomen, t’i përgjigjej kësaj fushate të drejtuar kundër rinisë me një artikull të botuar në gazetën “*El Ebram*” (Piramidat). Dr. Ibrahim tregoi se të gjithë ata që kanë marrë pjesë në analizimin e këtij problemi, aktualisht nuk e njohin fillimin e tij.

Do të kishte qenë më mirë për këta njerëz të kishin heshtur ose t'i ishin përkushtuar problemit me vërtetësi dhe ndershmëri, duke e shqyrtuar fenomenin në një rrugë realiste dhe të ekuilibruar. Por, kjo kërkon cilësi, të cilat këta njerëz nuk i kanë. Një opinion i balancuar do të merrte në konsideratë faktin se ekstremizmi fetar shpesh është një kundërveprim ndaj një ekstremizmi tjetër kundërshtar si p.sh. moslejimi dhe mospërfillja e çështjeve fetare ose qëndrimet cinike ndaj fesë. Ndaj duhet të bëhet një përpjekje për t'i sjellë të dy ekstremet tek moderacioni i Islamit. Natyra e jetës nganjëherë vendos një formë ekstremizmi kundër një tjetre, me qëllim të krijimit të një ekuilibri, koncept ky që gjendet në Kur'an:

“Dhe sikur All-llahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve, do të shkatërrohej toka, po All-llahu është bamiresh i madh ndaj njerëzimit.”

(2:251)

Çuditërisht të rinjtë ekstremistë muslimanë trajtohen me padrejtësi, ndërkohë që grupe të tjera ekstremiste, veçanërisht ata që kalojnë një jetë imorale dhe krejtësisht jofetare, nuk dënohen. Njerëzit e tillë as nuk burgosen, as nuk u nënshtrohen dënimeve të ashpra. Drejtësia kërkon që të dy llojet e ekstremizmit të dënohen.

A është e drejtë t'i a hedhim të gjithë fajin dhe t'i drejtojmë sulmet tona tek rinia, e cila jeton sipas mësimave të Islamit; të cilët e falin rregullisht namazin, u largohen haramëve, ulin shikimin dhe ruajnë thjeshtësinë dhe dëlirësinë; të cilët shqyrtojnë me kujdes se ç'është e lejuar dhe ç'është e ndaluar; të cilët ndjekin me përkushtim çfarë besojnë se është normë islame e sjelljes si psh. rritja e mjekrës, veshja e rrobave mbi nyjen e këmbës, përdorimi i misvakut për pastrimin e gojës; të cilët evitojnë bisedat e kota, nuk pinë kurrë duvhan dhe me mençuri e shpenzojnë paranë në atë

që është e dobishme? A është e drejtë t'i dënojmë këta të rinj, të cilët janë rritur në devocion dhe drejtësi, sado të tepruar dhe të ngurtë që mund të jenë, ndërkohë që heshtim ndaj sjelljes së lejuar imorale të të tjerëve, tek të cilët është e vështirë të dallosh kush është mashkull e kush femër? Të ndryshuar moralisht dhe intelektualisht nga mënyra perëndimore e jetesës, këta të fundit janë krejtësisht të larguar nga kultura islame. A është e drejtë të bëjmë shumë zhurmë dhe të dënojmë të ashtuquajturin *“ekstremizëm fetar”* dhe të heshtim ndaj *“ekstremizmit jofetar”*? A është e drejtë të përçmojmë dhe përqeshim një të re, e cila e mbulon fytyrën, sepse është e bindur se veprimi i saj është në përputhje me mësimet islame dhe me të cilën gjë ajo kërkon pranimin e All-llahut (xh.sh.), e të heshtim për një tjetër, e cila bredh rrugëve apo plazheve ose paraqitet në ekranin televiziv apo në filma gati lakuriq, duke kërkuar të nxisë instinktet dhe duke deklaruar se ajo thjesht po ushtron *“lirinë personale”*, e cila është e sanksionuar me kushtetutë? A mos kushtetuta garanton *“liri personale”* për lakuriqësinë dhe banalizmin, dhe e ndalon atë për thjeshtësinë dhe dëlirësinë?

Nëse shoqëria do të ishte ngritur kundër të pamoralshmëve dhe të pafeve dhe do të ishte përpjekur t'i ndryshonte të gjitha shfaqjet e së keqes, fenomeni i *“ekstremizmit fetar”* s'do të kishte ekzistuar kurrë në vendet tona. Edhe sikur të ishte shfaqur, për një arsye ose tjetër, ndikimi i tij do të kishte qenë më i vogël se ç'është sot. Gjithashtu duhet të dimë se sot ekstremizmi në botë është universal, i cili shfaqet në mënyra dhe fusha të ndryshme si p.sh. feja, politika, mendimi dhe sjellja.

Ekzistojnë shumë grupe ekstremiste fetare jomuslimane tejet aktive, të cilat as s'janë dënuar nga bota, siç janë dënuar grupet muslimane, e as s'janë trajtuar nga vendet e tyre siç janë trajtuar grupet muslimane në vendet e tyre. Ne kemi parë ekstremizmin fetar çifut në Izraelin cionist, të

mishëruar në parti dhe organizata që i deklarojnë parimet dhe qëllimet e tyre pa u frikësuar apo turpëruar. Për më tepër, shteti cionist, i formuar nga uzurpimi i një vendi musliman, u bazua ideologjikisht mbi ekstremizmin fetar dhe u projektua mbi bazë të Shkrimeve Çifute dhe Talmudit, si dhe të besimit të tyre se ata janë populli i zgjedhur i Zotit dhe zotërinjtë hyjnorë të botës dhe se dhuna për ta është e lejuar, në mënyrë që të realizojnë synimet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, grupet fallangiste të krishtera ushtrojnë forma ekstreme të dhunës dhe zbatojnë ekstremizmin fetar; ata i therin muslimanët, i masakrojnë trupat e tyre, ua presin organet gjenitale dhe ua fusin në gojë, përdhunojnë gratë muslimane, djegin librat fetarë islamë (duke përfshirë edhe Kur'anin) dhe mundohen të çnderojnë çdo gjë që lidhet me Islamin dhe muslimanët. E gjithë kjo bëhet në emër të Krishterimit dhe Krishtit, Apostullit të paqes dhe dashurisë, i cili iu drejtua pasuesve të tij: “Duajini armiq të tuaj, bëjuni mirë atyre që ju urrejnë! Bekoni ata që ju mallkojnë!... Atij që të bie me shuplakë në njëren faqe, ktheja edhe tjetrën” (Luka 6:27-29)

Veç kësaj, ne jemi dëshmitarë të shumë formave të ekstremizmit fetar të krishterë të drejtuar kundër muslimanëve, jo vetëm në Liban, por edhe në Qipro, Eritre, Filipine (Bosnjë, Çeçeni - G.Ç.) si dhe në vende të tjera. S'ka rëndësi nëse është ekstremizëm katolik, ortodoks apo protestant; ai është ekstremizëm i krishterë, një kryqëzatë e re.

Veç kësaj, gati çdo vit grupe ekstremiste fetare hindu masakrojnë shumë muslimanë paqësorë dhe të pafajshëm. Ironia qëndron në atë se ata të cilët therin qenie njerëzore me gjakftohtësi, ndalojnë therjen e kafshëve, sepse thonë se është mizore të vrasësh një qenie të gjallë. Për të njëjtën arsye, ata nuk i vrasin minjtë por i lënë të hanë drithërat që rriten në miliona hektarë. Të gjitha këto krijesa, thonë ata, nuk duhet të dëmtohen, sepse kanë “*shpirt*ra”! Por këta njerëz nuk hezitojnë t'i therin muslimanët, sikur këta të fundit të ishin qenie pa shpirt!

Duhet të kuptojmë se jetojmë në kohën e turbullirës, ankthit dhe rebelimit, që janë pasojë e përhapjes së materializmit, që ka shtrembëruar mendimin dhe sjelljen njerëzore. Megjithëse njeriu ka arritur të ngjitet në Hënë, prapëseprapë mjerisht ka dështuar të realizojë lumturinë në Tokë. Pa dyshim shekulli njëzet ka dëshmuar një përparim të shpejtë në të gjitha fushat e shkencës, një zhvillim i cili ka sjellë vetëm prosperitet material e jo shpirtëror. Megjithatë ky prosperitet nuk ka qenë në gjendje të krijojë lumturinë dhe qetësinë shpirtërore, të cilat i kanë shpresuar shumë nga përkrahësit e tij. Përkundrazi, ai ka shkaktuar që një numër gjithnjë e në rritje njerëzish, siç janë hipitë, të ndihen të humbur dhe të hutuar, dhe të rebelohen kundër këtij “modernizimi” duke u kthyer prapa tek natyra. Për ta jeta s’ka kuptim dhe qytetërimi s’ia ka dalë dot t’u përgjigjet pyetjeve të tyre këmbëngulëse: Cili jam unë? Cili është mesazhi im? Nga po vij dhe ku po shkoj? Ky ankth dhe rebelim gjeti jehonë edhe në vendet tona, gjë që solli ose një mospërfillje ndaj fesë ose një përkushtim dhe besnikëri më të madhe ndaj Islamit. Disa të rinj muslimanë i gjetën përgjigjet e pyetjeve të tyre tek Islami dhe u kthyen drejt tij me ngrohtësi dhe shpesh me zell të tepruar.

Do të ishte e paarsyeshme të presësh paqe dhe qetësi në kohën e sotme të rebelimit ose moderim dhe ekuilibër në një botë të karakterizuar nga ekstremizmi. As s’do të ishte e logjikshme të kërkoje prej këtyre të rinjve entuziastë *“urtësinë dhe pjekurinë”* e të moshuarve. Në një sens, njeriu është produkt i ambientit të tij.

Shërbimet e fshehta duhet të heqin dorë nga metodat e tyre të ashpra, torturat dhe vrasjet. Ne duhet të përhapim dhe inkurajojmë një atmosferë lirie, të mirëpresim kritikën dhe të ringjallim zakonet e paraardhësve tanë për këshillimin e njëri-tjetrit. Për këtë gjë kemi një shembull në praktikën dhe fjalët e Umer Ibn el Hattabit: “Ai i cili don të më këshillojë e ka derën e hapur në

çdo kohë, qoftë në mëngjes apo në mbrëmje. All-llahu e bekoftë atë person, i cili m'i vë në dukje gabimet e mia". Ai gjithmonë i inkurajonte dhe përkrahte ata, të cilët e këshillonin ose kritikonin.

Një ditë ndërsa ishte me një grup shokësh, një njeri tha: "O Halif, kije frikë All-llahun...". Shokët e Umerit u zemëruan nga kjo, por ai u kërkoi atyre ta linin atë njeri të fliste lirshëm, duke thënë:

Në një rast tjetër, Umeri iu drejtua të pranishmëve: "Nëse dikush prej jush sheh ndonjë shmangie tek unë, e ka për detyrë ta drejtojë atë". Me të dëgjuar këtë, një beduin u ngrit dhe tha: "Pasha All-llahun, nëse shohim ndonjë shmangie tek ti, do ta drejtojmë atë me shpatat tona (dmth. edhe sikur të duhet të përdorim forcën)". Umeri nuk u zemërua, por shumë i kënaqur tha: "El hamdu-lil-lah që ka muslimanë të gatshëm të përdorin edhe shpatat për ta vënë Umerin në rrugë të drejtë".

Një atmosferë lirie prodhon ide të cilat mund të shqyrtohen dhe analizohen racionalisht nga dijetarët, të përshtaten dhe zbatohen ose të flaken dhe të zhduken. Përndryshe, idetë janë të detyruara të lulëzojnë, rriten fshehurazi dhe të lëshojnë rrënjë, zhvillohen, rriten derisa bëhen dominuese dhe të fuqishme, duke i zënë njerëzit në befasi, sepse ata nuk dinin gjë për lindjen dhe zhvillimin e tyre. Mendimi dhe kuptimi i shtrembër janë burimet e ekstremizmit, prandaj duhet që për kurimin e tij të përdoren mendimi i shëndoshë dhe kuptimi i drejtë. Është një gabim i madh të përdoret forca për të përballuar mendimin; ai duhet rregulluar me kujdes, durim dhe në mënyrë intelektuale. Metodatat brutale të përdorura nga policia e fshehtë, nga krerët e grushteve ushtarake të shtetit, të cilët torturojnë dhe vrasin cilindo që nuk është dakord me ta, s'mund t'i japin fund ekstremizmit. Ata mund të kenë sukses përkohësisht, por në fund orvatjet e tyre do të dështojnë. Nëse një grup ekstremist shtypet, do të krijohet një tjetër më i dhunshëm.

Ndaj detyra jonë e parë është formimi i një ndërgjegjësimi të arsyeshëm islam i mbështetur mbi një fikh të ndriçuar nga mësimet e Islamit; një fikh i një mendjemprehtësie të thellë, i cili nuk përqëndrohet vetëm në problemet anësore, por edhe tek ato thelbësore; një fikh i cili lidh pjesët me tërësinë, degët me rrënjët, hipotetiken me definitiven; një fikh i cili kërkon gjykime nga burimet origjinale, jo vetëm nga degët. Krijimi i një ndërgjegjësimi të tillë dhe zhvillimi i një fikhu të tillë midis ekstremistëve s'është gjë e lehtë. Veç kësaj, për të ndryshuar besimet dhe bindjet e njerëzve duhen përpjekje të sinqerta, durim i madh, si dhe mbështetja dhe udhëzimi i All-llahut (xh.sh.)

Ata që janë në pushtet mendojnë ose priren të besojnë, se ndryshime të tilla mund të kryhen shumë lehtë nga mas-mediat. Ata mendojnë se këto kanale mund t'i ndryshojnë bindjet intelektuale dhe shpirtërore të njerëzve në drejtimin që dëshirojnë. Ata, qëllimisht apo pa qëllim, injorojnë faktin se mas-mediat e kontrolluara nga shteti dhe spikerët, agjentët dhe agjencitë e tyre janë të paaftë të realizojnë ndryshimet dhe vetëdijen e kërkuar, sepse forma dhe përmbajtja e orvatjeve të tilla kundërshtohet krejtësisht nga rinia. Kjo gjë është eksperimentuar nga regjime të shumta në vende të ndryshme, ku pushteti ka shfrytëzuar disa “*dijetarë*” dhe spikerë (folës), për t’iu mbajtur leksione të burgosurve me qëllim të “*larjes së trurit*”. Por të gjitha ato leksione, fjalime dhe predikime u vunë në lojë dhe dështuan me turp që ta arrinin këtë gjë. Transmetimi i dëshiruar i dijes mund të realizohet vetëm nga ulematë (dijetarët) e pandikuar nga influenza e pushtetit, dijetarët të cilët gëzojnë besimin e rinisë, për shkak të origjinalitetit të diturisë së tyre dhe fuqisë së bindjeve të tyre fetare. Veç kësaj, kjo kërkon një atmosferë të natyrshme pa premtime false dhe terrorizëm intelektual, i cili dominon pas dymbyllurave të mbyllura. Për më tepër një transformim i tillë s’mund të kryhet brenda natës me anë të ngulitjes dhe urdhrave ushtarake. Përkundrazi, ai kërkon

ballafaqim të lirë, dialog konstruktiv dhe komunikim të dyanshëm, të cilat nevojiten për realizimin e këtij qëllimi të fundit.

Ajo që dua të theksoj në lidhje me këtë është rreziku i konfrontimit të një forme të ekstremizmit intelektual me një tjetër dmth. konfrontimi i kokëfortësisë me kokëfortësi, i fanatizmit me fanatizëm, përgjigjja e së keqes me të keqe. Rreziku shfaqet psh. në prirjen për t'i akuzuar për kufr ata ekstremistë të cilët i akuzojnë të tjerët se janë kuffarë (jobesimtarë). Ndoshta disa njerëz, të cilët mbajnë një qëndrim të tillë, përmendin si provë të vërtetësisë së thënies së tyre këtë hadith: “Ai, i cili akuzon për kufr një musliman, kryen vetë kufr”. E vërteta është se nëse sillemi në këtë mënyrë, biem në të njëjtën grackë. Megjithatë, hadithi i lartpërmendur nuk e përfshin atë musliman, i cili akuzon për kufr një musliman tjetër, si rezultat i keqinterpretimit dhe keqkuptimit ligjor. Kjo gjë mund të tregohet me hadithe të vërteta si dhe me ngjarje të konfirmuara nga jeta e sahabëve (radijall-llahu anhum).

Ne kemi një shembull të mirë në qëndrimin e halifit Ali Ibn Ebu Talibit (radijall-llahu anhu) ndaj havarixhëve, të cilët e luftuan atë dhe në mënyrë të padrejtë e akuzuan për gjëra të ulëta, për të cilat nuk akuzohet asnjë musliman i rëndomtë, e jo më Aliu, hero i famshëm dhe më dinjitoz musliman, kushëriri i të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe dhëndër i tij. Pavarësisht nga kjo, Aliu i dënoi akuzat e rreme dhe të pabaza të havarixhëve pa i njollosur ata si kuffarë, siç kishin thënë ata për të. Veç kësaj, ai i mirëpriti ata në bashkësinë islame, duke menduar mirë për qëllimin e tyre.

Ndaj kur njerëzit e pyetën Aliun, nëse havarixhët ishin kuffarë, ai u përgjigj: “Ata kanë ikur nga kufri...”. Njerëzit ngulën këmbë: “Atëherë çfarë janë ata?”. Aliu u përgjigj: “Vëllezërit tanë në të

kaluarën që kanë gabuar ndaj nesh sot!”. Kjo do të thotë se havarixhët duhet të gjykohen si ata që kanë kryer bag’j, jo si kuffarë apo murteddë. Në këtë rast “bag’j” janë ata të cilët nuk i binden një imami të drejtë musliman, në bazë të një keqinterpretimi ligjor.

Nëse njerëz të tillë janë të fuqishëm dhe ngrenë krye kundër imamit, ai nuk duhet të nxitohet t’i luftojë ata, por duhet të dërgojë tek ata njerëz të cilët mund t’i korrigojnë gabimet e tyre duke debatuar me ta me dashuri, urtësi dhe durim, në mënyrë që të parandalojnë derdhjen e gjakut musliman dhe të ruajnë unitetin islam. Nëse ata ngulin këmbë në qëndrimin e tyre dhe fillojnë luftën, ata duhet luftuar derisa t’i binden urdhrat të All-llahut. Por gjatë luftimit, ata të cilët ikin nga fusha e betejës nuk duhet ndjekur, as s’duhet plagosur, as s’duhet vrarë robërit e luftës; gratë e tyre nuk duhet të merren si robëresha dhe pronat e tyre nuk duhet konfiskuar. Ata duhet të trajtohen si muslimanë, të cilët luftohen vetëm sepse përbëjnë një kërcënim për Ummetin, sepse nuk është qëllimi që të shfarosen, por të kthehen përsëri në gjirin e bashkësisë islame, atëherë kur ndalen nga luftimi i muslimanëve dhe respektojnë imamin e muslimanëve. Edhe ky i fundit ndalohej nga të luftuarit e tyre, madje edhe nëse vazhdojnë t’u mbesin besnikë bindjeve të tyre. Bindjet nuk ndryshohen me forcë e as që imponohen me shpatë.

Vlen të përmendim një aspekt tjetër të qëndrimit të Aliut si argument i nivelit të paprecedent të lirisë së të shprehurit, veçanërisht për opozitën, të arritur në ditët e para të Islamit; nivel të cilin vendet e tjera e arritën pas shumë shekujsh. Havarixhët ngritën krye, sepse e kundërshtuan pranimin e Aliut për arbitrim duke pretenduar se: “Urdhri (komanda) i përket vetëm All-llahut”. Aliu iu përgjigj kësaj me thënien e tij proverbiale dhe lakonike: “Një fjalë e vërtetë e shtrembëruar për t’i shërbyer batilit”. Pavarësisht nga kundërshtimi i tyre ndaj tij, Aliu u tha atyre me sinqeritet dhe qartë: “Ne nuk kemi ndërmend t’ju ndalojmë të faleni në xhamitë, as t’ju ndalojmë nga pjesa

juaj në plaçkën e luftës, as të fillojmë t’ju luftojmë, përderisa nuk përhapni korrupsion (prishje) në tokën e Islamit”. Kështu Aliu i dha opozitës dmth. havarixhëve, të gjitha këto të drejta, megjithëse secili prej tyre ishte një ushtar i armatosur dhe i stërvitur, i aftë të rrëmbente armët në çdo moment.

Gjithashtu vlen të përmendim rreth kësaj çështjeje se megjithëse një hadith i vërtetë i përshkruan havarixhët si të pabindur, ekziston një konsensus midis dijetarëve, i cili ndalon të cilësohen si kuffarë dhe sanksionon luftimin dhe vrasjen e tyre, pavarësisht se ata i kanë quajtur të gjithë muslimanët kuffarë. Imam Shevkani thotë në *“Nejl ul Ewtar”*:

“Shumica nga juristët sunnitë janë të mendimit se havarixhët janë muslimanë në bazë të dëshmisë së tyre se nuk ka zot përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij, dhe zbatimit të rregullt nga ana e tyre e shtyllave të tjera të Islamit. Mëkati i tyre është rezultat i një interpretimi të gabuar, në bazë të të cilit ata i quajtën të gjithë muslimanët e tjerë si kuffarë (jobesimtarë). Kjo i çoi ata në jashtëligjësimin e kundërshtarëve të tyre dhe akuzimin e tyre haptas për kufr dhe politeizëm.”⁹¹

El Hattabi thotë:

“Megjithëse havarixhët kanë rrëshqitur prej rrugës së drejtë, prapëseprapë dijetarët muslimanë kanë rënë dakord njëzëri që ata janë një grup islam. Ndaj ata e kanë lejuar lidhjen martesore me ta dhe ngrënien e kafshëve të therura prej tyre. Ata s’duhen konsideruar si kuffarë për aq kohë sa vazhdojnë të ndjekin themelet e Islamit.”

⁹¹ Esh-Shewkanij, Nejl-ul Ewtar, 7:352-353

Tjadi thotë:

“Pa dyshim kjo ishte gati çështja më e komplikuar për mutekel-limunët, derisa fakihu Abdulhakk e pyeti Imam Ebul Mealin për këtë. Ky i fundit nuk pranoi të vendoste, duke thënë se të fusësh një kafir në gjirin e Islamit apo të dëbosh një musliman prej tij, është një çështje fetare shumë serioze. Tjadi shton që edhe kadiu Ebu Bekr el Bakilani nuk pranoi të vendoste, duke thënë që: “Njerëzit (havarixhët) nuk kanë kryer kufr, por kanë thënë gjëra të cilat shpien në kufr”.

El Gazaliu në librin e tij “Ettefrikatu bejnel Iman vez zendikah” thotë:

“Duhet të jemi shumë të kujdesshëm në cilësimin e njerëzve si kuffarë. Të lësh një mijë kuffarë gjallë është më pak e dëmshme sesa të derdhësh gjakun e një muslimani.”

Ibn Battali thotë:

“Shumica e dijetarëve besojnë që havarixhët nuk qëndrojnë jashtë gjirit të Islamit. Aliu u pyet nëse ishin kuffarë banorët e Nehrevanit (të cilët ishin havarixhë). Aliu u përgjigj: “Nga kufri kanë ikur”. Gjithashtu Ibn Battali është i mendimit se havarixhët duhen konsideruar “bugat”, nëse ngrenë krye dhe fillojnë luftë.”

Dijetarët kanë rënë dakord se çështja e tekfirit (cilësimi i grupeve apo individëve si kuffarë) është e rrezikshme dhe me pasoja të rënda.

2. DETYRIMET E TË RINJVE MUSLIMANË

Detyra e parë e rinisë sonë muslimane është korrëgjimi i pikëpamjeve dhe mendimeve të tyre, me qëllim që ta njohin fenë e tyre në bazë të argumentit dhe kuptimit të qartë dhe sipas një metodologjie të përshtatshme. Fillimi i drejtë është nxënia e metodologjisë së duhur të kuptimit të Islamit dhe e marrëdhënieve me veten e tyre, njerëzit dhe jetën.

Historikisht, dijetarët islamë kanë vendosur disa parime dhe metoda, të cilat e kanë zgjeruar kuptimin e duhur dhe deduktimin e çështjeve dhe problemeve, të mbështetura në tekste apo jo. Kjo çoi në krijimin e shkencës së Usul-ul Fikhut, disiplinë e cila studion metodologjinë e nxjerrjes së ligjeve nga burimet e Islamit dhe përcaktimin e vlefshmërisë së tyre juridike apo kushtetuese. Kështu ata vendosën parimet e kontrollit të argumentit dhe argumentit të kontrolluar; subjektin dhe objektin e kontrollimit të aspekteve të argumentit; kryesoren dhe ndihmësen; të domosdoshmen dhe mohuesen; të përgjithshmen dhe të veçantën; të pakufizuarën dhe të kufizuarën; të shpallurën dhe të nënkuptuarën. Gjithashtu ata përcaktuan qëllimet e plota të Sheriatit si psh. ruajtjen e mirëqenies së njerëzve, asgjësimin e së keqes dhe të dëmshmes; ata i ndanë nevojat në: të domosdoshme, të nevojshme dhe komoditete. Kjo është një shkencë e veçantë e cila s'ka të ngjashme dhe për të cilën muslimanët kanë të drejtë të jenë krenarë. Veç kësaj, ekzistojnë parime dhe rregulla të fikhut, të cilat mund të mosgjenden në librat e Usulit, por që gjenden në libra të ndryshëm mbi Usul-ut Tefsir (Bazat e Tefsirit) dhe shkencat e Kur'anit si dhe në Usul-ul Hadith (Bazat e Hadithit) dhe shkencat e hadithit. Gjithashtu ekzistojnë rregulla dhe parime të shumta të shpërndara nëpër librat e besimit, interpretimit të hadithit dhe

jurisprudencës, të cilat mund të vëzhgohen nga ata, të cilët kanë fituar aftësinë për të depërtuar në brendësinë e qëllimit të Sheriatit dhe të skutave të tij të thella.

Prandaj, ajo që kërkohet, nuk është një kuptim i cekët i teksteve, por një dituri e thellë dhe një kuptim i drejtë i qëllimeve të ajeteve kur'anore dhe haditheve. Fikhu, apo vetëdija të cilën e trumpetojnë për gjeneratat muslimane në ngritje, duhet të ketë parasysh disa gjëra. Së pari: Njohja dhe depërtimi në brendinë e Sheriatit s'mund të jetë i plotë pa marrjen parasysh të të gjitha aspekteve të veçanta në lidhje me kontekstin e përgjithshëm të së vërtetës së Islamit. Për të dhënë një gjykim, duhet që ajeti kur'anor apo hadithi të interpretohet në dritën e haditheve të tjera, Sunnetit të të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) si dhe praktikës së sahabëve, dhe duhet të kuptohet nën dritën e Kur'anit, kontekstit të përgjithshëm dhe qëllimeve të Sheriatit. Përndryshe, në këtë kuptim do të ketë të meta dhe konfuzion në deduktim dhe nxjerrje, të cilat mund të krijojnë kontradikta në Sheriat dhe ta bëjnë atë burim talljesh dhe shpifjesh.

Për këtë arsye, Imam Shatibiu vendosi dy kushte për ixhtihad:

1. kuptimin e qëllimeve të Sheriatit në tërësi dhe
2. Aftësinë për të nxjerrë përfundime në bazë të këtij kuptimi.⁹²

Kjo mund të përmbushet vetëm kur ekziston një dituri e thellë dhe e gjerë e teksteve, veçanërisht e haditheve dhe traditave; një depërtim në shkaqet, ngjarjet, rrethanat dhe qëllimet e çdo teksti si dhe një aftësi për të bërë dallim midis të përjetshmes dhe të pandryshueshmes dhe asaj që është

⁹² Esh-Shatibi, El-Muwafekat, 4:105-106

formuluar për t'i bërë ballë një nevoje të përkohshme, një zakoni apo tradite ekzistuese ose disa rrethanave kalimtare, të cilat mund të ndryshojnë me ndryshimin e kësaj të fundit.

Një ditë isha duke mbajtur ligjëratë mbi veshjen e duhur islame për gratë, sipas Kur'anit dhe Sunnetit, kur një person nga auditori tha se hixhabi i përmendur në Kur'an duhet të përfshijë një mbulesë të jashtme shtesë. Unë iu përgjigja se hixhabi nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet për mbulimin me hijeshi të atyre pjesëve të trupit, të cilat Sheriati i ndalon të ekspozohen. Ndaj, ai mund të ndryshojë nga një vend dhe kohë në një tjetër. Por, personi i inatosur bërtiti se veshja e duhur është specifikuar shumë qartë në tekstin kur'anor, andaj s'kemi të drejtë ta ndryshojmë atë. Ai përmendi këtë ajet:

“O ti Pejgamber, thuaju grave tuaja, bijave tuaja dhe grave të besimtarëve le të vënë shamitë (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen e të mos ofendohen.”
(33:59)

Unë u përgjigja se Kur'ani disa herë specifikon disa mjete dhe metoda, të cilat ishin të përshtatshme dhe të zakonshme në kohën e zbritjes (vahjit), por të cilat s'kanë për qëllim të jenë të përhershme, nëse gjenden të ngjashme ose më të mira se ato. Shembulli i mëposhtëm është i mjaftueshëm për të provuar pikëpamjen time. All-llahu (xh.sh.) thotë:

“E ju përgatituni sa të keni mundësi force, e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre e me të ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët...”
(8:60)

Këtu është përmendur në mënyrë specifike kali, sepse në kohën e shpalljes, ai ishte një nga mjetet më të fuqishme të njohura. Por s'ka arsye pse muslimanët në kohën tonë të mos përdorin tanket

dhe mjetet e blinduara për të arritur qëllimin e treguar në ajetin e lartpërmendur dmth. t'ua kallin frikën në zemër armiqve të All-llahut (xh.sh.) dhe armiqve të muslimanëve. Në mënyrë të ngjashme, veshja e jashtme e gruas mund të jetë çdo veshje, e cila përmbush objektivin (qëllimin) e shprehur në ajetin e mësipërm dhe në vazhdim të tij:

“...që gratë muslimane të njihen dhe të mos ofendohen.”

(33:59)

Kur është kështu për sa i përket Kur'anit, i cili ka një natyrë të përjetshme dhe të gjithanshme, është logjike që Sunneti është më i hapur ndaj një shqyrtimi të tillë. Sunneti përmbledh një mori mësimesh, legjislativ dhe jolegislativ, të përgjithshme dhe specifike, të përjetshme dhe të ndryshueshme: një ndryshim i cili bëhet i nevojshëm nga një ndryshim në arsye dhe nevoja. Psh. në çështjet në lidhje me ngrënien, pirjen dhe veshjen, ka sunnete të obligueshme dhe të paobligueshme. Ngrënia me gishta në vend të ngrënies me lugë nuk është e detyrueshme. Mënyra e parë ishte më natyrale dhe e përshtatshme për jetën e thjeshtë dhe natyrën e arabëve në kohën e të Dërguarit (sal-llah-llahu alejhi ve sel-lem). Megjithatë kjo nuk do të thotë që përdorimi i lugës është haram (i ndaluar) apo mekruh (i papëlqyer), sepse ajo është sot e përhapur kudo dhe në asnjë mënyrë nuk tregon ekstravagancë apo teprim. Por kjo s'mund të thuhet për orënditë prej argjendi ose ari, përdorimi i të cilave është i ndaluar. Në mënyrë të ngjashme, duhet t'i bindemi urdhrit për të ngrënë dhe pirë me dorën e djathtë, përderisa qëllimi i këtij mësimi është fundamental dhe i pandryshueshëm, si dhe sepse ai kërkon të vendosë një zakon uniform midis muslimanëve, duke i orientuar ata të përdorin dorën e djathtë në çdo gjë. I Dërguari (sal-llall-llahu alejhi ve sel-lem) na ka urdhëruar: “Thuaj bismil-lah (para se të fillosh) dhe ha me dorën e djathtë.”

të”.⁹³ Në një hadith tjetër, ai thotë: “Askush prej jush të mos hajë ose pijë me dorën e majtë, sepse Shej-tani ha dhe pi me dorën e majtë”.⁹⁴ Për më tepër, në kohën e të Dërguarit, muslimanët s’kishin asnjë ide për sitat, të cilat u njohën dhe u përdorën më vonë. A mund të shikohet kjo si risi e ndaluar apo praktikë e urryer? Natyrisht jo.

Shembull tjetër është çështja e veshjes së një xhelabije (veshje) të shkurtër, të cilën të rinjtë e devotshëm muslimanë e ndjekin dhe ngulin këmbë në veshjen e saj, pavarësisht nga problemet që u dalin prej saj, sikur kjo gjë të ishte një nga fundamentet e Islamit. Këta të rinj nxjerrin dy argumente: 1. veshja duhet që të jetë xhelabije e shkurtër, sepse ky është lloji i veshjes që ka përdorur i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe sahabët e tij. Bile ata besojnë se veshjet e tjera na shpien të imitojmë jobesimtarët, një praktikë e ndaluar në Islam, dhe 2. duhet të jetë e shkurtër, sepse ka hadithe, të cilat ndalojnë veshjen e izarit ose xhelabijes mbi nyjen e këmbës si psh. “Pjesa e izarit që varet poshtë nyjeve të këmbës është në zjarr”.⁹⁵ Për sa i përket argumentit të parë, dimë nga Sunneti i të Dërguarit se ai vishte çdo gjë që kishte në dispozicion. Për këtë arsye, ai vishte këmisha, mantele dhe izarë. Gjithashtu i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka veshur veshje të prodhuara në Jemen dhe Persi, të cilat ishin qëndisur rreth e qark me mëndafsh. Ai ka vënë edhe imameh (kësulë) me dhe pa çallmë. Imam Ibnul Kajjimi thotë në *“El Hedj un nebevij”*:

⁹³ Me pajtim

⁹⁴ Transmeton Muslimi

⁹⁵ Transmeton Buhariu

“Udhëzimi më i mirë është Sunneti i të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), gjërat të cilat i zbatonte rregullisht, i urdhëronte dhe i inkurajonte njerëzit t’i punonin. Për sa i përket Sunnetit të tij në veshje, ai e kishte zakon të vishte çdo gjë që kishte në dispozicion, të prodhuar prej pambukut, leshit apo lirit. Dihet që ka veshur mantela nga Jemeni, mantela të gjelbër, xhybe, veshje me mëngë të gjata, këmisha, pantallona (shallvare) dhe xhelabije, këpucë dhe pantofla... Disa herë mbante një gërshet të hedhur prapa”.⁹⁶

Industria e tekstilit ishte e panjohur atëherë, ndaj njerëzit vishnin rroba të importuara nga Jemeni, Egjipti dhe Siria. Në kohën tonë, ne veshim pa asnjë lloj ndalimi veshje të brendshme, mbulesa koke, çorapë, këpucë etj., të cilat nuk janë njohur në kohën e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Atëherë, përse bëhet kjo zhurmë e madhe për xhelabijen në veçanti?

Për sa i përket argumentit të imitimit të kuffarëve (jobesimtarëve), na është e ndaluar të imitojmë veçoritë e tyre dalluese si pasues të feve të tjera, si psh. të mbajmë kryq, të veshim kostume kishtarë, të festojmë festat joislame, të cilat tregojnë ndjekjen e një feje tjetër. Ibn Tejmijje e shpjegon këtë gjë me hollësi në librin e tij “Tktida us Sirat il Mustekim fi Muhalefati Ehl il Xhehim”. Me përjashtim të gjërave të dukshme, gjykimi bëhet në bazë të qëllimit. Nëse një musliman imiton kuffarët me paramendim, atëherë ai duhet të fajësohet në bazë të qëllimit. Por, nëse dikush pa paramendim bën disa gjëra nga ato që bëjnë kuffarët, ai s’duhet fajësuar. Megjithatë është më e hijshme për një musliman të dallohet nga jomuslimanët, në të gjitha çështjet materiale dhe shpirtërore, sa më shumë që të jetë e mundur. Thelbi i kësaj çështjeje është që veshja e një xhelabije të shkurtër është më e pëlqyeshme, por veshja e një të gjatë s’është e

⁹⁶ Ibnul Kajjim, Zadul Miad, 1:143

ndaluar, nëse ky është vetëm një zakon i personit dhe me këtë nuk ka për qëllim të tregojë arrogancë, gjë të cilën e kemi shpjeguar më parë.

Të gjithë shembujt e mësipërm kanë të bëjnë vetëm me sjelljen vetjake. Ndaj, duke qenë të tilla ato janë më pak të rënda sesa problemet të cilat lidhen me bashkësinë në tërësi, punët e shtetit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, të cilat janë më komplekse dhe përbëjnë një rrezik për bashkësinë, shtetin dhe njerëzimin në mungesë të një jurisprudence largpamëse, e cila merr parasysh përmasat e duhura të nevojave njerëzore dhe interesave shoqërore.

Kur bëjmë thirrje për përtëritjen e mënyrës së vërtetë islame të jetesës dhe vendosjen e një shoqërie me të vërtetë islame, të udhëhequr nga një shtet islam, duhet të njohim faktin se jetojmë në një botë, në të cilën marrëdhëniet njerëzore janë të ndërsjella dhe komplekse, ideologjitë janë të shumta, distancat po shkurtohen dhe pengesat kanë filluar të bien. Është një botë e cila është bërë më e vogël se kurdoherë si rrjedhojë e përparimit teknologjik të paprecedent. Gjithashtu duhet të kemi parasysh faktin se në bashkësi përfshihen të fuqishmit dhe të dobëtit, burrat dhe gratë, të rriturit dhe fëmijët, të ndershmit dhe të pandershmit. Këtë shumëllojshmëri duhet patur parasysh kur kërkojmë të udhëheqim, nxjerrim ligje apo japim fetva.

Një musliman, i cili kërkon kënaqësinë e All-llahut, mund t'i vendosë kufizime vetvetes dhe të ndjekë mendimet më ekstreme dhe më të kujdesshme në përpjekjen e tij. Ai mund ta privojë vetveten nga të gjitha llojet e argëtimit si të kënduarit, muzika, fotografia, televizioni etj. Por, një shtet modern, a mund të bëjë pa këto? A mundet një ministri e brendshme, një zyrë pasaportash, një departament emigracioni apo trafiku, një institucion arsimor të bëjë pa fotografinë, e cila është bërë mjeti më i rëndësishëm i zbulimit dhe parandalimit të krimeve dhe falsifikimit? A mundet

një shtet bashkëkohor të mospërfillë kohët në të cilat rron dhe t'i privojë shtetasit e tij nga shërbimet e paçmueshme të televizionit dhe të mbështetet vetëm tek radioja, duke u arsyetuar se televizioni varet nga fotografia, e cila është *“haram”* siç debatojnë gjer më sot disa studentë të *“edukimit fetar”*?

Shkurt, ajo që dua të theksoj këtu është që kufizimet që vendos një person ndaj vetes së tij mund të tolerohen dhe pranohen, por do të ishte e patolerueshme dhe e papranueshme t'ua impononim këto kufizime grupeve të ndryshme në bashkësinë si një tërësi. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Cilido që u prin njerëzve në namaz duhet ta shkurtojë atë, sepse midis tyre ka të dobët, pleq dhe nga ata të cilët i pret puna”.⁹⁷ Ky udhëzim në lidhje me udhëheqjen e njerëzve në namaz është i zbatueshëm edhe për udhëheqjen e tyre në çdo aspekt të jetës.

Një nga problemet më serioze është mosmarrja parasysh, nga ana e disa njerëzve fetarë, e faktit që dispozitat (ahkamet) e Sheriatit nuk janë barabar të rëndësishme apo të pandryshueshme dhe si rrjedhim, mund të lejohen interpretime të ndryshme. Ekzistojnë gjykime hipotetike, të cilat kryesisht merren me transaksionet, zakonet dhe mënyrat. Ato janë të hapura ndaj ixhtihadit. Mospajtimi i bazuar në ixhtihad të vërtetë në lidhje me këto çështje, nuk përbën ndonjë kërcënim apo dëm. Përkundrazi, ai është një bekim mbi Ummetin dhe tregon përkulshmëri në Sheriat dhe hapësirë të pafund në fikh. Kanë ekzistuar ndryshime të mendimeve dhe mospajtim midis sahabëve, si dhe midis pasardhësve të tyre, në shumë çështje. Por, një mospajtim i tillë nuk ka shkaktuar kurrë mëri apo përçarje midis tyre.

⁹⁷ Transmeton Buhariu

Nga ana tjetër, ekzistojnë ahkame që trajtojnë çështjet e imanit, besimeve dhe ibadetit, të cilat janë përcaktuar në Kur'an, Sunnet dhe ixhma (konsensus), dhe të cilat janë bërë të qarta dhe të prera. Megjithëse nuk janë kërkesa të domosdoshme (darurijjat) të fesë, ato përfaqësojnë unitetin intelektual dhe të sjelljes së Ummetit. Shmangia nga këto ahkame është shmangie nga Sunneti; ajo është mëkat, risi e ndaluar dhe mund të çojë në kufr. Veç këtyre, ekzistojnë ahkame të cilat duhet të dihen medoemos nga të gjithë njerëzit (el ma'lum mined-dini bid-darureh), qofshin ata të arsimuar apo jo. Mohimi i tyre është një mohim i qartë i All-llahut (xh.sh.) dhe të Dërguarit të Tij (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Duhet të bëhet dallim midis ahkameve të bazuara mbi çështje themelore dhe atyre të bazuara në çështje anësore, të provuara qoftë me tekste apo me ixhtihad. Githashtu duhet bërë dallim midis ahkameve kategorike dhe atyre hipotetike në tekste, dhe midis ahkameve të domosdoshme dhe atyre jo të domosdoshme në fe. Secili ka statusin e vet.

Juristët (fukahatë) tanë të mëdhenj kanë ndryshuar nga njëri-tjetri në interpretimin e disa çështjeve dhe mund të gjejmë mendime të ndryshme në lidhje me një çështje. P.sh. ekziston një mospajtim mbi mëkatën e urryer të vrasjes së një muslimani me detyrim. A duhet të bie ndëshkimi mbi vrasësin apo mbi atë që e detyroi të vepronte ashtu? Apo duhet të bie mbi të dy apo mbi asnjërin prej tyre, përderisa krimi nuk është plotësisht i paramenduar dhe i kryer nga një person i vetëm? Të gjitha këto mundësi janë përmendur dhe mbështetur nga disa fukahatë. Bile edhe brenda një medh'hebi gjejmë mendime, rrëfime, mënyra dhe arsyetime të ndryshme mospajtimi midis ulemave të të njëjtit medh'heb. Mjafton të themi se tema e mospajtimit brenda medh'hebit të Imam Ahmedit, i cili është mbështetur mbi hadithet dhe i ndjek ato, ka përfshirë aq shumë opinione dhe rrëfime sa për t'u mbushur një libër me dymbëdhjetë vëllime i quajtur: *"El Insafu fir Raxhib minel Hilaf"*

Duke parë këtë, të rinjtë muslimanë duhet të njohin çështjet të cilat janë të hapura ndaj mospajtimit dhe ato që nuk janë të hapura. Por më me rëndësi është të njohin normat standarde të sjelljes të zbatuara në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe dallimeve. Ata duhet të mësojnë “*edeb ul hilaf*” (etikën e mospajtimit), të cilën e kemi trashëguar nga imamët dhe ulematë tanë. Duhet të mësojmë prej tyre se si të jemi tolerantë dhe pa paragjykime kundrejt atyre me të cilët nuk pajtohemi në lidhje me disa çështje fetare të dorës së dytë. Si mund të ndryshojmë dhe të mos pajtohemi, duke mbetur vëllezër të bashkuar, që e duam, e respektojmë njëri-tjetrin dhe përmbahemi nga shkëmbimi i akuzave? Para së gjithash, duhet të kuptojmë se mospajtimi rreth çështjeve anësore dhe të dorës së dytë, është i natyrshëm. Në të vërtetë, ekziston një Urtësi Hyjnore në caktimin e ahkameve të pakta në Sheriat si kategorike në qartësinë dhe kuptimin e tyre, dhe caktimin e ahkameve hipotetike, të cilat përbëjnë masën kryesore të ahkameve, dhe tek të cilat ekziston një hapësirë e gjerë për mospajtëm të frytshëm.

Është bekim që All-llahu (xh.sh.) ua ka dhuruar disa ulemave muslimanë aftësinë për të konstatuar, shqyrtuar nga afër dhe vendosur për problemet e mospajtimit pa paragjykime kundër ndonjë medhhebi ose mendimi. Këtu përfshihen imamët: Ibn Dekik El ‘Id, Ibn Tejmijje, Ibn Kajjimi, Ibn Kethiri, Ibn Haxher El Askalani, Ed Dehlevi, Esh Shevkani, Es San’ani etj. Por dallimet janë paracaktuar të rriten dhe vazhdojnë, sepse i kanë rrënjët thellë në natyrën e njeriut, jetën, gjuhën dhe Urdhrin Hyjnor. Çdo përpjekje për t’i eliminuar këto dallime do të dështojë, sepse ata do të luftojnë kundër natyrës njerëzore, kundër jetës, kundër të gjitha suneneve. Siç kemi përmendur më lart, mospajtimi i bazuar në ixhtihadin e vërtetë, i cili nuk krijon përçarje, është një bekim për Ummetin dhe një pasurim i fikhut. Mospajtimi objektiv nuk paraqet në vetvete ndonjë kërcënim, nëse shoqërohet me tolerancë dhe mungesë paragjykimesh, dhe është e çliaruar prej

fanatizmit, akuzave dhe mendjecektësisë. Sahabët kanë patur mendime të ndryshme mbi shumë çështje dhe ahkame praktike, por ata kurrë s’e dënuan njëri-tjetrin dhe patën lidhje shumë të përzemërta dhe të forta. Umer ibn Abdulazizi ka thënë: “Nuk do të kisha dëshiruar kurrë që sahabët të mos kishin pasur mosmarrëveshje. Mospajtimi i tyre është mëshirë”.

Bile interpretime të ndryshme kanë lindur që në kohën kur jetonte i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Ato u sanksionuan prej tij dhe ai nuk veçoi dhe kritikoi ndonjë grup. Menjëherë pas Betejës së Ahzabeve, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u tha sahabëve të tij:

“Kush beson në All-llahun dhe Ditën e fundit të mos e falë namazin e iqindisë pa arritur (në ngulimin e) Benu Kurejdhas”.⁹⁸

Disa nga sahabët e panë këtë praktikisht të pamundshme, ndaj e falën iqindinë para se të arrinin në destinacion. Të tjerët, të cilët morën kuptimin e dukshëm të këtij urdhri, e falën iqindinë vetëm pasi mbërritën në ngulimin e Benu Kurejdhas, siç i kishte urdhëruar i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), edhe pse kishte kaluar koha e ikindisë. Kur i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u informua për këtë, ai e aprovoi veprimin e dy grupeve, megjithëse njëri prej tyre duhet të kishte gabuar.

Kjo tregon qartë se nuk është mëkat të veprosh në bazë të një interpretimi të mbështetur në argument të fortë, qëllim të sinqertë dhe ixhtihad. Ibnul Kajjimi i ka përshkruar ata, që zbatuan thelbin e hadithit si Selefu Ehl-il Kijas (të parët e zbatuesve të analogjisë) dhe ata që zbatuan kuptimin e dukshëm të tij si Selefu Ehli Dhahirije (literalistë).

⁹⁸ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi

Për fat të keq, sot ka njerëz të cilët jo vetëm që deklarojnë se e dinë krejt të vërtetën dhe të gjitha përgjigjet, por edhe mundohen t'i kërcënojnë të tjerët që t'i ndjekin, duke besuar se ata mund t'i çrrënjosin me një goditje të gjitha medh'hebet dhe mospajtimet dhe t'i bashkojnë të gjithë njerëzit në një mendim. Ata janë të prirur të harrojnë se kuptimi dhe interpretimi prej tyre i teksteve nuk është më shumë se një hipotezë, e cila mund të jetë e saktë ose e pasaktë. Për më tepër, asnjë njeri (alim, dijetar) nuk është i pagabueshëm, edhe nëse i plotëson të gjitha kushtet dhe kërkesat e ixhtihadit. Ajo që është e sigurt është shpërblimi që do të marrë për ixhtihadin e tij, i saktë qoftë apo i pasaktë, nëse qëllimi është i singertë. Ndaj, këta njerëz nuk kanë bërë gjë vetëm se medhhebeve ekzistuese ua kanë shtuar edhe një! Është e çuditshme dhe absurde se ndërsa nuk e miratojnë përkatësinë e njerëzve nëpër medh'hebe të ndryshme, vetë mundohen t'i bindin njerëzit që t'i imitojnë ata dhe të pasojnë medh'hebin e tyre të ri.

Askush nuk duhet të hidhet në përfundimin se unë e kundërshtoj thirrjen e tyre për ndjekjen e teksteve apo interpretimin (ixhtihadin) dhe kuptimin e tyre nga ata. Kjo është një e drejtë absolute që i është dhënë cilido që i plotëson kushtet e ixhtihadit dhe mjetet e tij. Askush s'ka të drejtë të mbyllë dyert e ixhtihadit të cilat u hapën nga i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për mbarë Ummetin. Ajo që kundërshtoj është mendjemadhësia, arroganca, kotësia dhe mospërfillja e tyre për gjetjet e paraardhësve të tyre të ditur, mosrespekti i tyre për fikhun që kemi trashëguar nga stërgjyshërit tanë të mëdhenj. Unë e hedh poshtë pretendimin e tyre se vetëm ata e dinë të vërtetën, si dhe përshtypjen e tyre të gabuar se ata mund të eliminojnë mosbarazinë dhe mospajtimin, dhe t'i bashkojnë njerëzit në një mendim, atë të tyrin.

Një nga ithtarët e kësaj shkolle "të një mendimi" njëherë më pyeti se pse të gjithë muslimanët nuk pajtohen për mendimin juridik të mbështetur nga teksti. U përgjigja se teksti së pari duhet të jetë

autentik dhe i pranuar nga të gjithë, kuptimi i tij duhet të jetë i qartë dhe nuk duhet të jetë në kontradiktë me një tekst tjetër, më të fortë se ai apo i ngjashëm me të. Duhet të ketë pajtim të plotë për sa u përket tri pikave të mësipërme. Një tekst mund të konsiderohet si i vërtetë nga një imam, por një imam tjetër mund ta shikojë atë si të dobët ose si të vërtetë, por pa argument të provuar i cili do të justifikojë kuptimin e dhënë; një tekst mund të konsiderohet si i përgjithshëm nga një imam, por si i veçantë nga një tjetër, ose mund të shikohet si absolut apo i kufizuar; ai mund të konsiderohet si kategorik apo i anuluar. Një mosmarrëveshje e tillë çon në nxjerrjen e ahkameve të ndryshme p.sh., diçka mund të jetë vaxhib (e obliguar) ose haram (e ndaluar), mustehab (e preferuar) ose mekruh (e urrejtur). Shkurt, të gjitha këto dhe dallime të tjera përmbliken nga Ibni Tejmijje në librin e tij *“Ref’ul Melam anil Eimmeti el A’lam”*, nga Velijullah Ed Dehlevi në librat e tij *“Huxhxbetullahi el Baligah”* dhe *“El Insaffi Esbab il Ihtilaf”* dhe janë të detajuara nga Ali el Hafifi në librin e tij *“Esbabu Ihtilaf il Fukaha”*.

Le të shqyrtojmë hadithet e mëposhtme:

1. I Dërguari ka thënë: “Ajo grua që mban një gjerdan ari (në qafë) do të detyrohet të vendosë një të ngjashëm (të bërë) prej zjarri në Ditën e Gjykimit. Dhe ajo grua që mban vathë ari do të ketë të ngjashëm (të bërë prej zjarri) në Ditën e Gjykimit”.⁹⁹
2. “Ai i cili dëshiron që e dashura e tij të mbajë një rreth prej zjarri (në Ditën e Gjykimit), le ta lerë atë (të mbajë) një rreth ari. Dhe cilido që i dëshiron së dashurës së tij të mbajë një gjerdan prej zjarri (në Ditën e Gjykimit), le ta lerë atë (të mbajë) një gjerdan ari. Dhe cilido që i dëshiron së da-

⁹⁹ Transmetojnë Ebu Davudi dhe en-Nesa’iu nga Esma bint Jezid

shurës së tij të mbajë një byzylyk prej zjarri (në Ditën e Gjykimit), le ta lërë atë të mbajë një byzylyk prej ari. Por mund të bëni ç'të doni me argjendin”.¹⁰⁰

3. Transmetohet nga Thevbani (radijall-llahu anhu) se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e paralajmëroi bijën e tij Fatimenë që të mos mbante një zinxhir prej ari. Si përgjigje ndaj kësaj, ajo e shiti atë, bleu një skllav dhe e liroi atë. Kur u informua për këtë gjest, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha: “Falënderimi i takon All-llahut (xh.sh.) i cili e shpëtoi Fatimenë nga zjarri”.¹⁰¹

Dijetarët kanë qëndrime të ndryshme në lidhje me këto hadithe.

1. Disa prej tyre kanë shqyrtuar isnadin e tyre (zinxhirin e transmetuesve), e kanë gjetur atë të dobët dhe e kanë hedhur poshtë, duke e konsideruar të pamjaftueshëm për ndalim, i cili kërkon argumente të qarta, të prera dhe shqyrtim të kujdesshëm, veçanërisht në lidhje me çështjet e interesit të përgjithshëm, të cilat janë pranuar në tërësi nga muslimanët.

2. Të tjerët kanë rënë dakord se isnadi është i rregullt, por se këto hadithe janë anuluar, sepse argumente të tjera në burime të tjera kanë lejuar gratë të zbukurohen me flori. El Bejhekiu dhe të tjerë kanë treguar konsensusin mbi këtë çështje, i cili është pranuar në fikh dhe është bërë praktikë standarde.

¹⁰⁰ Transmeton Ebu Davudi nga Ebu Hurejre

¹⁰¹ Transmeton en-Nesa'iu

3. Disa i kanë konsideruar këto hadithe si të zbatueshme tek ata që nuk kanë ndarë zekatin e arit që posedojnë, duke e bazuar mendimin e tyre në disa hadithe të tjera, të cilat, megjithatë nuk u kanë shpëtuar kritikave, për më tepër, zekati për xhevahiret e grave është temë mosmarrëveshesh midis medhhebeve të ndryshme.

4. Disa juristë deklarojnë se këto hadithe synojnë t'i paralajmërojnë ato gra, të cilat më kot zbukurohen me ar, me qëllim që të tërheqin vëmendjen në pasurinë e tyre. Gjithashtu Nesaiu transmeton disa hadithe në lidhje me këtë çështje nën titullin: “Bab ul Kerahijeti lin Nisa fi idhhari Hulijjidh Dheheb” (Mospëlqimi i ekspozimit të zbukurimeve të arta nga gratë). Juristë të tjerë thonë se ato lidhen me zbukurimin e tepërt, për shkak të mendjemadhësisë.

5. Në kohën tonë, Shejh Nasiruddin el Albani ka dalë me një mendim të kundërt, që i kundërvihet konsensusit për lejimin e grave që të zbukurohen me ar, e i cili është pranuar nga të gjitha medh'hebet gjatë katërmbëdhjetë shekujve të shkuar. Ai jo vetëm që beson se isnadi i atyre haditheve është autentik, por edhe që këto tekste janë të prera (kategorike) për këtë çështje dmth. ndalimin e mbajtjes së unazave dhe vathëve prej floriri. Kështu ai i kundërvihet konsensusit të fikhut të të gjitha medh'hebeve dhe praktikës së Ummetit gjatë këtyre katërmbëdhjetë shekujve.

A e ka parandaluar ekzistenca e këtyre haditheve mosmarrëveshjen për autenticitetin apo udhëzimin e tyre? A mundet “*shkolla tradicionaliste*” moderne të zhdukë mospajtimin dhe t'i bashkojë njerëzit në një mendim në bazë të një hadithi apo tradite, të cilën e përdorin si argument? Përgjigjja ëshë mjaft e qartë: njerëzit do të vazhdojnë të mospajtohen dhe të kenë dallime mes vete në këso çështjesh, dhe kjo, insha All-llahu, nuk do të sjellë asnjë rrezik ose problem. All-llahu i Lartësuar thotë:

“Secili ka një anë, të cilës i kthehet...”

(2:148)

Në lidhje me këtë, ndihem i prirur të pranoj se nuk kam hasur në reformator apo prijës fetar, i cili në kohën tonë e ka kuptuar thelbin dhe etikën e mospajtimit, si Imami Hasan El Benna (vdiq më 1949). Ai i edukoi pasuesit e tij që ta besonin dhe zbatonin këtë etikë. Pavarësisht nga përkushtimi i thellë ndaj kauzës së solidaritetit islam, përpjekjet e tij të singerta për t'i bashkuar grupet (xhematet) e ndryshme islame dhe për t'i bërë ato të bien dakord mbi konceptet dhe parimet themelore islame, siç tregohet qartë në veprën e tij të mirënjohur *“El Usul ul Ishrun”* (20 Parimet), prapëseprapë ai ishte i bindur për paevitueshmërinë e mospajtimit në çështjet e dorës së dytë dhe ahkamet praktike të Islamit. Këtë ai e ka trajtuar me shumë elokuencë në shumë nga mesazhet e tij, gjë e cila është provuar se ka qenë e dobishme. Në *“Da’vetuna”* (Thirrja jonë), El Benna ka folur për karakteristikat e da’ves së tij, si e përgjithshme, e cila as s’përkrah një grup të veçantë, as s’mbron një vijë të veçantë mendimi. Ajo drejtohet në brendësinë e fesë dhe në thelbin e saj; ajo synon që t’i bashkojë të gjitha përpjekjet në mënyrë që të bëhet një punë më e frytshme, e cila do të sjellë rezultate më të mëdha; ajo e përkrah të vërtetën kudo që të jetë ajo; ajo pëlqen konsensusin dhe urren ekscentrizmin; ajo ia atribon shumë nga fatkeqësitë, të cilat kanë goditur muslimanët, mospajtimit të keqkuptuar dhe përçarjes; ajo beson se dashuria dhe besimi janë faktorët kryesorë të fitoreve të tyre dhe se shpresa e vetme për fuqizimin dhe rigjallërimin e Ummetit të sotëm është në përtëritjen dhe ndjekjen e praktikës së brezave të parë muslimanë. Por, pavarësisht nga besimi i tij i fortë në domosdoshmërinë e bashkimit dhe urrejtjen e përçarjes, El Benna (rehimehull-llah) shkruan:

“Ne besojmë se mospajtimet mbi çështjet fetare të dorës së dytë janë të pashmangshme për arsye të ndryshme. Më të rëndësishmet prej tyre janë:

- Dallimet intelektuale si pasojë e shkallës së intelektit dhe thellësisë së diturisë, shumëllojshmërisë dhe ndërlidhshmërisë së fakteve, e kjo fe është ajete, hadithe dhe tekste të cilat i komenton intelekti dhe mendimi brenda kufijve të gjuhës (arabe) dhe rregullave të saj, të cilat ndikojnë në interpretimin e teksteve. Këto ndryshojnë në njerëz të ndryshëm, ndaj edhe mospajtimi është i pashmangshëm.

- Bollëku i burimeve të diturisë në disa pjesë të botës islame dhe pamjaftueshmëria e tyre në vende të tjera është një faktor i rëndësishëm. Imam Maliku i tha Ebu Xha’ferit: “Sahabët e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u shpërndanë nëpër vise të largëta, çdo grup prej tyre zotëronte dituri. Nëse do t’i detyrosh ata (popuj) të pasojnë vetëm një mendim, atëherë do të krijosh fitne (përçarje)”.

- Gjithashtu ekzistojnë dallime kulturore rajonale. Imam Shafiiu ka dhënë fetva të ndryshme për të njëjtën çështje, në pajtim me kushtet e ndryshme në Irak dhe Egjipt. Në të dy rastet, ai e bazonte verdiktin e tij, në atë që besonte se ishte e vërtetë.

- Një faktor tjetër është mendimi i imamet për transmetuesin. Një imam mund ta konsiderojë një transmetues si plotësisht të besueshëm, por një tjetër mund të ketë dyshime për të njëjtën transmetues dhe si pasojë, nuk e merr atë çka ka transmetuar.

- Gjithashtu, një shkak i mospajtimit gjendet në vlerësimin e argumentit të ahkameve; disa i japin përparësi praktikës së njerëzve ndaj haditheve të transmetuara nga një transmetues i vetëm etj.

Për këto arsye, ne besojmë se një konsensus rreth çështjeve fetare të dorës së dytë është jo vetëm i pamundur, por edhe i papajtueshëm me natyrën e fesë, sepse një kërkesë e tillë sjell në mënyrë të pashmangshme ngurtësi dhe teprim, të cilat janë në kundërshtim me urdhëresat islame për përkulshmëri, lehtësim dhe thjeshtësi. Pa dyshim, këto virtyte do t'i mundësojnë Islamit që të përballojë kërkesat e të gjitha kohëve.

Gjithashtu, ne i kuptojmë arsyet e atyre të cilët nuk pajtohen me ne në lidhje me çështjet anësore dhe të dorës së dytë. Ky mospajtim nuk ndikon në dashurinë apo bashkëpunimin tonë të ndërsjellë, përderisa të gjithë ne na përfshin Islami.

A nuk jemi muslimanë, të cilët dëshirojmë për vëllezërit tanë muslimanë atë që dëshirojmë për vete? Atëherë pse të ekzistojë mosmarrëveshja, pse të mos ketë secili nga ne mendimet e tij të ndryshme dhe megjithatë, të përpiqemi të arrijmë në një pajtim, në një atmosferë çiltërsie dhe dashurie?

Sahabët e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk janë pajtuar në disa fetva, por kjo kurrësesi nuk krijoi përçarje në zemra, as që përçau unitetin e tyre. Ngjarja e namazit në Benu Kurejdha është një shembull i qartë i saj. Përderisa ata, të cilët i njihnin ahkamet më mirë se ne, kanë pasur dallime midis tyre, a nuk është absurde që të grindemi me njëri-tjetrin për gjëra të kota? Përderisa imamët tanë, të cilët e njihnin Kur'anin dhe Sunnetin më mirë se çdokush, kanë pasur mospajtime dhe debate, përse të mos veprojmë edhe ne ashtu? Përderisa ekzistojnë mospajtime rreth çështjeve anësore, madje të qarta dhe të mirënjohura, si ezani i cili thirret pesë herë në ditë, të mbështetura në tekste dhe tradita, ç'mund të thuhet për çështje më delikate, të cilat i nënshtrohen mendimit dhe deduktimit?

Gjithashtu vlen të kujtojmë se gjatë kohës së Halifatit, mospajtimet i paraqiteshin halifit dhe ai gjykonte për to. Mirëpo ku është sot halifi? Atëherë muslimanët duhet të gjejnë një gjykatës, të cilit do t'ia paraqesin çështjen e tyre. Përndryshe, mospajtimi i tyre do të çojë në një mosmarrëveshje tjetër.

Së fundi, vëllezërit tanë janë të vetëdijshëm për këtë dhe, si rrjedhim, kanë më shumë durim dhe çiltërsi ndaj atyre që i kundërshtojnë. Ata besojnë që secili grup njerëzish ka një dituri specifike dhe që në çdo da've, ka elemente të së vërtetës si dhe të pavërtetës. Ata e shqyrtojnë me kujdes të vërtetën, e pranojnë atë dhe, në mënyrë të butë e miqësore, përpiqen t'i bindin kundërshtarët e tyre në mendime. Nëse këta të fundit binden, kjo është diçka shumë e mirë, por nëse nuk binden, ata mbeten vëllezërit tanë muslimanë. Lusim All-llahun të na udhëzojë ne dhe ata”.

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e pikëpamjeve të Imam Hasan el Bennis mbi mospajtimet juridike dhe qëndrimin e tij ndaj tyre. Ajo tregon qartë njohjen e thellë nga ana e tij e Islamit, historisë dhe realitetit.

Dëshiroj gjithashtu të rrëfej një ngjarje praktike nga jeta e Hasan el Bennis, e cila është përvojë edhe e dijetarëve të tjerë, për t'i ilustruar këto koncepte dhe pikëpamje. Një ditë gjatë muajit të Ramazanit, El Benna ishte ftuar të mbante një ligjëratë në një fshat të Egjiptit. Njerëzit në atë fshat ishin ndarë në dy grupe dhe secili prej tyre kishte mendime të ndryshme në lidhje me numrin e rekateve në namazin e teravisë. Njëri grup deklaronte që sipas traditës së Umer ibn el Hattabit, ai duhet të ishte njëzet. Grupi tjetër këmbëngulte se duhet të ishte tetë, duke deklaruar se dihej mirë se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk e kishte kapërcyer kurrë këtë numër rekatesh. Si pasojë, secili grup e akuzonte tjetrin për bid'at (risi) dhe mosmarrëveshjet e tyre ki-

shin arritur në një nivel të rrezikshëm, gati për të çuar në konflikt fizik të hapur. Me të mbërritur Hasan el Benna, ata ranë dakord t'ia paraqisnin problemin atij.

Mënyra me të cilën e trajtoi ai këtë problem është udhëzuese për të gjithë ne. Së pari ai pyeti:

“Cili është hukmi (statusi ligjor) i namazit të teravive?”. Ata thanë: “Sunnet, ata që e falin atë, shpërblehen, ndërsa ata që s’e falin, nuk ndëshkohen”. Së dyti i pyeti: *“Cili është hukmi i vëllazërisë mes muslimanëve?”* Ata thanë: “Farz (obligim) fetar dhe ndihmë nga ndihmesat e imanit (besimit)!” Së treti i pyeti: *“A lejohet në Sheriatin islam humbja e farzit e ruajtja e sunnetit?”* dhe u tha atyre, se nëse e ruanin vëllazërinë dhe bashkimin e tyre dhe secili prej tyre shkon në shtëpi dhe e fal namazin e teravive sipas bindjes dhe argumentit të tij, kjo do të ishte më e mirë sesa grindja dhe kacafytja mes veti.

Kur unë ua përmenda këtë disa njerëzve, ata thanë se veprimi i El Bennas ishte një ikje nga e vërteta dmth. tregimi i dallimit midis sunnetit dhe bid’atit. Ata ngulën këmbë se kjo ishte detyrë e muslimanit. Unë iu përgjigja se kjo është një çështje e hapur ndaj opinionëve të ndryshme dhe se, megjithëse unë fal tetë rekate, nuk i akuzoj për bid’at ata që falin njëzet. Ata këmbëngulën se marrja e një vendimi në çështje të tilla është një detyrë, të cilës një musliman nuk duhet t’i shmanget. U përgjigja se kjo është e vërtetë kur duhet zgjedhur midis hallallit dhe haramit, por në çështjet për të cilat shkollat e mendimit juridik kanë pasur mospajtme dhe si rrjedhim, secili nga ne ka mendim të vetin, s’ka nevojë për fanatizëm apo zell të tepruar.

Shumë dijetarë muslimanë e kanë sanksionuar qartë këtë. Citimi i mëposhtëm është marrë nga një libër hanbelij i titulluar *“Sherhu Gajetil Munteba”*:

“Cilido që kundërshton një mendim të arritur nëpërmes ixhtihadit, vepron kështu për shkak se nuk e njeh statusin e muxhtehidëve, të cilët shpërblehen, kanë apo s’kanë të drejtë, për gjetjet e tyre të lodhshme dhe të vështira. Ata, të cilët i pasojnë këta muxhtehidë, nuk kryejnë ndonjë mëkat, sepse All-llahu ka vendosur (dekretuar) për secilin muxhtehid, atë gjë të cilën e ka arritur me anë të ixhtihadit të tij dhe e cila kështu bëhet pjesë e Sheriatit. Një shembull i kësaj gjendet në lejimin e ngrënies, në rrethana shtrënguese, të mishit të kafshës së ngordhur, ndërkohë që kjo gjë është e ndaluar për një person, i cili nuk është i detyruar ta hajë. Të dy këto janë verdikte juridike të përcaktuara mirë”.

Ibn Tejmijje thotë në “El Fetaval Misrije”.

“Ruajtja e bashkimit (në mes të muslimanëve) është rruga e drejtë. Besmele-ja mund të këndohet me zë të lartë për të mirën e përgjithshme. Gjithashtu është e këshillueshme të lihet e pëlqyeshmja, me qëllim të krijimit të harmonisë dhe afrimit, ashtu siç hoqi dorë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nga rindërtimi i Qabes (mbi themelet e vendosura nga Ibrahim i a.s.) në mënyrë që të mos armiqësohej (me banorët e Mekkes). Imamët, si psh. Imam Ahmedi, në lidhje me Besmele-në, apo lidhjen e vitrit (falja e tri rekateve me një selam), janë të mendimit që të lihet e preferueshmja për të pranueshmen, me qëllim që të ruhet bashkimi.”

Ibn Tejmijje i referohet hadithit të mëposhtëm, për sa i përket ndërtimit të Qabes. Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i tha Aishes (radijall-llahu anha): “Sikur populli yt të mos kishte qenë në xhahilijet (sjelljet dhe mentaliteti i kohës paraislame) deri para pak kohësh, do ta kisha rindërtuar Qaben mbi themelet (e vëna) nga Ibrahim”.

Ibnul Kajjimi ka diskutuar çështjen e Kunutit në namazin e sabahut. Disa njerëz e kanë quajtur Kunutin si bid'at, ndërsa të tjerë si mustehab (të pëlqyeshëm) të zbatuar në kohët e vështirësisë si dhe në kohë të tjera. Në librin e tij (Zad-ul Mead), ai thotë se Sunneti i të Dërguarit (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem) e sanksionon Kunutin si të zbatueshëm në kohët e vështirësisë dhe kjo gjë është pranuar nga dijetarët e hadithit, të cilët ndjekin atë që ka vepruar i Dërguari (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem). Ata e zbatojnë Kunutin, në ato kohë në të cilat edhe i Dërguari (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem) ka vepruar kështu dhe e lënë atë në ato kohë, në të cilat dihet se ai (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem) e ka lënë Kunutin. Ata e shikojnë Kunutin si sunnet dhe lënien e tij si sunnet. Ndaj ata, as s'u kundërvihen atyre që e zbatojnë Kunutin vazhdimisht, e as atyre që heqin dorë nga ai, duke mos e konsideruar atë si bid'at. Ibnul Kajjimi shkruan:

- Një qëndrim i duhur për të kërkuar bekimet e All-llahut (xh.sh.) dhe për ta falënderuar Atë, është qëndrimi në këmbë pas ngritjes nga rukuja. I Dërguari (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem) i ka bërë të dyja këto në këtë qëndrim. Është e pranueshme për imamin ta këndojë duanë e Kunutit me zë të lartë, në mënyrë që njerëzit që falen pas tij të mund të dëgjojnë. Umer ibnul Hattabi e ka ngritur zërin gjatë këndimit të Fatiha-së dhe po kështu ka vepruar edhe Ibni Abbasi gjatë namazit të xhenazes, në mënyrë që t'ua bënin të ditur njerëzve se ky veprim është sunnet. Veprimet e tilla janë temë mospajtimesh të pranueshme: as ata që i kryejnë, as ata që i lënë, nuk qortohen. Të njëjtën gjë mund ta themi për ngritjen e duarve (tekbiret) në namaz, mënyrat e ndryshme të te-shehud-it, ezanit, ikametit si dhe llojet e ndryshme të haxhxit, ifradit, kiranit dhe temettuit.¹⁰²

¹⁰² Ifradi nuk e obligon haxhiun me therje të kurbanit, ndërsa dy llojet tjera e obligojnë (G.Ç.)

Qëllimi ynë është vetëm të përmendim Sunnetin e të Dërguarit (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem), i cili është parimi ynë udhëheqës në këtë libër dhe të cilin kërkojmë ta shqyrtojmë. Me këtë dua të them se nuk jam munduar të trajtoj çka është e lejueshme e çka jo. Qëllimi ynë është praktika e lejueshme, të cilën i Dërguari (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem) e zgjodhi për vete dhe e cila është më e mira dhe më e përsosura. Nëse themi se nuk ka argument nga Sunneti, se ai vazhdimisht e ka kënduar Kunutin në namazin e sabahut apo e ka thënë Besmele-në me zë, kjo gjë nuk do të thotë se ne duhet ta konsiderojmë vazhdimësinë në kryerjen e tyre si mekruh apo bid'at. Ajo do të thotë vetëm se ky udhëzim është më i miri dhe më i përsosuri.”¹⁰³

Veç kësaj, është e lejuar për një person falja e namazit pas një imami të një medh'hebi tjetër, edhe sikur ky person të besojë se këtij të fundit i ka ndodhur diçka që e prish abdestin apo e zhvlerëson namazin e tij, megjithëse medh'hebi i imamit e lejon këtë. Ibn Tejmije thotë në *“El Fevakiḥ ul Adideḥ”*:

- “Muslimanët janë të një mendjeje për lejueshmërinë e namazit pas cilitdo prej tyre, siç kanë vepëruar sahabët dhe tabiünët, si dhe katër juristët e mëdhenj të Islamit. Cilido që e kundërshton këtë, është një risimtar i humbur, i cili është shmangur nga mësimet e Kur'anit, Sunnetit dhe konsensusit të muslimanëve.”

“Megjithëse, disa nga sahabët dhe tabiünët e këndonin Besmele-në me zë, ndërsa të tjerë jo, pra-pëseprapë ata vazhduan të faleshin pas njëri-tjetrit. Kështu veproi Ebu Hanifeja dhe pasuesit e tij,

¹⁰³ Ibnul Kajjim, Zadul Mead, 1:144

Shafiu dhe të tjerë, kur faleshin pas malikijve në Medine, megjithëse këta të fundit nuk e këndonin Besmele-në, as me zë e as pa zë.”

“Ebu Jusufi është falur pas Harun er-Rreshidit, i cili kishte hedhur kupat, të cilit Imam Maliku i kishte dhënë fetva se s’ka nevojë ta përtërish abdestin në këtë rast. Për këtë Ebu Jusufi e vazhdoi namazin e tij pas er-Rreshidit dhe nuk e përsëriti atë”

“Megjithatë, Ahmed ibn Hanbeli ishte i mendimit se duhet të rimerret abdest pas hedhjes së kupave dhe gjakrrjedhjes. I pyetur nëse duhej falur pas një imami, të cilit i kishte rrjedhur gjak, por nuk kishte rimarrë abdest, Ibn Hanbeli u përgjigj:

“Është e pakuptueshme të mos falesh pas Seid ibn Musejjebit dhe Malikut”. Dhe shtoi se në këtë çështje ka dy aspekte:

1. Nëse personi nuk vë re ndonjë gjë që e zhvlerëson namazin e imamit, ai duhet të vazhdojë të falet pas tij. Për këtë kanë rënë dakord paraardhësit tanë të drejtë dhe katër imamët e mëdhenj.
2. Nëse ai është i sigurt se imami ka bërë diçka që e bën atë të papastër (sipas mendimit të tij, jo të imamit), si psh. ka prekur organet e tij gjenitale ose të femrës pa dëshirë seksuale, ka hedhur kupat ose ka vjellë dhe nuk e ka përtërirë abdestin e tij - këto janë çështje në të cilat ka mospajtim mes dijetarëve - por statusi i namazit të atij që falet pas një imami të tillë është se: shumica e paraardhësve tanë të drejtë janë të mendimit se namazi i atyre që falen pas këtij imami është i

vlefshëm. Ky është mendimi i medhhebit të Malikut si dhe atyre të Shafiut dhe Ebu Hanifes. Shumica e teksteve të Ahmedit e mbështesin këtë mendim, i cili është ai i drejti...”¹⁰⁴

3. DITURIA, VLERAT DHE VEPRAT

Nga frytet më të rëndësishme të dijes dhe fikhut në fe janë:

Njohja dhe kuptimi i fesë ndihmon në vlerësimin e vlerave si dhe statusin në Sheriat të veprimeve dhe detyrave, të cilat kanë vendin e tyre të posaçëm në shkallën e urdhërimeve dhe ndalimeve. Një njohje e tillë parandalon çdo konfuzion në lidhje me statusin, ndryshimet ose ngjashmëritë, për sa i përket vlerës juridike të veprimit. Islami i ka dhënë një vlerë specifike çdo veprimi specifik sipas ndikimit të tij pozitiv në jetë ose sipas shkallës së dëmit dhe efektit negativ që mund të sjellë.

Nga urdhërimet ekzistojnë veprime mustehab (të lavdërueshme), neglizhimi i të cilave nuk ndëshkohet, ndërsa kryerja shpërblehet. Gjithashtu ka sunnete muekkedeh (sunnete të forta), ato të cilat i Dërguari (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem) i vepronte gjithmonë dhe nuk i linte kurrë, por që nuk i urdhëroi të tjerët në mënyrë të prerë që t'i kryenin. Sahabët i linin disa prej tyre në mënyrë që të tregonin se ato nuk ishin vaxhib (të obligueshme). Për këtë shkak, Ebu Bekri dhe Umeri hiqnin dorë disa herë nga kurbanet. Një lloj tjetër vaxhibi sipas disa medh'hebeve, është ajo çka

¹⁰⁴ Ibn Tejmijje, El Fewakihul Adideh, 2:181. Po ashtu shih dr. Jusuf el-Kardavi, Fetawa Muasire, 1:201-204

është urdhëruar, por jo në mënyrë të prerë. Farz është çka është urdhëruar në mënyrë të prerë dhe të qartë, kryerja e të cilit shpërblehet, neglizhenca ndëshkohet, moskryerja është fisk, mëkat, ndërsa mosbesimi në të është kufr.

Siç dihet nga të gjithë, farzi klasifikohet në dy kategori: farz kifajeh (obligim kolektiv) dhe farz ajn (obligim individual). Farzi ajn duhet kryer nga çdo musliman, ndërsa farzi kifajeh, nëse kryhet nga disa, nuk shkakton ndëshkimin e atyre që nuk e kanë kryer. Farzi ajn klasifikohet edhe më tej. Më të rëndësishmet janë ato faraid (obligime) të cilat konsiderohen si parime themelore të besimit islam: shehadeti dmth. dëshmia se nuk ka zot përveç All-llahut dhe se Muhammedi (sal-lal-llahu alejhi ve sel-lem) është Robi dhe i Dërguari i Tij, namazi, zekati, agjërimi dhe haxhxi, për ata që kanë mundësi të udhëtojnë. Ekzistojnë obligime të tjera të një grade më të ulët se sa ato që përmendëm më lart, por të cilat janë të detyrueshme. S'ka dyshim se Islami i jep përparësi farzit ajn mbi farzin kifaje. Kështu mirësia dhe bindja ndaj prindërve, e cila është farz ajn, ka përparësi mbi xhihadin, meqë ky i fundit është farz kifajeh. Ndaj nuk është e lejueshme të merret pjesë në xhihad pa pëlqimin dhe lejen e prindërve. Kjo është urdhëruar në një hadith të saktë. Veç kësaj, një farz ajn, i cili është i lidhur me të drejtat e bashkësisë, ka përparësi mbi një farz ajn tjetër, i cili lidhet me të drejtat e individit apo disa individëve, si psh. xhihadi dhe kujdesi për prindërit. Prandaj, në rast të një agresioni të huaj kundër ndonjë vendi islam, xhihadi bëhet farz ajn dhe merr përparësi ndaj të drejtave të prindërve. Kështu farzi ka përparësi ndaj vaxhibit, vaxhibi ndaj sunnetit dhe sunneti i fortë ndaj mustehabit. Gjithashtu Islami u jep përparësi interesave të shoqërisë ndaj atyre individuale dhe preferon veprimet që u sjellin dobi shumë personave ndaj atyre që i sjellin dobi vetëm një personi. Për këtë shkak, Islami preferon xhihadin dhe fikhun (studimin, hulumtimin) ndaj ibadetit personal, pajtimin midis grupeve ndërluftuese, ndaj namazit,

agjërimin dhe sadakasë nafile. Në mënyrë të ngjashme, “një sundimtar i drejtë shpërblehet më shumë për zbatimin e drejtësisë për një ditë sesa për kryerjen e ibadetit nafile për gjashtëdhjetë vjet”. Po ashtu Islami favorizon punën e zemrave mbi ato të gjymtyrëve, favorizon besimin (akide) mbi veprën dhe e konsideron atë se ai është bosht dhe themel.

Ja disa nga gabimet e rënda të kryera nga muslimanët gjatë periudhës së rënies dhe dekadencës:

- 1.** Ata lanë shumë pas dore detyrimet kolektive (farzet kifaje) të një rëndësie të madhe për krejt Ummetin si psh. përparimi dhe epërsia shkencore, industriale dhe ushtarake, pa të cilat muslimanët nuk mund ta arrijnë fuqizimin e plotë. Ata lanë pas dore ixhtihadin, nxjerrjen e Ahkameve, da'ven (Thirrjen islame) dhe kundërshtimin e sundimtarëve të padrejtë.
- 2.** Gjithashtu ata lanë pas dore disa obligime vetjake (farz ajn) apo, të paktën, nënvlerësuan vlerën e tyre siç është obligimi i çdo muslimani që të urdhërojë për të mirën dhe të ndalojë nga e keqja dhe e padëshirueshmja (el emr bil ma'ruf...).
- 3.** Ata i kushtuan më shumë rëndësi disa shtyllave themelore në kurriz të të tjerave; kështu ata i kushtuan më shumë rëndësi agjërimin të muajit të Ramazanit sesa namazit. Kjo është arsyeja që ata të cilët agjërojnë, janë më shumë se ata që falin namaz, veçanërisht tek gratë. Ka prej atyre, të cilët nuk e kanë vënë kurrë kokën në sexhde para All-llahut (xh.sh.). Veç këtyre, ka nga ata, të cilët i kushtojnë më shumë rëndësi namazit se zekatit, megjithëse All-llahu (xh.sh.) i ka përmendur ato së bashku në njëzet e tetë vende në Kur'an, gjë e cila i shtyu disa nga sahabët (radijall-llahu anhum) të thonë se: “Namazi i atij, që nuk e jep zekatin, është i pavlefshëm”. Pikërisht për këtë arsye, Ebu Bekr es Siddiku u betua t'i luftonte ata, të cilët bënë dallim midis namazit dhe zekatit.

4. Ata i kushtuan më shumë rëndësi disa nafiëve sesa farzeve dhe vaxhibeve. Kjo mund të vihet re edhe në praktikën e sufive të vonshëm, të cilët u përqëndruan tek ritualet, dhikri dhe tesbihi, duke lënë pas dore farzet (detyrimet) kolektive si: dënimi i korrupsionit dhe kundërshtimi i padrejtësive shoqërore dhe politike.
5. Ata i kushtuan më shumë rëndësi ibadetit individual si namazit dhe dhikrit, dhe lënë pas dore ibadetet kolektive si xhihadi, fikhu, pajtimi midis njerëzve dhe bashkëpunimi për rrënjosjen e drejtësisë, devotshmërisë, mëshirës dhe tolerancës.
6. Së fundi, shumë njerëz i kushtuan rëndësi shumë të madhe gjërave të dorës së dytë në kurriz të gjërave themelore si besimi, tevhidi (njësimi i All-llahut) dhe qëllimi i përpjekjeve morale dhe shpirtërore dmth. kërkimi i kënaqësisë së All-llahut.

SHKALLËT E TË NDALUARAVE

Ndalimet klasifikohen siç vijon:

1. mekruh tenzihen të cilat janë të urryera, por që nuk shkaktojnë ndëshkim;
2. mekruh tahrime të cilat janë të urryera, por jo të ndaluara kategorikisht dhe kështu janë më afër haramit se hallallit;
3. muteshabihatet (të dyshimtat) të cilat janë të panjohura për shumë njerëz dhe që kryhen si pasojë e padijes. Ai i cili bie në to bie në haram; dhe

4. harame (të ndaluara) quhen ato që janë të përcaktuara qartë në Kur'an dhe Sunnet. All-llahu (xh.sh.) thotë:

“... Ai ju sqaroi se çka është e ndaluar për ju...”

(11:114)

Haramet ndahen në dy kategori: të mëdha dhe të vogla. Haramet e vogla mund të shlyhen me kryerjen e detyrave fetare si namaz, agjërim dhe sadaka. Nga Kur'ani mësojmë se:

“Veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat.” (11:114).

Nga tradita e të Dërguarit mësojmë se kryerja e rregullt e pesë namazeve të përditshme, namazit të xhumasë dhe agjërimit të Ramazanit shlyen çdo mëkat të vogël të kryer ndërmjet tyre nga personi, nëse ruhet nga mëkatet e mëdha (el-Kebair), sepse këto të fundit nuk i pastrojnë as s'i shlyen gjë, pos pendimi i sinqertë, i cili rrjedh nga zemra plot kthesë, e të cilën e pastrojnë lotët e nxehtë. Më e keqja e tyre është shirku dmth. t'i shoqërosh All-llahut (xh.sh.) shok, një mëkat i cili nuk falet kurrë, pos me tewbe (pendim):

“S'ka dyshim se All-llahu nuk fal t'i përshkruhet atij shok, e përveç këtij mëkati i fal kujtdo.”

(4:48)

Pastaj sipas radhës vijnë mëkatet e përmendura në hadithe si mosbindja ndaj prindërve, dëshmia e rremë, magjia, vrasja, kamata, shpërdorimi i pasurisë së jetimëve dhe akuzimi i rremë, veçanërisht për kurvëri i grave të ndershme muslimane.

Të metat dhe konfuzioni kanë ardhur si pasojë e këtyre shkaqeve:

1. Njerëzit janë më të interesuar të kundërshtojnë mekruhet dhe muteshabihatet (të dyshimtat) sesa haramet, si dhe neglizhojnë vaxhibet. Gjithashtu ata janë më të interesuar për ato gjëra, për të cilat ka mospajtime midis dijetarëve se janë hallall apo haram, sesa për ato gjëra që janë rreptësisht të ndaluara.

2. Shumë njerëz janë shumë më të preokupuar me kundërshtimin e mëkateve të vogla sesa të atyre të mëdha si falli, magjia, shenjtërimi dhe përdorimi nga disa njerëz i varreve si vende për namaz dhe ibadet, kurbanet për të vdekurit, kërkimi i ndihmës nga të vdekurit e kështu me radhë. Mëkate të tilla ndotin pastërtinë e tevhidit.

SHKALLËT E NJERËZVE ME VEPRAT

Njerëzit nuk janë të gjithë njësoj. Disa të rinj shumë fetarë bëjnë gabim të madh kur i shikojnë dhe trajtojnë njerëzit sikur ata të ishin të gjithë të barabartë në dituri, durim, iman etj., dhe kështu nuk bëjnë dallim midis njerëzve në përgjithësi dhe muslimanëve të ditur dhe të përkushtuar; midis atyre, të cilët e kanë përqafuar Islamin vetëm pak kohë më parë dhe atyre, besimet e të cilëve janë të qëndrueshme; midis të dobëtut dhe të fortit; pavarësisht nga fakti se në Islam ka vend për secilin prej tyre, sipas statusit dhe aftësisë së tyre mendore. Duke i njohur këto dallime natyrore, Islami jep mundësi për këmbëngulje dhe lehtësim, farze dhe nafi, të detyrueshme dhe vu-lnetare. Ndaj All-llahu (xh.sh.) thotë:

“Pastaj Ne ua lamë në trashëgim Librin robërve Tanë që Ne i kemi zgjedhur; e prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë, e ka prej tyre që janë me ndihmën e All-llahut, të parët në punë të mira, e kjo është ajo mirësia e madhe.”

(35:32)

Ndaj, personi që i bën dëm vetvetes është përcaktuar (komentuar) si një që vepron disa të ndaluarra (haram) dhe përmbushja e detyrimeve (vaxhibât) të të cilit nuk është e plotë. Personi, i cili ndjek një rrugë të mesme, është ai që kryen vetëm detyrimet e tij dhe u shmanget të ndaluarave. Personi, i cili është i parë në punët e mira, është ai që kryen detyrimet (sunnetet) dhe të pëlqyeshmet, u shmanget jo vetëm të ndaluarave por edhe mekruheve dhe muteshabihateve. Të gjitha këto lloje njerëzish, duke përfshirë edhe atë person që dëmton vetveten, përfshihen në bashkësinë e Islamit dhe i përkasin Ummetit të zgjedhur islam, të cilin All-llahu (xh.sh.) e ka bërë trashëgimtar të Kur'anit:

“Pastaj Ne u lamë në trashëgim Librin robërve Tanë që Ne i kemi zgjedhur.”

(35:32).

Ndaj është e gabuar dhe marrëzi të dëbosh njerëz nga bashkësia e Islamit dhe Ummeti vetëm sepse ata kanë dëmtuar vetveten. Në mënyrë të ngjashme është gabim të mos e njohësh dhe pranosh këtë klasifikim dhe t'i trajtosh njerëzit, sikur të gjithë duhet të jenë të parët në punë të mira. Si rrjedhim, të rinjtë e flaktë muslimanë nuk duhet të nguten t'i akuzojnë muslimanët e tjerë për fisk, të shfaqin armiqësi dhe antipati ndaj tyre vetëm sepse ata kanë kryer disa mëkate të vogla apo disa vepra, gjykimi mbi të cilat është i paqartë, për to ekzistojnë argumente kontradiktore dhe si pasojë nuk mund të konsiderohen në mënyrë të prerë si haram. Në sinqeritetin e tyre për ka-

uzën e përbashkët, këta të rinj kanë harruar se Kur’ani, në mënyrë të qartë, ka bërë dallimin midis mëkateve të mëdha dhe atyre të vogla; këto të fundit nuk lejohet ta ndalojnë muslimanin e singertë t’i bëjë mirë dhe ta ndihmojë atë që bie në to, e të cilat i shlyen vetë shmangia nga mëkatet e mëdha. All-llahu (xh.sh.) thotë:

“Dhe vetëm të All-llahut janë ç’ka në qiej dhe në tokë, për t’i shpërblyer ata që bënë keq me të keqen e tyre dhe për t’i shpërblyer ata që bënë mirë, me të mirën e tyre. Ata që largohen prej mëkateve të mëdha dhe prej punëve të ndyta, përveç ndonjë pune të imët, s’ka dyshim se Zoti yt është që gjerësisht përfshin me falje...”

(53:31-32)

Thelbi i parimit të tolerimit të gabimeve ose mëkateve të vogla gjendet në interpretimin e fjalës arabe *“el-lemem”* (gabime të vogla). Ekzistojnë dy interpretime të rëndësishme të kësaj fjale. Ja se si e komenton atë Hafizi Ibni Kethir në ajetet 255-256 të sures En Nisa:

- Fjala *“muhsinun”* është komentuar se me të nënkuptohen ata, të cilët u shmangen mëkateve të mëdha dhe punëve të turpshme dmth. ndalimeve të mëdha, edhe nëse këta njerëz bëjnë disa gabime (mëkate) të vogla, All-llahu (xh.sh.) do t’i falë dhe do t’i mbrojë ata, siç ka premtuar në një ajet tjetër:

“Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha, të cilat u janë të ndaluara, Ne ju shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm.”

(4:31)

“... Ata që largohen prej mëkateve të mëdha dhe prej punëve të ndyta, përveç ndonjë pune të imët (el-lemem)...”

Ky pra është një përjashtim i qartë, meqë gabimet e vogla “*el-lemem*” janë nga mëkatet e vogla dhe veprimet e papëlqyera. Më pas Ibni Kethiri përmend: Ibni Abbasi ka thënë: “S’ka pasur ndonjë gjë më të afërt me “*el-lemem*” se hadithi i mëposhtëm i transmetuar nga Ebu Hurejre (radijall-llahu anhu):

“All-llahu ka caktuar për birin e Ademit pjesën e tij të kurvërisë, të cilën ai do ta kryejë patjetër. Kurvëria e syrit është shikimi (i diçkaje të ndaluar); kurvëria e gjuhës është e folura (e të ndaluarës); nefsi (epshi) dëshiron dhe lakmon, dhe pjesët personale (organet gjenitale) dëshmojnë për këtë ose e mohojnë atë”.¹⁰⁵

Ndaj Ibni Mes’udi dhe Ebu Hurejre thonë se “*el-lemem*” përfshin: vështrimin, shkeljen e syrit, puthjen dhe afrimin për marrëdhënie seksuale, por pa kryer kurvëri.

Interpretimi tjetër i “*el-lemem*” gjithashtu transmetohet nga Ibni Abbasi dhe nënkupton një person që kryen një vepër të turpshme, por që pendohet për këtë. Dhe tha: “I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “O Zot! Falja Jote është e madhe, sepse s’ka asnjë nga robërit e Tu, që të mos ketë kryer gabime të vogla”.¹⁰⁶

Edhe nga Ebu Hurejre dhe Hasani (radijall-llahu anhuma) transmetohet ngjashëm. Disa të tjerë thonë se “*el-lemem*” janë ato mëkate, të cilat kryhen nga një person, pa u kushtuar atyre vëmendje serioze dhe që i kryen ato rrallë. E gjitha kjo do të thotë se në Islam ka vend të mjaftë për

¹⁰⁵ Transmetojnë Ahmed, Buhariu dhe Muslimi

¹⁰⁶ Transmeton Ibn Kethiri sipas Ibn Xheririt dhe et-Tirmidhiut. Et-Tirmidhiu e konsideron si sahih garib (autentik por i transmetuar vetëm nga një person)

çdokënd që në mënyrë jo të vazhdueshme kryen mëkate të mëdha, sepse mëshira dhe falja e Allahut (xh.sh.) përfshin të gjitha mëkatet nga të gjithë ata që pendohen. Njëri nga shembujt më udhëzues për t'i mësuar njerëzit se si të mos i vënë re gabimet dhe fajet e vogla të atyre që i kryejnë obligimet (farzet) dhe ruhen nga mëkatet e mëdha, sepse njeriu nuk është i pagabueshëm, as engjëll, vjen nga qëndrimi i Umer Ibn el Hattabit (radijall-llahu anhu). Transmetohet¹⁰⁷ se disa njerëz shkuan tek Abdull-llah Ibni Umeri, i cili ishte në Egjipt, dhe i treguan atij se kishin vënë re se shumë mësimet të Kur'anit nuk po zbatoheshin nga bashkëkohësit e tyre dhe për këtë donin të pyetnin halifin Umer. Abdull-llahu bashkë me ta erdhi te Umeri. Kur Umeri u takua me Abdull-llahun, ky i fundit e njoftoi për qëllimin e vizitës dhe njerëzit që kishin ardhur me të. Umeri i kërkoi Abdull-llahut të caktonte një takim me ta. Kur njerëzit nga Egjipti erdhën në takim, Umeri (radijall-llahu anhu) iu kthye më të afërtit prej tyre dhe i tha: “Më trego me sinqeritet, a e ke lexuar të gjithë Kur'anin?” Njeriu u përgjigj pozitivisht. Umeri e pyeti përsëri: “A i ke ndjekur me rreptësi mësimet e tij në qëllimet e tua, me qëllim që të pastrosh zemrën dhe të mendosh për veprimet që bën?” Njeriu iu përgjigj negativisht. Umeri vazhdoi ta pyesë: “A i ke ndjekur rreptësisht mësimet e tij në uljen e shikimit (ndaj gjërave të ndaluara nga All-llahu), në fjalët dhe jetën tënde?” Çdonjëri prej këtyre pyetjeve, njeriu iu përgjigj negativisht. Umeri ua drejtoi këto pyetje edhe anëtarëve të tjerë të grupit, të cilët iu përgjigjën negativisht secilës prej tyre.

Atëherë Umeri tha: “Si mund të kërkoni prej tij (halifit, në këtë rast vetë Umeri) që t'i detyrojë njerëzit të ndjekin kuptimin tuaj për Librin e All-llahut, kur ju vetë nuk veproni ashtu, siç e

¹⁰⁷ Transmeton Ibn Xheriri sipas Ibn Avnit i cili citon Hasan el-Basriun

pohuat edhe vetë? Zoti ynë e ka ditur se çdonjëri prej nesh do të bëjë disa veprime të këqija...”.
Më pas lexoi këtë ajet:

“Nëse largoheni prej mëkateve të mëdha, të cilat u janë të ndaluara, Ne jua shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm.”

(4:31)

Duke iu drejtuar grupit, ai pyeti: “A e di populli i Medines përse keni ardhur këtu?” Kur ata u përgjigjën se jo, ai tha: “Sikur ta kishin ditur, do t’u kisha bërë (juve) shembull për të tjerët (me ndëshkim të rreptë)”. Kjo ngjarje transmetohet nga Ibn Xheriri në tefsirin e Ibni Kethirit dhe Ukbe e aprovon vërtetësinë e isnadit të saj.

Me këtë dituri largpamëse (fikhu Umerian) dhe kuptim të thuktë të Kur’anit, Umeri (radijall-llahu anhu) qe në gjendje ta zgjidhte këtë problem që në fillim të tij dhe t’i mbyllte dyert fanatizmit dhe zellit të tepruar. Sikur të kishte treguar butësi, ka ekzistuar rreziku të ngriheshin erëra të mëdha të fitnes (përçarjes), pasojat e së cilës nuk i di kush pos All-llahut xh.sh.!

4. KUPTIMI I AFTËSIVE, KUFIZIMEVE DHE KUSHTEVE TË TË TJERËVE

Një aspekt tjetër i fikhut të kërkuar plotësues të asaj që kemi cekur deri më tani është kuptimi dashamirës dhe vlerësimi i drejtë i niveleve të ndryshme të aftësive, kufizimeve dhe rrethanave, të cilat mund t’i pengojnë muslimanët e tjerë nga plotësimi i kërkesave të një jete ideale islame. Do të ishte një gabim i madh të pritnim ose të kërkonim nga të gjithë njerëzit të arrinin shkallën e

imanit e të binin shehidë si Hamza Ibn Abdulmuttalibi (radijall-llahu anhu) në rezistencën ndaj shtypjes, padrejtësisë dhe shfrytëzimit, dhe të sakrifikonin çdo gjë për çështjen e da'ves. Ky është një virtyt, të cilin vetëm pak njerëz e aspirojnë apo e realizojnë.

Disa njerëz mund të kënaqen vetëm me thënien fshehurazi të së vërtetës, disa të tjerë bile heshtin, të bindur se rrethanat mbizotëruese kanë arritur në një stad të tillë që është e kotë dhe ndoshta e rrezikshme të kundërshtosh haptazi apo të mundohesh t'i ndryshosh gjërat.

Të tjerë mund të besojnë se reformimi duhet të fillojë nga themeli, jo nga kulmi, dhe kështu drejtojnë përpjekjet e tyre tek individët, të cilët, siç besojnë ata, janë të aftë të realizojnë ndryshimin e dëshiruar në shoqëri, pasi të armatosen me qartësinë e shikimit dhe qëllimit, megjithëse zhdukja e regjimeve dhe sistemeve të perëndimizuara dhe laike nuk mund të realizohet pa një punë kolektive (në xhemaat) me rrënjë të thella dhe afat të gjatë, e udhëhequr nga një lëvizje popullore islame dhe e mbështetur në objektiva të qarta, metoda të studiuara mirë dhe qëndrueshmëri.

Megjithatë, Sheriati justifikon, bile kërkon, heshtjen para shikimit të së keqes, nëse kjo do të çonte në një të keqe më të madhe. Kjo është në pajtim me aksiomën islame se një musliman mund të zgjedhë të durojë një të keqe të vogël në mënyrë që të mos ndodh një e keqe më e madhe. Një zgjedhje e tillë sanksionohet nga Kur'ani dhe shfaqet qartë veçanërisht në ngjarjen e Musait (alejhis-selam) dhe vëllait të tij Harunit (alejhis-selam), të cilët qenë ngarkuar t'i komuniknin Mesazhin hyjnor Faraonit dhe popullit të tij. Musai (alejhis-selam) u ngjit në malin Sinaj dhe e la popullin e tij nën udhëheqjen e Harunit (alejhis-selam) si zëvendës i tij. Por sapo u largua Musai (alejhis-selam), izraelitët filluan të adhuronin statujën e artë të viçit, siç u propozoi Samiriu, dhe nuk ua vunë veshin paralajmërimeve të Harunit (alejhis-selam) kundër këtij drejtimi:

“E Haruni atyre u pat thënë më parë: “O populli im, ju vetëm u sprovuat me të, pse Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi, andaj ejani pas meje dhe më dëgjoni për këtë që po ju them”. Ata i thanë: “Ne nuk do t’i ndahemi këtij (adhurimit të vërtetë) derisa të kthehet tek ne Musai.”

(20:90-91)

Duke parë se ata nuk bindeshin, Haruni (alejhis-selam) heshti ndaj këtij devijimi, e a ka devijim më të madh se shirku?! Kur Musai (alejhis-selam) u kthye dhe pa devijimin e popullit të tij, u zemërua dhe në kulm të zemërimit, e qortoi Harunin (alejhis-selam), duke u sjellë shumë ashpër me të:

“O Harun, ç’të pengoi kur i pe se morën rrugën e gabuar. E ti të mos e vazhdosh rrugën time.”

(20:92-93)

Haruni (alejhis-selam) u përgjigj:

“O biri i nënës sime, mos më kap as për mjekre, as për flokësh, se unë u frikësova se do të thuash: “I përçave beni israilët dhe nuk e respektove porosinë time.”

(20:94)

Haruni (alejhis-selam) e konsideroi ruajtjen e unitetit të bashkësisë, derisa të kthehej prijësi i saj i parë, një arsye të mirë për heshtje ndaj humbjes në të cilën kishte rënë populli, në mënyrë që të mos akuzohej se kishte marrë një vendim të nxituar dhe kishte shkaktuar përçarje të bashkësisë dhe nuk e kishte pritur kthimin e Musaut. Kjo ndodhi i ngjan hadithit të përmendur më parë, në të cilin i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha se ai do ta kishte shembur Qaben dhe do ta kishte rindërtuar atë mbi themelet e vëna nga Ibrahim (alejhis-selam), sikur pasuesit e tij të mos kishin vetëm pak kohë që kishin hequr dorë nga idhujtaria.

Shembuj të tjerë gjenden në urdhrin e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për muslimanët që t'i durojnë padrejtësitë e sundimtarëve të tyre, nëse nuk kanë fuqi t'i rrëzojnë dhe zëvendësojnë ata me persona të drejtë, në mënyrë që kjo të mos krijojë një fitne dhe përçarje më të madhe, e cila çon në rezultate katastrofike si derdhja e gjakut musliman, humbja e pasurisë dhe paqëndrueshmëria, pa arritur ndonjë rezultat të ndjeshëm. Sundues të tillë mund të tolerohen përderisa tek ta të mosvihen re shfaqje të kufrit ose riddes. Në lidhje me këtë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Derisa të shihni (te ata) kufr të hapur, për të cilin keni argument nga All-llahu”.¹⁰⁸

Të dy rastet tregojnë qartë rëndësinë e ruajtjes së unitetit përballë një suksesi të pasigurt. Nga ana tjetër, vërehet qartë gabimi i idealistëve ëndërrimtarë, të cilët duan nga muslimanët ose të ndjekin me rreptësi Islamin në të gjitha sferat e tij, ose të largohen nga Islami tërësisht. Për ata nuk ekziston mes as klasifikim. Sipas mendimit të këtyre idealistëve, forca fizike është e vetmja metodë e cila duhet përdorur për të ndryshuar të keqen, duke mos shikuar dy rrugët e tjera: me fjalë dhe me zemër, dhe se e gjithë kjo varet nga aftësitë dhe mundësitë e individit. Duket se ata kanë harruar faktin se Islami nuk e miraton mbingarkimin e njerëzve, aftësitë dhe rrethanat e të cilëve duhet të kihen gjithmonë parasysh. Sheriati i ka marrë parasysh rrethanat e ndryshme dhe disa nevoja, saqë në rrethana shtrënguese, e ndaluara bëhet e lejuar dhe vaxhibi bie poshtë. Shqyrtimi i kësaj nga Ibn Tejmijje është shumë i aftë. Ai shkruan:

“All-llahu (xh.sh.) na ka treguar në shumë vende në Kur'an se Ai nuk i mbingarkon njerëzit më shumë se sa kanë mundësi. All-llahu thotë:

¹⁰⁸ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi

“All-llahu nuk obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij.”

(2:286)

gjithashtu:

“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira e Ne as që obligojmë ndokënd çka nuk ka mundësi (të veprojë).”

(7:42)

dhe:

“Askush nuk ngarkohet më tepër, vetëm aq sa e ka mundësinë e tij.”

(2:233)

si dhe:

“All-llahu nuk ngarkon askënd, vetëm aq sa i ka dhënë.”

(65:7)

Gjithashtu All-llahu (xh.sh.) e ka urdhëruar njeriun t’i bindet Atij sa të mundet. Ai thotë:

“Andaj, ruajuni dënimet të All-llahut sa të keni mundësi.”

(64:16)

Vetë besimtarët i janë lutur Atij (xh.sh.):

“Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me atë për të cilën nuk kemi fuqi.”

(2:286)

All-llahu (xh.sh.) e pranoi kërkesën e tyre. Të gjitha këto tekste tregojnë se Ai nuk i ngarkon askujt ndonjë barrë, të cilën s'mund ta bartë, përkundër filozofisë së predeterministëve (Xhehmijve); Ai nuk i ndëshkon ata që gabojnë apo harrojnë, përkundër fatalistëve Kaderij dhe racionalistëve Mu'tezilë.

Ajo që duhet theksuar është se nëse një imam, një sundimtar, një jurist, një dijetar apo një myfti kryen ixhtihad me sa ka mundësi dhe me frikë ndaj All-llahut, ky ixhtihad i tij është ai që All-llahu ka kërkuar prej tij dhe Ai nuk do ta ndëshkojë atë, nëse verdikti i tij është i gabuar. Kjo është në kundërshtim me pikëpamjet e Xhehmijve, të cilët mendojnë se muxhtehidi i bindet All-llahut, por mund ta dijë apo mos ta dijë të vërtetën. Gjithashtu kjo është në kundërshtim me Kaderijtë dhe Mu'tezilët, të cilët mendojnë se të gjithë ata që merren me ixhtihad e kanë arritur njohjen e të vërtetës; ky qëndrim i tyre është batil (i kotë, jo i vërtetë).

E njëjta gjë ndodh edhe me kuffarët (jobesimtarët); ata, të cilëve u arriti thirrja e të Dërguarit (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) në vendin e kufrit, e njohën atë si të Dërguar të All-llahut, besuan në çfarë iu zbrit atij dhe iu bindën All-llahut me aq sa patën mundësi, si Negusi (Nexhashiu, mbreti i Abisinisë) dhe të tjerë, por që nuk mundën të bëjnë hixhret (emigrojnë) në atdheun e Islamit dhe s'mundën ta zbatojnë krejt Sheriatin, ose sepse nuk u lejuan të bëjnë hixhret, ose sepse nuk u lejuan t'i zbatojnë besimet e tyre haptazi; dhe ata të cilët nuk patën asnjë që t'ua mësonte Sheriatin islam. Të gjithë këta janë besimtarë dhe nga banorët e xhennetit, insha All-llah. Si shembuj kemi: besimtarin nga populli i Faraonit, gruan e Faraonit dhe Jusufin (alejhis-selam), i cili e ftoi popullin e Egjiptit që ishte jobesimtar, në iman dhe tewhid (monoteizëm), megjithëse nuk mund t'u tregonte gjithçka që dinte për Islamin. Por ata refuzuan ta dëgjojnë atë. Në Kur'an, besimtari nga populli i Faraonit u tha atyre:

“Edhe Jusufi, qysh herët ju pat ardhur me argumente të qarta, e ju gjithnjë ishit në dyshim ndaj asaj që ju pat sjellë, derisa dhe kur vdiq, ju patët thënë: “All-llahu nuk do të dërgojë pas tij pejgamber.”

(40:34)

Veç kësaj, megjithëse Negusi ishte mbreti i të krishterëve, ata nuk ju bindën atij kur iu kërkoi të përqaфонin Islamin. Vetëm një grup i vogël e pasoi atë, ndaj kur vdiq nuk pati askush që t'i falë xhenazen. Megjithatë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ia fali namazin e xhenazes në Medine, në të cilin morën pjesë shumë njerëz, sepse i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) u tregoi për vdekjen e Negusit dhe tha: “Një vëlla juaji i drejtë nga populli i Abisinisë ka vdekur”.¹⁰⁹

Negusi nuk mundi të zbatonte një numër të madh mësimesh islame dhe nuk emigroi në atdheun e Islamit, nuk mori pjesë në xhihad dhe nuk kreu haxhxin. Gjithashtu transmetohet se ai nuk i ka falur pesë kohët e namazit, nuk ka agjëruar dhe nuk e ka dhënë zekatin, sepse këto do t'i zbulonin bindjet e tij para popullit kundër të cilit nuk mund të dilte.

Ne e dimë me siguri se ai nuk mundi të zbatojë tek populli i tij urdhërimet e Kur'anit, megjithëse All-llahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij t'i zbatojë këto urdhërime tek Popujt e Librit. Gjithashtu All-llahu (xh.sh.) e paralajmëroi të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) të mos i lejonte Popujt e Librit ta bindnin që të devijonte qoftë edhe pak, nga ajo që Ai i kishte zbritur atij.

Umer Ibn Abdulazizi (radijall-llahu anhu) u ballafaqua me vuajtje dhe armiqësi të mëdha për shkak të përkushtimit të tij të pafund ndaj drejtësisë. Besohet se u helmua për këtë shkak. Negusi

¹⁰⁹ Transmeton Muslimi

dhe të tjerë si ai janë të lumtur në xhennet, megjithëse ata nuk zbatuan veçse atë pjesë të Sheriatit që mundën. Ata zbatuan ato ligje që ishin të zbatueshme.

5. NJOHJA DHE KUPTIMI I SUNENEVE TË ALL-LLAHUT NË ATË QË KA KRIJUAR AI

Islami është feja e të menduarit racional dhe kritik. Kjo është arsyeja që një nga qëllimet e saj themelore është ta bëjë njeriun të vetëdijshëm për rëndësinë shumë të madhe të shkallëzimit, qëndrueshmërisë dhe pjekurisë. Ngutja është veçori karakteristike e njeriut në përgjithësi dhe e të rinjve në veçanti. Me të vërtetë, ngutja është një veçori e spikatur e kohës sonë dhe ajo i ka bërë të rinjtë tanë të etur ta mbjellin farën sot dhe ta korrin nesër. Por, vullneti i All-llahut në krijimin e Tij nuk e lejon këtë; një pemë kalon përmes fazave të rritjes para se të japë fruta. Krijimi i njeriut e ilustron këtë shumë qartë:

“Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, dhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj e bëmë krijesë tjetër. I lartë është All-llahu, më i miri Krijues.”

(23:14)

Fëmija lind, pi gjë, ha ushqim dhe shkallë-shkallë kalon nga fëmijëria në pjekuri. Në mënyrë të ngjashme, jeta lëviz gradualisht nga një fazë në një tjetër, derisa të realizohen sunenet e All-llahut. Islami filloi si një besim i lehtë, më pas shkallë-shkallë u futën obligimet, u caktuan ndalimet dhe

u detajuan çështjet legjislativë. Gradualisht, struktura mori formë të plotë dhe begatitë dhe bekimet e All-llahut (xh.sh.) u shpërndanë kudo. Më pas u shpall ajeti vijues:

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova begatinë time ndaj jush dhe zgjodha (pëlqeva) për ju Islamin si fe.”

(5:3)

Këto etapa dhe zhvillime janë mjaft të qarta, por rrallë, për të mos thënë aspak, vëzhgohen dhe kuptohen.

Të rinjtë janë skandalizuar nga korrupsioni që i rrethon duke shikuar përditë gjendjen e Ummetit islam e cila po keqësohet me shpejtësi. Shqetësimi i përbashkët nxit takime grupi; ata marrin përsipër t'i rregullojnë gjërat, të shpëtojnë atë që vlen të ruhet. Por, në ngutjen dhe entuziazmin e tyre, ata humbin qartësinë e shikimit, fillojnë të ëndërrojnë me sy hapur dhe ndërtojnë kështjella në ajër, besojnë se mund t'i zhdukin të gjitha format e korrupsionit dhe gënjeshtërs, dhe ta ngrenë shtetin islam brenda natës. Ata i nënçmojnë apo i shpërfillin humnerat dhe pengesat e pallogaritshme, të cilat i tejkalojnë mundësitë dhe mjetet e tyre. Dilema e tyre është e ngjashme me atë të njeriut që i kërkoi Ibni Sirini t'i interpretonte një ëndërr që kishte parë. Kishte parë në ëndërr sikur po notonte në një tokë të thatë dhe po fluturonte pa krahë. Ibni Sirini iu përgjigj: “Ti je njeri që ke shumë ëndrra dhe dëshira”. Ali ibn Ebu Talibi (radijall-llahu anhu) e paralajmëroi të birin: “... dhe ruhu nga mbështetja tek ëndrrat, sepse ato janë mallrat e budallenjve”.

Të gjithë e dimë se realiteti i korruptuar nuk mund të ndryshohet me strategji të pamatura të bazuara vetëm në dëshirat dhe qëllimet e mira. Është me vend që t'u tërheqim vëmendjen tek një libër “*Hatta jugajjiru ma bi enfusihim*” (Derisa të ndryshojnë çka kanë brenda në shpirt), të shkruar

nga dijetari sirian prof. Xhevdet Seid. Libri trajton “*sunenet e ndryshimit të shpirtit dhe të shoqërisë*” dhe titulli është nxjerrë nga këto dy ajete kur’anore:

“Me të vërtetë, All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata të ndryshojnë veten e tyre (me shpirtrat e tyre).”

(13:11)

dhe:

“Këtë e bëri, sepse All-llahu nuk do ta ndryshojë begatinë që ia ka dhuruar një populli derisa ata të ndryshojnë çfarë kanë në shpirtrat e tyre (në vetvete).”

(8:53)

Në përshtatje me titullin, libri është një studim i thellë psikologjik dhe shoqëror nën dritën e mësimave të Kur’anit. Ja një pjesë e shkëlqyeshme e hyrjes së tij:

“Midis të rinjve muslimanë ka prej tyre që janë të gatshëm dhe të vendosur për të flijuar jetën dhe pasurinë e tyre për çështjen e Islamit. Për fat të keq, ka pak prej tyre që e kalojnë jetën duke ndjekur një hulumtim serioz me qëllim përsosjen e një disipline të caktuar ose qartësimin e një të vërtete të errët. Për shembull probleme të tilla si ndarja midis besimit dhe sjelljes, midis asaj që deklarohet dhe asaj që bëhet shtrojnë pyetje të cilat kanë nevojë për përgjigje objektive dhe të studiara mirë, pa të cilat çdo reformë konstruktive është e pamundur. Plogështia e studimeve ekzistuese i dedikohet faktit se Bota islame akoma nuk e ka kuptuar plotësisht rëndësinë apo nevojën e hulumtimit, për shkak të besimit të përhapur se: “Shpata është më e fuqishme se pena” në vend të: “Mendohu para se të veprosh”. Këto mendime të ndryshme vazhdojnë të mbesin në konfuzion të plotë; as lidhjet e vërteta, as renditja natyrore e tyre nuk janë studiuar dhe kuptuar.

Veç kësaj, kushtet e imanit nuk janë studiuar akoma me kujdes në botën islame. Kjo nuk do të thotë se muslimanët nuk i kanë mësuar bazat e imanit dhe Islamit. Me këtë nënkuptojmë kushtet psikologjike dmth. ato të cilat duhen ndryshuar në shpirt, sepse ky ndryshim sjell lulëzimin e imanit, i cili është përshtatja e besimit me veprat.

Deri tani besohet se vetësakrifikimi dhe sadakaja janë virtytet më të larta, pa u shqyrtuar seriozisht se ç'është ajo që i bën ato të tilla. Vetëm sakrifica nuk mund t'i realizojë synimet, pa pasur një strategji të menduar dhe të planifikuar mirë. Ky mendim i inkurajon të rinjtë muslimanë të flijojnë jetën dhe pasurinë e tyre pa i detyruar ata të përpiqen dhe të ngulin këmbë për të studiuar dhe kuptuar. Shkak tjetër është se vetëflijimi mund të ndodhë nga një shtytje e çastit, ndërsa kërkimi i diturisë kërkon këmbëngulje, vetëdije, analizë kritike dhe largpamësi, të cilat së bashku sigurojnë vazhdimësi dhe sukses. Shumë të rinj muslimanë, me vrull të madh, i futen punës dhe studiojnë në fusha të ndryshme, por pasi fillojnë entuziazmi i tyre fillon të venitet, ia lëshon vendin bezdisjes dhe kështu e ndërpresin atë që kanë filluar.

Ne duhet t'i analizojmë këto qëndrime për të zbuluar shkaqet e një pagatishmërie të tillë dhe mosvazhdimi të studimeve serioze, të cilat ndodhin si rezultat i disa shkaqeve dhe faktorëve specifikë, të cilët nuk mund të zbulohen nga njerëzit e ngutshëm.

Prirja për kërkimin e reformave të nxituara dhe ndryshimin e realitetit, në mungesë të një vetëdije dhe vetëndryshimi, është absurde.

Ndierja e ndikimit të realitetit të sotëm në kushtet tona është një gjë, por vetëdija për rolin tonë (dmth. atë çka kemi në vetvete) është diçka tjetër. Kjo është ajo që Kur'ani kërkon t'ua mësojë njerëzve duke shpjeguar se ç'ndodh me ta dhe duke theksuar se thelbi i problemit është *“ajo që*

gjendet në vetvete” dhe jo një padrejtësi e jashtme. Kjo është esenca e ndryshimit historik dhe shoqëror të cilin e sanksionon Kur’ani. Moskuptimi i kësaj të vërtete të qartë turbullon shikimin tonë dhe sjell ato filozofi pesimiste dhe të nënshtruara, despotike dhe joislame.

Padrejtësia më e rëndë e vetëshkaktuar është moskuptimi i lidhjes së qenësishme nënshtruese midis njeriut, gjithësisë dhe shoqërisë. Si rezultat i saj, njeriu i keqgjykon aftësitë e tij dhe nuk ia del ta vendosë vetveten në atë pozicion, nga i cili mund të shfrytëzojë mundësitë njerëzore dhe natyrore për të përfituar në përputhje me sunenet që gjenden tek to. Ndaj mund të themi se para mendjes njerëzore dalin dy qëndrime kur ballafaqohet me një problem: të besojë se problemi u nënshtrohet disa ligjeve të caktuara dhe kështu mund të zgjidhet dhe kontrollohet; ose të besojë se ai është misterioz dhe mbinatyor, për pasojë nuk u nënshtrohet disa ligjeve ose se këto ligje nuk mund të zbulohen. Midis këtyre dy ekstremeve ekzistojnë qëndrime të shumta ndërmjetëse; çdo hipotezë ka një rezultat praktik, i cili pasqyrohet në qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve në varësi të drejtimit që ata ndjekin.

Pamundësia e muslimanëve për të jetuar sipas mësimave të Islamit është një problem që është provuar lehtë. Bile edhe pasi pranohet problemi, mbetet kjo pyetje: cilin nga dy qëndrimet e lartpërmendura duhet ta ndjekin muslimanët? Diskutimi i këtij problemi në këtë mënyrë, duke ia paraqitur atë vetëdijes së muslimanit, do ta ndihmojë atë për të përcaktuar qëndrimin e tij kundrejt problemit dhe për të hequr dorë nga qëndrimi i paqartë që mund të marrë. Në shumë raste, kur këto dy qëndrime ngatërrohen, paralizojnë efektin e njëri-tjetrit dhe problemi qëndron i paqartë. Zgjidhja kërkon, në një shkallë mjaft të madhe, një hipotezë të shëndoshë.”

6. DIALOG MBI SUNENET DHE KUSHTET E FITORES

Më poshtë po japim dialogun që bëra me disa të rinj entuziastë muslimanë. Ata pyetnin, unë përgjigjesha:

Pyetje: A nuk është e vërtetë se ne ndjekim të vërtetën (hakkun), ndërsa kundërshtarët tanë të pavërtetën (batilin)?

Përgjigje: Po, pa dyshim!

Pyetje: A nuk na ka premtuar Zoti ynë se e vërteta do të triumfojë mbi të pavërtetën dhe imani mbi kufrin?

Përgjigje: Po dhe All-llahu (xh.sh.) nuk do ta thyejë kurrë premtimin e Tij.

Pyetje: Atëherë çfarë po presim? Pse nuk fillojmë luftë kundër së pavërtetës?

Përgjigje: Feja jonë na mëson se kjo fitore u nënshtrohet disa suneneve dhe kushteve, të cilat duhet t'i ndjekim patjetër. Sikur të mos kishte qenë kështu, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) do t'i kishte shpallur luftë idhujtarisë që në fillim të periudhës mekkase dhe nuk do të kishte pranuar të falej në Qabe, e cila ishte e rrethuar me idhuj.

Pyetje: Cilat janë këto sunene dhe kushte?

Përgjigje: Së pari, All-llahu (xh.sh.) nuk e ndihmon të vërtetën (hakkun), vetëm sepse ajo është e tillë, por Ai e ndihmon atë përmes njerëzve besimtarë, të bashkuar dhe të vëllazëruar rreth fjalës së Tij. All-llahu (xh.sh.) i thotë të Dërguarit të Tij:

“Ai është që të fuqizoi me ndihmën e Tij dhe me besimtarët, dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre.”

(8:62-63)

Pyetje: Ku janë engjëjt (melekët), të cilët zbritën për të ndihmuar të vërtetën kundër së pavërtetës? Ata që zbritën në betejat e Bedrit, Hendekit dhe Hunejnit?

Përgjigje: Melekët ekzistojnë dhe do të vijnë t’i shpëtojnë besimtarët kur të dëshirojë All-llahu (xh.sh.). Megjithatë ato nuk zbresin në zbrazëti; duhet të ekzistojnë besimtarë të vërtetë këtu në tokë, të cilët përpiqen për mbizotërimin e së vërtetës dhe që kanë nevojë për ndihmë nga qielli që të forcohen. Rreth kësaj çështjeje Kur’ani është i qartë; ja ç’thotë All-llahu (xh.sh.) në këtë ajet të zbritur gjatë betejës së Bedrit:

“Edhe kur Zoti yt u kumtoi engjëjve se: Unë jam me ju, pra, inkurajoni ata që besuan! Unë do të hedh frikë në zemrat e atyre që nuk besuan.”

(8:12)

Pyetje: Nëse ka besimtarë të vërtetë, a do të vijë fitorja?

Përgjigje: Ata duhet ta përhapin Islamin me të gjitha mundësitë, t’i shumëfishojnë radhët e tyre dhe të bashkëbisedojnë me kundërshtarët e tyre, me shpresë që t’i bindin ata për vërtetësinë e thirrjes së tyre. Në këtë mënyrë, ata do të marrin fuqi për t’iu bërë ballë armiqve. Do të ishte e paarsyeshme që një person i vetëm të përballonte njëqind apo një mijë armiq. Numri maksimal i përmendur në Kur’an i jobesimtarëve që mund të përballojë një besimtar i vendosur dhe energjik, është dhjetë:

“O Pejgamber! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse prej jush janë njëzet të durueshëm, do t’i mundni dyqind, e nëse janë njëqind, do t’i mundni një mijë sish që nuk besuan, për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë (pse luftojnë).”

(8:65)

Por në kohët e dobësisë, numrat ndryshojnë:

“All-llahu u bëri lehtësim tani duke ditur se jeni dobësuar. Nëse prej jush janë njëqind të durueshëm, do t’i mundni dyqind, e nëse prej jush janë një mijë, me ndihmën e Zotit do t’i mundni dy mijë. All-llahu është me ata që janë të durueshëm.”

(8:66)

Pyetje: Por, kundërshtarët tanë janë gjithmonë në gatishmëri; ata ia kanë dalë t’i sabotojnë përpjekjet tona për përhapjen e fjalës së Zotit.

Përgjigje: Kjo gjë vërteton thënien se ekziston një kusht i domosdoshëm pa të cilin fitorja nuk mund të arrihet dmth. durimi përballë vuajtjeve, këmbëngulja përballë kundërshtimit dhe provokimit. i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i tha kushëririt të tij Abdull-llah Ibni Abbasit (radijall-llahu anhu): “Durimi është parakusht i fitores”.

Kjo është edhe këshilla e All-llahut (xh.sh.) për të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

“Ti ec pas asaj që të shpallet dhe bëhu i durueshëm derisa All-llahu të gjykojë. Ai është më i miri i gjykatësve.” (10:109)

“Dhe të jesh i durueshëm! Durimi yt është vetëm me ndihmën e All-llahut. Mos u pikëllo për ta, as mos u brengos për dredhitë që bëjnë! S’ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm dhe ata që janë bamirës.”

(16:127-128)

“Ti pra bëj durim, pse premtimi i All-llahut është i vërtetë, e kurrsesi mos të të luhasin ata që janë të dyshimtë.”

(30:60)

“Ti duro, ashtu siç duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta.”

(46:35)

“Ti bëj durim në vendimin e Zotit tënd, se ti je nën mbikëqyrjen Tonë dhe kur të ngrihesh madhëroje me falënderim Zotin tënd!”

(52:48)

Pyetje: Por, ne mund të këmbëngulim me durim për shumë kohë, pa patur sukses në ngritjen e një shteti islam, i cili do të zbatojë Sheriatin, do të ringjallë Ummetin islam dhe do të ngrejë përsëri flamurin e Islamit.

Përgjigje: Por a ke mësuar ndonjë të paditur, a ke udhëzuar ndonjë në rrugë të drejtë dhe a ke bërë ndonjë që të pendohet para All-llahut?

Kur ai u përgjigj pozitivisht, unë shtova: Kjo është një arritje e madhe, e cila na ofron tek synimi ynë. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Nëse All-llahu të mundëson të udhëzosh ndonjë person (në rrugë të drejtë), është më e mirë për ty se devetë e kuqe”. Ai obligim

për të cilin do të japim llogari është Thirrja islame, edukimi i njerëzve dhe puna; nuk është në dorën tonë realizimi i qëllimit tonë. Ne duhet të mbjellim farën dhe t'i shpresojmë frytet nga All-llahu. All-llahu nuk do të na pyesë: Pse nuk fituat?, por do të na pyesë: Përse nuk punuat?!

“Dhe thuaj: Punoni se All-llahu do ta shohë punën tuaj, edhe i Dërguari i Tij dhe besimtarët, e më vonë do të ktheheni tek Njohësi i së fshehtës dhe së dukshmes, e do t’ju njoftojë për atë që punuat.”

(9:105)

KAPITULLI I KATËRT KËSHILLA ATËRORE PËR RININË ISLAME

Në fund të artikullit tim të lartpërmendur të botuar në “*El Ummeh*”, Ramazan 1401 h., në të cilin diskutova aspektet pozitive dhe negative të “*Rizgjiimit të Rinisë Islame*”, theksova këto dy fakte:

I pari: Se kjo ringjallje sinjifikon një dukuri natyrore dhe të shëndoshë, e cila është shenjë që tregon qartë rikthimin tek fitre (natyrshmëria), tek rrënjët, që për ne në atdheun tonë islam, përfaqësohen nga Islami; fillimin dhe fundin, në të cilin mbrohem nga vështirësitë dhe nga i cili marrim fuqinë e shpirtit, shpresës dhe udhëzimit. Shoqëritë tona muslimane kanë kërkuar zgjidhje të importuara nga Perëndimi apo Lindja, por kanë dështuar në arritjen e ngritjes shpirtërore, bollëkut material, mirësisë ose mirëqenies shoqërore në ndonjë vend islam. Përkundrazi, zbatimi i

këtyre sistemeve të huaja të importuara na ka futur në një labirint vështirësish, të cilat kanë sjellë përçarje dhe dekompozim në shoqëritë muslimane. Për pasojë, opinionimi publik beson thellësisht në pashmangshmërinë e zgjidhjes islame, dmth. zbatimin e Sheriatit në të gjitha fushat e jetës. Ndaj nuk është për t'u habitur që roli i rinisë islame në këtë përpjekje karakterizohet nga kurajoja, vendosmëria dhe këmbëngulja.

I dyti: Shfaqjet e ngurtësisë dhe rreptësisë tek disa të rinj nuk mund të përmirësohen me dhunë, kërcënime apo akuza, të cilat janë të pafrytshme dhe mund të çojnë në shtimin e ashpërsisë dhe kokëfortësisë. Askush nga ne nuk dyshon për qëllimin e mirë dhe sinqeritetin e rinisë ndaj All-lahut dhe vetvetes. Ndaj këto shfaqje mund të kurohen vetëm duke u njohur me të rinjtë, duke kuptuar qëndrimet dhe mendimet e tyre, duke treguar vullnet të mirë për kuptimin e qëllimeve të tyre, duke kapërcyer hendekun që i ndan ata nga pjesa tjetër e shoqërisë, duke bërë dialog intelektual të duruar me ta me qëllim që të qartësohen konceptet, sqarohen keqkuptimet dhe njihen ngjashmëritë dhe dallimet.

1. DREJT NJË DIALOGU KONSTRUKTIV

Duke zhvilluar shumë dialogje të tilla, u kam dhënë shumë këshilla të rinjve, duke mos kërkuar asgjë tjetër përveç kënaqësisë së All-lahut. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) na mëson se besimtarët gjithmonë duhet të këshillohen me njëri-tjetrin, duke urdhëruar për të mirën dhe

ndaluar nga e keqja, me durim dhe këmbëngulje. Këto janë kërkesa të domosdoshme për të pasur sukses në këtë botë dhe shpërblim në botën tjetër. Ndaj këshilla ime ka synuar që të jetë një pikë orientimi, e cila insha All-llah, do të na udhëzojë drejt synimit tonë, do të na mundësojë të shmangim kurthet dhe devijimin, e do të na sigurojë vazhdimësinë e marshimit tonë.

I këshilloj të rinjtë të respektojnë specializimin. Ne jetojmë në një kohë në të cilën specializimi është bërë thelbësor, shkëlqimi në një disiplinë nuk do të thotë medoemos edhe shkëlqim në një tjetër. Ashtu siç nuk mund të këshillohem me një mjek për probleme inxhinierike apo ligjore, ashtu është e gabuar ta konsiderojmë Sheriatin si të hapur ndaj interpretimit të të gjithë njerëzve duke pretenduar se njohja e fikhut dhe Islamit nuk mund të monopolizohet nga një grup i veçantë njerëzish dhe se Islami, ndryshe nga fetë e tjera, nuk e njeh ekzistencën e klerit (rixhâl-ud-din). Është e vërtetë se Islami nuk ka njohur kurrë një klasë të tij si kleri i krishterë, por ka njohur rolin e besuar dijetarëve të specializuar në çështjet e fesë dhe të përmendur në këtë ajet kur'anor:

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ai, në mënyrë që të ruhet (nga e keqja).”

(9:122)

Kur’ani dhe Sunneti na mësojnë që ato çështje, për të cilat s’kemi dituri, t’ua paraqesim dijetarëve:

“Ne edhe para teje nuk dërguam veçse burra, të cilëve u dhamë shpallje, e nëse nuk e dini këtë, atëherë pyetni njerëzit e ditur.”

(21:7)

“Madje kur u vjen atyre ndonjë lajm qetësues ose shqetësues, ata e përhapin atë, e sikur t’ia linin atë Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do të dinin të nxjerrin përfundim.”

(4:83)

“Për këtë pyet ndonjë shumë të dijshëm.”

(25:59)

“E askush nuk të informon ty si i dituri.”

(35:14)

Gjithashtu i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), kur u informua se një të plagosuri i kishin dhënë fetva, se duhet ta lante krejt trupin para se të merrte abdest dhe të falej, gjë e cila i solli vdekjen, tha: “E vranë që i vraftë All-llahu! Pse nuk pyetën kur nuk dinin?”

Është me të vërtetë tronditëse të zbulosh se ka njerëz, megjithëse krejtësisht të pakualifikuar, që janë të gatshëm të japin fetva për problemet më serioze dhe më të ndërlikuara, fetva që mund të bie në kontradiktë me ato të dijetarëve të vjetër dhe të atyre bashkëkohorë. Këta njerëz nuk ngurrojnë kurrë t’i vlerësojnë si të gabuara fetvatë e dijetarëve të tjerë, të cilët i akuzojnë si injorantë duke bërë titur se dyert e ixhtihadit nuk janë të hapura vetëm për disa të zgjedhur, por për të gjithë. Kjo është e vërtetë, por ixhtihadi kërkon disa kushte të caktuara, nga të cilat këta njerëz nuk zotërojnë asnjë. Paraardhësit tanë kanë kritikuar bile edhe disa dijetarë, të cilët u ngutën në dhënien e fetvasë, pa u njohur mirë dhe pa e shqyrtuar me kujdes çështjen, duke thënë: “Disa njerëz, duke u ngutur, japin fetva për çështje, të cilat sikur t’i paraqiteshin Umer Ibnul Hattabit, ai do të këshillohej me të gjithë ata që morën pjesë në Betejën e Bedrit” dhe “Më guximtari prej jush në dhënien e fetvave është më guximtari për të hyrë në Zjarr”.

Pavarësisht nga dituria e thellë që posedonin, Halifët në Rrugë të Drejtë këshilloheshin me sahabët e ditur kur ballafaqoheshin me çështje kritike. Nga këto lloj fetvash kolektive lindi ixhmaja (konsensusi) në periudhën e parë islame. Kur këshilloheshin, disa sahabë kufizoheshin nga bërja e komenteve, ndërsa të tjerë thonin se nuk e dinin. Utbeh Ibn Muslimi rrëfen se qëndroi në shoqërinë e Ibni Umerit për 34 muaj. Gjatë kësaj kohe, Ibni Umeri u pyet për çështje të rëndësishme dhe përgjigjej shpesh se nuk e dinte. Ibni Ebu Lejla rrëfen të njëjtën gjë për rreth 120 sahabë të të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), shumica e të cilëve ishin nga ensarët dhe bashkëkohës të tij:

Kur ndonjëri prej tyre pyetej për ndonjë çështje, ai e drejtonte pyetësin tek një tjetër, i cili nga ana e tij e drejtonte atë tek një tjetër dhe kështu me radhë derisa më në fund pyetësi kthehej tek ai që e kishte pyetur në fillim. Ata donin të ishin të kursyer në transmetimin e hadithit apo dhënien e fetvasë si përgjigje ndaj një pyetjeje.

Ata Ibn es-Saibi ka thënë se kishte vënë re shumë nga bashkëkohësit e tij të dridheshin kur jepnin fetva. Seid Ibnul Musejjebe, dijetar nga brezi i tabiinëve i cili shkëlqeu në fikh, ka dhënë fetva rrallë. Por kur duhej të jepte, e luste All-llahun (xh.sh.) ta ruante nëse kishte gabuar pa qëllim, dhe ata që do ta ndiqnin fetvanë e tij.

I njëjti kujdes vihet re shpesh në praktikën e imamëve të medh'hebeve të pasuara. Ishte rregull më shumë sesa përjashtim për ta, të përgjigjeshin se nuk e dinin kur ishin të pasigurt. Për shembull Imam Maliku ishte jashtëzakonisht i kujdesshëm dhe shpesh thoshte: “Nëse dikush pyetet për ndonjë çështje, duhet të mendojë për xhennetin, xhehennemin dhe shpëtimin e tij në botën tjetër, para se të përgjigjet”. Ibnul Kasimi e ka dëgjuar Malikun të thotë: “Jam pyetur për

një problem të veçantë për më shumë se dhjetë vjet, por akoma edhe sot nuk kam vendosur për të”. Ibn Mehdi e ka dëgjuar Malikun të thotë: “Ka raste që më sjellin një çështje (për të shqyrtuar) dhe për këtë e kaloj tërë natën duke u menduar”. Mus’abi rrëfen se babai i tij u pyet njëherë për një problem, por duke qenë i pasigurt i tha të birin ta çonte pyetësin tek Maliku, i cili iu përgjigj: “S’mund të përgjigjem, shko dhe pyet ata që dinë më shumë se unë”. Ibn Ebu Hasani ka thënë: “Malikut iu kërkua mendim për njëzet e një çështje, por ai dha fetva vetëm për dy prej tyre, duke thënë shumë herë “La havle ve la kuvvete il-la-bil-lah” (S’ka forcë dhe as fuqi përveç asaj që ka dhënë All-llahu)”.

Me këtë gjë nuk kam për qëllim t’i shkurajoj të rinjtë islamë nga kërkimi i diturisë. Mësimi i diturisë është obligim për ne që nga djepi e deri në varr. Ajo që kërkoj të theksoj këtu është se sado që të mësojnë, gjithmonë do të kenë nevojë për ata që janë të specializuar. Në Sheriat ekzistojnë shumë degë ndërdisiplinore dhe usule (baza) të cilat këta të rinj nuk i dinë dhe nuk i kuptojnë, dhe për ç’gjë nuk kanë as kohë e as mjete. E ndiej veten të obliguar të them se nuk e miratoj prirjen e disa të rinjve, të cilët i braktisin fakultetet pasi janë regjistruar në to, kanë bërë përparime të dukshme dhe pritet të dalin mirë, për t’u specializuar në Sheriat. Këta njerëz e injorojnë faktin se kërkimi i diturisë dhe shkëlqimi në një disiplinë, është farz kifaje (obligim kolektiv). Duhet të vihet re që gara, e cila zhvillohet midis muslimanëve dhe jomuslimanëve, në zotërimin e shkencave laike (jofetare), është në kulmin e saj. Kur një musliman mundohet të mësojë, shkëlqejë dhe të thellohet në këto shkenca me qëllim të pastër vetëm për hir të All-llahut (xh.sh.), aktualisht është duke kryer ibadet dhe xhihad.

Le të kujtojmë se kur Mesazhi hyjnor iu shpall të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), sahabët e parë merreshin me profesione të ndryshme. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) nuk u

kërkoi atyre të hiqnin dorë nga puna dhe t'i përkushtoheshin studimit të Islamit, natyrisht duke i përjashtuar ata të cilëve u besohej ndonjë mision i posaçëm dhe për përmbushjen e të cilit duhet të ishin të përgatitur. Ajo, së cilës i frikësohem, është se prirja për të hequr dorë nga studimi i disiplinave të tjera me qëllim studimin dhe zotërimin e Sheriatit, mund të jetë e motivuar nga një dëshirë e fshehtë e pandërgjegjshme për popullaritet, dukje dhe udhëheqje, veçanërisht në takime, debate dhe seminare. Një dëshirë e tillë nuk është e lehtë të zbulohet, sepse Shejtani i mallkuar ka mjete dhe hyrje të panumërta për të depërtuar në shpirtin e njeriut, i cili është i përkulshëm ndaj joshjeve (tundimeve), nëse ky njeri nuk është vazhdimisht vigjilent. Kjo do të thotë se duhet t'i shqyrtojmë me kujdes mendimet, motivet dhe strategjitë tona, dhe duhet të mundohemi vazhdimisht të zbulojmë nëse këto janë të nxitura nga qëllime mondane apo shpirtërore. Vetëmashtrimi është një kurth që trazon motivet dhe turbullon qartësinë e shikimit. Duhet që t'ia kujtojmë gjithmonë vetvetes këtë ajet kur'anor:

“E kush i përmbahet fesë së All-llahut, ai pa dyshim është i udhëzuar në rrugën e drejtë.”

(3:101)

2. PËRFITONI NGA TË DEVOTSHMIT DHE TË DREJTËT

Meqenëse çdo disiplinë njihet mirë nga ata që janë të specializuar në të, i këshilloj të rinjtë ta marrin diturinë fetare nga dijetarët e besueshëm, të cilët e ndërthurin diturinë e thellë me devotshmërinë, drejtësinë dhe drejtpeshimin në jetë. Burimet kryesore të diturisë islame janë

Kur'ani dhe Sunneti, por cilido që dëshiron ta pasurojë kuptimin dhe njohjen e tyre këtë nuk mund ta bëjë pa interpretimet e ulemasë, shpjegimin e dijetarit dhe kuptimin e fukahave, të cilët ia kushtuan jetën e tyre studimit të tyre dhe të cilët vunë themelet e Usul ul Fikhut, duke na lënë një trashëgimi të gjerë të cilën vetëm injorantët dhe arrogantët mund ta përçmojnë. Atij që pretendon se e njeh Kur'anin dhe Sunnetin, por përçmon dijetarët e Ummetit, nuk mund t'i besohet mësimdhënia e Islamit. Nga ana tjetër, një person që ndjek vetëm gjetjet e ulemave dhe fukahave, si dhe veprat e katër juristëve të mëdhenj të Islamit, por lë mënjanë argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti, ai i injoron burimet e fesë dhe legjislacionit.

Ka dijetarë të specializuar vetëm në një degë të kulturës islame, jo të lidhur drejtpërdrejt me Kur'anin dhe Sunnetin si psh. në histori, filozofi dhe sufizëm. Këta dijetarë mund të jenë të dobishëm në fushat e tyre të veçanta, por nuk janë të kualifikuar në dhënie fetvash ose mësimdhënien e Sheriatit. Disa prej tyre mund të jenë oratorë dhe predikues të lindur, të aftë që me elokuencë t'i bindin të tjerët, por kjo nuk i bën ata të aftë për hulumtime shkencore, sepse ata shpesh e përziejnë të vërtetën me mitin, të vërtetën me të rremen, të rëndësishmen me të parëndësishmen. Ata japin fetva të gabuara për çështje që nuk i kuptojnë mirë: ngatërrojnë problemet dhe përparësitë; i zmadhojnë apo i zvogëlojnë çështjet. Megjithatë, njerëzit që magjepsen nga stili dhe elokuenca e tyre, i pranojnë pa ngurruar verdiktet dhe mendimet e tyre. Ndaj duhet të kujtojmë se retorika është një gjë dhe fikhu një gjë tjetër, dhe se ai që shkëlqen tek njëra, nuk duhet medoemos të shkëlqejë edhe tek tjetra.

Veç kësaj, ai që nuk i zbaton ato që predikon, nuk meriton të mësojë apo udhëzojë të tjerët. Zbatimi shfaqet tek drejtësia, devotshmëria dhe frika ndaj All-llahut (xh.sh.), të cilat janë frytet e diturisë së vërtetë. Kur'ani thotë:

“Në të vërtetë All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët.”

(35:28).

Kjo devotshmëri dhe ky kujdes e ruajnë dijetarin islam nga futja në çështje fetare të cilat nuk i njeh dhe nga shërbimi që mund t'i bëjë me diturinë e tij ndonjë sunduesi apo regjimi.

Tipari i tretë që duhet të gjendet tek dijetari i vërtetë është moderimi, i cili është cilësi unike e Islamit. Kemi qenë të pafat që në këtë kohë vërejmë shumë grupe kundërshtarësh, të cilët pretendojnë se zotërojnë dituri: tepruesit dhe mospërfillësit, ekstremistët dhe kundërshtuesit.

Hasen El Basri na ka paralajmëruar se “feja do të humbë si rezultat i veprimeve të tepruesit dhe mospërfillësit”. I pari është i prirur të ndalojë pothuaj çdo gjë, ndërsa i dyti i bën të gjitha gjërat e lejueshme.

Disa ekstremistë ndjekin një medh’heb dhe mundohen të mbyllin dyert e ixhtihadit. Nga ana tjetër, të shkujdesurit dhe mospërfillësit i shajnë të gjitha medh’hebet dhe i refuzojnë të gjitha doktrinat dhe verdiktet e mishëruara në to. Gjithashtu ka literalistë, të cilët ndjekin vetëm interpretimin literal (të fjalëpërfjalshëm) të teksteve, pa marrë parasysh qëllimet dhe rregullat; ndërkohë që ka nga ata që e interpretojnë përmbajtjen e teksteve sipas dëshirave dhe trilleve të tyre. Çështjet janë humbur midis këtyre dy ekstremeve. Ndaj kemi nevojë për njerëzit e moderuar, të cilët kanë mendje fakihu dhe zemër të devotshme; për ata të cilët i harmonizojnë obligimet me realitetin, të cilët bëjnë dallim midis asaj që pritet nga personi jo shumë i përkushtuar ndaj fesë dhe asaj që pritet nga i përkushtuari ndaj saj, të cilët e dinë mirë se nevojat kanë rregullat e tyre të veçanta dhe se duke u munduar të lehtësojnë, të mos heqin ndarjet midis së lejuarës dhe së ndaluarës apo duke qenë tepër të kujdesshëm, të shkaktojnë vështirësi dhe pengesa për njerëzit.

Imam Sufjan Thevriu, i njohur për devotshmërinë e tij dhe njohjen e thellë të hadithit dhe fikhut, ka thënë: “(Në lidhje me urdhërimet e ndalimeve në Islam) duhet të kërkohet lejimi nga një fakih i besueshëm, ndërsa fetvatë e shtrënguara mund të jepen nga çdokush”.

3. LEHTËSONI E MOS VËSHIRËSONI

I këshilloj të rinjtë të largohen nga teprimi dhe ekstremizmi dhe të ndjekin pjekurinë dhe lehtësimin, veçanërisht në marrëdhëniet me njerëzit e thjeshtë, nga të cilët nuk pritet të reagojnë si njerëzit e devotshëm. Një musliman, nëse dëshiron, mund të mbajë një qëndrim të kujdesshëm për një apo disa çështje. Por, nëse i përçmon lehtësimet fetare në favor të kujdesshmërisë, atëherë Islami do të shndërrohet në një “*grup masash paraprake*” që tregojnë vetëm ngurtësi dhe vështirësi; All-llahu do për robërit e Tij lehtësinë dhe gjerësinë. Kur’ani, Sunneti dhe praktika e sahabëve, të gjitha këto bëjnë thirrje për lehtësim dhe paralajmërojnë kundër teprimit dhe vështirësimit të gjërave për besimtarët. Ajetet e mëposhtme kur’anore, të cilat trajtojnë temat e agjërit, pastrimit, martesës dhe kisasit, e tregojnë këtë gjë:

“All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju.”

(2:185)

“All-llahu nuk dëshiron t’ju sjellë ndonjë vështirësi...”

(5:6)

“All-llahu dëshiron t’ju lehtësojë (vështirësitë), sepse njeriu u krijua i dobët.”

(4:28)

“O ju që besuat! U është bërë obligim gjurmimi për dënim për vrasje: i liri për të lirin, skllavi për skllavin, femra për femrën. Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet kuptueshëm dhe shpagimi atij le t’i bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj.”

(2:178)

Ndërsa nga Sunneti tashmë kemi përmendur disa hadithe të cilat këshillojnë për moderim dhe ekuilibër, duke i paralajmëruar kundër teprimit në fe:

“Ruhuni nga teprimi në fe. (Popuj) para jush janë zhdukur si pasojë e teprimit”.¹¹⁰

“Të shkatërruar janë mutenettuunët!” Dhe ai (i Dërguari) e përsëriti këtë tri herë.¹¹¹

Ebu Hurejre transmeton:

“Një beduin urinoi në xhami. Njerëzit u sulën ta ndëshkojnë, por i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i urdhëroi ata: “Lëreni atë dhe derdhni një kovë ujë (mbi vendin ku ka urinuar). Misioni juaj është t’i lehtësoni gjërat e jo t’i vështirësoni ato”.¹¹²

Është e vërtetë se sa herë që i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) duhej të zgjedhte midis dy obcioneve, gjithmonë zgjedhte më të lehtin, me kusht që të mos ishte mëkat.¹¹³ Gjithashtu ai iu

¹¹⁰ Transmetojnë Ahmedi, en-Nesa’iu dhe Ibn Maxhe në Sunenet e tyre

¹¹¹ Transmeton Muslimi

¹¹² Transmeton Buhariu

¹¹³ Me pajtim nga të gjitha autoritetet

drejtua Muadhrit (radijall-llahu anhu) kur dëgjoi se ai e zgjaste namazin: “O Muadh! A po i vë njerëzit në sprovë?”¹¹⁴ I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e përsëriti këtë tri herë me qëllim që të theksonte se krijimi i vështirësive për njerëzit ose përpjekja për të përdorur forcën me ta gjithmonë shkakton fitne.

Një person që kërkon përsosurinë dhe kujdesin, mund të ketë të drejtë t’ia vështirësojë gjërat vet-vetes, por nuk ka të drejtë t’ua imponojë atë të tjerëve dhe padashur t’i largojë ata nga feja. Për këtë arsye, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e zgjaste namazin kur ishte vetëm dhe e shkurtonte atë kur u printe të tjerëve. Në lidhje me këtë, ai ka thënë:

“Cilido prej jush që u prin njerëzve në namaz, duhet ta shkurtojë atë, sepse midis tyre ka të dobët, të sëmurë, pleq dhe ka prej tyre që kanë punë. Nëse ndokush prej jush fal namaz vetëm, mund ta zgjasë atë sa të dëshirojë”.¹¹⁵

Buhariu transmeton se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “Kur e filloj namazin dëshiroj ta zgjas, por sapo dëgjoj të qarën e ndonjë fëmije e shkurtoj atë që të lehtësoj nënën e fëmijës”. Gjithashtu Muslimi thotë në Sahihun e tij se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) kur u printe njerëzve në namaz lexonte më shumë ajetet e shkurtra të Kur’anit sesa ato të gjatat. Aisheja (radijall-llahu anha) ka thënë: “Si një gjest mëshire, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i ndaloi njerëzit nga visali (agjërimi vullnetar i disa ditëve pa ndërprerje). Por njerëzit i thanë: “Po ti vepron kështu!” Ai tha: “Unë s’jam si ju. Zoti im më jep të ha dhe të pi”.

¹¹⁴ Transmeton Buhariu

¹¹⁵ Transmeton Buhariu

Prirja për t'i lehtësuar gjërat është më urgjente në këtë kohë se ndonjëherë më parë. Jetojmë në një kohë të kredhur në materializëm, të humbur në zbavitje, plot me të këqija aq të mëdha sa që një person, i cili ndjek me përpikmëri parimet e tij fetare, ballafaqohet me një mori vështirësish dhe kufizimesh. Kjo është arsyeja pse fukahatë e kanë miratuar lehtësimin në kohët e vështirësisë dhe fatkeqësive.

4. THIRRNI ME URTËSI DHE BUTËSI

I këshilloj të rinjtë që të ndjekin rrugën e caktuar për ta në thirrjen e jomuslimanëve në Islam dhe në zhvillimin e dialogjeve me ta; rrugë e cila tregohet në këto ajete:

“Thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata në mënyrën që është më e mira.”

(16:125)

Siç dihet ajeti i mëposhtëm nuk urdhëron vetëm *“këshillë të mirë”*, por edhe *“mënyrë që është më e mira”*. Ndaj, nëse ka dy rrugë për të kryer një dialog, duhet të zgjedhet më e mira me qëllim që të fitohen zemrat e njerëzve dhe të kapërcehen hendeqet. Një nga mënyrat më të mira është ajo në të cilën përmenden dhe diskutohen së pari pikat e pajtimit, duke kaluar më pas në pikat e mospajtimit. Kur’ani thotë:

“Thttarët e Librit mos i polemizoni ndryshe vetëm ashtu siç është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që ju zbrit juve, dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.”

(29:46)

Çdo pikë mospajtimi që mbetet do të gjykohet nga All-llahu (xh.sh.):

“E nëse ata të kundërshtojnë ty, ti thuaju: All-llahu e di më së miri për këtë që ju po veproni. All-llahu do të gjykojë mes jush Ditën e Kijametit për atë që kundërshtoheshit.”

(22:68-69)

Nëse kjo është mënyra me të cilën muslimani duhet të kryejë një dialog me një jomusliman, atëherë si duhet të bisedojë ai me vëllain e tij musliman, i cili i përket kësaj feje të madhe? Disa vëllezër tanë muslimanë ngatërrojnë sinqeritetin dhe ashpërsinë në shprehjen e së vërtetës, megjithëse midis këtyre të dyjave s’ka asnjë lidhje. Thirrësi i urtë islam është ai i cili e përcjell dhe komunikon mesazhin tek të tjerët me një mënyrë të butë dhe fjalë shumë të përzemërta, natyrisht pa komprometuar përmbajtjen e mesazhit të tij. Realiteti na mëson se përmbajtja, pa marrë parasysh sa e madhe është ajo, mund të shtrembërohet dhe humbet si pasojë e sjelljes së ashpër, ndaj është thënë: “Ai që urdhëron për të mira, duhet ta bëjë këtë me urtësi”.

Imam Gazaliu ka shkruar në librin e tij “El Emru bil Ma’arufi ven Nehju anil Munker”: “Një person që urdhëron për të mirën dhe ndalon nga ajo që është e keqe dhe e padëshirueshme duhet të tregojë dhembshuri, simpati, urtësi dhe dituri”. Për ta provuar këtë, tregoi historinë e atij që erdhi tek El Me’muni, halifi i shquar abbasij, dhe filloi ta “*këshillojë*” atë rreth vesit dhe virtytit, në një mënyrë të vrazhdë, pa marrë parasysh statusin (rangun) e tij. El Me’muni, i cili kishte një njoh-

je të mirë të fikhut, iu drejtua atij: “Fol me butësi! Kujto se All-llahu dërgoi një më të mirë se ti tek një sundues më të keq se unë, duke e urdhëruar atë t’i fliste me butësi. Ai dërgoi Musain dhe Harunin, të cilët ishin më të mirë se ti, tek Faraoni, i cili ishte më i keq se unë dhe i urdhëroi ata:

“Shkoni që të dy tek Faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Thuani atij fjalë të buta, ndoshta ai mendohet e frikësohet.”

(20:43-44)

Kështu El Me’muni iu përgjigj kësaj kritike me një këshillë të vlefshme dhe njeriu nuk foli më. All-llahu (xh.sh.) e mësoi Musain (alejhis-selam) se mesazhi i tij për Faraonin duhet përcjellë me butësi:

“Shko tek Faraoni se vërtet ai e ka tepruar. Dhe thuaj: A e ke ndërmend të pastrohesh. Dhe të udhëzoj tek Zoti yt e t’ia kesh frikën Atij.”

(79:17-19)

Një shqyrtim i mëtejshëm i dialogut midis Musait (alejhis-selam) dhe Faraonit, siç rrëfëhet në Kur’an, zbulon se Musai (alejhis-selam) e zbatoi me shumë kujdes porosinë e All-llahut (xh.sh.), pa-varësisht nga tirania, arroganca, fyerjet, akuzat dhe sulmet e Faraonit, siç tregohet në suren Esh Shuara’.

Gjithashtu një studim i jetës së të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe Sunnetit të tij, në lidhje me këtë temë zbulon mirësinë, mëshirën dhe butësinë e tij, e cila nuk lë vend për ashpërsi, mizori apo zemërfortësi. Kur’ani e përshkruan kështu qëndrimin e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

“Juve ju erdhi i dërguar nga mesi juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmuesi i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”

(9:128)

Gjithashtu përshkruan marrëdhëniet e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) me shokët e tij:

“Ti ishe i butë ndaj tyre, sepse All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të largoheshin prej teje.”

(3:159)

Një ditë një grup çifutësh u ndeshën me të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe e përshëndetën me: “Essamu alejkum” (e cila do të thotë: Vdekja qoftë mbi ju) në vend të përshëndetjes së zakonshme: “Esselamu alejkum”. Aisheja u zemërua nga kjo gjë dhe iu përgjigj: “Alejkum essamu vel la’neh” (Vdekja dhe mallkimi qofshin mbi ju). Por, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha veç: “Ve alejkum” (Edhe mbi ju) dhe më pas iu kthye Aishes dhe i tha: “All-llahu do që besimtari të jetë i sjellshëm në çdo gjë”.¹¹⁶ Gjithashtu Aisheja transmeton një hadith tjetër: “All-llahu është i mirë dhe do mirësinë; Ai jep për mirësinë atë që nuk e jep për ashpërsinë dhe nuk jep për asgjë tjetër përveç saj (mirësisë)”,¹¹⁷ si dhe: “Mirësia i zbukuron gjërat, mungesa e mirësisë i shëmton ato”.¹¹⁸

¹¹⁶ Me pajtim nga të gjitha autoritetet

¹¹⁷ Transmeton Muslimi

¹¹⁸ Transmeton Muslimi

Xherir Ibn Abdull-llahu transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) të thotë: “Ai i cili është i privuar nga mirësia është i privuar nga krejt e mira”.¹¹⁹ Cili ndëshkim tjetër mund të jetë më i ashpër sesa të jesh i privuar nga krejt e mira?

Shpresoj që këto tekste islame të mjaftojnë për t’i bindur ata të rinj që përdorin mjetet e sulmit dhe dhunës, që të mund t’i largohen dhunës, teprimit dhe ekstremizmit, të cilat janë bërë karakteristikë e tyre dhe të ndjekin rrugën e urtësisë, miqësisë dhe tolerancës.

5. KULTURA E THIRRJES DHE DIALOGUT

Do të dëshiroja të theksoja këtu disa pika të rëndësishme dhe me vend në etikën e da’ves dhe dialogut:

1. Duhet që të respektohen të drejtat e prindërve dhe farefisit. As prindërit, as vëllezërit dhe motrat nuk duhet të trajtohen me ashpërsi ose pa respekt për shkak se janë risimtarë dhe devijues. Kjo gjë nuk ua heq atyre të drejtën për t’u trajtuar me mirësi dhe butësi. Në veçanti, të drejtat e prindërve janë përcaktuar qartë në Kur’an:

¹¹⁹Transmeton Muslimi në këtë mënyrë përmbledhëse

“E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, por në çështjet e jetës së kësaj bote të kesh mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer nga Unë...”

(31:15)

Ne kemi shumë ç’të mësojmë nga qëndrimi i butë dhe bindës i të Dërguarit Ibrahim (alejhisselam) në përpjekjen e tij për ta udhëzuar babain e tij idhujtar drejt së Vërtetës. Ibrahim këmënguli në qëndrimin e tij të butë, pavarësisht nga vrazhdësia e të atit dhe toni kundërshtues. Ç’mund të themi atëherë kur prindërit janë muslimanë dhe të dashur? Bile edhe nëse shkelin disa ligje të Sheriatit, prapëseprapë ata gëzojnë të drejtat prindore.

2. Islami na mëson për barazinë e të gjitha qenieve njerëzore, por kjo nuk duhet ngatërruar dhe keqkuptuar. Ka disa dallime si psh. moshë, të cilat duhet patur parasysh dhe të cilat kërkojnë nga ne që të tregojmë respekt dhe mirësjellje. Ne duhet të respektojmë të drejtat e të afërmeve, bashkëshortëve, fqinjëve dhe sundimtarëve. Etika islame na mëson se i riu duhet ta respektojë të vjetrin, ndërsa i vjetri duhet të tregojë dhembshuri për të riun. Ekzistojnë shumë hadithe që urdhërojnë për këtë gjë: “Respekti për një musliman të moshuar është një lavdërim për All-llahun”¹²⁰ dhe “Ai që nuk tregon dhembshuri për të riun, nuk respekton të moshuarin dhe që nuk i është mirënjohës dijetarit, nuk është prej nesh”.¹²¹

¹²⁰ Transmeton Ebu Davudi sipas Musaut me një isned autentik, ashtu siç përmendet në tejsirin e Menaviut, 1:347

¹²¹ Transmeton Ahmedi sipas Ibn-us Samitit me isned autentik. Po ashtu e transmetojnë edhe et-Taberaniu dhe el-Hakimi

3. Duhet të tregojmë konsideratë për ata njerëz që kanë një përvojë të pasur dhe që janë shumë aktivë në fushën e da'ves. Nëse, për ndonjë shkak apo një tjetër, ata dobësohen dhe e humbin entuziazmin e tyre, ne nuk duhet ta harrojmë ndihmesën që kanë dhënë dhe të fillojmë t'i shajmë apo diskreditojmë. Ky është Sunneti i të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) siç del qartë nga historia e Hatib Ibn Ebu Baltaas, i cili u dërgoi kurejshëve një mesazh ku u kërkonte atyre mbrojtje për fëmijët dhe të afërmit që kishte lënë në Mekke, në shkëmbim të informacionit për strategjinë dhe armatimin e muslimanëve, të cilët ishin përgatitur të çlironin Mekken. Kur mesazhi u kap dhe Hatibi e pranoi ç'kishte bërë, Umer Ibn El Hattabi (radijall-llahu anhu) u zemërua kaq shumë nga kjo tradhti sa që i kërkoi të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) që ta lejonte t'ia këpuste kokën Hatibit. Por, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) kundërshtoi duke thënë: “Ku mund ta dish, ndoshta All-llahu i ka parë (veprat) e njerëzve (që luftuan në betejën) e Bedrit dhe u ka thënë: “Bëni çka t'ju pëlqejë, sepse Unë ua kam falur (mëkatet e kaluara dhe të ardhshme)”. Përqafimi i Islamit nga Hatibi që në fillim dhe kurajoja dhe trimëria e treguar nga ai gjatë Betejës së Bedrit, e bënë të Dërguarin (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ta pranojë arsye-timin e Hatibit, duke iu kujtuar sahabëve (dhe të gjithë muslimanëve) statusin e posaçëm të atyre që luftuan në Bedër, betejën e parë midis muslimanëve dhe kuffarëve.

6. JETONI ME MASAT E GJERA

I këshilloj të rinjtë që të heqin dorë nga ëndrrat me sy hapur dhe idealizmi i tyre joreal. Ata duhet të zbresin në tokë dhe të identifikohen me masat që jetojnë gjysëm të uritura në rrethinat e për-

buzura të qyteteve të mëdha dhe në fshatra të varfëra, krejtësisht të harruara. Në këto vende ata do të gjejnë burimet e paprishura të virtytit, thjeshtësisë dhe pastërtisë, pavarësisht se janë të mbytur në varfëri. Atje mund të gjejnë fuqinë për ndryshimin shoqëror, mundësinë për përpjekje, luftë, lëvizje, ndihmë dhe rindërtim; atje mund të përzihen me masat dhe të tregojnë dhembshuri për nevojtarin, jetimin, zemërthyerin, të rraskapiturin dhe të shtypurin. Realizimi i këtyre objektivave të cilat në vetvete përbëjnë ibadet, kërkon përpjekje të përbashkëta, formim komitetesh kushtuar zhdukjes së analfabetizmit, sëmundjeve, papunësisë, mungesës së iniciativës dhe zakoneve të këqija si psh. dhënies pas duhanit, alkoolit dhe drogës; ai kërkon luftë kundër korrupsionit, devijimit, shtypjes, ryshfetit dhe praktikave të tjera. Lufta për të lehtësuar vuajtjet e të varfërit dhe për t'i dhënë atij udhëzimin e duhur, është me të vërtetë një formë ibadeti, rëndësinë e të cilit shumë muslimanë nuk e kuptojnë, megjithëse mësimet islame jo vetëm e inkurajojnë përhapjen e veprave të mirëbërës, por i lavdërojnë ato si detyra individuale dhe kolektive.

Veprat e mirëbërësisë që bëhen për rritjen e mirëqenies së bashkësisë, janë format më të mira të ibadetit dhe konsiderohen si degë të imanit, për aq kohë sa ata që i bëjnë nuk kërkojnë lavdërim dhe popullaritet, por vetëm kënaqësinë e All-llahut (xh.sh.). Le t'i kujtojmë njëri-tjetrit ato hadithe, nga të cilat mësojmë se disa veprime, duke filluar që nga urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja dhe e papëlqyera deri në heqjen e pengesave nga rruga, të gjitha këto janë vepra bamirësie. Ebu Hurejre transmeton këtë hadith:

“Për çdo gjymtyrë të njeriut shkruhet sadaka çdo ditë që lind dielli. Gjykimi me drejtësi midis dy vetave është sadaka; të ndihmosh një njeri t'i hipë kafshës së tij (gomarit, kalit, deve të etj.) apo t'i

ndihmsh të ngarkojë mbi të barrën është sadaka; një fjalë e mirë është sadaka; çdo hap që hedh për të shkuar në namaz është sadaka; heqja e pengesave nga rruga është sadaka”.¹²²

Ibni Abbasi transmeton një hadith tjetër rreth temës së njëjtë:

“Për çdo gjymtyrë të njeriut shkruhet namaz çdo ditë”. Njeri nga të pranishmit tha: “Kjo është gjëja më e vështirë që na ke kërkuar”. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha: “Urdhërimi yt për të mirën dhe ndalimi nga e keqja është namaz; ndihma që i jep të dobëtut është namaz; heqja e ndonjë ndytësire nga rruga është namaz dhe çdo hap që hedh për të shkuar në namazet (e përditshme) është namaz”.¹²³

Burejde (radijall-llahu anhu) transmeton se i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë:

“Çdo njeri ka treqind e gjashtëdhjetë nyje. Ai duhet të japë sadaka për secilën prej tyre”. Ata (sahabët) thanë: “Kush ka mundësi të veprojë kështu, o i Dërguar i All-llahut?” duke kujtuar se fjala ishte për sadaka në para (ose mall). Atëherë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha: “Të hedhësh dhë mbi ndonjë gëlbasë në xhami është sadaka; heqja e një pengese nga rruga është sadaka...”.¹²⁴

Ka shumë hadithe që rendisin mirësinë ndaj muslimanëve të tjerë, ndihmën për të verbrin, shurdhin dhe të dobët, kështillimin e atyre që e kanë humbur dhe janë hutuar, lehtësimin e mjerimit të nevojtarit etj., si forma të ibadetit dhe sadakasë. Kështu një musliman e jeton jetën si një burim

¹²² Me pajtim nga të gjitha autoritetet

¹²³ Transmeton Ibn Huzejme në Sahihun e tij

¹²⁴ Transmetojnë Ahmedi, Ebu Davudi, Ibn Huzejme dhe Ibn Hibbani

vital i veprave të virtytshme, duke bërë të mira ose urdhëruar të tjerët për kryerjen e tyre, gjithnjë duke luftuar kundër depërtimit të së keqes. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ka thënë: “I bekuar qoftë ai, të cilin All-llahu e ka bërë çelës për të mirën dhe dry kundër së keqes”.¹²⁵

Megjithatë, disa idealistë entuziastë mund të debatojnë se aktivitetet e tilla shoqërore do ta pengojnë përhapjen e Islamit dhe përpjekjet për t'i bërë njerëzit ta kuptojnë atë. Ata besojnë se edukimi islam është më i domosdoshëm se këto punë shoqërore. Përgjigjja ime është se angazhimi shoqëror është në vetvete një da've praktike, e cila arrin deri tek njerëzit në mjedisin e tyre. Thirrja e njerëzve në Islam nuk është thjesht bisedë; da'veja është pjesëmarrje në hallet e të tjerëve dhe kërkim i një ilaçi për zgjidhjen e problemeve të tyre. Imam Hasan El Benna e kishte kuptuar mirë këtë, ndaj ngriti një institucion bamirësie për shërbimet shoqërore dhe ndihmën financiare në çdo degë të “Vëllezërve Muslimanë” të cilin e themeloi në Egjipt për Thirrjen islame. Ai ishte i ndërgjegjshëm se muslimani është i urdhëruar për të bërë vepra bamirësie ashtu siç është urdhëruar për t'u përkulur dhe bërë sexhde. Kur'ani thotë:

“O ju që besuat, falni namazin me ruku e sexhde dhe vetëm Zotin tuaj adhuron. Bëni punë të mira se do të gjeni shpëtim. Luftoni me një luftë të denjë për hir të All-llahut, se Ai ju zgjodhi ju dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi.”

(22:77-78)

Ajeti i mësipërm përcakton tri pjesët e rolit të muslimanit në këtë jetë: raporti i tij me All-llahun (xh.sh.), i cili përfaqësohet nga ibadeti; roli i tij në shoqëri, të cilin duhet ta forcojë përmes

¹²⁵ Transmeton Ibn Maxhe

veprave të bamirësisë; raporti i tij me fuqitë e errësirës dhe së keqes, kundër të cilave ai duhet të kryejë xhihad. Por, idealistët entuziastë mund të debatojnë se përpjekjet duhet të përqëndrohen tek ngritja e një shteti islam, i cili zbaton Sheriatin në të gjitha fushat e jetës, brenda shtetit dhe punon për Thirrjen në Islam jashtë kufijve të tij. Realizimi i këtij qëllimi, thonë ata, automatikisht do t'i zgjidhë të gjitha problemet e mësipërme. Ngritja e një shteti islam, i cili zbaton Sheriatin dhe lufton për bashkimin e të gjithë muslimanëve nën flamurin e Islamit, natyrisht është detyra e krejt Ummetit. Të gjithë thirrësit islamë duhet të bëjnë ç'është e mundur për të arritur këtë objektiv, duke përdorur mjetet dhe metodat më të mira. Por realizimi i kësaj gjëje kushtëzohet nga një numër imperativash, disa nga më të rëndësishmit e të cilëve janë: bashkimi i të gjitha përpjekjeve, heqja e të gjitha pengesave, bindja e atyre që dyshojnë në qëllimin fisnik të kësaj kauze, edukimi i të rinjve me orientim islam dhe përgatitja e opinionit publik lokal si dhe atij ndërkombëtar, për ta pranuar ideologjinë dhe shtetin e tyre. E gjithë kjo kërkon kohë dhe këmbëngulje. Derisa kjo shpresë të realizohet, muslimanët duhet t'i bashkojnë përpjekjet me qëllim që t'u shërbejnë komuniteteve të tyre dhe të përmirësojnë shoqëritë e tyre. Ndërmarrje të tilla do të shkrijnë, përgatisin dhe provojnë aftësitë e brezave të ardhshëm për udhëheqjen e Ummetit.

Është e papranueshme për një musliman i cili mundet, nëse dëshiron, t'i ofrojë kurim mjekësor një pacienti në një klinikë publike apo spital bamirësie, ta kundërshtojë një gjë të tillë, sepse po pret që të ngrihet një shtet islam i cili do të ofrojë shërbime të tilla. Gjithashtu nuk i ka hije një muslimani, i cili mund të organizojë shërbimet për ndarjen e zekatit, të qëndrojë indiferent ndaj mjerimit dhe vuajtjeve të të varfërit, jetimit, plakut dhe vejushës, vetëm sepse shpreson se shteti i ardhshëm islam do t'i ndihmojë ata nëpërmjet një sistemi të plotë të mirëqenies shoqërore. Nuk i ka hije një muslimani të tregohet indiferent ndaj grindjeve tragjike dhe të pakuptimta midis

muslimanëve të tjerë, duke thënë se me këto çështje do të merret shteti i ardhshëm islam, i cili do t'i pajtojë njerëzit dhe do të luftojë agresorin.

Përkundrazi, detyrë e muslimanit është të luftojë të keqen dhe të punojë për të mirë me të gjitha mundësitë e tij, pavarësisht se sa e vogël mund të jetë kjo gjë. All-llahu (xh.sh.) thotë në Kur'an:

“Andaj, sa të keni mundësi ruajuni prej dënimit të All-llahut.”

(64:16)

Shembulli i mëposhtëm mund të ndihmojë për të ilustruar konceptin tim mbi shtetin e dëshiruar islam. Një kopshti me ullinj dhe palma i duhet një kohë relativisht e gjatë të japë frute. Atëherë, a është logjike, apo bile edhe praktike, që pronari i tij të mos zërë punë me dorë, por vetëm të presë të vjelat e ullinjve dhe hurmave? Natyrisht që jo. Ai duhet të mbjellë bimë të tjera që japin prodhime më shpejt si psh. perime, për të pjellorizuar tokën dhe për të nxjerrë ushqimin, duke u kujdesur në të njëjtën kohë për ullinjtë dhe palmat, të cilat do të japin prodhimin e tyre të parashikuar dhe të dëshiruar.

7. DËSHIRONI TË MIRËN MUSLIMANËVE

Këshilla e fundit atërore për të rinjtë muslimanë është të çlirohen nga prangat e pesimizmit dhe dëshpërimit. Megjithatë, ky optimizëm kërkon një njohje të vetëdijshme të disa kushteve të rëndësishme:

Së pari: Njerëzit nuk janë engjëj. Ata nuk janë krijuar nga drita, por nga balta. Ata, si edhe babai i tyre Ademi, nuk janë të pagabueshëm. Ne mësojmë nga Kur'ani:

“Ne i patëm urdhëruar edhe Ademit, po ai harroi, pra te ai nuk gjetëm vendosmëri.”

(20:115)

Njohja e gabueshmërisë sonë njerëzore dhe prirjes për tundim do të na mundësojë jo vetëm të tolerojmë dhe të ushqejmë në zemër një kuptim dashamirës të gabimeve dhe të metave të tjerëve, por edhe do të na nxisë t’iu rikujtojmë atyre të kenë besim dhe shpresë tek mëshira e All-lahut, dhe t’i paralajmërojmë ata për zemërimin dhe ndëshkimin e All-lahut. All-lahu (xh.sh.) i drejtohet të Dërguarit të Tij, Muhammedit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem):

“Thuaj: O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën nga mëshira e All-lahut, pse vërtet, All-lahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që shumë fal dhe është mëshirues.”

(39:53)

Përemri pronor tek *“robërit e Mi”* tregon dashurinë, kujdesin dhe dashamirësinë e All-lahut ndaj qenieve njerëzore, për të cilat Ai ka ruajtur mëshirë dhe falje të madhe për të gjitha mëkatet, sado të mëdha qofshin ato.

Së dyti: është e domosdoshme të kuptojmë se askush përveç All-lahut (xh.sh.) nuk e di se çfarë ndodh në thellësitë më të fshehta të shpirtit njerëzor. Ndaj jemi të obliguar t’i gjykojmë njerëzit në bazë të asaj që shfaqin. Psh. nëse një person deklaron se “nuk ka zot përveç All-lahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij”, ne duhet ta trajtojmë atë si musliman. Kjo gjë është në përputhje me Sunnetin e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Ai ka thënë:

“Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut, të falin namazin dhe të japin zekatin. Kur ta bëjnë këtë, do të fitojnë nga unë sigurinë për jetën dhe pasurinë e tyre, nëse janë në pajtim me Islamin, dhe llogarinë e tyre do ta japin para All-llahut të Madhëruar”.

Kjo është edhe arsyeja pse ai nuk i ndëshkoi munafikët (hipokritët), megjithëse ai ishte i sigurt se ata po bënin komplot kundër tij. Kur sahabët i sugjeruan se ai duhet t’i vriste ata për të shmangur kërcënimin e tyre, ai iu përgjigj: “Kam frikë se njerëzit do të thonë se Muhammedi po vret shokët e tij”.

Së treti: Ne duhet të pranojmë se çdo person që beson tek All-llahu (xh.sh.) dhe i Dërguari i Tij nuk mund të jetë i privuar nga disa të mira të lindura, sado të këqija që të bëjë. Kryerja e mëkateve të mëdha nuk e heq imanin e personit, derisa ai me qëllim, të kundërshtojë All-llahun (xh.sh.) dhe të përqeshë urdhrat e tij. Në këtë rast dhe kudo gjetkë, ne duhet të ndjekim Sunnetin e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem), i cili i trajtonte keqbërësit ashtu siç e trajton mjeku pacientin e tij e jo siç e trajton polici kriminelin. Ai ishte shumë i butë me ta dhe ua vinte veshin problemeve të tyre. Rasti i mëposhtëm do ta ilustrojë këtë pikë, insha All-llah: Një djalosh kur-rejshit erdhi te i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) dhe kërkoi leje për të bërë zina (adulteri). Sahabët u zemëruan kaq shumë nga kërkesa e këtij të riu, saqë u hodhën ta ndëshkojnë, por qëndrimi i të Dërguarit qe krejtësisht i ndryshëm. Me qetësi dhe gjakftohtësi, ai i kërkoi të riut që të afrohej dhe e pyeti: “A do ta dëshiroje këtë për nënën tënde?” I riu u përgjigj: “Jo!”. I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i tha: “Edhe të tjerët nuk e duan këtë gjë për nënat e tyre”. Pastaj i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) e pyeti atë nëse do t’i pëlqente kjo gjë për motrën, bijën dhe tezen e tij? Çdo herë, ai përgjigjej: “Jo” dhe i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) shtonte

se “Edhe të tjerëve nuk u pëlqen kjo gjë për njerëzit e tyre”. Më pas duke e kapur për dore, tha: “O Zot, falja mëkatin, pastroja zemrën dhe përforcoje (kundër epsheve)”.¹²⁶ Pas kësaj, ky i ri nuk ia hodhi më sytë zinasë.

Qëndrimi dashamirës i të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tregon qartë një gjest vullneti të mirë, një bindje në atë mirësinë e lindur të njeriut e cila peshon më shumë se elementet e së keqes, të cilat janë të përkohshme. Me dhembshuri dhe durim ai e diskutoi çështjen me të derisa e bindi atë për dëmin e zinasë. Jo vetëm kaq, por ai iu lut All-llahut (xh.sh.) që ta falte dhe ta udhëzonte atë të ri. Ekstremistët mund të thonë se butësia në këtë rast ishte e kuptueshme, sepse i riu në fakt nuk kishte bërë zina.

Atëherë të marrim rastin tjetër: Një grua e martuar kishte bërë zina, kishte mbetur shtatzënë dhe ia rrëfeu mëkatin të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Me vendosmëri dhe insistim, ajo kërkoi që të gurëzohej (goditej me gurë) deri në vdekje për të shlyer mëkatin e saj. Kur Halid Ibnul Velidi e mallkoi atë, ndërsa ajo po gurëzohej, i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i tha: “Bëhu i njerëzishëm, o Halid! Betohem në Atë, në dorë të të Cilit është jeta ime, ajo ka bërë një pendim të tillë që sikur të ndahej në 70 shtëpi të banorëve të Medines do t’i mbulonte ato”.¹²⁷

Dikush mund të thotë se kjo grua kishte bërë mëkat, por më pas u pendua. Le të shikojmë rastin tjetër: Në kohën e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) ishte një pijanec, i cili ishte sjellë shumë herë para të Dërguarit dhe ishte ndëshkuar, megjithatë ai vazhdonte të pinte. Një ditë kur

¹²⁶ Transmetojnë Ahmedi dhe et-Taberaniu ashtu siç përmendet në Mexhmu'al Zevaid, 1:129

¹²⁷ Transmeton Muslimi dhe të tjerët

ai u soll përsëri me të njëjtën akuzë, një njeri nga të pranishmit tha: “All-llahu e mallkoftë! Sa herë është sjellë para të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për t’u ndëshkuar?” i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) tha: “Mos e mallko atë! Pasha All-llahun, unë e di se ai e do All-llahun dhe të Dërguarin e Tij”. Transmetohet gjithashtu se ka thënë: “Mos i ndihmoni Shejtanit kundër vëllait tuaj”.

I Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i ndaloi ata që ta mallkonin atë, sepse një veprim i tillë mund të krijonte përçarje dhe urrejtje midis tij dhe vëllezërve të tij muslimanë; mëkati i tij nuk duhet ta këpuste lidhjen e vëllazërisë midis tij dhe muslimanëve të tjerë. Shqyrtimi i thellë i rasteve të mësipërme tregon qartë aftësinë e të Dërguarit (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) për të depërtuar në elementet e mirësisë që gjenden tek njeriu. Më shumë se kurrë më parë, ne kemi nevojë të studiojmë dhe të ndjekim modelin shembullor që na ka lënë i Dërguari (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem). Ata ekstremistë, të cilët pa dallim akuzojnë për kufr apo shirk, cilindo që bën ndonjë gabim, duhet të kuptojnë se duhet ta ndryshojnë strategjinë e tyre dhe të mësojnë se shumica e rasteve të korrupsionit dhe çoroditjes që ata urrejnë, rrjedhin kryesisht nga mosnjohja e Islamit, shoqëria e keqe apo shkujdesja. Zgjidhja gjendet në ndihmën që u duhet dhënë njerëzve për t’i kapërcyer të gjitha këto probleme. Të jesh i ashpër, t’i akuzosh të tjerët për kufr dhe të gësh gabime në çdo gjë që ata bëjnë, ky qëndrim sjell vetëm largimin e tyre. Një i urtë ka thënë: “Në vend që të mallkosh errësirën, mundohu të ndezësh një qiri për të ndriçuar rrugën”.

Kjo është këshilla ime për të rinjtë muslimanë entuziastë dhe të singertë, të cilët i dua shumë. Qëllimi im gjendet në fjalët e Pejgamberit Shuajb (alejhis-selam) siç tregohet në Kur’an:

“Unë nuk dua tjetër vetëm se të përmirësoj aq sa mundem, por këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e All-llahut, vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm tek Ai jam i drejtuar.”

(11:88)

Falënderimi i përket vetëm All-llahut (xh.sh.) me ndihmën e të Cilit u përfundua përkthimi i kësaj vepre. Paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi të Dërguarin e Tij, mëshirë për të gjithë njerëzimin, Muhammedin, familjen, shokët e tij dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Kijametit. AMIN.

Rijad 12/3/1996